

Council of Europe
European Commission



Conseil de l'Europe
Commission européenne

Projekti Rajonal CARPO

Shqip

Raporti mbi Gjendjen e Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Evropën Juglindore

Strasbourg, gusht 2006

Projekti CARPO ("Zhvillimi i sistemeve policore të besueshme dhe funksionale si dhe nxitja e luftës kundër aktiviteteve kryesore kriminale dhe i bashkëpunimit policor") është një projekt teknik i përbashkët dhe i bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian. Ai ka një kohëzgjatje prej 30 muajsh (mars 2004-shtator 2006). Këshilli I Evropës është përgjegjës për zbatimin e projektit, në partneritet me Belgjikën, Finlandën, Hungarinë, Italinë, Slloveninë, Spanjën, Suedinë dhe Organizatën Ndërkombëtar për Migracionin.

Për çdo informacion shtesë, ju lutem, kontaktoni:

Departamenti i Problemeve të Krimit

Drejtoria e Përgjithshme 1- Marrëdhëniet

Juridike

67075 Strasbourg CEDEX, Francë

Tel +33-3-9021-4506

E-mail: jean-charles.decordes@coe.int

Website: www.coe.int/economiccrime

Ref. n° : PC-TC(2006)9

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të interpretohen në asnjë mënyrë se përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian, ose të Këshillit të Evropës.

Pasqyra e lendes

1	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2	KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMI EKONOMIK NE EVROPEN JUGLINDORE: KUADRI.....	9
2.1	PRAPAVIJA DHE QËLLIMI I RAPORTIT	9
2.2	KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR.....	11
2.3	AMBJENTI QEVERITAR DHE EKONOMIK.....	13
2.4	KRIMI I ORGANIZUAR DHE TIPARET E TIJ TE SPIKATURA.....	14
3	AKTIVITETET KRIMINALE.....	21
3.1	TRAFIKIMI I DROGËS	21
3.1.1	<i>Stimuluesit e llojit të amfetaminës (ATS).....</i>	23
3.1.2	<i>Metamfetamina.....</i>	24
3.1.3	<i>Produktet e Kanabisit (hashashi, marihuana, vaji i hashashit).....</i>	26
3.1.4	<i>Kultivimi i luleve të opiumit dhe prodhimi i heroinës.....</i>	28
3.1.5	<i>Kokaina.....</i>	30
3.1.6	<i>Drogat dhe krimi.....</i>	31
3.1.7	<i>Drogat dhe SIDA.....</i>	32
3.2	TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE.....	35
3.3	KONTRABANDA E PERSONAVE.....	45
3.4	KRIMI EKONOMIK	50
3.5	PASTRIMI I PARAVE.....	61
3.6	KORRUPSIONI.....	65
4	PROFILET E ZONAVE TË PROJEKTIT	69
4.1	SHQIPERIA.....	69
4.2	BOSNJA DHE HERCEGOVINA	80
4.3	KROACIA.....	85
4.4	MALI I ZI	92
4.5	SERBIA	97
4.6	KOSOVA.....	104
4.7	“ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISE”	112
5	KONKLUZIONE.....	119
6	BIBLIOGRAFIA	122
7	SHKURTIMET DHE AKRONIMET	127

1 PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti I pare për gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore u përgatit verën e vitit 2005, në kuadër të projektit CARPO, një projekt rajonal për policinë I bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian.¹ Përmbajtja e raportit të pare për gjendjen e krimit u prezantua para Ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë së Evropës Juglindore në takimin e tyre të Nivelit të Lartë, të mbajtur në shtator të vitit 2005, në Brijuni, Kroaci.

Ky raport për gjendjen e krimit, përfaqëson një variant të përmirësuar dhe të azhornuar në mënyrë thelbësore të raportit të vitit të shkuar. Ai është rezultati përfundimtar i angazhimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me përfaqësues të institucioneve të ndryshme (Policia, njësitë e Inteligjencës, ose Informacionit Financiar, administratës tatimore dhe doganore, prokurorëve të specializuar dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit) nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova² Mali I Zi, Serbia dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” (që këtej e tutje do të quhen “zona të projektit!”). Raporti mbështetet në informacionet dhe vlerësimet e dhëna nëpërmjet dy pyetësorëve (2004 dhe 2006) në vlerësimet shitesë, të bëra nga zyrtarët e sipërpërmendur, por edhe në një game të gjerë raportesh të fundit qeveritarë si dhe nga burime të tjera publike.

Krimi i organizuar dhe krimi ekonomik lidhen që të dy ngushtë me motivin e përfitimit dhe prodhojnë sasi të mëdha përfitimesh të paligjshme. Këta dy forma të krimit e kërcënojnë seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, si dhe të drejtat e njeriut, por edhe sigurinë e shtetit dhe zhvillimin ekonomik në Evropën Juglindore dhe më gjerë.

Në të shkuarën e afërt, Evropa Juglindore, pavarësisht përpjekjeve të shumta në këtë fushë dhe një numri rezultatesh premtuese, është prekur më tepër nga krimi i organizuar dhe krimi ekonomik se sa pjesët e tjera të kontinentit evropian.

Parandalimi dhe dënimi i krimit të organizuar dhe krimit ekonomik mbështeten gjerësisht në një njohje të thellë të këtyre fenomeneve ndërkuftare, në një vullnet politik të qartë dhe të vendosur, politika kombëtare dhe strategji kundër krimit, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare sikurse dhe në zbatimin e përpiktë të tyre. Pa një njohje të thellë të dimensioneve ndërkuftare të krimit dhe të rrjeteve të tij, qeveritë do të dështojnë në mënyrë të pashmangshme, në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Këshilli i Evropës ka qenë për një kohë të gjatë i shqetësuar për efektet afat-gjata të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, sidomos në Evropën Juglindore. Këto shqetësime si dhe perspektiva e pranimit të vendeve pjesëmarrëse në këtë projekt në Bashkimin Evropian (BE) diktojnë nevojën e një analize sistematike dhe të argumentuar të shtrirjes, natyrës dhe karakteristikave të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon. Prandaj, qëllimet e këtij raporti janë:

- Të azhurnojë raportin për gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore të vitit 2005, duke u përqendruar në çështjet thelbësore për rajonin;
- Të nxjerrë në pah zhvillimet e reja, kërcënimet, mangësitë analitike, si dhe çështje të tjera që lidhen me krimin që janë shqetësuese për rajonin e Evropës Juglindore;
- Të ndihmojë politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon që të marrin vendime dhe masa kundër krimit, nga pozita më të informuara;
- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në strategjitë kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Globalisht, krimi i organizuar dhe krimi ekonomik është një koncept dinamik që i përshtatet vazhdimisht një ambjenti në ndryshim të përhershëm. Është gjithnjë e më shumë shumë-kombësh, i strukturuar në mënyrë

¹ Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funkcionuese të Policive dhe Nxitja e Luftës kundër Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe i Bashkëpunimit Policor.

² Aktualisht nën administrimin e përkohshëm të UNMIK-ut në përputhje me rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

heterogjene dhe tepër fleksibël. Kjo është e vërtetë edhe për krimin e organizuar në Evropën Juglindore, i cili përbëhet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh kriminale, të tilla si drogat e paligjshme, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda e personave dhe krimet ekonomike:

- Rruga tradicionale ballkanike e trafikut të drogës është shndërruar në një rrugë dykahëshe, duke e rritur vëllimin e trafikut. Kryesisht, heroina dhe kanabis lëvizin në kahjen drejt Bashkimit Evropian që është dhe tregu kryesor i konsumimit të drogave të paligjshme, ndërkohë që prekursorët kimikë dhe drogat sintetike janë duke lëvizur në kahjen drejt lindjes, gjithnjë e më shumë në formën e trafikimit të shumë-drogave ('ngarkesë koktejl'). Grupet turke dhe shqiptare të krimit të organizuar dominojnë në këtë fushë të krimit, por të gjitha grupet e krimit të organizuar e kanë rritur bashkëpunimin ndërmjet tyre. Grupet etnike shqiptare të krimit të organizuar janë duke u afruar gjithnjë e më shumë kontrollimit të tregjeve evropiane të kokainës. Megjithatë, kapjet e drogave dhe të prekursorëve kimikë edhe pse në rritje, janë ende në nivele të mesme. Në disa zona të këtij projekti, tregjet e brendshme të drogave janë duke u rritur me shpejtësi, bashkë me numrin e përdoruesve të drogës, që gjithnjë e më tepër janë përdorues të shumëfishtë droge (poli-përdorues). Prandaj, duhen shtuar jo vetëm masat dënuese, por edhe masat parandaluese si dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi rrezikun e HIV/AIDS-it.
- Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzimin e tyre seksual është bërë më i fshehtë (klandestin) dhe më i sofistikuar. Ai shtron sfida të reja, në drejtim të trafikimit të brendshëm dhe rekrutimit lokal si dhe të klientelës vendase në rritje. Kjo sjell ndërlikime politke, pasi kërkon jo vetëm masa ndëshkuese, por edhe një parandalim më të mirë dhe politika publike që duhet të trajtojnë çështjet e shëndetit që shkaktohen nga tregu i brendshëm i seksit. Viktimat duket se po pësojnë një trajtim fizik më pak të dhunshëm, por po iu nënshtrohen më shumë presioneve psikologjike, sidomos kërcënimit për jetën e familjeve të tyre në vendin e origjinës, martesave të detyruara dhe kërkesave për azil për të garantuar qëndrim më të gjatë. Një shqetësim serioz përbën numri i fëmijëve të trafikuar (nën moshën 18 vjeç), që supozohet se do të rritet më tej në të ardhmen, meqenëse trafikantët dhe bashkëpunëtorët e tyre, pjesërisht të shqetësuar nga HIV dhe AIDS po zgjedhin viktimat gjithnjë e më të reja. Disa zona të projektit kanë raportuar trafikimin e fëmijëve për të lypur, ose për qëllime akoma më të fshehta, siç janë adoptimi i paligjshëm, ose trafiku i organeve.
- Migracioni i paligjshëm ka qenë në krye të axhendave kombëtare dhe ndërkombëtare për njëfarë kohe, ndërmjet të tjerash, për shkak të zgjerimit të fundit dhe të mëtejshëm të BE-së, lëvizjes së lire të njerëzve dhe aksesit në tregjet e punës, por edhe për shkak të kërkesave ekonomike, të diktuar nga rënia e popullsisë aktive nëpër vendet e BE-së. Përpjekjet e harmonizuara në fushën e ligjvënies dhe të zbatimit të ligjit kundër migracionit të paligjshëm, duket se kanë sjellë një ndryshim pozitiv, në uljen e numrit të personave të kontrabanduar, përgjatë kufijve. Sidoqoftë, ky ende mbetet një biznes shumë fitimprurës për grupet ndërkombëtare të krimit të organizuar, që mbart rreziqe relativisht të vogla dhe përfiton nga politikat e dobëta të kufirit të vendeve të Evropës Juglindore dhe nga fakti që sistemet e kontrollit të kufijve në BE-në e zgjeruar nuk po funksionojnë ende siç duhet. Kompleksiteti i lëvizjes së shumë njerëzve, përgjatë distancave të gjata, kërkon organizata kriminale shumëkombëshe dhe të sofistikuar. Sidoqoftë, lehtësuesit e këtij fenomeni që veprojnë përgjatë seksionit të Evropës Juglindore të itinerarit të trafikimit, janë shpesh shtetas të këtij rajoni.
- Krimi ekonomik i cili cënon seriozisht të gjitha zonat e projektit në rajon vazhdon të zhvillohet. Përfundimi i sanksioneve kundër Serbisë dhe si rrjedhojë ndërprerja e kanaleve të kontrabandës së cigareve dhe naftës si dhe përpjekje të tjera në fushën e miratimit dhe të zbatimit të ligjeve, e kanë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme mbledhjen e të ardhurave. Kështu, janë hequr disa mundësi të tregtisë së paligjshme në rajon. Megjithatë, mbeten mundësi të tjera, të tilla si kontrabanda në përmasa të mëdha e të gjitha llojeve të mallrave (cigareve dhe duhanit, armëve, eksplozivëve, alkolit, metaleve të çmuara, etj) shumëfishimi i parave të falsifikuara, falsifikimi i dokumenteve dhe krijimi i kompanive fiktive - instrumentet bazë për shmangien e taksave dhe për pastrimin e parave - duket se janë të kudondodhura në të gjitha zonat e projektit dhe vazhdojnë të çenojnë besimin e publikut në ekonominë e tregut dhe në sistemin e drejtësisë penale. Forma të tjera të krimit ekonomik, të tilla si prodhimi i mallrave pirate dhe krimi kibernetik, duket se janë neglizhuar dhe nuk janë trajtuar siç duhet në disa prej zonave të projektit.

- Edhe pse autoritetet e zonave të projektit e kanë pranuar ndikimin negativ që krimet e rënda kanë mbi ekonominë, shoqëritë dhe zhvillimet demokratike të këtyre vendeve, vlerësimi i humbjeve të të ardhurave publike, për shkak të krimit ekonomik, ose kostot që krijohen nga tregjet e brendshme të drogës janë ende të papërgatitura. Meqenëse të adhurat janë emëruesi i përbashkët i të gjitha formave të ndryshme të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, hetimet dhe inteligjenca financiare, sikurse dhe mundësia e kapjes dhe e konfiskimit të të ardhurave nga krimi, janë vendimtare në luftën kundër këtyre fenomeneve. Ashtu siç kërkohet nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, Task-Forca për Veprim Financiar e Kombeve të Bashkuara (UN) dhe siç mbështetet nga projekti CARPO, të gjitha zonat e projektit kanë krijuar Njësi të Inteligjencës Financiare (FIU) ose organizma të tjerë të ngjashëm, shkëmbejnë praktikatat e mira, kanë ndërmarrë programe trajnimi intensive dhe analiza krahasuese si dhe kanë nisur të kryejnë, në shkallë të kufizuar hetime financiare që lidhen me hetimet penale. Këto instrumente, megjithatë, duhen aplikuar në mënyrë më sistematike.
- Me maturimin e tregjeve kriminale, grupet kriminale gjithashtu përpiqen t'i konsolidojnë aktivitetet ekzistuese, të ndryshojnë llojin e aktivitetit kriminal dhe t'i ligjërojnë të ardhurat dhe pozitën e tyre në shoqëri. Korrupsioni si në nivel të ulët, ashtu edhe në nivel të lartë, mendohet se është një instrument themelor për influencimin dhe depërtimin tek strukturat politike dhe komerciale. Në të gjitha zonat e projektit, korrupsioni ende përbën shqetësim madhor. Fakti se të gjitha këto vende kanë miratuar korniza ligjore të modernizuara, kanë parashikuar strategji gjithpërfshirëse kundër korrupsionit dhe kanë krijuar shërbime për luftën kundër korrupsionit (shërbime antikorrupsion) është premtues, megjithatë, niveli konkret i zbatimit të tyre në praktikë si dhe angazhimi pa rezerva i autoriteteve të zbatimit të ligjit në këtë drejtim ende përbën shqetësim. Këto përpjekje mund të ndihmojnë për prerjen e lidhjeve të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik me strukturat publike dhe ligjore. Sidoqoftë, shifra të besueshme dhe të krahasueshme lidhur me shkallën e problemeve të korrupsionit janë të padisponueshme.
- Autoritetet e zbatimit të ligjit në Evropën Juglindore raportojnë se krimi i organizuar dhe krimi ekonomik janë të vështirë për t'u parandaluar dhe për t'u zbuluar. Grumbullimi i provave me qëllim dënimit të këtyre rasteve, është një proces kompleks, në veçanti, në rastin e krimeve ndërkombëtare. Kështu, në perspektivën e hyrjes së këtyre vendeve në BE, axhendat politike duhet ta trajtojnë me përparësi të veçantë parandalimin dhe dënimin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik si dhe përqasjen e standardeve dhe praktikave respektive me standardet e Kombeve të Bashkuara, Rekomandimet e Këshillit të Evropës, Direktivat e Bashkimit Evropian dhe Vendimet Kornizë të tij si dhe standarde të tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

Masat e zhvilluara nga zonat e projektit në kuadër të projektit CARPO, por edhe në kontekstin e bashkëpunimeve të tjera më BE-në, Paktin e Stabilitetit, Qendrën e SECI-t, Kombet e Bashkuara, apo mekanizmat monitorues të Këshillit të Evropës si GRECO dhe MONEYVAL, do të ndihmojnë në kapërcimin e këtyre të metave, nëpërmjet:

- Përmirësimi të mbledhjes dhe analizës së informacionit mbi krimin e organizuar dhe krimin ekonomik, me qëllim thellimin e njohurive dhe të kuptimit të këtyre fenomeneve në rajon;
- Përqasja e statistikave kombëtare për krimin dhe ngritja e tyre në nivelin e statistikave të përdorura në BE, përdorimit të koncepteve dhe përkufizimeve të përbashkëta, themelimit të një sistemi të përbashkët raportimi, në përputhje me sistemin e përdorur nga Europoli dhe nga 25 Shtetet Anëtare të BE-së (ENFOPOL 35) duke i kushtuar vëmendje të posaçme garantimit të konfidencialitetit në shkallën e duhur (duke përfshirë zbatimin e instrumenteve ligjore evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave dhe të jetës private), përgatitjes së rregullt të Raporteve vjetore mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik apo mbi Vlerësimin e Kërcënimit, miratimit të instrumenteve të përbashkëta për matjen e krimit, ndërmjet institucioneve dhe përmes juridiksioneve të ndryshme, studimit të pikave të ndjeshme të sektorëve ekonomikë dhe impaktit financiar të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik, bashkëpunimit ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit me akademitë dhe kërkuesit e pavarur.
- Mekanizmave të mbështetura nga shërbimet inteligjente për të projektuar politika të ngritura mbi vlerësime të gjithanshme dhe strategji apo plane-veprimi si dhe për të forcuar bashkëpunimin në rajon, mbi bazën e prioriteteve dhe të objektivave. Kjo mund të ndiqet nga formula: "Inteligjenca është informacioni i

përpunuar dhe i trajtuar për veprim nga organet e zbatimit të ligjit” dhe mund të zbatohet në mënyrë të ngjashme me konceptet “ekip i përbashkët hetimor” dhe “modeli i grupit shënjestër” të përpunuara nga Europol, që përfshijnë policinë, policinë kufitare, doganat dhe shërbime të tjera të specializuara të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi i ngushtë duhet gjithashtu të kërkohet me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera, duke shfrytëzuar në mënyrë të veçantë Ambasadat (Atashetë Policorë dhe Ekspertët), Europolin (rrjetin e Oficerëve të Ndërlidhjes së BE-se), Frontex-in (që është në zhvillim e sipër), Interpolin (NCB), Qendrën SECI (zyrat kombëtare) dhe, atëherë kur ligjërisht është e mundur dhe e përshtatshme, Eurojust-in ose OLAF-in;

- Forcimit të zotësive për hetim në fushën e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik. Kjo nënkupton përpjekje domethënëse për kapërcimin e barrierave gjuhësore nëpërmjet trajnimit të zyrtarëve të zbatimit të ligjit, në fushën e gjuhëve të huaja. Vënia në përdorim e teknikave të posaçme hetimore, aksioneve të maskuara, inteligjencës njerëzore, sistemeve të monitorimit të prekursorëve kimikë, makinave të tabulateve, mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve, inteligjencës financiare, sekuestrimit të të ardhurave të paligjshme nga krimi, ose metoda të tjera pune, p.sh. Operacionet e Impaktit të Madh (High-Impact Operations – HIO), metodat e angazhimit të shumë sektorëve në fusha me rendësi parësore, (SWAP), Procedurat e Operacioneve Standarde, (SOP);
- Monitorimi i efektivitetit të masave për parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik mbi baza sistematike. Kjo do të thoshte jo vetëm vlerësimin përfundimtar të Programit CARDS që do të përfshinte Projektin CARPO dhe projekte të tjera, që janë duke u zbatuar.³ Në të ardhmen, do të ishte diçka e mençur të bëheshin, atje ku kjo është e mundur, analiza të shpenzimeve/përfitimeve si dhe të realizohej një studim rreth forumeve rajonale dhe projekteve që janë duke funksionuar mirë, sipas gjykimit të partnerëve në rajon, dhe atyre që nuk po funksionojnë mirë. Mundësitë janë krijuar, por ato duhet të eksploroohen edhe më shumë, që të kthehen në realitet. Krijimi i komiteteve rajonale ose kombëtare të përbëra nga përfaqësues të organizmave kryesore ndërkombëtare të asistencës dhe nga partnerët lokalë do ta shtonte sinkronizimin e nismave dhe do të kursente shpenzimet;
- Ratifikimi dhe zbatimi në tërësi i instrumenteve evropiane do t'i ndihmojë përfundimisht zonat e projektit që të arrijnë progresin në këtë drejtim dhe të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar. Kjo do të përfshinte në mënyrë të veçantë Protokollin e dytë Shtojcë të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (CETS 182), Konventën për Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit (CETS 198) dhe Konventën për Veprim kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore (CETS 197), sikurse dhe miratimi dhe zbatimi i standardeve dhe rregulloreve të BE-se.⁴

Ky raport është një hap i mëtejshëm në një detyrë afat-gjatë; ai duhet kryer për çdo vit dhe duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me proceset e Europolit, në përpilimin e Raportit të BE-së për Gjendjen e Krimit të Organizuar. Ai ka nevojë për komente, identifikimin e informacionit që duhet rifreskuar, për konfirmimin ose tërheqjen e vlerësimeve të bëra në të, sikurse dhe për t'iu dhënë përgjigje më të gjera, pyetësorëve në të ardhmen.

Shpresohet se ky raport do të përbëjë një udhërrëfyes për politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon për të projektuar politika publike kundër krimit, nga pozita më të informuara, si dhe të ndërmarrin në përputhje me këto politika, veprime të ndërthurrura në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore.

³ P.sh: MOLI-MK, PACO-Serbia ose PACO-Impact.

⁴ Deri më sot, me përjashtim të Shqipërisë, e cila e nënshkruar dhe ratifikuar ETS 182, asnjë prej zonave të Projektit nuk e ka ratifikuar ende CETS 182, CETS 197 dhe CETS 198

2 KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMI EKONOMIK NE EVROPEN JUGLINDORE: KUADRI

2.1 PRAPAVIJA DHE QËLLIMI I RAPORTIT

Krimi i organizuar dhe krimi ekonomik kanë qenë në axhendën e Këshillit të Evropës për të paktën dy dhjetëvjeçarë⁵ dhe janë rikonfirmuar si shqetësime kryesore në Takimin e Tretë të Nivelit të Lartë, të Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive, në maj të vitit 2005.⁶ Po ashtu, këto çështje janë trajtuar me përparësi në axhendën e BE-së, që është dëshmuar me krijimin e Eurpolit, Eurojust-it dhe Frontex-it dhe akoma më shumë me futjen e dhjetë shteteve të reja në BE, në vitin 2004, më përgatitjen e terrenit për futjen (para-hyrjen) në BE të Rumanisë dhe Bullgarisë si dhe me fillimin e negociatave me Kroacinë dhe me “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”.

Në Evropën Juglindore, pavarësisht disa tipareve të dallueshme, mendohet se krimi i organizuar dhe krimi ekonomik nuk kanë arritur të njëjtat përpjestime kritike në të gjitha zonat e projektit. Pranohet përgjithësisht se krimi i organizuar dhe krimi ekonomik në Evropën Juglindore kërcënojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, stabilitetin dhe progresin ekonomik dhe shoqëror në këtë rajon. Natyra komplekse dhe në ndryshim të përhershëm e krimeve të rënda shtron kërcënime të reja për këto shoqëri në tranzicion dhe ka impakt edhe përtej kufijve të Evropës Juglindore. Analiza e krimit në rrafshin mbarë evropian demonstroi se zgjerimi i kohëve të fundit i BE-se dhe krijimi i BE-se me 25 shtete si dhe vazhdimi i këtij procesi drejt Evropës Juglindore nuk ka shkaktuar një ndryshim të plotë të panoramës së krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik, por përkundrazi ka krijuar tregje dhe sfida të reja për grupet e krimit të organizuar dhe ka thjeshtuar trafikun e paligjshëm të qenieve njerëzore dhe të të gjitha mallrave të tjera.

Shkëmbimi i informacionit në shkallë të gjerë ndërmjet autoriteteve evropiane të zbatimit të ligjit, analiza e përmirësuar e informacionit kriminal si dhe një bashkëpunim më i ngushtë ndërkombëtar kanë ngritur shqetësime të mëdha lidhur me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik në Evropën Juglindore. Kjo si dhe perspektiva e pranimit të këtyre vendeve në BE, diktojnë nevojën e një analize sistematike dhe thelbësore të shtrirjes, natyrës dhe karakteristikave të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon, si dhe rrjetet e tij ndërkombëtare.

Sidoqoftë, pavarësisht përmirësimeve të legjislativave kombëtare në këtë fushë, rezultojnë se njohja e asaj çka përbën krimin e organizuar dhe krimin ekonomik dhe në veçanti njohja e ndërlikimeve ndërkufitare dhe ndërkombëtare është ende e kufizuar. Si kundërpërgjigje, Këshilli i Evropës skicoi projektin CARPO (“Zhvillimi i Sistemeve Policore të Besueshme dhe Funksionale dhe Nxitja e Luftës kundër Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe i Bashkëpunimit Policor”) për të fuqizuar kapacitetet e policive kundër krimeve të rënda në Evropën Juglindore.⁷ Një prej rezultateve të pritshme të këtij projekti është të thellojë njohjen për krimin e organizuar dhe krimin ekonomik si dhe kërcënimet që lindin prej tyre.

Kështu, qëllimi i këtij raporti që pasqyron gjendjen e krimit dhe që është hartuar në kuadër të Projektit CARPO, është:

- Të azhurnojë raportin për gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore të vitit 2005, duke u përqendruar në çështjet thelbësore për rajonin;
- Të nxjerrë në pah zhvillimet e reja, kërcënimet, mangësitë analitike, si dhe çështje të tjera që lidhen me krimin që janë shqetësuese për rajonin e Evropës Juglindore;
- Të ndihmojë politikë-bërësit në Evropë dhe në rajon që të marrin vendime dhe masa kundër krimit, nga pozita më të informuara;

⁵ Shih për shembull Rekomandimin e Këshillit të Evropës, Nr. R (86) 8 mbi politikën kundër krimit në Evropë në një kohë ndryshimesh.

⁶ Deklarata e Varshavës, 17 maj 2005.

⁷ Ky projekt është një financim i përbashkët i Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, ai ka një kohëzgjatje prej 30 muajsh (mars 2004-gusht 2006). Për më shumë informacion shih: <http://www.coe.int/cards-police>

- Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në strategjitë kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Raporti i vitit 2005⁸ ishte rezultati përfundimtar i mbështetur në punën e kryer nga grupet e punës, të përbërë nga anëtarë të agjencive kompetente të zbatimit të ligjit (kryesisht policia) nga shtatë zonat e projektit. Përveç përfaqësuesve të njësisë të specializuara policore, të cilët mbizotëruan në përbërjen përfundimtare të grupeve të punës, ato përfshinë gjithashtu edhe agjenci të tjera të zbatimit të ligjit, të tilla si Njësitë e Inteligjencës Financiare, (kundër pastrimit të parave), administratat e tatimeve dhe të doganave (në lidhje sidomos me krimin ekonomik dhe humbjen e të ardhurave publike), prokurorë të specializuar dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (të ardhurat publike dhe tenderat publikë).

Sikurse dhe në rastin e përgatitjes së raporteve vjetore të Këshillit të Evropës mbi krimin e organizuar në Evropë⁹, një pyetësor iu dërgua grupeve të punës në të gjitha zonat e projektit, në pranverë të vitit 2004. Një seri aktivitete u ndërmorën për anëtarët e grupeve të punës, me synim trajnimin e tyre në gjerësi lidhur me analizën strategjike të krimit dhe mbi kriteret ligjore, institucionale dhe praktike në mbledhjen, analizën dhe menaxhimin e të dhënave mbi krimin. Me qëllim finalizimin e “Raportit për Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore”, të vitit 2005, u organizuan workshope në të gjitha zonat e projektit, tre seminare rajonale u organizuan në periudhën shtator 2004 dhe qershor 2006, sikurse dhe tre vizita studimore (Mbretëria e Bashkuar – Shërbimi Kombëtar Inteligent për Krimin, Policia spanjolle – Njësia Qendrore e Inteligjencës për Krimin, Europoli – Departamenti për Krimet e Rënda).

Burimet kryesore për raportin e gjendjes së krimit, të vitit 2006¹⁰ kanë qenë përgjigjet që iu dhanë pyetësorit të dytë (më të zgjeruar) që iu dërgua në prill të vitit 2006, të gjithë partnerëve të CARPOs në çdonjërin nga zonat e projektit, komentet mbi profilet e para të vendeve të projektit por edhe raportet publike të gjendjes së krimit, kërkime dhe raporte e informacione të tjera, të përgatitura nga Këshilli i Evropës, Europol-i, Eurojust-i, EMCDDA, Fronetx, IOM, OLAF, OSCE, Qendra SECI, Pakti i Stabilitetit, Transparency International, UNDOC, Departamenti i Shtetit i ShBA-ve, por edhe një numër raportesh nga universitete, institucione kërkimore të shumta, që fokusohen tek rajoni, kërkimet në Internet si dhe media.

Raporti i vitit 2006 “Për Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore” plotëson me të dhëna të freksëta dhe përmirëson analizën e shtrirjes, natyrës, karakteristikave të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon:

- Kapitulli i parë trajton gjetjet themelore dhe rekomandimet në formën e një përmbledhjeje ekzekutive;
- Kapitulli i dytë ofron një vështrim të përgjithshëm të kuadrit në të cilin ky raport u përpunua, sfondin dhe qëllimin e hartimit të tij, konceptin e përgjithshëm të krimit të organizuar dhe një përshkrim të shkurtër të krimit të organizuar dhe të tipareve të tij më të sipkatura;
- Kapitulli i tretë analizon një numër zonash, të cilat gjykohet të jenë tregje të rëndësishme kriminale për zonat e rajonit, pjesëmarrëse në këtë projekt – trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda në persona, krimi ekonomik, kontrabanda e mallrave të ligjshme, pastrimi i parave – si dhe ndërmerr sprovën e identifikimit të grupeve të krimit të organizuar, strukturës dhe modus operandi të tyre, por edhe prirjet (për aq sa të dhënat e disponuara e lejojnë një analizë të tillë);
- Kapitulli i katërt (“Profilet e zonave të Projektit”) provon të përshkruajë dhe të vlerësojë kërcënimet më të rëndësishme në dimension rajonal, dhe në dimensionin e secilës zone të projektit, pavarësisht vështirësive në zotërimin e mjeteve për matjen dhe krahasimin e seriozitetit të secilit kërcënim;
- Kapitulli i pestë dhe i fundit e mbyll raportin dhe jep disa rekomandime që mund të jenë me vlerë, për intensifikimin e përpjekjeve në luftë kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

⁸ Raporti i vitit 2005 u përpunua nga Zj. Kristina Hemon (këshilltare, Mbretëria e Bashkuar).

⁹ Shih: www.coe.int/economiccrime

¹⁰ Raporti I vitit 2006 u përpunua nga Z. Uwe Kranz (këshilltar, Gjermani).

Krimi i organizuar dhe krimi ekonomik janë duke u rritur, duke e pasuruar sferën e aktivitetit të tyre me lloje të reja krimesh dhe me kufij të rinj, duke shfrytëzuar bizneset e ligjshme për të ligjësuar aktivitetet e tyre kriminale dhe duke përdorur teknologji të lartë, sidomos për të izoluar dhe për të koduar komunikimet e tyre. Krimi i organizuar dhe forma të tjera të krimit ekonomik dhe të krimeve të rënda ka shumë mundësi të mbeten prioritet i shoqërive evropiane dhe aq më tepër i vendeve në tranzicion, siç janë vendet e Evropës Juglindore.

Ky raport do të shërbejë si një bazë për njohjen e përbashkët të fenomenit të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në Evropën Juglindore si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet zonave të projektit, njëzet e pesë shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera.

2.2 KONCEPTI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

Koncepti më i vjetër shumë-kombësh i krimit të organizuar (1998) i përkufizuar në mënyrë zyrtare në një dokument që ka fuqinë e të drejtës ndërkombëtare është përkufizimi i organizatës kriminale në Veprimin e Përbashkët të miratuar në nivelin e BE-së¹¹

“Organizata kriminale nënkupton një shoqatë të strukturuar, të krijuar për një periudhë të dhënë kohore, me pjesëmarrjen e një, ose më shumë personave, që operon në mënyrë të bashkërenduar, me qëllim kryerjen e veprave penale të cilat ndëshkohen me heqje lirie, ose urdhër izolimi, për të paktën 4 vjet, ose me një denim edhe më të rendë, kur këto vepra përbëjnë qëllim në vetvete, ose mjet për arritjen e përfitimeve materiale, ose sipas rastit, për të influencuar në mënyrë të padrejtë, autoritetet publike operative.”

Sidoqoftë, edhe pse ai ishte miratuar në formën e Veprimit të Përbashkët, asnjëherë nuk u ratifikua nga asnjë prej Vendeve anëtare të BE-së.

Këshilli i Evropës – në Rekomandimin e tij Rec (2001) 11 – miratoi një përkufizim të ngjashëm të ‘grupit të krimit të organizuar’, pa e reduktuar fushën e tij të veprimit tek veprat e ndaluara ndërkombëtare¹².

Konventa mbi Krimin e Organizuar Ndërkufitar e **Kombeve të Bashkuara** (UNTOC) mund të konsiderohet si përpjekja më e rëndësishme deri më sot, për të arritur një koncept të pranuar globalisht për krimin e organizuar. Kjo konventë ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2003. Deri në qershor 2006, ajo është ratifikuar nga të gjitha zonat e projektit, nga shumica e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian (deri më sot, 19 shtete). Kështu, është instrumenti ligjor më i vlefshëm për Evropën dhe për rajonin. UNTOC zbatohet për krimin e organizuar, korrupsionin, pastrimin e parave, dhe pengimin e drejtësisë, por me kusht që vepra penale të ketë natyrë ndërkombëtare dhe të përfshijë një grup të organizuar kriminal, sipas përkufizimit të dhënë në konventë. Sipas nenit 2 të kësaj konvente:

- (a) ‘**Grupi i organizuar kriminal**’ nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime, ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte, ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.
- (b) ‘**krim i rëndë**’ nënkupton atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një denim maksimal të heqjes së lirisë, prej të paktën katër vjetësh ose me një denim më të rendë.
- (c) ‘**grup i strukturuar**’ nënkupton një grup që nuk krijohet rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një veprave penale, dhe që nuk nevojitet të ketë të përcaktuar rolet e anëtarëve të tij, vazhdimësinë e anëtarësisimit në të, ose të ketë një strukturë të zhvilluar.

¹¹ Veprimi i përbashkët 98/733/JHA (Justice and Home Affairs-Punët e Brendshme dhe Drejtësia), i datës 21 dhjetor 1998, miratuar nga Këshilli Evropian, mbi bazën e Nenit K.3 të Traktatit për BE-në, që parashikonte penalizimin e pjesëmarrjes në një organizatë kriminale në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian.

¹² Rekomandimi (2001) 11 I Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me parimet udhërrëfyese kundër krimit të organizuar, miratuar nga Komitetit I Ministrave, më date 19.09.2001, në mbledhjen e 765-të të Zëvendës-Ministrave.

Përgjigjet që iu dhanë pyetësorit tregojnë se të gjitha zonat e projektit e kanë inkuadruar një përkufizim të tillë të krimit të organizuar dhe të grupit të krimit të organizuar në legjislacionet e tyre penale.

Prapëseprapë, parandalimi dhe kontrolli i krimit të organizuar mbetet një koncept evaziv, i ndërtuar mbi bazën e një perceptimi mbi formën më kërcënuese të krimit për shoqërinë dhe që ndikohet nga interesa të ndryshme politike dhe institucionale. Ai ndodh në një kontekst dinamik i cili ofron mundësi të reja për krimin e organizuar dhe kërkon një lloj përshtatjeje si për kriminelët, ashtu edhe për agjencitë e zbatimit të ligjit. Ai plazmohet nga konteksti ekonomik, shoqëror dhe politik në të cilin vepron, ku ekzistojnë marrëdhënie të ndërlikuara grupeve të krimit të organizuar, shtetit dhe shoqërisë. Koncepti i vjetër i grupeve të krimit të organizuar, të organizuara në mënyrë të prerë dhe hierarkike, i ka lënë vendin një koncepti të ri, të grupeve të krimit të organizuar, në formën e sipërmarrjeve, me struktura të zhvilluara dhe me rrjete fluide, që përdorin mjete të shpejta dhe të sigurta komunikimi, duke e bërë akoma më të vështirë, detyrën e identifikimit dhe analizimit të krimit të organizuar.

Lidhja rastësore ose, akoma më shumë, ngatërrimi i konceptit të krimit të organizuar me terrorizmin e shton edhe më tej konfuzionin, duke shkaktuar ndonjëherë lidhjen e gabuar të terrorizmit me metodat e veçanta që e financojnë, ose e drejtojnë atë. Krimi i organizuar dhe terrorizmi janë – a priori – koncepte të ndara. Krimi i organizuar ka si qëllim primar arritjen e përfitimit material ose financiar, ndërkohë që terrorizmi përdor dhunën pa kriter, për të ndryshuar rendin kushtetues ose ligjor të vendosur, si dhe politikat. Shumica e grupeve dhe e rrjeteve kriminale në Evropë janë përfshirë në mashtrime dhe forma të tjera të krimit ekonomik, prodhimin dhe trafikun e drogave dhe kontrabandën, ose trafikimin e qenieve njerëzore, por nuk janë të përfshira në aktivitete që kanë lidhje me terrorizmin¹³. Sidoqoftë, ekzistojnë disa ngjashmëri ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke qenë se terrorizmi ka prirje të konvergjeje me krimin e organizuar. Në këtë kontekst, ka arsye të mjaftueshme për të diskutuar për marrëdhënien ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik dhe terrorizmit mbarëbotëror, që mendohet se është veçanërisht e vërtetë për Al-Qaedën¹⁴.

Terroristët kanë nevojë për mjete për të kryer sulmet e tyre. Aftësia për të prodhuar, dhe për të lëvruar financat për të gjetur armë, për të rekrutuar dhe trajnuar kuadrot si dhe për të komunikuar, sidomos nëpërmjet Internetit, është esenciale për ta. Disa grupe terroriste e financojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet kultivimit të drogës dhe migracionit të paligjshëm, kurse të tjera grupe terroriste kanë operuar në formën e rrjeteve të decentralizuara, të cilat dikur gjenin dhe lëvronin para nëpërmjet kanaleve formale dhe burimeve të tjera të ligjshme, të tilla si biznese private dhe organizata bamirësie, ndërsa sot përdorin forma akoma më të vështira për t'u zbuluar siç janë përdorimi i korrierëve të parave, ose i sistemeve alternative të të ardhurave, që shpesh cilësohen me emrin “banka të nëndheshme”.

Meqenëse çështja e terrorizmit nuk trajtohet në pyetësorin e vitit 2006, zonave të projektit u është kërkuar që të zbatojnë në kualifikimin e krimit, ose të grupeve kriminale, si “krim të organizuar”, kriteret¹⁵ e mëposhtëme:

Kriteret e detyrueshme

1. Bashkëpunimi i tre ose më shumë personave
2. Për një periudhë të zgjatur ose të pacaktuar kohe
3. Të dyshuar, ose të dënuar për kryerjen e një vepre të rëndë penale
4. Me synimin për të arritur fitime dhe/ose pushtet

¹³ Raporti i Këshillit të Evropës për Gjendjen e Krimit të Organizuar, 2005, Fokusi tek kërcënimi i krimit ekonomik, dhjetor 2005.

¹⁴ Shih rezolutën 1373 të Kombeve të Bashkuara, të miratuar nga Këshilli i Sigurimit, pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara, e cila e përkufizon terrorizmin si më poshtë: “Do të quhet terrorizëm çdo veprim që bëhet me qëllim shkaktimin e vdekjes, ose të dëmtimeve fizike tek qytetarët, ose tek palët jo-ndër-luftuese, me qëllim frikësimin e popullsisë ose detyrimin e qeverisë apo të një organizate ndërkombëtare për të kryer, ose për të mos kryer një veprim të caktuar”.

¹⁵ Këto kriteret janë të njëjta me ato që janë përdorur që prej vitit 1997, në BE (ENFOPOL, 35, Rev 2, 6204/97) për hartimin e raportit të përvitshëm të BE-së, mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar, të përgatitur nga Europoli, gjatë këtyre 10 vjetëve. Për pasojë “Udhëzimet Analitike” të Europolit dhe rregullat për shkëmbimin e informacionit (si për shembull sistemi 4x4x3, për vlerësimin dhe klasifikimin e burimeve, informacionin dhe trajtimin e tij) janë përdorur edhe në Seminaret e Trajnimit të Projektit OCTOPUS.

Kriteret fakultative:

5. Secili anëtar ka një rol, ose një detyrë të veçantë
6. Përdor një formë të caktuar të disiplinës së brendshme
7. Përdor dhunën ose metoda të tjera të frikësimit
8. Ushtron ndikim mbi politikën, median, administratën publike, organet e zbatimit të ligjit, administrimin e drejtësisë, apo mbi ekonominë duke përdorur korrupsionin, ose mjete të tjera
9. Përdor struktura tregtare, apo të ngjashme me biznesin
10. Përfshihet në pastrim parasi
11. Vepron në nivel ndërkombëtar

Përveç karakteristikave minimale (ose 'kriterëve të detyrueshme' nga 1 tek 4), të paktën dy nga 'kriteret fakultative' duhet të plotësohen, për ta kualifikuar një grup kriminal, ose një krim, si krim të organizuar. Kjo metodë ka avantazhin që personat juridikë, dhe profesionistët që janë të angazhuar në forma të reja ose të rënda të krimit të organizuar, apo krimit ekonomik, duhet gjithashtu të përfshihen.

2.3 AMBJENTI QEVERTAR DHE EKONOMIK

Natyrë e institucioneve shtetërore dhe politike duket se janë faktorë përcaktues për krimin e organizuar. Tema të përgjithshme në lidhje me politikën dhe qeverisjen janë decentralizimi i pushtetit dhe ndryshimi i rolit të shtetit. Këto ndryshime janë shkaktuar nga mbarimi i Luftës së Ftohtë, nga kërcënimet e reja, siç janë konfliktet ndër-etnike dhe ndër-shtetërore, terrorizmi ndërkombëtar, liberalizimi i tregut, decentralizimi dhe globalizimi, lëvizja e lire e personave dhe e mallrave si dhe një rol gjithnjë e më i madh i aktorëve jo-shtetërorë, të tillë si strukturat qeverisëse mbikombëtare (BE, Gjykata Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë, dhe institucione të tjera ndërkombëtare), korporatat shumëkombëshe si dhe pushteti dhe influenca në rritje e kompanive të sigurimit. Kjo shpërndarje e pushtetit ngre pyetjen e pozitës primare të shtetit në luftimin e krimit.

Menjëherë pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 dhe 7 korrikut 2005, masat kundër terrorizmit kanë përfshirë edhe forcimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar për kontrollin e krimit të organizuar. Traktatet tashmë ekzistuese janë rifreskuar dhe janë miratuar traktate të reja, të tilla si Konventa, vendime, direktiva, rekomandime, ose protokolle të BE-së, Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, siç janë për shembull ato në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit apo krimit të organizuar, të trafikimit të qenieve njerëzore, të krimit kibernetik¹⁶.

Në vitet e fundit, organizma të rinj evropianë janë krijuar, të tillë si Europol, Eurojust, ose CEPOL, që janë përqendruar gjithnjë e më shumë tek çështjet e zbatimit të ligjit në Evropën Juglindore, apo dhe organizma të ngjashëm në rajon, si Qendra SECI. Në 1 maj 2004, një prej zhvillimeve themelore ishte zgjerimi i Bashkimit Evropian me 10 vende të reja anëtare, që në vitin 2005, u pasua nga një agjenci e re evropiane për menaxhimin e kufijve, me emrin Frontex.

Evropa Juglindore ka tiparet e veta të veçanta, që reflektohen tek sfidat e politikës dhe qeverisjes, të tilla si lufta në vendet e ish-Jugosllavisë, sanksionet ndërkombëtare kundër Serbisë, rënia e shtetit shqiptar gjatë viteve 90, shpallja e pavarësisë nga Mali i Zi në qershor të vitit 2006, si dhe diskutimet që ende nuk kanë mbaruar, lidhur me statusin e Kosovës. Kufijtë dhe shtetet e reja, që u krijuan në vitet 90, kërkonin institucione të reja. Përpjekjet e përafrimit, si në drejtim të krijimit të institucioneve të reja, ashtu edhe në drejtim të miratimit të kuadrit të ri ligjor dhe në reformimin e të drejtës së vjetër, i çënoi edhe më tej kapacitetet institucionale dhe buxhetin publik, prej kohësh të dobëta dhe të dëmtuara nga lufta. Për ato vende, që ishin të suksesshme në drejtim të përafrimit, vështirësia qëndronte në ekzekutimin e instrumenteve të reja, e përzier kjo edhe më mungesën e pajisjeve teknike për zbatimin e tyre. Kufijtë e BE-së u zhvendosën më në jug, duke vënë një theks më të madh në policimin e kufirit dhe në përfshirjen në një shkallë sa më të gjerë të *EU acquis* nga vendet kandidatë të Evropës Juglindore. Ka debate që theksojnë se vendndodhja e këtij rajoni në mesin e shteteve të BE-së e bën edhe më delikate situatën në rajon, çka kërkon një angazhim edhe më të madh të politikës së BE-së në këtë rajon¹⁷.

¹⁶ Shih Këshillin e Evropës, <http://conventions.coe.int/>

¹⁷ Lidhur me këtë argument shih Komisionin Ndërkombëtar, *Ballkani në të ardhmen e Evropës, prill 2005*.

Pa qenë nevoja të përballeshin me asnjë prej sfidave të përbashkëta për shtetet, të cilat ofronin mundësi unike për krimin e organizuar për të infiltruar strukturat qeveritare dhe të biznesit, kriminelët përfitonin nga avantazhet konkurruese që ishin rrënjësor tek lidhjet rajonale të ngushta dhe të shtrira në kohë, shërbimet e sigurimit, publike dhe private, policia kufitare dhe doganat. Shoqëritë në Evropën Juglindore vazhdojnë ta perceptojnë korrupsionin si një prej problemeve madhore. Me globalizimin e tregtisë së ligjshme, po globalizohet edhe tregtia në tregjet kriminale klasike, të tilla si trafiku i drogës, armëve, automjeteve, cigareve, si dhe tregtia e mallrave të tjera jo-tradicionale. Në kushtet e asimetrive në zhvillimin njerëzor – faktorët nxitës të migracionit – qeniet njerëzore po bëhet një mall gjithnjë e më i vlefshëm, që kontrabandohet, trafikohet dhe shfrytëzohet për punë, ose për seks.

Hapësirat e reja për mashtrime, krime financiare, falsifikime dhe forma të tjera të krimit ekonomik ofrojnë mundësi shumë here më të mëdha fitimi, duke patur rreziqe shumë here më të vogla, duke u mbështetur në një dallim të turbullt ndërmjet ekonomisë së ligjshme dhe aktiviteteve financiare. Në Evropën Juglindore, mashtrimet në fushën e taksave dhe të doganave dhe mashtrimet në fushën e privatizimeve mendohet se kanë më shumë rendësi se sa krimi i organizuar tradicional. Kjo ndodh për faktin se impakti i krimit ekonomik ndjehet më shumë nga vetë këto shtete, se sa përtej kufijve. Dallimi ndërmjet sipërmarrjeve të ligjshme, të cilat pëdorin mënyra të paligjshme për të kryer bizneset e tyre dhe ri-investimi i të ardhurave nga krimi, në ato që mund të duken aktivitete ekonomike të ligjshme në njërin anë dhe grupeve të krimit të organizuar, të krijuara posaçërisht për kryerjen e krimeve ekonomike, por që drejtohen në mënyrë të ngjashme me kompanitë, në anën tjetër, nuk është shumë i qartë. Ri-investimi i të ardhurave nga krimi në ekonominë e ligjshme shoqërohet me korrupsion dhe ngre shqetësime serioze lidhur me besimin e publikut tek institucionet qeverisëse.

Një pjesë e madhe e kapaciteteve ekonomike prodhuese u shkatërruan gjatë luftës, ose u shpërfillën në mënyrë të rëndë gjatë viteve 90, duke humbur tregjet ndërkombëtare, që ato dikur u shërbenin. “Dekada e humbur” ka vënë një theks më të madh tek tregtia e mallrave, si të ligjshme, ashtu edhe të paligjshme, duke e rritur në mënyrë të ndjeshme koston e tregtisë lokale. Rritja e tarifave të kontrabandimit dhe të trafikimit kanë ndjekur të njëjtat tendenca, duke ofruar një terren të përshtatshëm për krimin e organizuar, i cili duket se është kthyer në një prej mekanizmave për shpërndarjen e paligjshme të pasurisë kombëtare në rajon¹⁸.

Ndryshimi i të drejtave pronësore nëpërmjet privatizimit, përbën një tjetër element kyç për krimin ekonomik, pasi mendohet se zhveshja dhe falimentimi i ndërmarrjeve shtetërore, për të ulur çmimin e tyre gjatë shitjes duket se ka shkaktuar humbjen më të madhe të besimit të publikut tek institucionet qeveritare. Bashkë me humbjen e të ardhurave publike nga evazoni fiskal dhe doganor, mashtrimi me tenderat dhe mashtrimet në fushën e privatizimit janë një prej shqetësimeve kryesore për disa prej zonave të projektit në Evropën Juglindore.

2.4 KRIMI I ORGANIZUAR DHE TIPARET E TIJ TE SPIKATURA

NDËRGJEGJËSIMI DHE BASHKËPUNIMI

Janë fjalë kyçe për një luftë edhe më të ashpër kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik. Pavarësisht ashpërsimit të politikave kundër krimit në Evropë dhe krijimit të organeve evropiane, të tilla si Europol, Eurojust, EMCDDA, apo OLAF dhe mbështetjes së madhe nga ana e institucioneve dhe strukturave të tjera ndërkombëtare, të tilla si Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara, Qendra SECI, Pakti i Stabilitetit, apo Komisioni Ndërkombëtar për Ballkanin, krimi i organizuar dhe krimi ekonomik në zonat e projektit ende vëzhgohet si fenomen më shumë kombëtar. Kjo nxit përhapjen dhe zhvillimin e strukturave dhe grupeve të krimit të organizuar dhe krimit ekonomik. Vetëm shumë pak prej aktiviteteve kriminale, për të cilat ekziston detyrimi për t’i hetuar apo për t’i analizuar nën dritën e krimit të organizuar dalin në dritë. Ekspertët janë të mendimit se përmasat e krimit të organizuar që është zbuluar, (që nuk përfshin shifrat e errëta të krimit), përbëjnë vetëm majën e ajsgut.

Kështu, kuptimi i këtij fenomeni mbështetet gjerësisht në politikat e krimit dhe në prioritetet e zbatimit të ligjit, të cilat kushtëzohen nga kërcënimet që perceptohen në një kohë të caktuar. Bashkëpunimi ndërkombëtar i dobët ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit, është veçanërisht i tillë në Evropën Juglindore. Përgjithësisht, duhet

¹⁸ Shih *Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar në Evropën Juglindore (2003)* dhe *Transporti, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar (2004)*, Qendra për Studime Demokratike.

nënvizuar fakti se në Evropën Juglindore dhe në Evropë¹⁹ ka shumë grupe të krimit të organizuar, të cilat dallohen nga origjina, përmasat, sfera e aktivitetit dhe disa parametra të tjerë. Krimi i organizuar është në pjesën më të madhe i padukshëm dhe shpesh ka lidhje me biznesin e ligjshëm. Ashtu si edhe në pjesë të tjera të Evropës, edhe në Evropën Juglindore, krimi i organizuar i shtrin rrjetet e tij duke përfshirë lloje të reja krimesh dhe kufij të rinj, ai kryen aktivitete kriminale të shumëllojshme, duke i kryqëzuar aktivitetet me rrezik të lartë, me aktivitete me rrezik të ulët dhe duke krijuar marrëdhënie ndërkombëtare, fleksibël, të cilat mund të përshtaten lehtësisht dhe t'u përgjigjen kërkesave, sfidave dhe strategjive të reja të zbatimit të ligjit.

LLOJET E KRIMIT TË ORGANIZUAR

Janë raportuar nga zonat e projektit në të gjitha variantet, në mënyrë të veçantë kontrabanda dhe aktivitetet e paligjshme ndër-kufitare të cilat kanë lulëzuar duke arritur një nivel të tillë, sa që sot konsiderohen problemi kryesor kriminal në këtë zonë. Tregjet kryesore kriminale të cilat janë të përbashkëta për shumicën e vendeve të Evropës Juglindore janë:

- Trafiku i drogave;
- Trafikimi i qenieve njerëzore;
- Migracioni i paligjshëm;
- Krimi ekonomik, si evazioni fiskal, mashtrimi, kontrabanda (kryesisht e cigareve/duhanit), pastrimi i parave.

Në varësi të të dhënave të ofruara nga zonat e projektit si dhe të të dhënave dhe informacioneve që janë në dispozicion nga burime të tjera, një lloj analize, më tepër një vlerësim i krimeve dhe zonave është bërë në kapitullin 3 "Aktivitetet Kriminale", dhe një analizë më e hollësishme, në nivel vendi është bërë në kapitullin 4 "Profilet e zonave të Projektit".

GRUPET E KRIMIT TË ORGANIZUAR

ufuqizuan, pasi ato shfrytëzuan avantazhin e mundësive të reja dhe kapën tregje të reja, duke shfrytëzuar struktura tregtare, për të operuar në botën e biznesit të ligjshëm dhe duke përdorur teknologjitë moderne të komunikimit, për të ruajtur dhe për të zgjeruar kontaktet e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare. Duke lidhur aleanca me grupet ndërkombëtare të krimit të organizuar ato janë bërë më të rrezikshme duke u bërë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare, më të pakapshme dhe fleksibël. Gjithsesi, përcaktimi i numrit të grupeve dhe rasteve të krimit të organizuar, parashtron vështirësi të mëdha. Mungesa e të dhënave të hollësishme mbi grupet e krimit të organizuar në vendet e Evropës Juglindore i ka rrënjët tek fakti se shumica e zonave të projektit ende nuk i mbledhin dhe nuk i raportojnë në mënyrë sistematike të dhënat mbi krimin e organizuar. Si rrjedhojë, sistemet inteligjente për mbledhjen e të dhënave lidhur me krimin e organizuar ndryshojnë shumë nga njëri vend i projektit në tjetrin. Disa prej këtyre vendeve, edhe kur ishin në gjendje të jepnin shifra lidhur me rastet e krimit të organizuar në tregje të ndryshme, nuk ishin në gjendje të ofronin të dhëna lidhur me grupet e krimit të organizuar, të përfshira në këto raste. Prandaj, identifikimi i qartë i grupeve të krimit të organizuar mbetet i vështirë, por thellimi i analizës operationale të rrjeteve kriminale dhe të kalimit të paligjshëm të parave mund të ndihmojë në kapërcimin e këtyre vështirësive.

Në përgjithësi, duket se grupet e krimit të organizuar si organizata kriminale shumë-funksionale, të strukturuar në mënyrë etnike, homogjene dhe hierarkike janë duke ndryshuar. Grupet e krimit të organizuar më me influencë janë grupe të përbërë nga vendasit, me lidhje të fuqishme në rajon dhe në disa raste edhe me shtete të BE-së. Gjithsesi, etnia ekskluzive po bëhet gjithnjë e më pak domethënëse. Përveç grupeve shqiptare të krimit të organizuar (të cilat megjithatë, pasi e kanë forcuar rolin e tyre si "ofruer të shërbimeve kriminale" duke u futur në rrjete bashkëpunimi me kombësi të tjera të Evropës Juglindore dhe pasi kanë marrë në zotërim shumë prej tregjeve kriminale, janë duke i deleguar gjithnjë e më shumë disa aktivitete kriminale, tek grupe të caktuara), ka më tepër grupime të gjera dhe organizata të stilit të mafias. Ka të dhëna se shumë prej grupeve të krimit të organizuar kanë në përbërje shumë enti/kombësi dhe zonat e projektit kanë raportuar për grupe të krimit të organizuar, autoktone dhe jo-autoktone të cilave karakterizohen si "fluide", "të rrafshata", "të strukturuar në formë celulash", dhe "të ngjashme me rrjetin".

¹⁹ Krimi i Organizuar në Evropë, Konceptete, Skemat dhe Politikat e Kontrollit në Bashkimin Evropian dhe Përtej tij, C. Fijnaut dhe L. Paoli, 2004.

Grupet e krimit të organizuar janë duke anagazhuar gjithnjë e më shumë profesionistë, të tillë si juristë, financierë, ekspertë të shërbimit financiar dhe “specialistë” të tjerë, për aktivitetet e tyre. Gjithsesi, emëruesi i përbashkët për të gjitha grupet apo rrjetet e krimit të organizuar në Evropën Juglindore, mbetet pastrimi i parave dhe një shkallë e caktuar korrupsioni (nga nivele të ulëta, tek nivele të larta), që lidh strukturat e ligjshme me ato të paligjshme.

Në disa fusha të krimit, përgjigjet e dhëna për pyetëtorin, vetëm në disa raste kanë raportuar në mënyrë të pjesshme dhe të fragmentarizuar lidhur me numrin, përmasat dhe përbërjen e grupeve të krimit të organizuar. Prandaj, edhe besueshmëria e këtyre përgjigjeve është e kufizuar.

Sipas përgjigjeve, në vlerësimin më të përmbajtur mund të thuhet se në vitin 2005, zonat e këtij projekti kanë hetuar të paktën 200 deri në 300 grupe të krimit të organizuar. Meqenëse këto grupe ndryshojnë për nga numri i autorëve (3-20 dhe më shumë pjestarë janë raportuar), është e vështirë të vlerësohet numri i përgjithshëm i kriminelëve të krimit të organizuar. Në bazë të raporteve, autoritetet e zbatimit të ligjit kanë akuzuar rreth 2500 autorë. Duke patur parasysh se shifrat e raportuara për lloje të caktuara krimesh, që kryhen zakonisht nga grupe të krimit të organizuar, mund të pohohet se numri i grupeve të krimit të organizuar dhe i autorëve është dy, deri në tre here më i madh, ose edhe më shumë.

Grupet *shqiptare* tipike të krimit të organizuar përbëhen nga vendas, për shkak të mentalitetit të njëjtë, dhe të marrëdhënieve klanore nëpër të gjithë Evropën Juglindore dhe përtej saj, kryesisht me grupet turke të krimit të organizuar dhe shpesh me ndërmjetësimin e grupeve egjiptiane, edhe me kartelet e Azisë dhe të Amerikës së Jugut. Disa grupe kanë përveç anëtarëve vendas edhe të huaj, kryesisht italianë. Sipas përgjigjeve, të dhëna nga Shqipëria, në vitin 2005 janë hetuar nga 40 deri në 80 grupe të krimit të organizuar, (deri në 20 grupe për trafikim të paligjshëm të lëndëve narkotike, deri në 20 grupe për trafikim qeniesh njerëzore, deri në 13 grupe për kontrabandë personash, nuk është paraqitur asnjë shifër lidhur me pastrimin e parave, krimin ekonomik dhe korrupsionin). Përmasat e grupeve të krimit të organizuar mendohet të jenë nga 3 deri në 5 persona, (për trafikimin e qenieve njerëzore) dhe nga 3 deri në 20 persona (për trafikimin e drogave të paligjshme).

Grupet e krimit të organizuar nga *Bosnja dhe Hercegovina* mendohet se nuk kanë një mbizotërim të caktuar etnik. Megjithëse, ka një numër tepër të madh rastesh, në të cilat autorët janë përfshirë në prodhimin dhe trafikimin e drogave, trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimin ekonomik (sidomos në evazion fiskal, falsifikim të parave, korrupsion dhe pastrim parash), nuk është paraqitur asnjë shifër mbi numrin e grupeve të krimit të organizuar të përfshira në këto lloj aktivitetesh kriminale.

Grupet *kroate* të krimit të organizuar janë kryesisht të përbërë nga vendas, dhe në pjesën më të madhe, të përfshirë në trafikun dhe shpërndarjen e drogës. (2005: nga 393 raste të shpërndarjes së lëndëve narkotike, në 94 raste janë evidentuar grupe të krimit të organizuar). Supozohet se grupet kroate të krimit të organizuar, të cilat në pjesën më të madhe nuk kanë strukturë hierarkike, dominojnë vetëm në tregjet e ri-shitjes dhe shpesh mbajnë kontakte të ngushta me grupet e krimit të organizuar, shqiptare, ruse dhe italiane. Janë raportuar vetëm 2 raste të përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar në trafikimin e qenieve njerëzore dhe asnjë rast/shifër lidhur me përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar, në fusha të tjera të krimit, pavarësisht një rritjeje të ndjeshme të kontrabandës së personave, me 34% dhe rritjes së ndjeshme të krimeve kundër pronësisë intelektuale dhe të rasteve të korrupsionit.

“*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*” ka raportuar në total 20 grupe të krimit të organizuar, të përbëra zakonisht nga 5 deri në 30 kriminelë të moshës deri në 55 vjeç, shumica prej të cilëve kanë kombësi maqedone. Përveç dy grupeve të regjistruara në fushën e kontrabandës së emigrantëve, nuk është dhënë asnjë informacion tjetër lidhur fushat e krimit të organizuar dhe krimin ekonomik, në të cilat janë përfshirë 18 grupet e tjera të krimit të organizuar. Duke iu referuar shifrave për veprat penale, mendohet se këto grupet duhet të jenë përfshirë kryesisht në trafikun e drogës, falsifikimin e parave dhe në kontrabandën e personave dhe të mallrave. Si struktura, ashtu edhe përbërja e grupeve të krimit të organizuar nuk janë fort të shtrënguara, lidhjet formohen në familje, ose në marrëdhënie të tjera të ngushta, por gjithsesi, stereotipi i grupit të krimit të organizuar, mono-etnik dhe familjar, është kapërcyer dhe është vërejtur angazhimi edhe i një numri kriminelësh nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia.

Mali i Zi ka raportuar për vitin 2005 në total 14 procedime kundër 58 kriminelëve, të cilët kanë kryer si grupe të krimit të organizuar, 85 krime, kryesisht mashtrime (22 raste), kontrabandë (10 raste), droga të paligjshme (10 raste) abuzimi me postin zyrtar (10 raste), pastrim parash dhe armëmbajtje pa leje, ose posedim të eksplozivëve (nga 7 raste për secilën), krime ekonomike (6 raste), trafikim të qenieve njerëzore (3 raste) si dhe pastrim parash (2 raste). Ndërkohë nuk janë paraqitur akuza lidhur me kontrabandën e personave, korrupsionin dhe krimin kibernetik.

Serbia nuk ka dhënë asnjë shifër lidhur me grupet e krimit të organizuar, në pyetësonin e vitit 2006, me përjashtim të një rasti të trafikimit të qenieve njerëzore. Me siguri, një pjesë e madhe e rasteve të raportuara, kanë lidhje me trafikimin e drogave të paligjshme dhe me kontrabandën e personave. Duke iu referuar raporteve të mëparshëm si dhe informacioneve të fundit mbi zhvillimet e krimit²⁰, mendohet se numri i grupeve të krimit të organizuar dhe kriminelëve mund të arrijë shifrat nga 50 deri në 70, me deri në 500 anëtarë.

Me përjashtim të 3 rasteve të krimit të organizuar ekonomik, *Kosova* nuk ka raportuar lidhur me numrin e grupeve të krimit të organizuar si dhe nuk ka dhënë asnjë informacion lidhur me përmasat e këtyre grupeve, kombësinë e anëtarëve, etj, ashtu sikurse ka vepruar për vitin 2003 dhe 2004 (27 grupe të krimit të organizuar, të cilëve u shtohen rreth 830 autorë). Megjithëse shifrat e paraqitura për veprat penale të trafikimit të drogave të paligjshme, trafikimit të qenieve njerëzore dhe të kontrabandës së emigrantëve si dhe lloje të tjera krimesh, për vitin 2005, janë në rritje, asnjë informacion tjetër nuk është dhënë lidhur me përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar dhe individëve të tjerë në këto aktivitete kriminale.

DHUNA DHE FRIKËSIMI

vazhdojnë të përdoren si modus operandi tipik por gjithnjë e më shumë në një mënyrë më të kalkuluar dhe të kujdesshme. Frikësimi dhe dhuna kundër viktimave janë element i pandashëm i grabitjes, shantazhit dhe gjobëvënies. Këto janë gjithashtu metoda tepër të përhapura në tregun e drogës, si një mjet për zgjidhjen e pretendimeve ndërmjet grupeve rivale.

Dhuna përdoret për të shtrënguar disiplinën brenda vetë grupit të krimit të organizuar, ose kundër grupeve konkurruese. Sipas të dhënave, grupet shqiptare janë ndër më të dhunshmet në këtë drejtim, megjithëse shpërthime të dhunshme janë vërejtur edhe në Bosnjë Hercegovinë dhe në Serbi. Në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin e individëve, dhuna ka qenë qenë metoda kryesore për të garantuar "bashkëpunimin" me viktimat. Megjithatë, prirjet e fundit sugjerojnë se dhuna mund të tërheqë vëmendjen e padëshiruar të organeve të zbatimit të ligjit dhe "të dëmtojë biznesin", duke i shtyrë kriminelët të gjejnë metoda alternative për të garantuar bashkëpunimin e viktimave, të tilla si presionet psikologjike kundër familjarëve të tyre, që ato i kanë lënë prapa në vendin e tyre, martesë të detyruara, ofrimi i një pagese modeste dhe e kushteve të mira për jetesë, praktikohen nga trafikantët në Bosnjë Hercegovinë dhe në Kosovë. Siqoqoftë, në zonat e projektit është vënë re një tendencë në rritje e ndikimit politik dhe ekonomik, kryesisht nëpërmjet korrupsionit. Në shumë nga këto zona, dëshmitarët në rastet e krimit të organizuar dhe sidomos nëse ata janë bashkëpunëtorë të drejtësisë mendohet se janë të rrezikuar. Evropa Juglindore është pjesërisht mbrapa vendeve të tjera evropiane, në zbatimin e programeve të mira për mbrojtjen e dëshmitarëve, duke u përballur kryesisht me kufizime të natyrës financiare.

PRAKTIKAT MASKUESE

janë bërë një modus operandi i rëndësishëm i përdorur nga grupet e krimit të organizuar, për t'u mbrojtur nga organet e zbatimit të ligjit dhe për të ruajtur pozitën e tyre në tregjet evropiane kundër konkurrentëve të tyre. Ato janë një prej arsyeve kryesore të zgjatjes dhe kompleksitetit të hetimeve mbi krimin e organizuar. Praktikrat maskuese më të zakonshme kanë për qëllim mbrojtjen e komunikimeve ndërmjet kriminelëve, të cilët përdorin gjerësisht, telefonat celularë me kartë të ndërrueshme SIM, sikurse dhe mjete të tjera komunikimi të zëvendësueshme, të cilat i ndryshojnë shpesh, si dhe mesazhe gojore ose të shkruara, kodimin e të dhënave, etj.

Në kontekstin e Evropës Juglindore, hendeku ndërmjet krimit të organizuar, i cili zotëron kapacitete financiare, për të investuar në teknologjinë e komunikimit dhe tëurvejimit dhe agjencive të zbatimit të ligjit, të cilat kanë kufizime buxhetore, është tepër i madh. Fatmirësisht, në disa raste kriminelët kanë qarkulluar shumë besim në vetvete dhe qarkulluar e ndajnë rrezikun e zbulimit, saqë ata caktojnë takime dhe e kryejnë "biznesin" në publik, për

²⁰ Raporti për Gjendjen e Krimit të Organizuar, i Këshillit të Evropës, i vitit 2005, me theksin tek krimi ekonomik, dhjetor 2005.

shembull, kalimin e paligjshëm të kufirit nga emigrantët. Maskimi mbrojtës kundër autoriteteve publike mund të përfshijë kundër-survejin, rryshfetin, krijimin e rrjeteve strategjike, blerjen e informacionit, ose survejimin e autoriteteve hetimore. Metoda ofensive nuk përbën praktikë në këto vende, por mund të përfshijë gjurmimin aktiv të nëpunësve civilë dhe të përfaqësuesve të gjyqësorit, presionin mbi ata ose mbi familjet e tyre, krijimin e kushteve për shantazhimin e tyre si dhe metoda të tjera, të cilat janë vërejtur shumë rrallë, mbështeten në të dhëna sporadike²¹, dhe për të cilat ose ka patur shumë pak, ose aspak raste të hetimit publik, apo dënimit.

Duke patur parasysh pozitën e rëndësishme që krimi ekonomik dhe pastrimi i parave ka për të gjitha llojet e krimit, përdorimi i strukturave ligjore komerciale nga grupet e krimit të organizuar, është shumë i përhapur dhe realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me një ose më shumë punonjës të brendshëm të këtyre strukturave (zyrtarë të bankës, ose të zyrave të regjistrimit, etj.) nëpërmjet blerjes ose investimit tek strukturat e ligjshme, ose nëpërmjet krijimit të kompanive fiktive²².

Një faktor tjetër, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në luftimin e pastrimit të parave është ekonomia e mbështetur në cash (para në dorë). Pavarësisht modernizimit të sistemeve bankare në rajon, një pjesë e madhe e aktiviteteve ekonomike dhe e transaksioneve financiare ende bëhen me para në dorë. Kjo e bën çdo hetim financiar, një sfidë të vërtetë. Sektorë të tillë, si sektori i pasurive të patundshme, shit-blerjes së makinave, industrisë së argëtimit, industrisë së basteve dhe të seksit, firmat e sigurimit, firmat ndërtuese, stacionet e benzinës, transporti, kompanitë e import/eksportit, bankat dhe mundësitë e majme për privatizim, preferohen nga grupet e krimit të organizuar, meqenëse këto janë biznese që mbështeten fuqimisht në cash (para në dorë). Duke qenë se grupet e krimit të organizuar, bëhen gjithnjë e më shumë të sofistikuar dhe profesioniste, çdo sector është i përshtatshëm, duke filluar nga zotërimi i aksioneve në kompanitë e huaja, krijimi ose pjesëmarrja në holdingjet financiare, si dhe investimi dhe huadhënia për një kompani, me qëllim blerjen e saj.

PRIVATIZIMI I SIGURISË

është shpesh i rëndësishëm për sigurinë dhe besimin e publikut tek qeveria dhe autoritetet e zbatimit të ligjit. Privatizimi i sigurisë në rajon, në fillim të viteve 90, pasqyron një prirje globale, sipas së cilës rolet e sigurimit, të cilat tradicionalisht ishin ekskluzivisht domenë e shtetit, gradualisht filluan të delegohen tek aktorë privatë. Një nën-kulturë veçanërisht e paqëndrueshme në kuptimin e krimit të organizuar e ka burimin pikërisht tek lidhja ndërmjet kriminelëve dhe shërbimeve të sigurimit, të cilat u vendosën gjatë luftërave të viteve 90.

Një numër faktorësh krijoi një kërkesë për sigurim privat në Evropën Juglindore gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, duke përfshirë, nivelet e larta të krimit dhe korrupsionin publik, standarde të dobëta të policimit, shoqëruar me heqjen e mbrojtjes shtetërore mbi pronën e sapoprivatizuar. E gjitha kjo shkaktoi rritjen e fuqishme të sektorit privat të sigurimit. Në vitet e tij të hershme, kjo industri ishte e parregulluar dhe shfaqte problemet e vërejtura edhe në sektorët e tjerë ekonomikë që vinin nga një ekonomi e centralizuar dhe e komanduar.

Disa pjesë të kësaj industrie u lidhën ngushtë me elementë të krimit të organizuar²³ sikurse në rrethana të caktuara u lidhën ngushtë me politikat e nacionalizmit ekstrem. Përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit, me miratimin e ligjeve nga ana e qeverive, për ta vënë këtë sektor nën kontroll, ai ka nisur të bëhet më profesional. Edhe pse në shumicën e rasteve, anëtarët e industrisë private të sigurimit nuk përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë për shtetin, apo për qytetarët e Evropës Juglindore, shqetësime domethënëse mbeten lidhur me lidhjet e tyre të parregullta me botën kriminale, politike dhe paraushtarake.

²¹ Intervista me zyrtarë të zbatimit të ligjit në rajon të kryera në periudhën ndërmjet shtatorit 2004 dhe qershorit 2005.

²² Përdorimi i strukturave tregtare i shërben qëllimeve të ndryshme, si p.sh.: mbulojnë dhe maskojnë aktivitetet e paligjshme, ofrojnë mbështetje logjistike si dhe shërbime të tjera, për aktivitetet kriminale; lehtësojnë pastrimin e parave; krijojnë lidhje me autoritetet publike dhe struktura të tjera të ligjshme të shoqërisë; lejojnë pjesëmarrjen në tenderat publikë; pasurojnë interesat e biznesit; ndihmojnë në kontrollimin dhe monopolizimin e tregjeve. Shih Këshilli i Evropës, (2005), fq. 57.

²³ Shih partnerët në Krim: Rreziku I Simbiozës ndërmjet Sektorit të Sigurimit dhe Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore, Qendra për Studime Demokratike (2004) dhe raportet e ICG: Serbia: hapja e flatrave (2005)

Një studim i kohëve të fundit, i cili do të mund të shërbente si udhërrëfyes për politikë-bërësit vlerëson situatën në të gjitha zonat e projektit, shqyrton prapavijën e privatizimit të sigurisë, kërcënimet bashkëkohore për sigurimin, shërbimet që ofrohen nga kompanitë private të sigurimit (PSC) dhe rregullimi e mbikqyrja e PSC-ve²⁴.

ASIMETRITË EKONOMIKE

janë të pashmangshme në rrafshin global dhe ndihen edhe në Evropën Juglindore. Dinamikat e kërkesës dhe ofertës ndikojnë njësoj si mbi tregun e ligjshëm, ashtu edhe mbi tregun e paligjshëm, dhe të dyja tregjet shfaqin sjellje të ngjashme me biznesin, kur hasin mundësi të mira për fitime. Procesi i globalizimit ekonomik ndryshon konditat jo vetëm për aktivitetet e ligjshme, por edhe për aktivitetet e paligjshme. Globalizimi mund t'i përtheksojë më shumë asimetritë, të cilat dyshohet se gjenerojnë krimin (kanë natyrë krimogjenike).

Duke iu referuar indeksit të zhvillimit njerëzor të Raportit të vitit 2004, të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), në Europë gjenden 15 nga 20 shtetet më të zhvillura të globit. Por, të gjitha vendet e Evropës Juglindore, duke përfshirë Rumaninë, Bullgarinë dhe Turqinë bëjnë pjesë në fashën e mesme të zhvillimit njerëzor. Vetëm Kroacia përfshihet në vendet me indeks të lartë të zhvillimit njerëzor (HDI)²⁵, megjithëse diferenca me vendet e tjera fqinje nuk është shumë e lartë. Asimetritë ndërmjet Evropës Perëndimore dhe fqinjve të saj më të afërt është pra, e ndjeshme, ashtu siç demonstrohet edhe nga tabela e mëposhtëme.

Tabela 1: Asimetritë në zhvillimin njerëzor në Evropë²⁶

Vendi	Popullsia (milione) 2006	Të ardhurat kombëtare bruto për frymë (US\$) 2005	Pozicioni për zhvillimin njerëzor 2003	Vendi në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2005	Veprat penale të regjistruara 2000	Dënimet 2000	Popullsia në burgje 2004
					Per 100 000 inhabitants in 2000		
Shqipëria	3.58	4,900	72	126	149	117	105
Bosnia dhe Hercegovina	4.49	6,800	68	88			67
Kroatia	4.49	11,600	45	70	1 597	403	68
Serbia dhe Mali i Zi	10.83	2,700		97			92 108
"Ish Republika Jugosllave e Magedonisë"	2.05	7,600	59	103	*976	*366	78
Andora	0.07	24,000					90
Armenia	2.97	5,300	83	88	360	203	92
Austria	8.19	32,900	17	10	6 891	512	100
Azerbajxhani	7.96	4,700	101	137	*73	*197	198
Belgjika	10.38	31,900	9	19	**8 558	1 446	88
Bullgaria	7.38	9,000	56	55	1 779	388	127
Qipro	0.78	21,600	29	37	575	**126	50
Republika Çeke	10.23	18,100	31	47	3 811	615	182
Danimarka	5.45	33,400	14	4	9 447	**767	70
Estonia	1.32	16,400	38	27	4 038	717	330
Finlanda	5.23	30,600	13	2	10 262	3 351	69
Franca	60.87	30,000	16	18	6 405	957	91
Gjeorgjia	4.66	3,300	100	130	269	173	165
Gjermania	82.42	29,800	20	16	7 616	1 071	96
Greqia	10.68	22,800	24	47	3 482		83

²⁴ SALW dhe Sigurimi Privat në Evropën Juglindore – një Shkak, apo një Efekt i Pasigurisë, 15 gusht, 2005.

²⁵ Vendet e renditura nga numri 1 deri në 55 përfshihen në fashën me zhvillim të lartë njerëzor, ndërkohë vendi nga pozicioni 55 deri në 142 bëjnë pjesë në fashën e mesme të HDI-së, kurse vendet e renditura në pozicionin nga 143 e në vazhdim i përkasin fashës së tretë të vendeve me HDI të ulët. Shih *Raportin për Zhvillimin Njerëzor, të UNDP, të vitit 2004*.

²⁶ Burimet: PNUD 2005 për pozicionimin në zhvillimin njerëzor (bazuar në arsimin, pritshmëritë për jetëgjatësinë, dhe të ardhurat kombëtare bruto sipas fuqisë blerëse për frymë); CIA - Libri Botëror i Fakteve 2006, për popullsinë në korrik 2006 (përafërime) dhe Prodhimi Kombëtar Bruto për frymë (PPP) në 2005 (përafërime); Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i Transparency International për vitin 2005; Qendra ndërkombëtare për Studime mbi Burgjet lidhur me popullsinë e burgjeve, të vitit 2004; WODC 2003 me të dhëna për krimin për vitin 2000 me përjashtim të rasteve kur është shënuar ndryshe: *UNODC 2002 **në 1999 ***të dhënat janë vetëm për Anglinë dhe Uellsin;

Raporti mbi Situatën CARPO

Vendi	Popullsia (milione) 2006	Të ardhurat kombëtare bruto për frymë (US\$) 2005	Pozicioni për zhvillimin njerëzor 2003	Vendi në Indeksin e Perceptimit të korrupsionit 2005	Veprat penale të regjistruara 2000	Dënimet 2000	Popullsia në burgje 2004
Hungaria	9.98	16,100	35	40	4 445	1,034	165
Islanda	0.29	34,900	2	1		*719	40
Irlanda	4.06	34,100	8	19	1 928	193	85
Italia	58.13	28,400	18	40	**4,123	**484	100
Letonia	2.27	13,000	48	51	2,087	528	339
Lihtenshtejni	0.03	25,000					53
Lituania	3.58	13,900	39	44	2,275	571	234
Luksemburgu	0.47	55,600	4	13	5 216		111
Malta	0.40	19,000	32	25	4 345		72
Moldavia	4.46	2,100	115	88	864	360	297
Hollanda	16.49	30,600	12	11	8 215	658	123
Norvegjia	4.61	42,400	1	8	3 278	1 427	65
Polonia	38.53	12,700	36	70	3 278	577	209
Portugalia	10.60	18,600	27	26	3 616	534	128
Rumania	22.30	8,400	64	85	1 578	338	180
Federata ruse	142.89	10,700	62	126	2 022	811	532
Slovakia	5.43	15,800	42	47	1,642	399	164
Slllovenia	2.01	21,000	26	31	3,614	358	59
Spanja	40.39	25,200	21	23	2,308	*254	139
Suedia	9.01	29,800	6	6	13,693	1,338	75
Turqia	70.41	7,900	94	65	712	*1,512	95
Ukraina	46.71	6,800	78	107	1,126	470	415
Mbretëria e Bashkuar	60.60	30,900	15	11	***9,817	***2,684	***140

3 AKTIVITETET KRIMINALE

3.1 TRAFIKIMI I DROGËS

Sistemi ndërkombëtar i kontrollit të drogës është i bazuar në tri konventa të Kombeve të Bashkuara në lidhje me drogën ((1961, 1971 and 1988)²⁷, të cilat gëzojnë pothuajse aderim universal dhe kufizojnë përdorimin e disa qindra substancave psikoaktive për përdorim mjekësor dhe shkencor. Abuzimi me këto substanca, dhe kryesisht i opiateve (duke përfshirë heroinën), kanabisin, kokainën dhe kokainën e kristaluar, dhe stimulantët e tipit të amfetaminës (ATS, përfshirë *ecstasy*, amfetaminat dhe stimulantët e tjerë sintetikë), përbën një çështje të rëndësishme globale. Raporti Botëror i Drogës së UNDOC-së për vitin 2006²⁸, demonstroi përparimin që është bërë në të kaluarën, por nxjerr në pah gjithashtu edhe disa elemente të dobëta në sistemin global të kontrollit të drogës., në më të shumtën furnizimin me heroinë nga Afganistani, kërkesën për kokainë në Europë, dhe furnizimin/kërkesën për kanabis gjatë.

Sistemi multilateral i kontrollit të drogës, në fakt, e ka përqëndruar problemin në 5 për qind të popullatës së botës (rreth 200 milionë njerëz të moshave nga 15-64). Nga këta 5 për qind të popullatës që përdorin drogat e paligjshme, të paktën një herë në vit (sipas mesatares vjetore), vetëm pothuajse gjysma e tyre (2.7 për qind e popullatës së moshës nga 15-64) i përdorin rregullisht drogat, që do të thotë, të paktën një herë në muaj. Numri i atyre që njihen zakonisht si narkomanë apo përdorues problematikë të drogës arrin deri në 25 milionë persona në të gjithë botën, apo ekuivalenti i 0.6 për qind të popullatës së moshës nga 15-64. Duket se kjo shifër nuk ka ndryshuar shumë në vitet e fundit në nivel global, për shkak se rritjet e numrit në disa vende janë kompensuar me zvogëlim të numrit të tyre në disa vende të tjera.²⁹

Ndërkohë që numri më i madh i përdoruesve të drogës jeton në vendet në zhvillim, Europa që po zgjerohet, duket se përbën tregun më fitimprurës të drogës në botë, po të merren parasysh fuqia blerëse dhe numrat e përdoruesve të drogës. Afërsia ndaj një tregu të tillë dhe rëndësia e 'Rrugëve të Ballkanit' tregon se trafikimi i drogës duhet të vazhdojë të mbetet në fokusin e agjensive të zbatimit të ligjit për Europën Jug-Lindore edhe në të ardhmen. Europa mbetet një treg i rëndësishëm për drogat stimuluese, dhe treguesit sugjerojnë që për Europën si të tërë, tendenca përsa i përket përdorimit të kanabisit, amfetaminës, *ecstasy* dhe kokainës po vazhdon të rritet. Përdorimi i drogës në Europë vazhdon të mbetet në pjesën më të madhe një fenomen i brezit të ri, dhe në veçanti i meshkujve të rinj.

Shifra më të orientuara për Europën janë raportuar nga Qendra Monitoruese Europiane për Drogat dhe Narkomaninë (EMCDDA)³⁰, dhe disa nga shifrat kryesore janë vënë në dukje si më poshtë vijon:

- Përllogaritet që mes 3 - 31 për qind e të rriturve (të moshës nga 15-64 vjeç) e kanë provuar kanabisin të paktën një herë. Duke u bazuar në anketa të ndryshme, mund të përcaktohet një mesatare, e cila sugjeron që rreth 20% e popullatës apo 62 milionë evropianë ta kenë provuar tashmë këtë substancë (përdorimi gjatë gjithë jetës), dhe 6% apo 20 milionë evropianë ta kenë provuar këtë substancë në 12 muajt e fundit (shifrat e vjetshme);
- Drogat sintetike janë drogat e dyta ndër substancat më të përdorura në Europë nga shifrat e raportuara, dhe në veçanti *Ecstasy*, (në shumë mënyra) e ka kaluar edhe përdorimin e amfetaminës, si drogën e dytë më shumë të përdorur pas kanabisit;

²⁷ Këto janë Konventa e Vetme mbi Drogërat Narkotike (1961), Konventa mbi Substancat Psikotropike (1971) dhe Konventa kundër Trafikimit të Paligjshëm në Drogërat Narkotike dhe Substancat Psikotropike (1988).

²⁸ Raporti Botëror i UNODC-së për vitin 2006 për Drogën, i referohet në seksione të ndryshme një numri rajonal destinacionesh, të cilat fatkeqësisht, nuk janë zyrtare. Ato përkufizohen si më poshtë vijon (vetëm për Europën): Europa Perëndimore dhe Qendrore: BE plus EFTA plus San Marinon dhe Andorrën; Europa Lindore: vendet evropiane CIS; Europa Juglindore: Turqia dhe vendet Ballkanike që nuk janë pjesë e BE-së; Megjithatë, ky raport i UNODC-së për vitin 2006 përmend në mënyrë të veçantë vetëm dy vende nga Europa Jug-lindore: Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi, në Serbi.

²⁹ Sigurisht që kjo përfshin edhe përdorimin e shumë drogave. Të dhënat sipas Raportit të UNODC-së për Drogën në Botë, për vitin 2006.

³⁰ Qendra Europiane e Monitorimit për Droën dhe Narkomaninë (EMCDDA), Raporti Vjetor 2005.

- Në lidhje me heroinën, EMCCDA llogarit me përafërsi se ka mesatarisht 4 - 7 raste në 1,000 vetë, të moshës nga 15-64 vjeç. Përlllogaritjet e tanishme sugjerojnë se ka ndoshta rreth 1.2 dhe 2.1 milionë përdorues problematikë droge në BE, nga të cilët, 850,000 vetë deri në 1.3 milionë vetë ka të ngjarë të jenë persona që kanë filluar të injektohen kohët e fundit;
- Mbizotërimi i përdorimit të kokainës ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në Europë, por përsëri tendenca duket se vjen përgjithësisht drejt rritjes. Përdorimi i kokainës varion në BE mes 0.5 - 6% (përdoruesve të përjetshëm), respektivisht 1% e gjithë të rriturve (duke iu referuar shifrave të vjetshme). Megjithatë, duhet të vihet re se të rinjtë po përdorin gjithnjë e më shumë kokainën (1 - 11.6% e të gjithë të rriturve të moshës nga 15-34 vjeç), që do të thotë rreth 3 - 3.5 milionë të rritur evropianë që përdorin shpesh kokainën.

Shifrat e mësipërme tregojnë që nga njëra anë, shkalla e madhe e prodhimit dhe trafikimit të drogës mbeten format më të zakonshme të krimit mes rrjeteve kriminale, që kanë shënjestër Europën si të tërë; nga ana tjetër, që ka rreth 40 milionë njerëz, shumica të rinj në vendet evropiane të cilët kanë përjetuar përvoja të përdorimit të drogave kohët e fundit, dhe që përfaqësojnë një treg tejet të madh të kërkesës për drogë.

Shifra të ngjashme duhet të priten edhe të paktën në të ardhmen e afërt për Europën Jug-Lindore³¹. Prandaj, është themelore të zbatohen politika ndërkombëtare të provuara të zbatimit të ligjit, veprimtari të tilla dhe një bashkëpunim më të ngushtë në rajon, ashtu siç është përcaktuar edhe në dy Strategjitë e BE-së dhe në Planet shoqëruese të Veprimit të BE-së në lidhje me Drogat³².

Përveç këtyre, duhet të përmirësohen edhe veprimtaritë që kanë lidhje me Planin e Veprimit mbi Drogën mes BE-së dhe Ballkanit, të adoptuara nga Këshilli i BE-së në qershor të vitit 2003. Kjo kornizë politike plotëson tri Programet kryesore të BE-së në fushën e drogës, CADAP, SCAD dhe BUMAD. Pas shumë vitesh përvoja në fushën e kontrollit të drogës, si në fushën ndërkombëtare, ashtu edhe në veçanti në vendet e BE-së (në kuptim më të gjerë), tashmë është e ditur se vetëm një strategji koherente, afatgjatë, mund të zvogëlojë furnizimin, kërkesën dhe trafikimin e drogës.

Trafikimi i drogës është një formë themelore e krimit të organizuar në të gjithë Europën, dhe në veçanti në Europën Jug-lindore me të mirënjohurat "Rrugët e Ballkanit", të cilat janë përdorur më parë nga grupet turke të krimit të organizuar për trafikimin e heroinës, dhe që përdoren në ditët e sotme për trafikimin e të gjitha llojeve të drogave të paligjshme, si edhe në kuadër të asaj që njihet si "trafikimi i shumë drogave", ku ngarkesat njihen si "ngarkesat kokteil", dhe që përfshijnë prekursorët, drogat kimike dhe sintetike.

Trafikimi i drogave përfshin grupet kriminale të organizuara lokale të kryesura nga kapot e tyre dhe të përbëra nga shtetas të vendeve të burimit apo të tranzitimit. Megjithatë, projektet zonale raportojnë në mënyrë të zgjeruar lidhjet e ngushta midis grupeve vendore dhe jo-vendore të krimit të organizuar, si në transportimin dhe shpërndarjen e drogave, ashtu edhe në mënyrë të zgjeruar, edhe përfshirjen e trafikuesve të drogës në veprimtari të tjera të paligjshme, si p.sh. trafikimin e qënieve njerëzore. Grupet shqiptare të krimit të organizuar janë shndërruar në furnizuesit kryesorë të kanabisit bimor (kultivimin dhe trafikimin e tij), dhe janë duke mbështetur trafikuesit e heroines turke dhe të kokainës kolumbiane, dhe po përpiqen kohëve të fundit të hyjnë plotësisht në tregëtinë e kokainës, duke përbërë kështu një kërcënim në rritje për BE-në³³.

³¹ Në Europën Jug-lindore, të dhënat në lidhje me abuzimin me drogën janë të rralla dhe jo-koherente. Opietat (heroina): Kroacia 0.7% e popullatës së moshës nga 15-64, Shqipëria me 0.5 të popullatës dhe Mali i Zi, Serbi me 0.4% të popullatës). Kokaina: Kroacia 0.2% e popullatës së moshës nga 15-64. Kanabisi : Kroacia 3.9% (e popullatës së moshës nga 15-34 vjeç), Shqipëria 2.6% e popullatës (nga mosha 15-24 vjeç) dhe Mali i Zi, Serbi 0.7% e popullatës (nga 15-34 vjeç).

³² Strategjia e BE-së 2000 - 2004 (e adoptuar nga Këshilli i BE-së, Dokumenti 9283/00, CORDROGUE 32, Bruksel, më 7 qershor 2000) dhe i shoqëruar me Planin e Veprimit të BE-së për Drogën (200-2004), të adoptuar nga Komisioni Europian, Dokumenti COM(2001) 301; Strategjia e BE-së 2005-2012 (adoptuar nga Këshilli i BE-së, Dokumenti 15074/04, CORDROGUE 77, Bruksel, 16.-17 Dhjetor 2004 dhe i shoqëruar me Planin e Veprimit të BE-së për Drogën (2005-2008), adoptuar nga Komisioni Europian në qershor 2005 (CORDROGUE 25) dhe me Planin pasues të Veprimit të BE-së për Drogën (2009-2012).

³³ "Në bazë të informacionit të agjensive të zbatimit të ligjit, çdo vit, rreth 30 ton kokainë trafikohen nga Shqipëria në Europë me anë të rrugëve ajrore" dhe "Grupet etnike shqiptare të krimit të organizuar e kanë rritur rolin e tyre në trafikimin e heroinës. Raportohet që ato kontrollojnë rreth 80% të këtij trafikimi në disa prej vendeve nordike, dhe 40% të trafikimit të heroinës në

Përjasja analitike e adoptuar në këtë raport e vë theksin në secilën nga substancat kryesore të përdorura. Kjo përjasje specifike e lidhur me substancën është konceptuar krejt thjeshtë për t'u kuptuar dhe ka avantazhin shtesë që pjesa më e madhe e treguesve të përdorimit të drogës, janë bazuar mbi masat e sjelljes së veçantë ndaj substancave. Disavantazhi i kësaj përjasjeje është që nuk reflekton faktin që përdorimi i poli-drogave ("pjesa përputhëse" e trafikimit të multi-drogave), është një faktor madhor i problemeve të drogës në Europë.

Përsa i përket aftësive analitike, mjeteve dhe strukturave organizative që kanë lidhje me të, duhet të theksohet që përgjigjet e përfuara kanë qenë shpesh fragmentuese dhe të pamjaftueshme. Do të nevojitet asistencë dhe trajnime të mëtejshme për të mbushur hapësirat analitike ekzistuese, me qëllim që të përmirësohen mbledhja e të dhënave dhe sistemet raportuese, dhe të përafrohet informacioni në lidhje me trafikimin e drogave dhe analizimi i tij me atë të niveleve të BE-së dhe OKB-së:

- Një hap i parë mund të jetë përpunimi vjetor i Raporteve në lidhje me Situatën e Krimit të Organizuar, ngjashmërisht të strukturuar, dhe të detajuara si Raportet e Këshillit të Europës apo Europolit për Krimin e Organizuar, me fokusimin kryesor në Trafikimin e Drogave;
- Si hap i dytë mund të jetë, gjithashtu, forcimi i mbështetjes për Programin Global të Vlerësimit (GAP). Ky Program është lançuar nga UNODC në 1998³⁴ si përgjigje ndaj nevojës për të përmirësuar të dhënat globale, bazuar në kampionet dhe tendencat e prodhimit të drogës, trafikimit dhe përdorimit të saj. Kjo gjë mbështet gjithashtu edhe zhvillimin e mbledhjes së të dhënave me anë të sigurimit të mjeteve metodike që ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave të cilësisë së lartë dhe në ndërtimin e kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave në nivele kombëtare dhe rajonale. Metodot e përdorura nga GAP janë zhvilluar për të mbështetur mbledhjen e të dhënave rreth një grupi treguesish kryesorë të abuzimit të drogës, të cilat janë pranuar nga Shtetet Anëtare dhe gjenden në pjesën e II-të të Pyetësorit të përmirësuar të Raporteve Vjetore (ARQ)³⁵;
- Hapi i tretë mund të jetë të sillt legjislacioni kombëtar, në veçanti ai në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe ligjin e procedurës penale sa më afër standarteve të BE-së, dhe të negociohet një marrëveshje operationale bashkëpunimi me Europolin;
- Hapi i katërt mund të jetë përdorimi më i zgjeruar i Qendrës SECI, për qëllimet e shkëmbimit të informacionit dhe kapaciteteve analitike të tij.

3.1.1 Stimuluesit e llojit të amfetaminës (ATS)

Grupi i stimuluesve të llojit të amfetaminës (ATS) përfshin amfetaminat (amfetaminën, metamfetaminën), *ecstasy* (MDMA dhe substancat që lidhen me të), dhe stimulantë të tjerë sintetikë (metkatinoninën, fenterminën, fenetilinën, etj...). Stimulantët e llojit të amfetaminës prodhohen më së tepërmi në Kinë, Mianmar dhe Filipine. Prodhimi global i stimuluesve të llojit të amfetaminës është për momentin afër 480 tonë metrikë³⁶, 3 të katërtat e së cilës janë ose metamfetaminë ose amfetaminë, dhe një e katërta e së cilës është '*ecstasy*'.

Pas vitesh të rritjeve të shpejta, tregu për stimulantët e llojit të amfetaminës po stabilizohet. Janë rritur tej mase konfiskimet e ngarkesave, duke demonstruar edhe një herë se popullarizimi i drogave në disa vende ka tendencën

vendet e tjera të Europës Perëndimore, megjithëse ato mbështetën shpesh në organizatat kriminale turke, për t'i furnizuar ato me heroinë. Në Greqi, grupet etnike shqiptare të krimit të organizuar, në bashkëpunim të ngushtë me shtetasit grekë, dominojnë trafikimin e kokainës. Italia raporton se shqiptarët etnikë shkëmbejnë heroinën për kokainë dhe se ata janë të përfshirë në trafikimin e kokainës në Mbretërinë e Bashkuar" (për më shumë detaje shih: Raportin e BE-së mbi Krimin e Organizuar, 2005, Europol).


³⁴Në këtë kontekst, UNODC po punon gjithastu me qeveritë dhe me një mori organizatash, për të themeluar tregues për normat dhe standartet; për të përmirësuar sistemet e mbledhjes së të dhënave dhe ato të raportimit, siç është p.sh. Indeksi Global i Drogave të Paligjshme (IDI), i cili mund të sigurojë një masë të vetme, dhe standarte të krahasueshme të problemit të drogës së një vendi të tërë, të kundrapeshuar me numrin e popullatës së tij. Indeksi i Drogave të Paligjshme kombinon të gjitha kategoritë kryesore të drogave të paligjshme, duke i konvertuar ato në një referencë droge hipotezë bashkë me masën e prodhimit të drogave të paligjshme, trafikimit dhe përdorimit të tyre, në një masë të vetme të dëmit potencial që lëviz përgjatë zinxhirit të tregut.

³⁵ UNODC, Raporti Botëror i Drogës 2006.

³⁶ UNODC, Raporti Botëror i Drogës 2006.

të shkaktojë pakësimin e tyre diku tjetër, duke shkaktuar kështu riorganizimin e vetë tregut, në mënyrë të veçantë duke shfrytëzuar vendet në tranzicion ku ka zbatim të dobët të ligjit.

Tabela 1:



Sources: UNODC estimates based on UNODC, Annual Reports Questionnaire Data / DELTA and INCB, 2005 Precursors, March 2006, UNODC, 2005 World Drug Report and UNODC, Ecstasy and Amphetamines – Global Survey 2005.

Procesi i prodhimit, që përfshin blerjen e kimikateve, sintetizimin, kthimin në formë tablete, paketimin dhe hedhjen e mbeturinave, është pandryshueshmërisht i ndarë mes vendeve të ndryshme. Kjo përfshin shpesh, bashkëpunimin mes grupeve kriminale që operojnë në zonat kufitare, duke e ulur kështu rrezikun e shkatërrimit të rrjeteve të përgjithshme të prodhimit. Shembuj të kësaj janë trafikimi nga Belgjika dhe Holanda, në Portugali të pluhurit të 'ecstasy' për t'u kthyer në tabletë dhe ai i pluhurit të amfetaminës në Mbretërinë e Bashkuar për t'u prerë e për t'u ri-paketuar me një logo. Hetimet në Shtetet Anëtare të BE-së demonstrojnë rolin kryesor të lehtësisë në furnizimin me kimikate, materiale dhe pajisje të marra nga vende europiane si edhe vende të tjera përtej saj.

Prodhimi i konsiderueshëm i amfetaminës zhvillohet edhe në Poloni, ndërkohë që raportohet prodhimi i amfetaminës dhe 'ecstasy' nëpër BE, në veçanti në Shtetet Baltike dhe në Bullgari, ku kjo e fundit është vendi burimor i tabletave të amfetaminës me logon 'Captagon' të trafikuar në sasi të mëdha në Gadishullin Arabik. Rritja në mënyrë të vazhdueshme e konfiskimeve në BE gjatë vitit 2004 dhe 2005 të dërgesave të amfetaminës deri në 500 kg³⁷ (konfiskimet më të fundit në Serbi), tregojnë një zgjerim të këtij tregu dhe atij të prodhimit të amfetaminës, në një nivel të zgjeruar trafikimi në Europë.

3.1.2 Metamfetamina

Kjo drogë njihet që të jetë e shoqëruar në veçanti me probleme shëndetësore dhe shoqërore. Në botë, ekziston një shqetësim në rritje përsa i përket zgjerimit të problemeve të shkaktuara nga metamfetamina. Prodhimi dhe konsumimi në shkallë të gjerë në vendet europiane i metamfetaminës nuk ka ndodhur deri më tani. Prodhimi evropian i metamfetaminës vazhdon të mbetet në një shkallë të gjerë i kufizuar në Republikën Çeke, dhe në një masë më të vogël, në vendin fqinjë - Republikën Sllovaqe, në disa nga shtetet Balltike dhe në Moldovi. Numri i laboratoreve të shkatërruara të metamfetaminës në Republikën Çeke është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, nga 18 në 1995, në 28 në 2000, 188 në 2003 dhe 248 në 2004. Numër i madh laboratorësh të shkatërruara është raportuar gjithashtu edhe nga Moldavia, (136 në 2004), pasuar kjo nga Republika Sllovaqe, (12 në 2004, një rritje prej 3 na krahasim me vitin e mëparshëm).


Duke u bazuar në të dhënat në lidhje me origjinën e drogave të konfiskuara, 88% e përgjigjeve që kanë të bëjnë me vendet europiane gjatë periudhës 2002-2004, sugjerojnë që prodhimi i amfetaminës vazhdon të jetë i përqëndruar në Europë. Holanda, Polonia dhe Belgjika, të pasuara nga Lituania dhe Estonia, Bullgaria dhe Gjermania, citohen shpesh si burimet kryesore të amfetaminës. Përsa i përket konfiskimeve të laboratorëve të amfetaminës, Europa numëronte rreth 77 % të të gjitha laboratoreve të tilla gjatë periudhës 2002-2004.

Numri i laboratorëve të konfiskuar në Europën Perëndimore dhe Qendrore është rritur nga mesatarja prej 25, gjatë periudhës 1995-99, në 35 gjatë periudhës 2000-2004, (47 në 2004). Kjo rritje ka qenë edhe më e madhe në Europën

³⁷Raporti i Europolit për Drogën, 2006.

Lindore (Bjellorusi, Moldavi, Rusi dhe Ukrainë), ku zbulimet e laboratorëve të raportuar u rritën nga 11, mesatarisht gjatë periudhës 1995-99, në 94 gjatë periudhës 2000-2004, (141 në 2004) ³⁸.

Tabela 2: Origjina e amfetaminës në periudhën 2002 –2004



* Number of times a country was identified by other countries as a source country for amphetamine over the 2002-04 period (n = 175), based on information provided by 40 countries

Source: UNODC, Annual Reports Questionnaire Data.

Këto të dhëna bashkë me konfiskimet e kohëve të fundit tregojnë se ka një zhvendosje graduale të prodhimit të amfetaminës drejt Europës Lindore dhe Jug-Lindore. Zonat e projekteve duhet të inkurajohen të forcojnë mbështetjen e veprimtarive dhe operacioneve ndërkombëtare, siç janë ato të Europol-it, apo ato të UN INCB (Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve të OKB-së). Kjo gjë duhet parë në përputhje me gjetjet, por jo me shifrat e mëdha, të raportit të kohëve të fundit të vitit 2006, nga Ministria e Brendshme e Republikës Serbe (Bosnja dhe Hercegovina), që tregon “se sasitë e improtuara të substancave të destinuara për prodhim industrial, e tejkalojnë nevojën, dhe një gjë e tillë, jo në pak raste, trafikimi i tyre është i paligjshëm” ³⁹.

Konfiskime të raportuara të *ecstasy* janë rritur me 87% në 2004, dhe kanë arritur një rekord të ri prej 8 kilogramësh të shprehur në ekuivalencë, nga të cilët 51% u konfiskuan në Europë, duke tejkeluar edhe shifrat maksimale të shënuara në 2002 me 20%. Rëndësia e Hollandës dhe Belgjikës, vendet tradicionale burimore të *ecstasy*, duket se ka rënë, meqë prodhimi në vende të tjera europiane po rritet⁴⁰.

Më së shumti, stimuluesit e llojit të amfetaminës, ATS, kalohen kontrabandë nga vendet europiane, por është në rritje gjithashtu edhe numri i vendeve të Europës Lindore dhe Jug-Lindore, ku po lulëzojnë laboratorët klandestinë. Duke marrë në konsideratë natyrën në rritje të tregut të gjerë europian për stimuluesit, potenciali për zgjerimin e përdorimit të metamfetaminës nuk mund të injorohet për vendet e Europës Jug-Lindore, dhe për këtë arsye, kjo mbetet një zonë e rëndësishme për t’u treguar vigjilentë. Një tendencë rritjeje në tregun vendor për stimuluesit e llojit të amfetaminës, ATS, është vënë re tashmë në Serbi (përgjigja nga kjo zonë e projektit thekson se, kjo është “shumë e popullarizuar tek të rinjtë” dhe “shumë e përhapur”), në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kroaci, në Malin e Zi, në Kosovë dhe në “ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, për shkak të rritjes së kërkesës për këto lloje drogash, por gjithashtu edhe për shkak se mund të zbulohen edhe furnizime më të mëdha. Për më tepër, Turqia me zgjerimin e turizmit, po shfaqet si një destinacion domethënës për *ecstasy* e siguruar në Europën Perëndimore. Në këtë aspekt, përdorimi i dyfishtë i “Rrugëve të Ballkanit”, është i pritshëm në kontrabandimin e heroinës dhe *ecstasy* nga/dhe BE-ja. Prodhimi i amfetaminës me logon ‘Captagon’, që më parë raportohet në Bullgari, është shfaqur kohëve të fundit edhe në Turqi⁴¹.

Duket se ka një tregëti në rritje me kimikatet e perkursorëve, e cila kalon përmes Ballkanit, e që synon në prodhimin jashtë rajonit, ose që thekson se po bëhen përpjekjet bazë për të themeluar prodhimin e drogës në rajon. Metamfetaminat përbëjnë një problem në rritje për Europën Lindore, Rusinë dhe Azinë, me laboratorët e drogës në lëvizje, ku në shumë raste, ato lëvizin nga perëndimi në lindje, ndërsa kimikatet e perkursorëve, në mënyrë të përgjithshme lëvizin nga lindja në perëndim, pra në kahun e kundërt.

³⁸ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën, 2006.

³⁹ Bosnjë dhe Hercegovina - Informacion mbi Situatën e Sigurisë në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 2005.

⁴⁰ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën, 2006.

⁴¹ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën, 2006

Kontrollimi i kimikatevë të perkursorëve është veçanërisht një sfidë e vështirë, meqë këto substanca, të tilla si efedrina dhe kimikate të tjera, gjenden në medikamentet që blihen pa recetë dhe në të ashtëquajturat ‘medikamente të ftohta’, nëpër farmaci. Tonelata perkursorësh transportohen në rajon, ku laboratorët klandestine operojnë në liri relative, veçanërisht në vendet ku paqëndrueshmëria dhe dobësia në agjensitë e zbatimit të ligjit, i lejon prodhuesit të operojnë pa u ndëshkuar.


Në 2005, agjensitë e zbatimit të ligjit në Shqipëri hetuan dy raste konfiskimesh të sasive të konsiderueshme të efedrinës nga Kina dhe Mbretëria e Bashkuar. Bosnja dhe Hercegovina ka raportuar kohëve të fundit një konfiskim prej 34 tonësh të acidit acetik anhidrit, (kimikat perkursor për heroinën); policia e Serbisë ka zbuluar një tregëti të kimikateve perkursore të importuara nga Franca, Republika Çeke dhe Rumania, të cilat futen më pas kontrabandë në Bullgari dhe Turqi. Ata zbuluan disa laboratore të paligjshme për prodhimin e ecstasy, dhe konfiskuan 2 milionë tableta *ecstasy*, si edhe 20 tonë acid.

Zonat e projekteve duhen inkurajuar të përdorin më tepër Sistemin e Logos së Europolit për Kokainën (ECLS), i cili përm,ban më shumë mënyra operuese, informacion fotografik dhe të dhëna të tjera në lidhje me konfiskimet e kokainës, si edhe pësra i përket logove dhe shënimeve të drogave, dhe paketimeve të tyre. Sistemi ECLS bën të mundur identifikimin e përputhjeve mes konfiskimeve, me synimin për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar mes agjensive të zbatimit të ligjit dhe shkëmbimit të informacionit. Të dhënat vjetore më të fundit të Katalogut të Logos së Kokainës nga Europoli prezantohen në formën e CD-së dhe në formatin e printuar.

3.1.3 Produktet e Kanabisit (hashashi, marihuana, vaji i hashashit)


Prodhimi i kanabisit përbëhet kryesisht nga tre produkte të ndryshme: kanabisi bimor (marihuana), kanabisi në formë rrëshire (hashashi) dhe vaji i kanabisit. Prodhimi global i kanabisit ka ardhur duke u rritur dhe përllogaritet në 45,000 tonë metrikë, (2003: 40,000 tonë metrikë, 2004: 42,000 tonë metrikë)⁴². Ka edhe tregues të tjerë që tregojnë se prodhimi i kanabisit është rritur. Si përllogaritjet e numrit të konsumatorëve të kanabisit në botë, ashtu edhe sasitë e konfiskuara të kanabisit nga agjensitë e zbatimit të ligjit, janë rritur gjatë dekadës së kaluar.

Tabela 3: Prodhimi i kanabisit bimor (i përllogaritur)



Sources: UNODC, World Drug Reports 2004 and 2005, UNODC, Annual Reports Questionnaire Data, Government Reports and UNODC estimates.

Tabela 4: Konfiskimet e Kanabisit bimor gjatë 1999-2004



Source: UNODC, Annual Reports Questionnaire Data.

Europa përbën tregun më të madh të botës për kanabisin në formë rrëshire, që numëron për më shumë se 70% të konfiskimeve të këtilla për vitin 2004. Gjatë periudhës 2002-2004, Shtetet Anëtare cituan Marokun si vendin kryesor burimor, të pasuar nga Pakistani dhe Afganistani. Proporcioni i Marokut, megjithatë, ka pësuar rënie të dukshme, nga 31% gjatë periudhës 1999-2003, në 28% gjatë periudhës 2002-2004.

Vende të tjera të përmednura si burime të rëndësishme të kanabisit në formë rrëshire, janë Shqipëria dhe Holanda. Në disa raste, nuk është gjithnjë e qartë nëse kanabisi në formë rrëshire është prodhuar në këto vende, apo thjeshtë është blerë në këto vende, duke e pasur origjinën nga Maroku. Megjithatë, prodhimi i kanabisit në formë rrëshire në Marok ka rënë ndjeshëm. Një studimin e bërë në vitin 2003, e llogariti prodhimin e përgjithshëm të rrëshirës në rreth 3,060 tonë metrikë, të kultivuara në 134,000 hektarë tokë në Rajonin Rif, nga një numër prej

⁴² UNODC Raporti Botëror mbi Drogën, 2006

96,600 familje. Studimi i bërë në vitin 2004, tregoi një rënie prej 10% të tokës së dedikuar për kultivimin e kanabisit (120,500 hektarë), me një prodhim të përllogaritur prej 2,760 tonësh metrikë. Studimi i zhvilluar në vitin 2005, gjeti një rënie të mëtejshme prej 37%, që do të thotë 72,500 hektarë, me një rënie prodhimi prej 1,070 tonësh metrikë, që reflekton qartë përpjekjet e intensifikuara të autoriteteve marokene në luftën kundër prodhimit të drogës⁴³.

Përveç këtyre përpjekjeve në Marok, ekziston një shqetësim në rritje në Europë në lidhje me impaktin negativ të përdorimit të kanabisit⁴⁴. Maroku vazhdon të furnizojë më shumë se 80% të së gjithë rrëshirës së konsumuar në Europë⁴⁵, që përbën tregun më të madh të rrëshirës, e që gjeneron çdo vit përafërsisht rreth 10 bilionë Euro. Përveç kësaj, Pakistani dhe Afganistani, kontribuojnë gjithashtu në tregun botëror të rrëshirës. Konfiskimet dhe konsumimi i rrëshirës sugjerojnë se tendenca afat-gjatë po vjen drejt një rritjeje në prodhimin global që arrin deri në 7,500 tonë metrikë e më shumë (2004/2005).

Të dhënat e përdorshme në kërkesat për mjekimet për drogën në Europë, e vënë kanabisin të dytin në listën e opiateve, megjithëse kanabisi ende numëron për vetem 12% të të gjitha kërkesave për mjekim, dhe panorama e përgjithshme po ndikohet në mënyrë të ndjeshme nga situata në disa vende. Megjithëse të dhënat e përdorshme sugjerojnë se në Europë ka rreth 3 milionë njerëz, kryesisht meshkuj të rinj, mund të jenë përdorues të kanabisit duke e marrë atë çdo ditë, masa e përjetimit të mundshëm të problemeve të këtij grupi për shkak të përdorimit të drogës, mbetet ende e panjohur. Pritet që një gjë e tillë të vihet re edhe në vendet e Europës Jug-Lindore.

Fuqia e produkteve të kanabisit përcaktohet nga përmbajtja në to e tetrahidrokanabinolit (THC), që është edhe përbërësi kryesor aktiv. Sipas studimeve në Kanada, Shtetet e Bashkuara dhe Hollandë, për shembull, përmbajtja mesatare e THC-së, është rritur në mënyrë të konsiderueshme (USA: nga më pak se 2% në vitet 1970, në 6.3% në 2003-in)⁴⁶. Në vitin 2003, për vendet për të cilat ka të dhëna të përdorshme, kanabisi në formë rrëshire në nivelet e shitjes u raportua të kishte një përmbajtje mesatare të THC-së, e cila ndryshonte nga më pak se 1% në Poloni, deri në 25% në Republikën Sllovaqe, ndërkohë që fuqia e kanabisit bimor varionte nga 1% në Hungari dhe Finlandë, deri në 20% (i kultivuar në shtëpi në Hollandë), e deri në 25% në Republikën Sllovaqe⁴⁷. Vetëm Mali i Zi ka dhënë një përshkrim jo të detajuar të kanabisit të trafikuar nga Shqipëria, i cili "konsiderohet të jetë i një cilësie të lartë (përqindje të lartë të THC-së)".

Prodhimi i kanabisit bimor (marihuanës), është gjithashtu i shpërndarë edhe në vende të tjera të Europës Jug-Lindore, të cilat raportojnë gjithashtu kultivim të kanabisit, siç është Serbia (2003: kultivim në shkallë të vogël me 2,000 bimë), Kosova (2004: policia e Kosovës dhe UNMIK-u kanë shkatërruar 12 fusha kanabisi) dhe Shqipëria, e cila vazhdon të mbetet i vetmi vend në rajon që prodhon produkte të kanabisit (hashash, marihuanë dhe vaj hashashi) për eksport (2004: Shkatërrimi i rreth 74,000 bimëve; 2005: Shkatërrimi i rreth 333,000 bimëve; 2006: Shkatërrimi i rreth 2,000 bimëve kanabis vetëm gjatë 5 muajve të parë të vitit).

Vendet e destinacionit të hashashit dhe marihuanës së prodhuar në Shqipëri, janë kryesisht Greqia dhe Italia, por ka pasur raporte të trafikimit në Kosovë, Malin e Zi, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", dhe në disa raste të pakëta, edhe në Shtetet Anëtare të BE-së, në shkëmbim të heroinës. Importi i marihuanës organizohet kryesisht nga grupet kriminale të organizuara të Kolumbisë, Xhamaikës, Afrikës së Jugut, Nigerisë dhe Shqipërisë. Grupet e organizuara kriminale shqiptare janë shndërruar në një sigurues të fuqishëm të kanabisit bimor. Ngarkesat e mëdha të hashashit dhe marihuanës arrijnë kryesisht me rrugë detare, përmes kanaleve të kontrabandës ndërkombëtare, (kontenierëve), nga vendet e Afrikës Veriore dhe Perëndimore nëpër portet italiane dhe sllovene, prej ku vazhdojnë rrugën nëpër zonat e projekteve, me përdorimin e rrugëve tokësore. Hashashi dhe marihuana vijnë gjithashtu edhe me anë të rrugëve detare nga Shqipëria, apo drejtëpërdrejtë nga vendet Amerikano-Jugore në portet detare të Kroacisë për shpërndarje të mëtejshme. ("shih kanalet e 'Rrugave të Ballkanit'"). Transportimi i hashashit dhe marihuanës me rrugë tokësore, organizohet kryesisht nga territoret e Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë.

⁴³ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën, 2006; Raporti i Europolit mbi Drogën 2006.


⁴⁴ Raporti i EMCDDA-së 2005; Spanja, Italia, Danimarka, Finlanda dhe Irlanda kanë raportuar se pothuajse e gjithë sasia e kanabisit në formë rrëshire e ka pasur origjinën nga Maroku.

⁴⁵ Europol, 2005 BE: Raporti mbi Krimin e Organizuar, Tetor 2005.

⁴⁶ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën 2006.

⁴⁷ EMCDDA, Raporti Vjetor 2005.

Tabela 5: Konfiskimet e kanabisit (Kg/mesataren vjetore)



Burimi: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (UNODC)

Përsa i përket kërkesës, Europa është pothuajse tregu më fitimprurës i kanabisit në botë. Afërsia e një tregu të tillë dhe rëndësia e ‘Rrugëve të Ballkanit’ tregojnë që trafikimi i drogës duhet të vazhdojë të mbetet fokusi i agjensive të përforcimit të ligjit edhe në të ardhmen. Produktet e paligjshme të kanabisit janë drogat më të përhapura në të gjitha vendet e rajonit, dhe në shumicën e vendeve të projekteve ato janë quajtur si problemi më i madh.

3.1.4 Kultivimi i luleve të opiumit dhe prodhimi i heroinës

Në vitin 2005, ekspertët kanë vënë re disa zhvillime pozitive: zona e përgjithshme e përdorur për kultivimin e luleve të opiumit është zvogëluar, ashtu siç është zvogëluar edhe prodhimi global i opiumit, ndërkohë që konfiskimet globale të opiateve (heroinës, morfinës dhe opiumit) u rritën, veçanërisht në Europën Jug-Lindore. Në rang botëror, zona e përllogaritur nën kultivimin e paligjshëm të luleve të opiumit ka pësuar një rënie prej 22% (nga 195,940 hektarë në 151,500 hektarë), kryesisht në sajë të kultivimit të ulët në tri vendet kryesore burimore⁴⁸. Prodhimi global i opiumit është përllogaritur në 4,620 tonë metrikë.

Afganistani përbën pjesën më të madhe të tij: 4,100 tonë metrikë (89%) janë prodhuar në vendin kryesor burimor për Europën. Në të kaluarën, Afganistani e ka rritur në mënyrë të qëndrueshme prodhimin e opiumit nga 2002 në 2005⁴⁹, duke e tejkaluar edhe prodhimin e mëparshëm sasior përpara se Talebani të paraqiste “fatëa-n” në kultivimin e luleve të opiumit, duke i zhdukur në mënyrë radikale zonat e kultivimit në fund të vitit 2000 dhe në pranverë të vitit 2001. Kultivimi i luleve të opiumit vazhdon të shpërndahet në Afganistan, duke treguar që përpjekjet pas-Talebane për kontrollimin e drogës nga komuniteti ndërkombëtar, nuk kanë qenë aq sa duhet të suksesshme. Rreth gjysëm milioni njerëz besohet që të jenë të përfshirë në këtë biznes në opiatet afgane, me një fitim të përllogaritur që numërohet deri në 40 bilionë dollarë amerikanë në vit.

Pavarësisht se UNODC-ja llogarit që në Afganistan zona nën kultivimin e lules së opiumit ka pësuar rënie për here të parë që nga viti 2001, me 21% nga 131,000 hektarë (2004) në 104,000 hektarë (2005)⁵⁰, nivelet e përgjithshme të prodhimit të opiumit janë ndier shumë pak⁵¹. Një shqetësim të madh përbën fakti që kultivimi i lules së opiumit është paraqitur edhe në zonat ku nuk njihet më parë, dhe tashmë gjendet në të gjitha 34 provincat e vendit. Përveç kësaj, tendenca kombëtare fsheh në mënyrë të konsiderueshme dallimet mes provincave. Ndërkohë që në disa

⁴⁸ Afganistani, Mianmari dhe Republika Demokratike e Popullit të Laosit (Lao PDR).

⁴⁹ UNODC Raporti Botëror mbi Drogën 2006; Në vitin 2004, 67% e kultivimit global të luleve të opiumit u zhvillua në Afganistan.

⁵⁰ Krahasuar me të dhënat e vitit 2004, kjo mund të quhet një pakësim vjetor, por krahasuar me rreth 80,000 hektarë në vitin 2003, rreth 104,000 hektarë ende vazhdojnë të mbeten në nivele të larta.

⁵¹ UNODC Raporti Botëror mbi Drogën, 2006; Pavarësisht se ka një zbritje rreth 21% në kultivimin e lules së opiumit, kushtet e favorshme të rritjes, kanë rezultuar në kërkesa më të mëdha për opiumin, duke çuar në një pakësim të përgjithshëm të prodhimit deri në masën 2%.

provincia vihet re një zvogëlim i ndjeshëm (p.sh. Nangarhar, nga 28,213 hektarë në 1,093 hektarë), kultivimi është rritur në provincat e tjera (p.sh. Kandahari, nga 4,959 hektarë në 12,989 hektarë).

Duke analizuar studimeve afatgjata të paraqitura nga UNODC-ja, këto zvogëlime të kohëve të fundit, nuk duhen theksuar mjaft: ngritjet dhe zbritjet e statistikave të krimit, “shifra” të tilla të lëvizshme, bëjnë thirrje për programe të qëndrueshme dhe për sfida që do ta kthenin rezultatin e pakësimit vjetor në ndryshime afatgjata strukturore.

UNODC-ja përllogarit 72% të opiumit të shndërruar në heroinë që gjendet në Afganistan. Në vitin 2005, u prodhuan rreth 410 tonë mertikë heroinë, pjesa më e madhe e së cilës për të shkuar në Europë dhe Rusi⁵². Rreth 10,000 tonë kimikate, duke përfshirë edhe 1,000 tonë anhidrid acetik nevojiten për tërë këtë proces. Agjensia e Kontrollimit të Drogës në Taxhik llogarit se në Afganistan gjenden më shumë se 400 laboratore për prodhimin e heroinës, ku 80 prej tyre janë të vendosura përgjatë kufirit me Taxhikistanin⁵³. Pothuajse e gjithë sasia e heroinës së konsumuar në Europë, është e bazuar në opiumin që vjen nga Afganistani, (90%), për të cilën “Rrugët e Ballkanit”, vazhdojnë të mbeten kanalet kryesore të trafikimit.

Trafikimi i heroinës drejt BE-së vazhdon të dominohet nga grupet kriminale turke dhe ato grupe të tjera të shoqëruara me to. Këto grupe përdorin ndërmjetësit në Azinë Jug-Perëndimore për të kontaktuar me kriminelët apo sekserët vendas, të cilët mund të blejnë sasi të mëdha heroine drejtpërdrejtë nga vendet e origjinës. Shumë rrallë ndodh që ngarkesat e heroinës të bëjnë udhëtimin nga Afganistani në Europë, në një udhëtim të vetëm; ato blihen dhe shiten nga grupe të ndryshme kriminale përgjatë rrugës⁵⁴. Në përgjithësi, rritja masive e trafikimit të mallrave dhe pasagjerëve në Europë, e ul rrezikun dhe prodhimin e investimeve më të mëdha për trafikuesit e drogës, të cilët në mënyrë të veçantë në trafikimin e drogës, ndjekin tendencën e sipërmarrësve: “Rrezik i ulët – përfitim i madh”.

Ndërkohë që pritet transportimi i mëtejshëm për në Europën Perëndimore, heroina shpesh grumbullohet në stoqe të mëdha në vendet përgjatë ‘Rrugëve të Ballkanit’. Përdorimi i dyfishtë i ‘Rrugëve të Ballkanit’ për të kontrabanduar heroinën në BE dhe *ecstasy* nga BE-ja ia vlen të përmendet⁵⁵. Shqipëria është e destinuar të shndërrohet në një prej vendeve më të rëndësishme të tranzitimit për trafikimin e heroinës nga Afganistani nëpërmjet Turqisë, dhe vendeve të tjera të Europës Jug-Lindore, duke mos i marrë parasysh shifrat në rritje apo në zbritje (2004: 91 raste me 152 të pandehur; 2005: 67 raste me 116 të pandehur).

Proporcioni i opiateve të konfiskuara, i shprehur në ekuivalentet e heroinës, përgjatë rrugës së trafikimit Afganistan - Europë, është rritur në masën nga 78% në 85% mes viteve 2002 dhe 2004, duke reflektuar rritjen e niveleve të prodhimit të opiumit në Afganistan dhe nivelet në rritje të trafikimit të opiateve nga ai vend.

Grupet kriminale etnike shqiptare⁵⁶ raportohet të luajnë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në shpërndarjen për shitje të heroinës në Europë. Për arsye të pozicionit të saj gjeografik, Turqia mbetet korridor kryesor për trafikimin e heroinës drejt BE-së. Ky vend shërben si një vend fillësë për “Rrugët Ballkanike”. Shumica e heroinës nga Azia Jug-Perëndimore arrin në Europë nëpërmjet këtyre rrugëve.

Kriminelët shqiptarë e importojnë heroinën në bashkëpunim të ngushtë me trafikantët turq, maqedonas dhe kosovarë. Zakonisht, transportimet organizohen me maune, autobusë, dhe makina drejt rrugëve të dyta, ose Turqi-Bullgari-”ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”-Shqipëri, ose Turqi-Bullgari-”ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”-Kosovë-Shqipëri. Shumica e heroinës gjen rrugën e saj për në Greqi, Itali, Bosnjë-Hercegovinë, (e cila nuk ka paraqitur informacion për periudhën 2005/2006), Kroaci, Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe në vazhdim drejt tregjeve në Shtetet e tjera Anëtare të BE-së.

⁵² UNODC Raporti Botëror mbi Drogën 2006.

⁵³ Europol Raporti mbi Drogën 2006.

⁵⁴ Europol Raporti mbi Drogën 2006.

⁵⁵ Europol Raporti mbi Drogën 2006.

⁵⁶ Në këtë kontekst “Shqiptarët” janë konsideruar si persona që e identifikojnë veten si të tillë, duke u bazuar në kulturën, historinë, gjuhën, traditat apo pasardhësit e tyre, pavarësisht nga fakti se ku jetojnë, në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi, Serbi, apo në ndonjë vend tjetër.

Vetëm një përqindje e vogël e heroinës, në shumicën e rasteve e një cilësie të dobët, qëndron në Shqipëri për të plotësuar kërkesat në rritje të tregut vendas. "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" llogarit se sasia e heroinës së konsumuar në vit është afërsisht rreth 300 kg. Mali i Zi ka raportuar se heroina në tregun vendas zakonisht përpunohet dhe përzihet me substanca të ndryshme. Heroina është droga e dytë më shumë e gjindshme në tregjet serbe; pjesa më e madhe e heroinës vjen nga Kosova, ku heroina raportohet të jetë droga më e gjindshme. Kontrabandimi i kimikateve perkursore në Afganistan, të cilat përdoren në prodhimin e paligjshëm të heroinës, përbëjnë një anë tjetër të këtij biznesi "të papastër". Konfiskimi i 34 tonëve acidi anhidrit, (një kimikat perkursor për heroinën), që u raportua nga Bosnjë-Hercegovina në vitin 2005, dëshmon për ekzistencën e një tregëtie të perkursorëve kimikë që përdoren për prodhimin e drogës në Europën Jug-Lindore.

Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e bëra deri më tani dhe konfiskimeve të raportuara, sipas përlogaritjeve të sasive të mëdha të heroinës që trafikohet përmes Europës Jug-Lindore, konfiskimet e bëra përbëjnë vetëm një nivel tejet të vogël.

Si pasojë e këtij zhvillimi, UNODC-ja, për herë të parë, ka përcaktuar vendet e Europës Jug-Lindore në Raportin a saj Vjetor mbi Drogën për vitin 2006, duke i cilësuar këto vende "me tendencë rritjeje" në lidhje me abuzimin e heroinës dhe opiateve të tjera. Kjo gjë ka një impakt të konsiderueshëm për Europën dhe Ballkanin, jo vetëm përse i përket disponueshmërisë së heroinës, por gjithashtu edhe përse i përket termave të sigurisë dhe stabilitetit, si edhe besueshmërisë së komunitetit ndërkombëtar në lidhje me ri-ndërtimin a shoqërive të brishta të pas-luftës.

Llogaritjet e mbizotërimit të përdorimit të drogës me kalimin e kohës janë të pabarabarta dhe madje nuk lejojnë të identifikohen tendenca me afate kohore të mesme. Në ngjashmëri me Shtetet e reja Anëtare të BE-së, vendet e Europës Jug-Lindore duket se kanë përjetuar probleme me heroinën më vonë, duke pasur kështu një situatë më të ndryshueshme. Në shumicën e vendeve të projektit, heroina mbetet droga kryesore për të cilën klientët kërkojnë mjekim. Sipas autoriteteve maqedonase të shëndetësisë, çdo vit rreth 600 deri në 700 individë kërkojnë mjekim shëndetësor në lidhje me abuzimin me drogat. Sipas autoriteteve shqiptare në bazë të të dhënave të qendrave të trajtimit për narkomanët, gjatë vitit 2000 ka pasur 968 persona që kanë kërkuar mjekim, ndërsa në vitin 2003 numri i tyre është rritur në 1,360 persona. Përgjigja më e fundit nga anketat e vitit 2006 nuk përmendin shifra, por theksojnë se vihet re një rritje e qëndrueshme e numrit të personave që kërkojnë mjekim. Përveç disa shifrave⁵⁷, asnjë prej zonave të tjera të projektit nuk ka dhënë të dhëna statistikore.

3.1.5 Kokaina

Kokaina prodhohet nga gjethet e kakaos të kultivuara në Amerikën Jugore. Zona nën kultivimin e gjetheve të kakaos (159,600 hektarë) ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme kryesisht gjatë vitit 2005 me një shifër prej 28% më pak se nivelet maksimale të shënuara gjatë vitit 2000 (221,300 hektarë). Shumica e kakaos vazhdon të kultivohet në Kolumbi (54%), e ndjekur kjo nga Peruja (30%) dhe Bolivia (16%)⁵⁸.

Megjithëse e destinuar kryesisht për tregun amerikano-verior, një sasi e konsiderueshme e kokainës trafikohet nga Amerika e Jugut për në Europë përmes Oqeanit Atlantik, me anë të rrugëve ajrore apo detare, kryesisht nëpërmjet Spanjës dhe Hollandës, ndërkohë që kokaina vjen në Europën Jug-Lindore përmes porteve të Detit Adriatik dhe rrugëve tokësore si nga jugu është edhe nga veriu. Anijet e shpejta, anijet tregëtare dhe anijet e transportit kontenier, mbeten format më të përdorshme për lëvizjen e drogës përmes rajonit, por trafikuesit mund të përdorin gjithashtu edhe avionët për hedhje nga lart në ujërat ndërkombëtare. Në vitin 2005, autoritetet kolumbiane raportuan madje konfiskimin e një nëndetëseje që ishte në procesin e ndërtimit⁵⁹.

Prodhimi global i kokainës ka mbetur pothuajse në të njëjtin nivel në vitin 2005, dhe kjo është praktikisht e pandryshueshme po të krahasohet me nivelet e një dekade më herët. Potenciali për prodhimin e kokainës arriti shifrën prej 910 tonë metrikë në vitin 2005. Prodhimi potencial i kokainës në Peru arriti shifrën prej 180 tonë

⁵⁷ Deri më tani, në Shqipëri çmimi i heroinës ndryshon nga 11,000 Euro/kilogrami deri në 14,000 Euro kilogrami. Fitimet nga tregu maqedonas i afrohen shifrave prej 10-12 milionë Euro.

⁵⁸ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën 2006.

⁵⁹ Europol Raporti mbi Drogën 2006; Kjo anije do të kishte pasur mundësinë të transportonte 15 tonë kokainë përmes Detit të Karaibeve.

metrikë në vitin 2005, ndërsa për Bolivinë, shifra arrin në 90 tonë metrikë. Për arsye të një bashkëpunimi më të mirë mes agjensive të zbatimit të ligjit dhe përmirësimeve në shërbimet e tyre, si edhe në përmirësimin e ndarjes së të dhënave, konfiskimet e kokainës janë rritur vazhdimisht: 34% në vitin 2003 dhe 18% në vitin 2004 (588 tonë metrikë), shifra më e lartë e shënuar ndonjëherë. Treguesit janë të tillë që tregojnë se kjo gjë vazhdoi me të njëjtat ritme në vitin 2005, dhe ndoshta do të vazhdojë e tillë edhe për vitin 2006.

Përdorimi global i kokainës ka rënë pak. Megjithatë, në ndryshim nga zhvillimet në Kanada apo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku mbizotërimet e përdorimit të drogës në një studim për studentët e shkollave të mesme, tregon që si kokaina ashru edhe kokaina e kristalizuuar, ka pësuar rënie vjetore gjatë vitit 2005⁶⁰, ndërkohë që përdorimi i kokainës në Europë është ende në rritje. Përdorimi i kokainës në Europën Perëndimore dhe Qendrore (1.1% e popullatës së moshës nga 15-64 vjeç), është ende i ulët në krahasim me Amerikën e Veriut, (me 2.3%), por tendenca europiane po shkon lart. Pothuajse 25% e përdoruesve të kokainës në botë, (më shumë se 3 milionë vetë) jetojnë në Europën Perëndimore dhe Qendrore. Kërkesat për mjekime që kanë lidhje me kokainën po shtohen. Megjithatë ka ndryshime të konsiderueshme mes vendeve, kokaina numëron rreth 10% të të gjitha kërkesave për mjekim nëpër Europë. Përdorimi i kokainës së kristalizuuar, një formë droge veçanërisht e shoqërueshme me problemet shëndetësore, dhe me probleme të tjera, mbetet e kufizuar në Europë.

Kokaina arrin në të gjitha zonat e projektit me anë të korrierëve, me anë të rrugëve ajrore, e fshehur nëpër bagazhe dhe rroba, me anije, apo me anë të dërgesave postare urgjente.

Trafikimi i kokainës duke përdorur rrugët detare (portet në Greqi, Mal të Zi, Kroaci, Shqipëri dhe Itali), përfshin zakonisht sasira të mëdha (dhe cilësi më të lartë) të këtij narkotiku. Transportimet më të mëdha të kokainës, janë kryesisht të një karakteri tranzit, të transportuara me rrugë tokësore me anë të mauneve, të paketuara shpesh nëpër shishe dhe të drejtuara për në tregjet e BE-së.

Deti më tani, në Shqipëri çmimi i kokainës është rreth 35,000 Euro kilogrami. Policia serbe, gjatë një hetimi të përbashkët me forcat e tjera policore, kryesisht me autoritetet italiane të zbatimit të ligjit, ndihmuan në konfiskimin e 200 kg kokainë, (190 kg u konfiskuan në Itali, ndërsa 10 kg u konfiskuan në Serbi). Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e kokainës janë të organizuara mjaft mirë dhe kanë strategji transportuese efikase.

3.1.6 Drogat dhe krimi

Në nivel europian, të dhënat e krahasueshme në shumicën e aspekteve të marrëdhënieve mes drogave dhe kimit, në pjesën më të madhe mungojnë. Përrjashtimi i vetëm janë shlekjet ligjore në fushën e drogës, të cilat regjistrohen si vepra penale përkundrejt legjislacionit në lidhje me kontrollimin e drogave. Megjithatë krahasimet mes vendeve duhen bërë me kujdes, duket se mes fundit të viteve 1990 dhe vitit 2003, veprat penale në lidhje me drogën pësuan një rritje në mjaft vende të BE-së, dhe vendet e Europës Jug-Lindore përfituan mjaft nga ky zhvillim. Të gjitha Kodet Penale në zonat e projektit e kanë adoptuar legjislacionin përkatës kundër drogave.

Pak dihet në lidhje me çmimet, fitimet, dhe përdorimin e të mirave të përfutuara nga krimi, që përbën edhe bazën për hetimet e ardhshme, p.sh. në pastrimin e parave apo konfiskimet. Duke pasur parasysh faktin e prodhimit të drogës, trafikimit të saj dhe shitjes në rrugë që gjeneron biliona për Europën, në Euro (apo në dollarë amerikanë), duket se ka ende një fushë të gjerë për të përmirësuar zbatimin e ligjit.

Serbia ka raportuar në lidhje me grupin kriminal më të madh të organizuar, të quajtur "Klani i Zemunit"⁶¹, i cili kishte 6 nën-grupe që mbulonin shitjen me anë të rrjeteve të tyre të tregëtarëve. Udhëheqësit e klanit i investuan të ardhurat e tyre, që llogariteshin në miliona Euro në prona të tundshme e të patundshme dhe në mallra luksi. Për ta siguruar biznesin e tyre, duke përdorur fuqinë e tyre të pamasë financiare, që llogaritet në qindra milionë Euro, klani filloi të korruptojë zyrtarë në gjyqësor dhe në polici, dhe themeloi një media me qëllim që të ndikonte tek opinioni publik. Të ardhurat e paligjshme nga lrimi, duket se janë investuar në privatizime, prona të patundshme, biznese tregëtare, etj ... Fitimet nga tregu maqedonas arrijnë deri në 10-12 milionë Euro. Fitimi i përgjithshëm nga

⁶⁰ UNODC, Raporti Botëror mbi Drogën 2006; Sipas këtij studimi, mbizotërimi i kokainës ka pësuar një rënie prej 20% më pak se në vitin 1998.

⁶¹ Zemuni është një qark i Beogradit.

veprat penale të lidhura me drogën, nuk mund të specifikohen në mënyrë më të detajuar, duke pasur parasysh mungesën e hetimeve në fushën e pastrimit të parave.

Grupet kriminale kroate përfshijnë struktura të përziera, të cilat udhëhiqen zakonisht nga një person me të kaluar penale. Disiplina zbatohet përmes kërcënimeve dhe dhunës, më shumë për t'i detyruar klientët të paguajnë borxhet e tyre, si edhe përmes tërheqjes së fitimeve kriminale. Anëtarët kanë një tendencë drejt veprave të tjera penale, siç janë kontrabanda e armëve dhe cigareve dhe zhvajtjen e parave. Të ardhurat e përfituara haexhohen më së shumti në prona të tundshme e të patundshme, siç janë pronat në zonat turistike, dhe mënyrën ekstravagante të jetesës. Agjensitë kroate të zbatimit të ligjit kanë raportuar që kriminelët e organizuar përdorin mënyra të ndryshme për të mbrojtur veprimtaritë e tyre, siç janë masat e kundërsurvejimit, përdorimin e shpesh të mesazheve të koduara dhe shprehjeve të caktuara gjatë bisedave telefonike dhe komunikimeve me e-mail, ndryshimin e shpesh të kartave telefonike të para-paguara, veprimtaritë transkombëtare, transferimin e paligjshëm të parave të fituara ilegalisht, përmes kufijve të shteteve dhe bankat e huaja.

Sipas autoriteteve shqiptare, vlera e drogës së prodhuar apo të trafikuar përmes Shqipërisë arrin shumën mesatare vjetore prej 50 milionë Euro.

3.1.7 Drogat dhe SIDA

Në fund të vitit 2005, në botë kishte rreth 38,6 milionë njerëz që jetonin me HIV/SIDA. Gjatë të njëjtit vit, u shënua një numër i përlloritur prej 4,1 milionë rastes të reja, si edhe një numër prej 2,8 milionë njerëz të cilët humbën jetën. Një e treta e popullatës që jeton me HIV/SIDA janë të moshës nga 15 dhe 24 vjeç. Abuzimi i drogës me anë të injektimit, përbën një nga forcat madhore që e shtyn këtë epidemi, duke i atribuar asaj një transmetim me HIV prej rreth 5%⁶². Veprimtaritë parandaluese për të kufizuar shpërndarjen e HIV/SIDA-s në nga ata persona që abuzojnë me drogën duke e marrë atë përmes injektimit, dhe kalimit të saj, tek bashkëshortët e tyre, fëmijët dhe popullata në përgjithësi, janë tejet të rëndësishme.

Në përgjithësi, tendenca e SIDA-s përmes injektimit të drogës ka pësuar një rënie prej disa kohësh. Kontakti heteroseksual ia ka kaluar tashmë injektimit të drogës, si faktori me rrezikshmëri më të lartë për zhvillimin e SIDA-s në Europë. Kjo mund t'i atribuohet rritjes së mundësisë të terapisë aktive anti-retrovirale, (HAART) në përdorim që në vitin 1996 në vendet më të prekura të BE-së. Megjithatë, të dhënat në lidhje me këtë duket se janë të varfra përsa i përket një numri vendesh balltike dhe atyre të Europës Jug-Lindore. Mund të debatohet, që një gjë e tillë mund të reflektohet në një rritje të rasteve të reja të SIDA-s në mes personave që injektojnë drogë, të paktën në disa nga vendet e kësaj zone. Shumë pak informacion në lidhje me këtë është siguruar nga zonat e projektit. Duhet të vazhdojë që situata të monitorohet me vigjilencë.

Në vitet e fundit, Europa dhe Azia Qendrore kanë përjetuar rritjen më të shpejtë të epidemisë së HIV/SIDA në rang botëror. Megjithatë, në vendet e Europës Jug-Lindore, mbizotërimi i shkallës së virusit HIV është nën 0.1%, gjë që e vendos atë ndër më të ulëtat. Kjo mund t'i dedikohet nivelit të ulët të infektiveve në gjirin e popullatës, ose pjesërisht, duke pasur parasysh mungesën e sistemeve monitoruese adekuate. Të gjithë faktorët kryesorë kontribues në shpërthimin e epidemisë së HIV/SIDA-s janë tashmë prezentë në këtë rajon. HIV-i dhe SIDA ndikon në mënyrë jo-proporcionale të rinjtë (80% të njerëzve të infektuar me HIV, janë të moshës 30 vjeçare ose më të rinj)⁶³. Shumica e vendeve kanë popullata shumë të reja, të cilat janë ndikuar nga proceset e tranzicionit shoqëror, luftërat, papunësia dhe faktorë të tjerë. Mes të rinjve, ka një rritje të përdorimit të drogës dhe sjelljeve të rrezikshme seksuale.

Prandaj, numri i rasteve me HIV pritet që në të gjitha vendet e projektit të rritet, dhe kjo tashmë po ndodh, veçanërisht në Serbi. Edhe shfaqja e Hepatitit C ka pësuar gjithashtu rritje, gjë që sugjeron praktikën e ndarjes së shiringave të infektuara mes përdoruesve të drogës.

⁶² UNODC, Abuzimi dhe Kërkesa për Drogë, Qershor 2006.

⁶³ Banka Botërore, HIV/SIDA në Ballkanin Perëndimor, Tetor 2005, fq. 1-199.

Përveç vuajtjes njerëzore, një epidemi HIV/SIDA mund të ketë një impakt domethënës në koston e kujdesit për individët, familjet, shërbimet shoqërore, dhe shoqërinë si të tërë. Një studim i Bankës Botërore ka gjetur sisteme të dobëta shëndetësore dhe hapësira në lidhje me financimin e tyre, bashkë me mungesa të kapaciteteve të nevojshme institucionale, për të zbatuar Strategjitë HIV/SIDA të bazuara në fakte dhe që të kenë një kosto të efektshme. Duhet të rritet angazhimi politik për të vepruar me saktësi kur ndodhin gjërat. Ndërhyrjet parandaluese janë me kosto të efektshme, dhe në afatet e shkurtra, të përballueshme me burimet brenda vendit.

Tabela 2: Konfiskimet e Drogës në “Rrugët Ballkanike” midis 1998 dhe 2004 në kilogramë dhe njësi

Vendi	Droga	2000	2001	2002	2003	2004*	2005	2006 (I-V)
Shqipëria	Heroina	47.000	4.500	71.714	114.475	155.925	40.9	77.6
	Kokaina	4.000	0.266	0.006	1.286	2.4	2.8	1.0
	Kanabisi Bimor	6604.0	6915.0	13717.89 9	7760.170	4544.154 (marihuana) 73757(bimë)	8,332.0	379.9
	Kanabis rrëshirë	-	-	-	-	1.185		
	Ecstasy Amf.	-	-	-	-	10 u		
Bosnja dhe Hercegovina	Heroina	0.375	1.900	3.265	-	5.036	68.53	
	Kokaina	164.392	-	0.240	-	-	30.86	
	Kanabisi Bimor	127.982	467.585	919.545	-	168.192	318.51+ 1,956 bimë	
Kroacia	Kanabis rrëshirë	-	0.060	-	-	-	11.86	
	Ecstasy	-	-	1212 u	-	-	3,387	
	Amf.	-	-	117.000	-	-	4.71	
	Heroina	7.041	19.569	46.359	85.727	114.4	27.1	
	Kokaina	913.127	1.487	3.365	380.769	17.6	9.0	
	Kanabisi Bimor	797.501	737.911	608.070	435.037	428.2	983.2	
“Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë”	Kanabis rrëshirë	1.041	4.559	2.107	2.281	5.9	53.4	
	Ecstasy	9979 u	12906u	110632u	29840u	27.048 u	33.601u	
	Amf. (kg and njësi)	2.124	0.931	28.026	3.814	7.2	14.3	
	Heroina	90.789	110.882	28.572	66.145	242.000	69.3	
	Kokaina	4.689	5.860	0.342	0.342	0.131	11.0	
	Kanabisi Bimor	1333.399	99.115	29.234	180.681	550.000	203.2 + 3,077 bimë	
Serbia dhe Mali i Zi	Kanabis rrëshirë	427.519	309.846	258.406	423.564	-	3.2	
	Ecstasy	280 u	45 u	0.002 kg 18 341 u	-	-	2.857u	
	Amf.	-	-	7.015	-	-	1.8	
	Heroina	-	62.518	43.462	262,995. 0	469.604	342.010	

Raporti mbi Situatën CARPO

Mali i Zi ⁶⁴	Kokaina	-	3.723	1.962	5,336.1	15,468.0	5,321.0	
	Kanabisi Bimor	-	1230.224	774,284	1464.955	3901,870	1142,004	
	Kanabisi rrëshirë	-	4.534	6.814	648.1	3,350.1	8,020	
	Ecstasy	-	0.079 kg 10811 u	10 000 u	76,194u	9,260u	7,539u	
Mali i Zi	Amf. Heroina	-	0.087	-	113.1 kg	6.1 kg	1.1 kg	
	Kokaina	-					17.6	
	Kanabisi Bimor	-					0.03	
Kosova	Kanabisi Bimor	-					367.5	
	Kanabis rrëshirë	-					10.5	
	Ecstasy	-						
	Amf.	-						
	Heroina	-	0.82	6.11	46.78	23.28	36.48	5.81
	Kokaina	-	0.04	1.41	8.48	0.01	3.79	
	Kanabisi Bimor	-	30.72	48.05	30.82	23.29 + 7,983 bimë	55.30 + 31,158 bimë	16.16
	Kanabis rrëshirë	-	-	-	-	0.95	0.21	0.26
	Ecstasy	-	4u	50u	40u	56u	39.5u	
	Amf.	-	0.03	0.02	-	12.0	13.12	

*Të dhënat për 1998-2004 janë marrë nga UNODC Raporti Botëror mbi Drogën - 2005. Të dhënat për 2004 janë marrë nga Departamenti Amerikan i Shtetit *Raportet e Strategjisë së Kontrollimit Ndërkombëtar të Narkotikëve*, për 2003 dhe 2004, dhe pjesërisht edhe të dhënat për 2005 - 2006 janë marrë nga zonat e projektit, të cilat i janë përgjigjur pyetësorit për vitin 2006 (shih kapitullin 4).

3.2 TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE⁶⁵

Në një raport të kohëve të fundit theksohet se ka ende mungesë informacioni në lidhje me përmasat e këtij krimi dhe se përpjekjet për të luftuar këtë lloj trafikimi kanë qenë deri më sot pak a shumë të pabashkërenduara dhe jo të efektshme⁶⁶. Për shumë vite trafikimi i qenieve njerëzore ka qenë pjesë e axhendës së qeverive të shumë vendeve europiane. Veç të tjerash, kjo reflektohet në numrin e madh të konventave ndërkombëtare të nënshkuara në vitet e fundit:

- Konventa për të drejtat e fëmijëve (1990)⁶⁷;
- Konventa e Europolit (1998)⁶⁸;
- Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e qenieve njerëzore [SPTF] (2000)⁶⁹;
- Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për “Aktet kundër Trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimi seksual” (2000) dhe për “Mbrotjtjen e fëmijëve ndaj shfrytëzimit seksual” (2001)⁷⁰;
- Direktivë e Këshillit të Bashkimit Europian për plotësimin e dispozitave të Nenit 26 të Konventës për implementimin e Marrëveshjes së Shengenit të 14 Qershorit 1985 (Përgjegjësia penale e agjencive të fluturimit “ (2001)⁷¹;
- Vendimi Kuadër i Bashkimit Europian për luftën kundër Trafikimit të qenieve njerëzore (2002)⁷²;
- Protokoll i Opsional i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve, për shitjen e fëmijëve (2002)⁷³;
- Autorizimi europian i arrestimit (European arrest warrant) (extradimi) (2002)⁷⁴;
- UNOHCHR, Parime dhe Udhëzime të Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2002)⁷⁵;
- Plan i Veprimit të OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁷⁶;
- ‘Protokoll për Trafikimin’ i Konventës së UNTOC (2003)⁷⁷;
- Vendimi Kuadër i Këshillit të Bashkimit Europian për luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë (2004)⁷⁸;
- Direktiva e Këshillit të Bashkimit Europian mbi lejen për qëndrim afat-shkurtër (2004)⁷⁹;
- Konventa e Këshillit të Europës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (ETS 197)

⁶⁵ Ky raport qëllimisht nuk trajton çështje të adoptimit të jashtëligjshëm të fëmijëve, trafikimit të organeve apo të pornografisë me fëmijë, të cilat janë në fakt aspekte të trafikimit të qenieve njerëzore.

⁶⁶ Raport i UNODC “Trafficking In Persons: Global Patterns”, botuar më 24 Prill 2006.

⁶⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, aprovuar nga rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithëshme, datë 20 Nëntor 1989, hyrë në fuqi më 2 Shtator 1990. Bullgaria dhe Rumania, dhe vendet candidate për në Bashkimin Europian, Kroacia dhe Turqia, e kanë nënshkruar dhe ratifikuar këtë protokoll.

⁶⁸ Konventa për Ngritjen e një Zyre të Policisë Europiane (Konventa e Europolit), në bazë të Nenit K.3 të traktatit për bashkimin europian, Aneksi i referuar në Nenin 2, 1998.

⁶⁹ SPTF u krijua për të inkurajuar dhe forcuar bashkëpunimin mes vendeve të Europës Jug-lindore (SEE) dhe punon nën patronazhin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), fatkeqësisht veprimtaritë e dokumentuara perfundojnë në vitin 2004.

⁷⁰ Këshilli i Europës, R(2000)11 dhe R (2001)16.

⁷¹ Direktiva e Këshillit të Bashkimit Europian 2001/51/EC, OJ L 187/45.

⁷² Vendimi i Kuadër i Këshillit të Bashkimit Europian 2002/629/JHA, OJ L 203/1.

⁷³ Protokoll i Opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë u bë ligjrisht i zbatueshëm në 18 Janar 2002. Deri tani më shumë se 100 vende e kanë nënshkruar dhe ratifikuar këtë Protokoll (see: www.ohchr.org).

⁷⁴ Vendimi Kuadër i Këshillit të Bashkimit Europian 2002/584/JHA, OJ L 190/1.

⁷⁵ UNHCHR, Parime dhe Udhëzime të Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Suplement i Raportit të Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Këshillin Ekonomik dhe Social. f.2. E.2002.68.

⁷⁶ Bazuar në Deklaratën Ministrore për Trafikimin e qenieve njerëzore, aprovuar në Porto, 2002.

⁷⁷ Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons, Especially women and Children, supplementing the United Nations Convention against Transnational Organised Crime, aprovuar nga Rezoluta A/RES/55/25 e dt. 15 Nëntor 2000 në session e pesëdhjetë e pestë të Asamblesë së Përgjithëshme të Kombeve të Bashkuara, hyrë në fuqi më 25 Dhjetor, 2003. Të gjithë vendet e përfshira në projekt e kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Palermos të Kombeve të Bashkuara dhe Protokollin Shoqërues të Trafikimit.

⁷⁸ 2004/68/JHA, 22 Dhjetor 2003.

⁷⁹ EU Council Directive 2004/81/EC, 29 Prill 2004, (OJ L 626/19, 6.8.2004).

Ndërkohë që është e pashmangshme që një pjesë e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore hyjnë në një vend tjetër si emigrantë të paligjshëm, si pasojë e metodave të përdorura nga trafikantët, kemi të bëjmë me dy lloje shumë të ndryshme krimi⁸⁰. Në ndryshim me konceptin e kontrabandimit të emigrantëve, që kryesisht nënkupton kalimin e kufirit në mënyrë të paligjshme, në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore kemi të bëjmë me shkelje të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, të cilët shpesh janë viktimë e rrjeteve të organizuara kriminale.⁸¹ Si e tillë, pra, më shumë se me një çështje të politikës së emigracionit, çështja ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave dhe të drejtave të tyre, si dhe me ndëshkimin e trafikantëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Trafikimi i qenieve njerëzore përbën, kështu, një problem shumë-planësh e gjithnjë e në rritje në nivel global⁸².

Si pasojë, duhen nënvizuar gjashtë sfida madhore qeveritare:

- Zbatimi dhe vënia në funksionim me efektshmëri i një legjislacioni të harmonizuar anti-trafik;
- Ulja e kërkesës për shërbime të ofruara nga punonjëset e seksit, apo për produkte me çmime të ulura të prodhuara nga njerëz që shfrytëzohen me forcë në ferma, fabrika apo miniera;
- Intensifikimi i bashkëpunimit për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare;
- Vënia në shënjestër e kriminelëve që përpiqen të përfitojnë nga vulnerabiliteti i njerëzve që përpiqen t'i shpëtojnë varfërisë, papunësisë, urisë apo shtypjes;
- Mbrojtja e viktimave të trafikimit, veçanërisht gratë dhe fëmijët;
- Dhënia e ndihmës institucionale për përfshirjen e viktimave të trafikimit në programet e rikthimit të tyre në vendet përkatëse.

Trafikimi i qenieve njerëzore, edhe pse përbën një krim të rëndë dhe shkelje të drejtave të njeriut, në shumë vende vazhdon të trajtohet si shkelje e lehtë, që nuk merr dënime të rënda e nuk kërkon pajisje speciale apo rrjete të komplikuar biznesi. Fatmirësisht, siç ndodh në shumicën e vendeve europiane⁸³, vendet e projektit, falë mbështetjes së organizmave dhe programeve europiane, si p.sh. CARDS⁸⁴, Këshilli i Europës⁸⁵, Qendra SECI, Pakti i Stabilitetit, OSBE, ODIHR dhe Kombet e Bashkuara, kanë kohë që kanë përqëndruar përpjekjet e tyre në lidhje me këto çështje.

Në vitin 2003, Projekti LARA i Këshillit të Europës identifikoi vendet që kanë një boshllëk në legjislacion në lidhje me këto shkelje. Në pyetorin 2006 të Këshillit të Europës shumica e vendeve pjesëmarrëse në projekt raportuan amendamente substanciale në legjislacionin përkatës, veçanërisht në Kodet Penale respektive⁸⁶, strategji të reja, plane veprimi, ndryshime organizative dhe strukturore, si dhe akivitete të tjera (përveç Bosnias dhe Hercegovinës). Tani së fundmi Organizata Ndërkombëtare e Emigracionit (IOM) sapo ka përfunduar me sukses një projekt dy-vjeçar në mbështetje të shteteve të Europës jug-lindore për dhënien e lejeve provizore të qëndrimit viktimave të trafikuar, me angazhimin në këtë proces të OJQ-ve të ndryshme, përfshirë edhe krijimin e një mekanizmi *watchdog*. Të gjithë vendet e rajonit të përfshira në projekt kanë përpunuar dhe vënë në veprim

⁸⁰ *Trafficking of Human Beings for Sexual Exploitation in the EU: A Europol Perspective*, Janar 2006.

⁸¹ Sipas Nenit 3 (a) të Konventës së UNTOC "Trafikim personash do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, pritja apo marrja në dorëzim i personave, nëpërmjet kërcënimit apo përdorimit të forcës a të formave të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, mashtrimit, gënjeshtërisë, abuzimit të pushtetit apo të pozitës vulnerabël, apo marrjes dhe dhënies së pagesave apo përfitimeve për të siguruar aprovimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve, apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën dhe shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktika të ngjashme me skllavërinë, apo heqjen e organeve".

⁸² Raporti i UNODC "Report on "Trafficking In Persons: Global Patterns, 24 Prill 2006, ka identifikuar 127 vende të origjinës, 98 vende transit dhe 137 vende destinacioni dhe konkludon se: "Praktikisht asnjë vend në botë nuk është i paprekur nga krimi i trafikimit të qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual apo punë të detyruar."

⁸³ Europol, "Legislation on Trafficking in Human beings and Illegal Immigrant Smuggling", Tetor 2005.

⁸⁴ Community Assistance for Reconstruction, Development and Stability.

⁸⁵ Për shembull: Këshilli i Europës, Projekti LARA, Criminal Law Reform in South-eastern Europe on Trafficking in Human beings, Korrik 2002 - Tetor 2003.

⁸⁶ Në ndryshim nga Bashkimi Europian, nivelet dhe llojet e ndëshkimeve nuk ndryshojnë ndjeshëm mes vendeve të përfshira në projekt, të cilat janë në përputhje të plotë me Konventën e UNTOC dhe me objektivin e politikës së Bashkimit Europian për harmonizimin e legjislacionit.

legjislacionin e domosdoshëm për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord të mbështesin një qasje rajonale ndaj problemit në fjalë⁸⁷.

Edhe pse janë bërë mjaft përmirësime në nivelin e legjislacionit⁸⁸, problem mbetet moszbatimi në terma konkrete i standarteve ndërkombëtare nga ku edhe përfitojnë trafikantët e qenieve njerëzore.

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi (seksual) i individëve vulnerabël është kryesisht një “krim i nëndheshëm”, gjë që shpjegon dhe vështirësinë për përcaktimin në mënyrë të saktë të përmasave të problematikës që lidhet me elementë të ndryshëm të kësaj forme të krimit të organizuar. Shumë nga përpjekjet për zbatimin e ligjit fokusohen vetëm në elementët e dukshëm të trafikimit të qenieve njerëzore, duke anashkaluar në pjesë të madhe strukturat spontane dhe organizative që fshihen pas tyre. Kudo në Europë, shpesh nuk dihet se shumë nga raportimet për shkelje penale, si për shembull në rastin e përdhunimeve, izolimeve apo burgimevet e paligjshme, dëmtimeve të rënda trupore, apo rastet e grabitjeve apo vjedhjeve (të dokumentave), fshehin në vetvete elementë të trafikimit të organizuar të qenieve njerëzore. Situata komplikohet më tej në lidhje me identifikimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore nisur nga fakti se shumë shpesh gratë e trafikuar heshtin në lidhje me trafikantët e përfshirë në krim, pasi përpiqen të mbrojnë familjet në vendet e tyre të cilët gjenden nën kërcënimin e grupeve të krimit të organizuar.

Trafikimi i qenive njerëzore shpesh ka të bëjë me organizata kriminale që përdorin kërcënimin apo ushtrjnë dhunë, përdorin forcën, mashtrimin, gënjeshtren apo mjete të tjera. Trafikimi përfshin disa veprime të dallueshme, por të ndërlidhura, si rekrutimi, transporti, vendosja/akomodimi, dhe shfrytëzimi, që nuk është diçka që ndodh vetëm një herë, por që kryhet gjatë një periudhe të caktuar kohe. Grupet e krimit të organizuar shfrytëzojnë në një anë mundësitë që ofron tregu për shërbime seksi dhe punë të lirë (kërkesa), dhe, në anën tjetër, situatën vulnerabël të grave dhe fëmijëve në shumë vende (oferta). Për më tepër bëhet fjalë për përfitime të larta ndërkohë që, megjithë ndryshimet në legjislacionin përkatës, risku i kontrollit dhe i sanksioneve është i ulët, ⁸⁹ si dhe përfitohet nga fakti se sistemi i ri i kontrollit të kufijve në BE-në e zgjeruar ende nuk ka nisur të funksionojë siç duhet⁹⁰.

Shifrat e ulëta të raportuara dhe niveli i ulët i dënimeve të dhëna për keqbërësit e përfshirë në trafikim të qenieve njerëzore është një çështje që përbën shqetësim serioz e që duhet trajtuar me kujdes. Raporti ka për qëllim të plotësojë boshllëqet në legjislacion në vendet e projektit duke trajtuar çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore në lidhje me dënimet e harmonizuara dhe të përshtatshme, legjislacionin procedural, parandalimin, rritjen e vetëdijes publike, mbledhjen e të dhënave dhe intensifikimin e proceseve të ri-integrimit.

Nuk është e qartë nëse ka patur vërtetë një rritje të numrit të personave të trafikuar nga ose nëpërmjet vendeve të Europës Jug-lindore për në BE, pasi ende nuk bëhet një grumbullim i centralizuar i të dhënave, që do të lejonte përcaktimin e përshkallëzimit real të problemit ⁹¹. Mungesa e të dhënave dhe statistikave të sakta për fenomenin dhe angazhimi relativisht i mangët forces së ligjit në këtë fushë problematike ka penguar dukshëm që vendet e përfshira në projekt të mund të raportonin në mënyrë të plotë e të hollësishme.

⁸⁷ Konferencë për Bashkëpunimin Rajonal në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Stokholm, 9 Qershor, 2006, McKinley, Drejtor Gjeneral i IOM-it, fjala hyrëse, ku ai nënvizon se “kjo gjë përbën një shembull për disa nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian”.

⁸⁸ Të gjitha vendet e projektit kanë nënshkruar Konventën e Palermos të Kombeve të Bashkuara dhe Protokollin e Trafikimit të 12 Dhjetorit 2000. Ratifikimi i tij ndodhi në Shtator 2001 (Serbia dhe Mali I Zi), Prill 2002 (Bosnia dhe Hercegovina), Gusht 2002 (Shqipëria), Janar 2003 (Croacia) dhe Janar 2005 (“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”).

⁸⁹ Në 2006, Europoli raportoi dhënien e dënimeve me burgim për 18 dhe 23 vjet të trafikantëve të dënuar në UK. Në këtë mënyrë trafikimi i qenieve njerëzore nuk përbën më një aktivitet me “risk të ulët”.

⁹⁰ Europol, 2005 *EU Organised Crime Report*, 25 Tetor 2005.

⁹¹ Shiko raportet shumë të hollësishme për vitet 2002, 2003 dhe 2004 nga Barbara Limanowska “*Trafficking in Human beings in South-eastern Europe - Focus on Prevention in: Albania, Bosnia and Herzegovina, Bulgaria, Croatia, the former Yugoslav Republic of Montenegro, Serbia, Moldova, Romania, Montenegro, Serbia, and the UN Administered Province of Kosovo.*”, përgatitur dhe botuar nga UNICEF, UNOHCHR dhe OSCE/ODIHR në Mars 2005.

Informacioni i siguruar përmes organizatave ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë, megjithatë, bën të ditur se nuk kemi të bëjmë me ndonjë rënie të këtij biznesi, por mundet që kemi të bëjmë me një tendencë të re, pasi duket të kemi më shumë “trafikim të brendshëm” në disa nga vendet e origjinës, si dhe një “treg të fshehur”

Çdo vit, qindra e mijëra burra, gra e fëmijë trafikohen apo kontrabandohen në mënyrë të paligjshme në të gjithë botën. Informacioni që ekyiston në lidhje me përmasat e vërteta të problemit është i kufizuar dhe në varion në varësi të burimeve të ndryshme. Për shembull, në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit “Trafikimi i personave” (TIP) për vitin 2005⁹² raportohet se në të gjithë botën, çdo vit trafikohen përmes kufijve ndërkombëtare afërsisht 600,000 deri 800,000 persona për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar, nga të cilët 70% janë gra dhe 50% fëmijë. Sipas vlerësimeve të IOM-it 500,000 gra trafikohen çdo vit për në tregjet e prostitucionit në Europë⁹³. Ndërsa OSBE-ja ka vlerësuar se 1.2 milionë fëmijë (nën 18 vjeç) trafikohen në të gjithë botën çdo vit, blihen e shiten për t'u shfrytëzuar në punë shtëpiake apo ferma, në miniera dhe në industrinë e seksit, ose për t'u shfrytëzuar si lypsarë apo për krime të vogla.

Edhe pse mungojnë të dhëna të sakta, sipas vlerësimeve të disa OJQ-ve që punojnë në këtë fushë, deri në 30% të viktimave të trafikuar në Europën Jug-lindore janë fëmijë. Pritet që këto shifra të rriten, pasi trafikantët përpiqen të sigurojnë vajza më të reja për shfrytëzim seksual, veçanërisht ato të tregëtuara apo të shituara si të virgjëra nga frika e HIV/AIDS. Përgjigjet e marra nga vendet e përfshira në projekt në lidhje me trafikimin e fëmijëve ishin jo të përshtatshme dhe shifrat të paplota e fragmentare. Veç kësaj, trajtimi i fëmijëve të trafikuar në të njëjtën mënyrë siç trajtohen rastet e të rriturve nuk është e saktë, veçanërisht në rastet kur fëmijët janë shitur nga vetë prindrit e tyre.

Për këtë arsye Task Forca e Paktit të Stabiliteti i pat kërkuar vendeve të rajonit zhvillimin e një Plani Veprimi Kombëtar të plotë kundër trafikimit të fëmijëve dhe zbatimin e tij sa më shpejt të ish e mundur⁹⁴. Vendet e Projektit, megjithatë, duhet t'i përpunojnë këto Plane Veprimi në përputhje edhe me standartet e BE-së, si Vendimi Kuadër i BE-së për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve e të pornografisë me fëmijë⁹⁵, si dhe Direktivën për leje-qëndrimin provizor për viktimat e trafikimit që bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.

Duke patur parasysh rëndësinë që marrin “Rrugët e Ballkanit” për kontrabandimin dhe trafikimin e një serie mallrash të kërkuara në tregjet europiane, nuk është për t'u habitur që një numër i madh i personave të trafikuar, veçanërisht gra, kalojnë tranzit nëpër këto rrugë⁹⁶. Tashmë ka ca kohë që trafikimi i qenieve njerëzore përbën një problem serioz për Europën Jug-lindore. Ky rajon ka shërbyer si tranzit dhe vend burim, por gjithnjë e më shumë edhe si vend destinacioni.

Për më tepër, afërsia mes vendeve të origjinës, si Moldavia, Rumania, Ukraina nga njëra anë dhe vendeve hyrëse për në BE, si Greqia dhe Italia në anën tjetër, bënë të mundur që rrejet kriminale të trafikimit nga Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë të bashkëpunojnë ngushtësisht mes tyre.

Biznesi i trafikimit funksionon në këtë mënyrë:

- **Rekrutimi:** Gratë u përgjigjen njoftimeve për punë në gazetë apo internet për kujdestare fëmijësh, modele, parukiere, kërcimtare, kamariere, etj. Ato rekrutohen apo inkurajohen, nga miq apo të afërm të tyre, për të përfituar nga “mundësi punësimi në Perëndim”;

⁹² Departamenti Amerikan i Shtetit (2005), “*Trafficking in Persons (TIP) Report*”; Megjithatë, absolutisht i njëjti vlerësim është dhënë edhe nga Raporti TIP I 2002 (<http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2005/>).

⁹³ www.iom.int/en/news

⁹⁴ Taska Forca e Paktit të Stabilitetit për trafikimin e qenieve njerëzore, takimi i 6 për anti-trafikimin, Beograd, 23-24 Mars 2004, Konkluzionet dhe Raporti i Progresit, Portoroz, 7 Qershor 2004.

⁹⁵ Këshilli i BE-s, “*Trafficking in human beings*” Vendimi Kuadër, 19 Korrik 2002.

⁹⁶ Mes arsyeve të tjera, ‘Rrugët e Ballkanit’ nxitën Shefin e Task Forcës për Policinë Europiane t’i kërkojë Europolit të përpilojë një Plan Veprimi specifik për trafikimin e qenieve njerëzore nga një vend problematik (Bullgaria), që u aprovua në Maj 2003

- **Mashtrimi me dokumentet e identifikimit:** Transporti dhe dokumentet e identifikimit rregullohen nga grupe të krimit të organizuar;
- **Detyrimi i borxhit:** Shpesh dokumentet e identifikimit u merren me të mbërritur në destinacion dhe femrat gjenden para nja borxhi të madh që i detyrohen trafikantëve për transportin e që u duhet ta shlyejnë nëpërmjet prostitucionit;
- **Shtrengimi me dhunë:** Shpesh femrat shtrengohen me dhunë. Ka raportime të shumta për femra të mbajtura në izolim, të rrahura, të përdhunuar, të drogjuara në mënyrë që t'i "thyejnë" ato e t'i detyrojnë të punojnë. Për këtë qëllim kërcënohen edhe familjet e tyre;
- **Shfrytëzimi i vazhduar:** Viktimat shiten apo shkëmbehen mes grupeve kriminale dhe vendeve të ndryshme me qëllim që të sigurojnë ekzistencën e "mallit të freskët" në treg, të parandalojnë zbulimin, dhe të disorientojnë viktimën, duke i hequr asaj çdo mundësi për kontakte që mund ta ndihmojnë të largohet.

Prania ndërkombëtare, sidomos në Kosovë dhe Bosnie e Hercegovinë⁹⁷, fillimisht krijoi një kërkesë të konsiderueshme për shërbime seksi në fund të viteve 1990 dhe në fillim të viteve 2000, duke e kthyer Kosovën dhe Bosnien e Hercegovinën në një zonë destinacion për gratë e trafikuar⁹⁸. Në Janar të vitit 2004, lista e UNMIK-ut për baret dhe ambjentet e tjera, që nuk duheshin frekuentuara nga stafi i KFOR-it dhe UNMIK-ut, disa prej të cilave besohet se ishin përfshirë në trafikim, shkoi në më shumë se 200 në janar 2004⁹⁹. Në të njëjtën kohë, në Kosovë dhe Bosnie e Hercegovinë shumë vende publike ku ofroheshin shërbime të seksit, u mbyllën me ndërhyrjen e EUFOR-it, KFOR-it dhe të agjensive të zbatimit të ligjit.

Përgjigjet e dhëna për pyetsorin 2006 të Këshillit të Europës tregojnë se një punë e madhe mbetet për t'u bërë për një përmirësim të mëtejshëm të rezultateve të qeverisë e të zbatimit të ligjit në këtë fushë dhe provojnë sa më poshtë:

Tabela 3: Shifra në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore të raportuara nga vendet e projektit

2005	Shqipëria	B dhe H	Kroacia	Kosova	Mali i Zi	Serbia***	"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"
Raste	40 (Mol) 409 (GPO)	-	6	45	3	-	12
Raste OC	-	-	2	-	-	-	-
Grupe OC	3 (Mol) or 21**	-	-	-	-	-	-
Shkelës	65 (Mol) 439 (GPO) 75 **	-	-	90	3	-	40
Viktima	-	-	-	-	23	44	-

* Mol (Ministria e Brendshme) – GPO (Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm)

** Trafikimi i femrave, armëve dhe qenieve njerëzore;

*** 2000-2006: 314 raste, 286 shkelës, 2002-2006: 190 viktima.

Shqipëria ka raportuar se në vitin 2003 janë përndjekur 24 grupe kriminale të përfshira në trafikim (nuk është dhënë informacion në lidhje me numrin e rasteve dhe të shkelësve të ligjit) Në nëntë muajt e parë të vitit 2004, janë shpërbërë 13 grupe kriminale, të cilët kishin të regjistruara 74 raste femrash të trafikuar për qëllime shfrytëzimi

⁹⁷ Në fundi të 2005, KFOR-i kishte në Kosovë 16,000 paqeruajtës nga 36 kombe (<http://www.nato.int/kfor>); numri aktual i trupave të EUFOR-it është 7,000 <http://www.euforbih.org> dhe më shumë se 250 organizata ndërkombëtare dhe OJQ.

⁹⁸ Shiko deklaratën për shtyp të Amnesty International *Kosovo: Trafficked women and girls have human rights*, 5 Qershor 2004 <http://news.amnesty.org/mavp/neës.nsf/print/ENGEUR700122004> dhe *Kosovo: International peacekeepers fuelling explosion in sexual exploitation, trafficking and human misery*, 6 Maj 2004; *Human Rights Eatch Hopes Betrayed: Trafficking of women and girls to post-conflict Bosnia and Herzegovina for forced prostitution*, Vol 14, No. 9, nëntor 2002; dhe *Kosovo UN troops 'fuel sex trade'*, BBC nëës, 5 Qershor 2004, news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/europe/3686173.stm.

⁹⁹ Numri i vendeve "off-limit" (që nuk duhen frekuentuar) jep vetëm një refleksim të përafërt të shkallës së rritjes së trafikimit dhe prostitucionit. Raporti i vitit 2003 i Njësisë Investigative të UNMIK-ut për Përndjekjen dhe Trafikimin (TPIU) , Amnesty International (2004) dhe intervistë me zyrtarin e UNMIK-ut, Korrik 2005.

seksual, me implikimin e 115 shkelësve. Janë regjistruar gjithashtu edhe nëntë raste të trafikimit të fëmijëve me implikimin e 11 shkelësve. Nuk është dhënë asnjë informacion për tre muajt e fundit të vitit 2004. Për vitin 2005, policia ka raportuar 30 raste të trafikimit të grave me 49 keqbërës/shkelës dhe 10 raste trafikimi të miturish me 16 shkelës. Një tjetër burim policor ka raportuar 21 grupe të krimit të organizuar me 75 shkelës të akuzuar për krimin e trafikimit të femrave për prostitucion, të armëve dhe të qenieve njerëzore. Për të njetën periudhë Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në Tiranë (GPO) ka raportuar 409 raste të trafikimit të grave me 439 keqbërës/shkelës. Pavarësisht nga të tilla shifra të ndryshme, që nuk lejojnë bërjen e një analize të saktë, Shqipëria konfirmon se trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen në rënie. Megjithatë sipas UNODC, Shqipëria është, në radhë të parë vend transit ("shumë i lartë"), kryesisht për viktimat të trafikuar nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina për në Greqi, Itali dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Së dyti, është vend origjine ("shumë i lartë"), vendet destinacion janë kryesisht Belgjika, Franca, Greqia, Italia, Holanda, Mbretëria e Bashkuar dhe, në një masë më të ulët, Gjermania. Së treti, Shqipëria është vend destinacion ("mesatar") për të trafikuarit nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar trafikimit të fëmijëve, sidomos të fëmijëve romë, e egjiptianë. Shifrat zyrtare janë dukshëm fragmentare, të ndryshme dhe përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të problemit në përgjithësi, ndaj vëmendje më e madhe i duhet kushtuar këtij fenomeni kriminal.

Bosnia dhe Herzegovina (BiH) vë në dukje në përgjigjet e dhëna për pyetsorin e vitit 2005 se shfrytëzimi seksual është bërë më i fshehtë e më i sofistikuar (apartamente private, shërbime eskorte, Internet). Megjithatë, BiH nuk ka paraqitur shifra apo të dhëna për 2004, apo 2005. Megjithatë sipas UNODC, BiH është, në radhë të parë, vend tranzit ("i lartë"), kryesisht për viktimat nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina për në Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Së dyti, është vend destinacion ("i lartë") për viktimat që vinë nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina, por edhe nga Bjellorusia, Kazakistani dhe Federata Ruse. Së fundi, BiH është vend origjine ("mesatar"), nga ku viktimat trafikohen për në Kroaci, Gjermani, Itali, Hollandë, Spanjë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Viktimat janë kryesisht gra dhe vajza për shfrytëzim seksual.

Kroacia ka raportuar se tregu i saj i trafikimit është i vogël krahasuar me vende të tjera të projektit, në rajon. Në 2004 ishin 3 grupe të krimit të organizuar me 11 keqbërës/shkelës të përfshirë në 3 raste të regjistruara. Në 2005 janë hetuar në total 6 raste të trafikimit të qenieve njerëzore, nga të cilat vetëm dy prej tyre rezultuan të lidhura me krimin e organizuar. Këto të dhëna tregojnë se Kroacia vazhdon të jetë vend transit, megjithëse është raportuar se "treguesit statistikorë demonstrojnë në mënyrë të qartë se Kroacia po bëhet një vend destinacion". Në fakt, sipas UNODC, Kroacia përgjithësisht klasifikohet vetëm si "mesatar", si vend destinacion (për viktimat nga Ukraina), vend transit (për viktimat nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina dhe vende të tjera të Europës Qendrore dhe Juglindore për në vendet e BE-s) dhe vend origjine (veçanërisht për Austrinë, Italinë dhe Spanjën).

Kosova ka raportuar se në 1 nëntor 2005 përfundoi procesi i ndryshimit të emërtesave apo të mjaft strukturave policore dhe se sektori i trafikimit të qenieve njerëzore (THBS) u integrua plotësisht nën komandën e Shërbimit Policor të Kosovës (KPS), në Departamentin e Krimit të Organizuar. Oficerët ndërkombëtarë të policisë nuk e kanë më statusin e supervisorit dhe që nga ky moment luajnë rolin e Oficerëve monitorues (Monitors and Liaison Officers). Në Maj të vitit 2005, u nënshkrua Plan Veprimi i Kosovës për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, një kuadër i konsoliduar i të gjithë veprimeve dhe aktorëve pjesëmarrës në veprimtaritë anti-trafik. Kosova ka caktuar një Koordinator të Shërbimeve Sekrete në sektorin e trafikimit të qenieve njerëzore, gjë që ka shërbyer për bërjen e një analize më të mirë. Në vitin 2003, IOM-i ka raportuar një numër të konsiderueshëm kosovarësh të trafikuar brenda për brenda vendit (83), sidomos të mitur rreth moshës 15 vjeçare¹⁰⁰. Në vitin 2004, janë identifikuar 48 viktimat, 11 nga të cilët fëmijë (më pak se 18 vjeç). Shumica e viktimave vinin nga Moldavia (17), Shqipëria (13) dhe vetëm 11 ishin nga Kosova. Sipas analizave zyrtare dhe të besueshme të Sektorit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore (THBS¹⁰¹) në UMNİK për vitin 2005, janë regjistruar një numër total prej 95 shkeljesh, janë akuzuar rreth 90 shkelës dhe arrestuar 34. Shumica e shkelësve ishin shqiptarë etnikë (45). Numri i viktimave të trafikuar ishte 49, nga të cilët 14 ishin fëmijë. 38 viktimat (11 fëmijë) pranuan asistencë për strehim

¹⁰⁰ Shih *Amnesty International* (2004) dhe IOM (Korrik 2004) f. 63 - 64.

¹⁰¹ THBS - *Year End Report 2005*; Megjithatë: Prokurorët ndërkombëtarë, në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë në UMNİK, raportojnë për të njetën periudhë vetëm 17 raste, me 37 keqbërës, nga të cilët vetëm 17 janë dënau.

dhe vetëm një pjesë u kthyen vendin e tyre (14)¹⁰². Në 2005 janë realizuar disa operacione të mëdha, të hapura ose të mbuluara. Deri më sot (Qershor 2006), THBS ka bërë kontroll në 603 lokale, ka mbyllur 15 prej tyre, ka bërë 20 arrestime për trafikim të qenieve njerëzore dhe prostitucion, ka identifikuar 20 viktime, 13 nga të cilët kanë përfituar asistencë nga DAS (Asistencë Direkte për viktimat e trafikimit, një partneritet agjensish, ku perfshihen THBS, MOJ, CSW, IOM dhe OJQ). UNODC e klasifikon Kosovën, së pari, si vend tranzit (“i lartë”) për viktime nga Bjellorusia, Moldavia, Rumania, Federata Ruse dhe Ukraina, për t’u trafikuar për në Shqipëri, Bosnie e Hercegovinë, Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore, si dhe në Mal të Zi dhe Serbi. Së dyti, Kosova është vend destinacion (“i lartë”), me viktime që trafikohen nga Moldavia, Rumania, Ukraina, por edhe nga Bullgaria dhe Federata Ruse. Së fundi, Kosova raportohet si vend origjine (“mesatar”) për viktime të trafikuar për në Itali dhe Austri, por edhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Mali i Zi raporton 28 raste në 2003, 10 nga të cilat me 31 shkelës që duket se veprojnë brenda 7 grupeve të krimit të organizuar për periudhën 2000 - 2004, dhe vetëm 3 raste me 3 shkelës dhe 23 viktime të trafikuar në 2005. Raporti i Trafikimit të UNODC doli në Prill 2006, kështu që analiza për Malin e Zi është kryer për Unionin Serbi e Mal i Zi (shih më poshtë).

Serbia ka raportuar për vitin 2003 një total prej 17 rastesh trafikimi të kryera nga 106 shkelës organizuar në 16 grupe të krimit të organizuar. Në Serbi policia ka identifikuar 49 viktime të trafikimit në 2003¹⁰³, shumica e të cilëve ishin nga Rumania, Moldavia, Ukraina dhe Federata Ruse. Duket se po rritet fenomeni i trafikimit brenda vendit të viktimave lokale, sidomos të mitur. Për 2005 nuk janë raportuar shifra të krahasueshme (veç faktit se numri i viktimave të trafikuar duket se po bie dhe se në 2005 nga 44 viktime në total, 21 ishin qytetarë të huaj, kryesisht nga Moldavia, Ukraina dhe Rumania). Në gjysmën e parë të 2004-ës, OJQ-ja lokale ASTRA ka ndihmuar 30 viktime të trafikimit, 22 nga të cilët vendas dhe vetëm 8 të huaj. Sipas Raportit të Trafikimit të UNODC, Serbia dhe Mali i Zi, ishin, në radhë të parë, vende tranziti (“i lartë”) për viktime nga Europa Qendrore dhe Jug-lindore për në Bosnie e Hercegovinë, sidomos nga Moldavia, Rumania dhe Ukraina për në Itali dhe vende të tjera të Europës Perëndimore. Në radhë të dytë, ato janë raportuar si vende destinacioni (“mesatar”), kryesisht për viktimat nga Ukraina dhe, në një shkallë më të ulët, nga Moldavia, dhe si vende origjine (“mesatar”) për Hollandën dhe Spanjën.

“Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” ka raportuar se përmes vëndit janë trafikuar rreth 2000 deri 4000 gra duke gjeneruar një përfitim vjetor nga kjo veprimtari kriminale rreth 30 milione Euro. Në të njejtën kohë raportohen vetëm 21 raste për 2004, që përfshijnë 13 grupe kriminale me 52 shkelës, dhe vetëm 12 raste me 40 shkelës për 2005. Sipas UNODC, ky vend klasifikohet, në radhë të parë, si vend tranzit (“i lartë”) kryesisht për viktime nga Bullgaria, Moldavia, Rumania, Ukraina për në Shqipëri dhe, pjesërisht, që aty përmes Italisë për në Francë dhe Mbretërinë e Bashkuar, por edhe nga vende të tjera të Europës Qendrore dhe Jug-lindore drejt Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë. Veç kësaj, është vend origjine i nivelit “të mesëm” për viktimat e trafikuar drejt Italisë dhe vend destinacion për viktimat e trafikuar nga Bullgaria, Moldavia, Rumania dhe Ukraina.

Për trafikimin e qenieve njerëzore në Europën Jug-lindore mund të nxirren konkluzionet e mëposhtme:

- Nga pikëpamja sasiore, trafikimi i qenieve njerëzore në Europën Jug-lindore duket të jetë një krim jo shumë i rëndësishëm e që, për më tepër, duket se është në rënie ose, të paktën, po bëhet më pak i dukshëm. Më pak viktime kthehen nga vendet e rajonit për në vendin e tyre të origjinës, por më shumë viktime kthehen nga vendet e BE-s në vendet e tyre të origjinës¹⁰⁴. Viktime që kërkojnë asistencë duket të jenë më të pakta. Gjithashtu edhe raportimet për trafikim të qenieve njerëzore në këtë rajon janë më të pakta. Megjithatë, shumica e raporteve nacionale janë fragmentare, nuk njihen shifra të vërteta, janë të paqarta, ndryshojnë nga burimi në burim, bile edhe brenda informacioneve të dhëna nga i njëjti burim, janë të pamjaftueshme,

¹⁰² UNICEF/UNOHCHR/OSCE-ODIHR (2002, 2003) dhe 2004: *THB in South Eastern Europe 2004 – Focus on Prevention*. Duhet nënvizuar, megjithatë, se të dhënat janë marrë nga burime të ndryshme dhe janë shpesh kontradiktore. Ndaj, çdo deklaratë për tendenca zhvillimi positive apo negative duhet konsideruar me kujdes, Mars, 2005.

¹⁰³ UNICEF/UNOHCHR/OSCE (2004), f. 116.

¹⁰⁴ Kjo është konfirmuar edhe nga IOM-i në Gjermani, i cili raporton vetëm një numër shumë të vogël të grave që vijnë nga vendet e projektit, p.sh të arrestuara në Gjermani dhe të rikthyera në vendet e tyre (2003/2004: asnjë, 2005: 1 për në Shqipëri, 1 për në Kroaci dhe 1 për në FYROM, por 19 për në Bullgari dhe 23 për në Rumani).

shkurt të diskutueshme. Zyra hollandeze e "National Rapporteur Against Trafficking in Human Beings (Raporteri Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore)" vlerëson se vetëm 5% e viktimave raportojnë viktimizimin e tyre, apo arrijnë të tërheqin vëmendjen e autoriteteve shtetërore¹⁰⁵, e nejtja analizë ekziston edhe në Shtete të tjera Anëtare të BE-s.

- Shumica e personave të trafikuar veprojnë në përputhje me të ashtu-quajturit "Push & Pull Factors" (Faktorët e Shtytjes & Tërheqjes), që kombinohen me fenomenin e emigracionit ilegal. Arsytet që i shtyjnë personat të largohen nga një zonë, për të shkuar diku tjetër, njihen si "Faktorë të shtytjes" (si papunësia e lartë, tregu i punës i mbyllur ndaj grave dhe diskriminimi në bazë të seksit, varfëria, mungesa e mundësive për të përmirësuar cilësinë e jetës, diskriminimi seksual dhe racial, ikja nga persekutimi, dhuna, abuzimi apo shkelja e të drejtave të njeriut apo arsye të tjera sociale e ambientale). Arsytet që i tërheqin personat drejt një zone të veçantë "Faktorë të Tërheqjes" (si kërkesa për punëtorë në industrinë e seksit, kërkesa nga shumë konsumatorë të pasur për seks komercial, mundësitë më të mira për punësim, paga më të larta e kushte më të mira pune apo standarte e cilësi më të mira jetese)¹⁰⁶.
- Profili i viktimave është i qartë: viktimat janë në pjesën më të madhe gra e vajza që janë të huaja në vendin ku shfrytëzohen. Në pak raste janë raportuar viktima fëmijë e meshkuj, veçanërisht nga Shqipëria e Kosova. Në shumicën e tyre viktimat janë nga vende të Europës Qendrore dhe Jug-lindore: Moldavia, Rumania, Ukraina, Federata Ruse, Bullgaria. Gjithashtu është vënë re edhe një ndryshim i profilit të viktimave: numri në rritje i viktimave vendase të rekrutuara nga Shqipëria, Bosnia dhe Herzegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova për një lloj "tregu rajonal, pjesërisht si një fazë fillestare që i paraprin udhëtimit të gjatë të viktimës drejt industrive perëndimore të seksit (kryesisht Austri, Belgjikë, Francë, Gjermani, Itali, Hollandë dhe Mbretëria e Bashkuar), të cilat janë pak a shumë vendet e destinacionit final.
- Trafikimi i fëmijëve nuk mund të jetë kurrësesi një nën-produkt i neglizhuar në trafikimit të qenieve njerëzore. Ai gjeneron përfitime të mëdha dhe si pasojë është në duart e kriminelëve të organizuar e për pasojë po zgjerohet në mënyrë dramatike. Krimi i përcaktuar si trafikim fëmijësh nënkupton shfrytëzimin komercial seksual të fëmijëve, përfshirë edhe pornografinë me fëmijë. Por nënkupton edhe forma të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve, duke i detyruar ata të vjedhin, të lypin si dhe i referohet edhe fëmijëve që punojnë në kushtet e punës së detyruar. Fëmijët zënë një numër të konsiderueshëm të viktimave. Në disa vende të Europës Jug-lindore, 50 për qind a më shumë e viktimave të raportuara janë nën moshën 18-vjeçare, d.mth janë fëmijë¹⁰⁷. Ky numër pritet të rritet akoma më tej, pasi trafikantët dhe bashkëpunëtorët e tyre po fokusohen gjithmonë e më shumë tek viktima gjithmonë e më të vogla në moshë pjesërisht nga frika e infeksionit HIV e AIDS¹⁰⁸. Disa vende raportojnë trafikim fëmijësh për qëllim lypje, prostitucion, apo qëllime të tjera edhe më të kamufluara, si adoptimi ilegal, apo marrje organesh. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar trafikimit të ciganëve, egjiptianëve, e veçanërisht fëmijëve romë për shfrytëzim seksual, për të lypur dhe për adoptim¹⁰⁹.
- Shumica e rekrutimeve bëhen nga persona të të njejtit nacionalitet me viktimën e që pas këtij momenti viktima trafikohet në tregjet e huaja. Duket, gjithësesi, se ka disa ndryshime në lidhje me rekrutimet e bëra nga persona me të njejtin nacionalitet. Kjo tendencë e re mund të interpretohet si një kërkesë më e lartë për këto tregje, apo se grupet e krimit të organizuar nga këto vende janë fuqizuar më shumë. Edhe pse rekrutimi vazhdon të kryhet sipas metodave tashmë të njohura (shiko më lartë), vihet re tendenca e

¹⁰⁵ Bureau NRM (2005), *Trafficking in human beings*, Raporti I Tretë dhe I Katërt I Raportit Nacional Hollandez, Den Haag: Bureau NRM <http://www.victimology.nl/onpub/national/NL-NRMEngels>; Gjithashtu: Raporti i Katërt i Qeverisë hollandeze për implementimin e Konventes së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (CEDAW), 2000-2004.

¹⁰⁶ Europol, *Fact sheet on Trafficking in Human Beings*, 2005 (www.europol.eu.int).

¹⁰⁷ *Save the Children* (2004).


¹⁰⁸ OSCE Conferencë e nivelit të lartë "Lufta kundër Trafikimit të Fëmijëve", Vienë, 18 Mars 2005, (http://www.osce.org/documents/cTHB/2005/03/15338_en.pdf).

¹⁰⁹ Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Europë (OSBE): "Awareness Raising for Roma Activists on the Issue of Trafficking in human beings in South-Eastern Europe", Konferenca e Varshavës, Prill 2006 dhe botime të Qendrës Europiane për të Drejtat e Romëve (www.errc.org).

rekrutimit nga gratë, që, në pjesën më të madhe, janë vetë viktimat të trafikuar¹¹⁰. Ky lloj rekrutimi bëhet përmes një kontrolli më të kujdesshëm, në bazë të informacioneve që tregojnë se nga vjen viktimat e çfarë familje ka¹¹¹. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, viktimat që kanë përfituar asistencën e IOM-it, për shembull, tregojnë se ekziston një nivel më i lartë ndërgjegjësimi për mundësinë e trafikimit, por megjithatë ato janë të gatshme të rrezikojnë me qëllim që të mund të largohen nga vendi i tyre.

- Përveç dhunës dhe kërcënimit, presioni psikologjik dhe korrupsioni, si dhe bashkëpunimi me autoritetet, duket se janë mjetet më të përhapura për të mundësuar trafikimin dhe për mbrojtjen e biznesit. Trafikimi i qenieve njerëzore kërkon që autoritetet publike të mbyllin sytë ndaj këtij problemi apo të bashkëpunojnë aktivisht (duke filluar që nga nivelet politike dhe personat që mund të ndikojnë në marrjen e vizave, zyrtarët e emigracionit, stafi i ambasadave, doganat, policia, zyrtarët lokalë që lëshojnë lejet e punës, policia gjyqësore, e të tjerë¹¹².
- Trafikimi i viktimave përtej kufirit si dhe trafikimi i brendshëm i viktimave lokale, në shërbim të një tregu lokal e rajonal, me kërkesa gjithnjë në rritje për shërbime seks, vazhdon të jetë një problem serioz. Pasi janë trafikuar brenda vendit, viktimat fitojnë njëfarë “përvojë” e më pas ato mund të trafikohen përtej kufirit. Viktimat e trafikuar brenda vendit konsiderohen si pjesë e një lloji të vjetër biznesi prostitucioni dhe ende nuk po shihen nga autoritetet e këtyre vendeve si një fenomen kriminal në rritje. Kjo gjë ka pasoja të veta për viktimat (të cilave shpesh vazhdon t’u mohohet mbrojtja dhe ndihma) si dhe për zbatimin e ligjit (ku deportimi i referohet investigimeve afat-gjata për krimin e organizuar). Kjo gjë mund të shpjegojë përse në të gjithë Europën investigimet e krimit të organizuar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore janë të pakta.

Grafiku 6: Trafikimi i raportuar në Europë



Burimi: Raport i UNODC për Trafikimin, 2006

- Në Kosovë dhe Bosnie e Hercegovinë, të trafikuarat e përfshira në biznesin e seksit komercial duket se jetojnë në kushte më të mira, me një rrogë të vogël, por të paguar rregullisht, dhe banesa private më të mira. Dhuna e ushtruar për kontrollimin e viktimave duket të jetë zvogëluar dhe është zëvendësuar nga një

¹¹⁰ Në Kosovë informacionet e mbledhura konfirmojnë se deri 50% e rekrutuesve janë femra dhe zakonisht ish- viktimat të shfrytëzuara në industrinë e seksit. .

¹¹¹ Për shembull, në Gjermani, nga 1100 trafikantë të dyshuar, 31% e të dyshuarve ishin nga Europa Qendrore dhe Lindore, 215 ishin femra, shpesh herë ish-prostituta, që tani rekrutonin gra nga vendet e tyre apo bënëin agjenten për shtëpitë publike, apo supervizonin shtëpitë publike (BKA, *Organised Crime situation report on Trafficking in human beings*, 2003).

¹¹² Këshilli i Europës (2002): *Trafficking in human beings and Corruption* (Programi PACO, TP 28 rev). Strasburg.

trajtim më i mirë për të shmangur vëmendjen e padëshiruar, që funksionon në kombinim me një formë jo-të dhunshme kontrolli – varësinë ndaj drogës dhe alkolit¹¹³.

- Klientela lokale dhe tregjet lokale janë në rritje dhe zhvillim. Mbyllja e shumë bareve dhe klubeve në Bosnie e Hercegovinë çoi në një shvendosje të tregut, duke bërë që shërbimet e seksit tashmë të ofrohen në apartamente private e me shërbime eskorte, gjë që e bën më të vështirë t'i zbulosh e t'i kontrollosh. Gjithashtu, me kufizimet e vëna për trupat e huaja në Bosnie e Hercegovinë, si dhe në Kosovë, tregu i krijuar tashmë është vënë kryesisht në shërbim të klientelës lokale¹¹⁴. Përmirësimi i situatës në lidhje me zbatimin e ligjit dhe hetimet e ndërmarra me sukses në zonat ku ushtrohet ky aktivitet mund të kenë çuar në uljen e shifrave. Megjithatë, ulja mund të shpjegohet edhe me tendencën e qartë për të kaluar në veprimtari “pas-dyerve”, gjë që i vështirëson hetimet e policisë. Gratë dhe vajzat vendosen në apartamente të mbyllura ku presin klientët, ose viktimat femra dërgohen nga një takim në tjetrin, ku gjithshka rregullohet përmes telefonit, apo komunikimit me internet.

Rekomandime:

- Nisur nga kompleksiteti i çështjes në fjalë dhe ndërvepimi mes faktorëve të ndryshëm që ushqejnë dhe mbajnë trafikimin, bëhet e domosdoshme pasja e një qasje të integruar dhe në shumë nivele. Një qasje e tillë duhet mbështetur në një bashkëpunim dhe koordinim shumë-disiplinor mes të gjithë faktorëve të interesuar, duke përfshirë organizatat jo-qeveritare (OJQ-t), organizatat e punës dhe aktorë të tjerë relevantë të shoqërisë civile¹¹⁵. Vendet e origjinës, transit dhe destinacion duhet të rrisin më tej bashkëpunimin e tyre në mënyrë që të realizojnë një progres domethënës. OJQ-t, gjithashtu, luajnë një rol thelbësor, jo vetëm në dhënien e ndihmës personave të trafikuar, por edhe në monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit nga ana e Shtetit të detyrimeve ligjore në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut.
- Vendet e përfshira në projekt duhet të nxiten në ngritjen e një pike qendrore ku mblidhet dhe analizohet në mënyrë sistematike informacioni i marrë nga burime të ndryshme. Kjo mund të jetë një zyrë e “Raporterit nacional”, si në Hollandë, ose një tjetër mekanizëm i këtij lloji. Objektivi mund të ishte monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë të pavarur i strategjive dhe plan-veprimeve kombëtare, mbledhja e të dhënave nga të gjitha agjensitë e përfshira në proces, përfshirë edhe zbatimin e ligjit, marrja në mënyrë sistematike e informacionit nga OJQ-t dhe organizmat ndërkombëtare, bërja e analizave, shkëmbimi i informacioneve të inteligjencës me vende të tjera në rajon dhe, në fund, raportimi tek qeveritë apo parlamentet e vendeve në fjalë.

¹¹³ IOM (Korrik 2004) f. 10-12.

¹¹⁴ Up to 90% of clientele in Kosovo are Kosovar males, IOM (July 2004), p.67 citing UNMIK's TPIU.

¹¹⁵ European Commission, Experts Group on Trafficking in human beings, 2006.

3.3 KONTRABANDA E PERSONAVE

Emigracioni është një temë mjaft komplekse, qoftë si çështje sociale, qoftë si një problem kriminal. Protokollin e Kombeve të Bashkuara për Emigracionin nga Toka, Deti dhe Ajri¹¹⁶ ka për qëllim parandalimin dhe luftën kundër kontrabandave të personave. Kjo e fundit ka ca ngjashmëri, në disa aspekte, me trafikimin e personave, por mes tyre ka disa ndryshime të rëndësishme. Së pari, kontrabandimi i emigrantëve, edhe pse shpesh kryhet në kushte të rrezikshme dhe degraduese, ka të bëjë me emigrantë që kanë rënë dakord që të kontrabandohen, pra të kalojnë kufirin në mënyrë ilegale. Trafikimi i viktimave, në dallim me këtë, ka të bëjë me persona që, ose nuk kanë rënë dakord për një gjë të tillë, ose, edhe nëse kanë qenë fillimisht dakord, kjo gjë e humbet kuptimin, si pasojë e veprimeve dhunuese, mashtruese apo abuzive të përdorura nga trafikantët. Së dyti, kontrabandimi përfundon me mbërritjen e personave në destinacionin e planifikuar, ndërsa në rastin e trafikimit, shpesh shfrytëzimi i viktimës vazhdon përtej këtij momenti, në vende të tjera, gjë që gjeneron të ardhura të tjera të paligjshme për trafikantët. Së treti, kontrabandimi është gjithmonë ndërshtetëror/ndërkufitar, ndërsa trafikimi mund të mos jetë i tillë (trafikimi i brendshëm).

Globalizimi kontribuon në rritjen e konsiderueshme të kontrabandimit të personave dhe trafikimit të qenieve njerëzore, duke bërë që, si kontrabandimi i personave, edhe trafikimi i tyre, të bëhen biznesi kryesor global i grupeve të krimin të organizuar. Ashtu siç ndodh në rastin e trafikimit, shkaqet kryesore të kontrabandimit janë pikërisht “faktorët e shtytjes” që çojnë në zhvendosje të detyruar të njerëzve, si fatkeqësitë natyrore, lufta, konfliktet etnike dhe fetare, persekutimi politik, luftrat civile dhe varfëria, apo gjendja e rëndë ekonomike, faktorë që i shtojnë emigrantët të lenë vendin e tyre. “Faktorët e tërheqjes”, të tillë si nevoja për forca të lira pune, gjendja ekonomike e stabilizuar dhe siguria e përgjithshme sociale, një lloj zhvillimi relativ në vendet destinacion, sistemet qeverisëse demokratike, stabiliteti politik e social dhe, më e rëndësishmja, ekzistenca e diasporave/komuniteteve të caktuara, përbëjnë kriteret për zgjedhjen e një vendi destinacion, që shpesh është një Shtet Anëtar i BE-s.

Në Europë kontrabandimi i personave – si një shprehje e emigracionit të paligjshëm – përbën një çështje mjaft të rëndësishme politike¹¹⁷ dhe për shumë kohë tashmë ka zënë një vend prioritar në axhendat nacionale e ndërnacionale, ndër të tjera e trajtuar në lidhje me zgjerimet më të fundit dhe ato të ardhshme të BE-s, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe aksesin me tregjet e punës, ksenofobinë e racizmin, si dhe në lidhje me kërkesat ekonomike që vijnë me rënien e popullsisë aktive në BE¹¹⁸, duke forcuar në këtë mënyrë domosdoshmërinë për një emigracion ekonomik të ligjshëm dhe më të kontrolluar¹¹⁹.

Është e vështirë të përcaktosh shtrirjen e emigracionit ilegal¹²⁰. Shifrat e përlogaritura bazohen kryesisht në kërkesat për azil, gjë që mund të japë një ide të përafërt, por s’mund të shërbejë si bazë për të gjykuar në lidhje

¹¹⁶ Neni 3 i “Protokollit kundër Kontrabandimit të Personave në rrugë Detare, Tokësore dhe Ajrore”, suplement i Konventës së UNTOC, i nënshkruar dhe ratifikuar nga të gjitha vendet në projekt, e përkufizon kontrabandimin si “...prokurimi, me qëllim përfitimi direkt apo indirekt financiar apo material, i hyrjes ilegale të një personi në një Shtet tjetër/palë, ku personi nuk është shtetas apo resident i përhershëm”. Sipas Konventës së Europolit, Shtetet Anëtare të BE-s e përkufizojnë emigracionin ilegal si : “...veprimtari që kanë për qëllim të mundësojnë, për qëllime përtimi financiar, hyrjen, qëndrimin apo punësimin në territorin e Shteteve Anëtare të BE-s, në kundërshtim me rregullat dhe kushtet e zbatueshme në Shtetet Anëtare”

¹¹⁷ Parlamenti Europian, Projekt mendim i Komitetit për Zhvillim për Komitetin e Lirive Civile, Drejtësisë dhe Çështjet e Brendëshme mbi lidhjet mes emigracionit legal e ilegal dhe integritit të emigrantëve (2004/2137(INI)), Shkurt 2005; Plani i Politikës së Komisionit Europian për Emigracionin Legal, Bruksel, 21 Dhjetor, 2005; Karta e Gjelbër për “një qasje të BE-s për menaxhimin e emigracionit ekonomik (COM(2004)811. Austria si vendi që ka kryesinë e Këshillit të BE-s (gjysma e parë e 2006). Austria ka shpallur një nismë madhore me vendet e reja fqinje me BE-n për promovimin e politikave dhe praktikave koherente dhe bashkëpunuese në lidhje me çështje të emigracionit dhe të sigurisë.

¹¹⁸ Popullsia e BE-s pritet të bie në rreth 20 milionë punëtorë në periudhën 2005 – 2030.

¹¹⁹ Sipas IOM-it, nga 130 milionë emigrantë në të gjithë globin, rreth 20 deri 40 milionë janë emigrantë të parregullt. Mendohet se në vendet e zhvilluara të Europës Perëndimore hyjnë çdo vit rreth 500,000 emigrantë të parregullt. Në të njëjtën kohë, kërkesat për azil në 2003 arritën nivelin më të ulët në 20 vitet e fundit, gjë që tregon një ulje të numrit të emigrantëve legalë, por jo domosdoshmërisht të hyrjeve dhe qëndrimeve ilegale në BE.

¹²⁰ Shiko projektin e përbashkët të ICMPD-Europol “Për një Reagim të Plotë ndaj Vërshimit të Emigracionit të Përzier” dhe takimi i fundit në Liban, më 26-28 April 2006, ku përfaqësues të 59 Shteteve arabe dhe Europiane Partnere (APS-EPS), DCAF, Komisioni Europian, IOM-i, Lidhja e Shteteve Arabe, UNESCWA, UNODC dhe UNHCR dhe FRONTEx u mbledhën për të

me përmasat reale të emigracionit ilegal. Shifrat mbi azilin në BE, përgjithësisht, kanë pësuar një rënie dhe, që me implementimin e EURODAC, databaza që bazohet në marrjen e shenjës së gishtërinjve për azil-kërkuesit e që ka filluar të funksionojë në Janar të vitit 2003, ka rënë edhe “blerja e azilit”¹²¹.

Situata në Europën Jug-lindore është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, edhe pse vazhdon të paraqesë një numër shqetësimesh. Rreth 2 milionë njerëz janë kthyer nëpër vendet e shtëpitë e tyre, por janë ende rreth 1.3 milionë të tjerë të shpërngulur, përfshirë edhe 230,000 serbë etnikë, romë dhe pjesëtarë minoritetesh të tjera të larguar nga Kosova. Mali i Zi, Serbia e Kosova vazhdon të strehojë 390,000 refugjatë nga konfliktet e mëparëshme, komuniteti më i madh i refugjatëve në Botë. Korrupsioni dhe urrejtja ndër-etnike janë shumë të përhapura në disa zona. Rajoni vazhdon të jetë në një udhëkryq mjaft të ndjeshëm dhe shërben kryesisht si një zonë tranzit për kontrabandimin e personave.

Interpoli e di që “Rrugët Ballkanike” për në Europën Perëndimore përdoren për kontrabandimin e emigrantëve nga vendet aziatike e të Lindjes së Mesme, nëpërmjet Iranit, Turqisë dhe Bullgarisë¹²². Një numër gjithnjë e më i madh vendesh europiane raportojnë raste të krimit të organizuar, që kanë të bëjnë me kontrabandimin e personave. Sipas Eurostat, Europol dhe Frontex¹²³, rreth 500,000 emigrantë ilegalë vërshojnë çdo vit në BE, duke iu shtuar rreth 300,000 – 400,000 azil-kërkuesve të regjistruar, shumica e të cilëve përmes “Rrugëve ballkanike”.

Sipas një analize më të hollësishme të Europol-it¹²⁴, shqetësimi aktual më i madh i Shteteve Anëtare të BE-s është numri ende domethënës i emigrantëve ilegalë nga Rajoni i Ballkanit, Federata Ruse, Kina, Iraku dhe vendet poshtë shkretëtirës së Saharasë, India, Afganistani dhe Pakistani. Disa nga vendet më të afërta fqinje me BE-n përdoren si pika e fundit para përfundimit të këtij udhëtimi klandestin për në BE. Afërsia gjeografike dhe lidhjet social-kulturore midis vendeve të origjinës, tranzit dhe destinacion, sistemet ekzistuese të transportit legal dhe ilegal, si dhe ekzistenca e diasporave, natyrisht, përcaktojnë rrugët kryesore të përdorura nga kontrabandistët. Organizimi i emigracionit ilegal është një biznes me risk të ulët për grupet e krimit të organizuar, të cilët i ndajnë aktet e ndryshme të emigracionit ilegal në vende të ndryshme, ndërmjet grupeve të ndryshme të krimit të organizuar, gjë që e bën më të vështirë kontrollimin dhe detektimin e strukturave të krimit të organizuar. Emigracioni ilegal gjeneron përfitime të konsideruashme kriminale, çmimi për emigracionin ilegal përcaktohet nga nacionaliteti dhe gjendja financiare e emigrantit, rreziku që paraqet udhëtimi, shkalla e profesionalizmit të “ofruesve të shërbimit” dhe, në një masë më të pakët, nga vendi i destinacionit.

Si rezultat i identifikimit dhe i shfrytëzimit të dobësive në regjimet ekzistuese të kontrollit të emigracionit, janë krijuar disa rrugë të preferuara, të cilat janë pjesërisht të ndërlydhura mes tyre:

- Rruga e Mesdheut Lindor;
- Rruga Afrikano Veriore;
- Rrugët Ballkanike;
- Rruga e Bregut Atlantik në Afrikën Perëndimore;
- Rruga e Europës Qendrore dhe Lindore;
- Rruga balltike.

Rruga Afrikano Veriore duket se përballon volumin më të madh të emigracionit ilegal për në BE. Rrugët e Europës Qendrore dhe Lindore duket se po marrin rëndësi gjithmonë e më shumë, ndërsa impakti i rrugës Balltike ka rënë. Vendet e përdorura më shumë si tranzit para se të mbërrihet në kufijtë e jashtëm të BE-s janë Rusia (Moska), Ukraina (Kievi), Turqia (Stambolli), dhe, me një natyrë më rajonale, disa vende në Europën Jug-lindore (Sarajeva dhe Beogradit), të cilat përdoren ose si pika nisje, ose si pika grumbullimi për udhëtimin e mëtejshëm për në BE.

identifikuar përbërjen e vërshimeve të emigracionit, rrugët aktuale dhe të reja të emigracionit, veprimtaritë e krimit të organizuar, *modus operandi* dhe çështje të menaxhimit të kufijve. Rezultatet përfundimtare të analizës së rreziqeve, të diskutuara në tre seanca pune, u paraqitën në takimin e dytë të fazës përgatitore, që u fokusua në Sfidat e Sistemeve të Menaxhimit të Emigracionit, që u mbajt në 7-9 Qershor, 2006, në Brdo, Slloveni.

¹²¹ Europol, Emigracioni ilegal i organizuar për në BE, Mars, 2006.

¹²² www.interpol.org

¹²³ Frontex Agjencia e re Europiane për Menaxhimin e Kufijve, aprovuar nga Regullorja e Këshillit (EC) No 2007/2004 I dt. 26 Tetor 2004.

¹²⁴ Europol, , Emigracioni ilegal i organizuar për në BE, Mars, 2006.

Për sa i përket kontrabandimit të personave dhe krimet të organizuar në lidhje me të, duhen nënvizuar këto çështje dhe tendenca zhvillimi¹²⁵:

Të gjitha vendet e projektit (veç Kosovës) janë shtete palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët të v. 1951 dhe Protokollin e v. 1967 dhe kanë aprovuar ligjet për Azilin, kanë amenduar kodet e tyre penale me dispozita të veçanta për kontrabandimin e personave, apo kalimin ilegal të kufijve nacionalë. Deri tani, vendet e projektit janë, pak a shumë, në një linjë me standartet ndërkombëtare dhe kanë nivele të përbashkëta të dënimeve dhe të rrethanave rënduese¹²⁶. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për parandalimin dhe bllokimin e kontrabandimit të emigrantëve ilegalë në përputhje me standartet europiane¹²⁷ apo për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave të trafikuar, pasi edhe pse problemi është shumë serioz, të dhënat dhe statistikave për kontrabandimin e personave nga grupe të krimet të organizuar vazhdojnë të jenë të shumë të mangëta.

Në Shqipëri, falë mbështetjes masive të dhënë nga orgnizmat ndërkombëtare e europiane, kontrollet më të shpeshta e më efektive nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit gjatë viteve të fundit kanë krijuar të tjera vështirësi për kontrabandistët. Është arritur majft sukses, sidomos, në mbylljen e rrugëve drejt Italisë përmes detit, si dhe në ndjekjen e një numri të madh kriminelësh. Përpara se të mbylleshin këto rrugë të kontrabandimit përmes detit për në Itali, rreth 100,000 emigrantë duhet të kenë ndjekur këtë rrugë për të hyrë në vendet e BE-s, gjë që në periudhën 1998 – 2002 duhet të ketë gjeneruar rreth 60 – 100 milionë Euro përfitime të paligjshme. Që nga kjo kohë kanë marrë rëndësi rrugët tokësore dhe pikërisht kufiri me Kosovën (174 km i gjatë) që përshkon një zonë malore, thuhet të pakapërcyeshme, ku kontrolli i policisë, edhe nëse ekziston është fare i pamjaftueshëm¹²⁸. Për sa i takon numrit të rasteve, Shqipëria ka regjistruar në vitin 2003, 16 raste me implikimin e po kaq grupeve të krimet të organizuar dhe të 58 shkelësve.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2004, rekordet tregojnë 365 (ose 280 sipas GPO-s) raste të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të organizimit e asistimit të këtij procesi me implikimin 644 (ose 516 sipas GPO-s) shkelësve, kryesisht me origjinë kosovare (duhet nënvizuar se shifrat e raportuara janë fragmentare dhe me ndryshime). Në vitin 2005, Shqipëria ka raportuar 123 raste të kryera nga 259 shkelës, nga të cilat 13 raste janë raportuar me implikime të grupeve të krimet të organizuar. Duket se kufiri verior i Shqipërisë është përdorur veçanërisht për kalimet e paligjshme (të njerëzve, si dhe të armëve, drogave e të mallrave të tjera) nga grupet shqiptare në bashkëpunim me grupet kosovare, maqedonase e serbe të krimet të organizuar.

Pas marrëveshjes së Paqes së Dejtonit të vitit 1995, *Bosnia dhe Hercegovina (BiH)* ka parë kthimin e më shumë se 730,000 refugjatëve. BiH konsiderohet si një vend transit nga ku transportohen ilegalisht qytetarë shqiptarë, kinezë, turq, indianë e pakistanezë për në vendet e Europës Perëndimore. Ata hyjnë në BiH nga Mali i Zi dhe Serbia, përmes kufirit lindor të vendit. Grupe lokale kriminelësh i shoqërojnë ata përtej lumenjsh e kufijsh ilegalë për në Kroaci. Në të shkuarën, janë regjistruar mjaft raste kur në Bosnie e Hercegovinë kanë hyrë grupe të mëdha emigrantësh ilegalë, gjoja si turistë apo pjesëtarë të shoqatave kulturore. Kohët e fundit duket se komuniteti kinez i vendosur në vend ka lidhje me elementë kriminelë të organizuar që mundësojnë emiracionin nga Kina drejt Europës Perëndimore. Ndërkohë raportohet një kordinim i ngushtë mes agjensive të ndryshme, sidomos takime të rregullta mes aktorëve ndërkombëtarë e nacionalë si Grupi Ndërkombëtr i Punës për luftën kundër trafikimit të geneve njerzore, ku ndër të tjera bëjnë pjesë IOM, OHCHR, OSBE, UNICEF dhe një numër OJQ-sh lokale.

Kroacia ka raportuar se, nga Prilli 2004, rreth 210,000 Serbë krotë vazhdonin të ishin në mërgim, kryesisht në Mal të Zi e në Serbi. Ripërfitimi i pasurive të tyre dhe rindërtimi janë çështjet më të rëndësishme që ndikojnë në kthimin e refugjatëve në Kroaci, një vend klasik transit në rrugën drejt BE-s. Janë raportuar kryesisht shtetas shqiptarë, turq

¹²⁵ Informacion dhe pëgjigjet e dhëna nga UNHCR për pyetorin e Këshillit të Europës

¹²⁶ Europol, *Legislation on Illegal Immigrant Smuggling*, Mars 2004, Aneks II, *Comparison of relevant legislation on Illegal Immigration*.

¹²⁷ "Programi Tampere " I BE-s [COM(2004)401], pasuar nga "Programi i Hagës ", një plan 5-vjeçar për krijimin e një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë në BE (nënshkruar nga Këshilli European në Nëntor 2004), i cili ndjek këta 'gurë kilometrikë': Këshilli i Vendimeve Kuadër të BE-s për Forcimin e Kuadrit Penal për Parandalimin e Hyrjes, Tranzitit dhe Qëndrimit të Paautorizuar (2002/94g/JHA, 28. Nëntor 2002); *Direktiva e Këshillit të Evropës lidhur me Përgjegjësinë Penale të Agjencive të Fluturimit* (2001/51/EC, 28. Qershor 2001); Autorizimi European i Arrestimit 2002 (ekstradimi); Propozimi për një Direktivë të Këshillit European për Leje-qëndrimin Provizor (OJ, 2201/C 126 E/17) dhe Direktiva e Këshillit për Procedurat e Azilit, adoptuar në 1 Dhjetor 2005.

¹²⁸ IOM (Korrik 2004), f. 70.

e kinezë, por edhe emigrantë nga vende të tjera të Europës Jug-lindore, nga Europa Lindore, Azia (afganë, irakenë, kurdë) e deri Afrika. Koacia ka raportuar se kalimet e paligjshme përmes teritorit të saj organizohen në bashkëpunim të ngushtë mes kontrabandistëve kroatë dhe atyre nga Bosnia e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, ku ekzistojnë një numër vend-strehimesh për mbajtjen e emigrantëve ndërkohë që janë në pritje për t'u transferuar në Europën Perëndimore. Shumë nga kontrabandimi i emigrantëve në Kroaci është përqëndruar dhe shkon përmes Zagrebit. Në vitin 2004, janë raportuar 194 raste kalimesh të paligjshme të 223 emigrantëve ilegalë, nga të cilët 15 raste klasifikohen si krim i organizuar me implikimin e 11 grupeve. Në vitin 2005, janë raportuar 260 raste të kontrabandimit të 270 emigrantëve ilegalë, gjë që përfaqëson një rritje prej 34,02 për qind. Fatkeqësisht nuk ka asnjë raportim rastesh me implikim të grupeve të krimit të organizuar.

Në vitin 2003, "Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" regjistroi 8 raste të kontrabandimit të organizuar të personave, ku implikoheshin 4 grupe me një total prej 12 shkelësish. Për vitin 2004 nuk ka të dhëna të raportuara. Në 2005 janë raportuar 35 raste të regjistruara, me 61 keqbërës, dy nga të cilat të klasifikuara si raste të krimit të organizuar me 23 keqbërës. Në një rast, një grup i organizuar, me 31 pjestarë (nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) kishte kontrabanduar përmes 10 veprimtarish të ndryshme, rreth 100 persona përmes kufirit Maqedoni-Greqi, pjesërisht të ndihmuar nga 3 punonjës të Policisë Kufitare Maqedonase.

Rekordet e Malit të Zi tregojnë 257 kalime ilegale të kufirit në 2003, dhe 372 në nëntë muajt e parë të 2004. Nuk është raportuar se sa nga këto raste janë cilësuar si raste të implikimit të grupeve të krimit të organizuar. Në vitin 2005, nuk ka patur raste të raportuara në lidhje me kontrabandimin e rganizuar të personave. Kontrabandimi duket të ketë pësuar ulje në sajë të liberalizimit të regjimit të vizave, që është i vërtetë sidomos për kontrabandimin nga Shqipëria. Nga ana tjetër, zbatimi i një regjimi më të fortë vizash për qytetarët shqiptarë dhe kosovarë për Bosnien e Hercegovinën dhe Kroacinë ka bërë që të rritet kërkesa për kalim ilegal të personave në kufijtë me këto shtete.

Në vitin 2003, Serbia ka regjistruar 27 raste të krimit të organizuar në lidhje me kontrabandimin e personave, me implikimin e 16 grupeve me 64 shkelës. Në 2005, ka një rritje të dukshme të shifrave: 37 shkelje të kontrabandimit të 219 emigrantëve ilegalë, të kryera nga 87 shkelës, kryesisht serbë (73), por edhe kinezë (5), boshnjakë (4), maqedonas (3) e të tjerë. Në 2005, Serbia ka regjistruar 1.076 qytetarë të huaj që kanë hyrë ilegalisht në këtë territor; krahasuar me 2004, kemi të bëmë me një rritje të lehtë prej 2 për qind. Shumica ë këtyre emigrantëve ilegalë mund të jenë kontrabanduar nga grupe të krimit të oganizuar. Megjithatë, duke iu referuar gjinisë së këtyre emigrantëve, duhet theksuar se numri femrave është rritur shumë më tepër se ai i meshkujve emigrantë (në total 115 femra, që do të thotë një rritje prej 100 për qind). Një interpretim i kësaj rritjeje domethënëse është se një përqindje domethënëse e këtyre emigrantëve duhet të jenë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimi seksual. Gjithashtu ka një rritje edhe të kontrabandimit të të miturve (135 emigrantë ilegalë, një rritje alarmante rreth 60 për qind) që mund të interpretohet në të njëjtën mënyrë.

Mbi 220,000 pjestarë të komuniteteve minoritare që jetojnë në Mal të Zi dhe Serbi janë në pritje të riintegrit të tyre në Kosovë që pas trazirave të shpërthyerave në Mars 2004, në pjesën veriore të provincës. Në tre ditët e trazirave, 4000 pjestarë të minoriteteve, kryesisht serbë, romë e ashkali u shpërngulën. Nën ombrellën e United Nations Country Team (UNCT), organizmat ndërkombëtarë kanë bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e të Kthyerve dhe Komuniteteve në Misionin e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në Kosovë, me CIVIPOL-in dhe Institucionet Provizore të Vetëqeverisjes në Kosovë, si Shërbimi Policor i Kosovës (KPS), për t'iu përgjigjur flakë për flakë problematikës sociale dhe kriminale të krijuar. Është raportuar se tregu i kontrabandë së emigrantëve në Kosovë, si edhe kudo gjetkë, është mjaft fitim-prurës, qoftë nëpërmjet organizimit të kalimeve ilegale të emigrantëve, qoftë përmes organizimit të udhëtimeve (agjensitë e udhëtimit), duke akomoduar përkohësisht emigrantë, apo duke u siguruar atyre dokumente identifikimi të falsifikuara. Numri i emigrantëve të kontrabanduar përmes teritorit të Kosovës vlerësohet të jetë disa mijëra në vit (përgjigjet në pyetsorin e 2005-ës). Megjithatë, sipas pyetsorit të 2006-ës, Njësia Investigative e Policisë Kufitare të KPS-s ka raportuar për 2006 vetëm 105 raste të emigracionit ilegal. Prokurorët ndërkombëtarë që punojnë me Departamentin e Drejtësisë së UNMIK, kanë raportuar vetëm 7 raste me implikimin e 27 shkelësve dhe një numër të panjohur emigrantësh nga Pakistani, Bangladeshi dhe India. Nuk ka asnjë raportim në lidhje me numrin e rasteve të krimit të organizuar.

Konkluzionet që mund të nxirren në lidhje me kontrabandën e emigrantëve ilegalë në dhe përmes Europës Jug-lindore janë si më poshtë:

- Megjithë shifrat e vogla e madje në rënie (përveç Koracisë që ka raportuar një rritje prej 34%) dhe statistikat shumë të ndryshueshme (p.sh. emigrantë ilegalë/persona të kontrabanduar/trafikim qeniesh njerëzore, rekord krimesh/padi/dënime,drejtësia/policia/ burime të tjera nga njëri vend në tjetrin në projekt) përgjigjet e dhëna në pyetësorë tregojnë se kemi të bëjmë me një rol të fortë të grupeve të krimit të organizuar me një sofistikim në rritje të mjeteve të përdorura për kontrabandën e personave, si dhe me një bashkëpunim mes grupeve të ndryshme kriminale lokale në të gjithë rrugët e njohura nga kalon kjo kontrabandë, si dhe me aktorë globalë në Azi dhe Europën Lindore. Megjithatë, baza e vërtetë e dokumentuar e këtij deklarimi mbështetet në 13 (Shqipëria) dhe 2 (FYROM) rastet e kontrabandës së personave të lidhura me krimin e organizuar.
- Përsa i përket numrit aktual të emigrantëve, ekziston një vijë e hollë ndarëse midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së personave, dy kategori jo shumë të dallueshme, megjithë përkufizimet që përfshihen në protokollin e Konventave të Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Transnacional në nivelin e BE-s¹²⁹. Shifrat e personave të kontrabanduar dhe të trafikuar shpesh përzien bashkë, pjesërisht ngaqë trajtimi i rasteve të personave të kontrabanduar kërkon më pak burime dhe mbështetet tek praktikat e deportimit, ndërsa rastet e trafikimit kërkojnë një investigim më kompleks si dhe mbrojtje të viktimave, duke bërë të mundur shpesh deportimin e viktimave, gjë që sjell dhe shfryrjen e shifrave në këtë rast.
- Në krahasim me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabandimi i personave nuk kërkon shumë sofistikim operacional, po të kemi parasysh qëllimet më pak komplekse të këtij tregu kriminal. Grupe të nivelit të mesëm janë në gjendje të organizojnë çdo udhëtim, duke filluar që nga sigurimi i dokumenteve të identifikimit të falsifikuar, deri te kalimi i kufijve ndërkombëtarë me mjete ilegale apo me rryshfet, në bashkëpunim me kompani transporti dhe agjenci udhëtimi që janë, shpesh, të lidhura me kontrabandistët, ose janë vetë kontrabandistë. Masat e unifikuar për zbatimin e ligjit kanë bërë që azil-kërkuesit të kalojnë nga format më pak të rrezikshme të emigracionit ilegal (p.sh. me fluturim të rregullt me avion dhe me një dokument udhëtimi të falsifikuar) tek mënyrat më klandestine, të cilat janë më të shtrenjta dhe më të rrezikshme për fëmijët, gratë e burrat të përfshirë në këtë veprim (p.sh. vdekja tragjike e 20 kinezëve që u zbuluan në vitin 2004 në Dover, të kontrabanduar nga grupi i shumë-njohur 'Snakehead Gangs').
- Rrugët që përshkojnë Europën Jug-lindore, edhe pse të një natyre më shumë rajonale, bëjnë pjesë në rrugët më të përdorura tranzit përpara se të mbërrihen në kufijtë e jashtëm të BE-s, destinacioni përfundimtar i thuhet shumicës së personave të kontrabanduar. Qytete më të mëdha në Europën Jug-lindore, si Sarajeva dhe Beogradi, përdoren ose si pika nisjeje ose pika grumbullimi për vazhdimin më tej të udhëtimit drejt BE-s (njëlloj si Moskë, Stambolli dhe Kiev).
- Grupe të nivelit më të lartë mund të sigurojnë asistencë logjistike për emigrantët në vendin e destinacionit final, zakonisht duke u mbështetur në lidhjet me komunitete të të njëjtit etnicitet apo kombësi, të vendosur në atë vend. Ndërsa rrjetet e trafikimit që operojnë në Europën Jug-lindore i kanë rrënjët kryesisht në Europën Lindore, rrjetet e kontrabandës i kanë fijet e tyre deri në Bangladesh, Pakistan, Indi e Kinë.
- Një tjetër tendencë që vihet re në zonat e mbuluara nga projekti është se një pjesë e atyre që janë marrë fillimisht me trafikim njerëzish më pas kanë kaluar në kontrabandën e njerëzve, të armëve apo mallrave të tjera përtej kufirit. Është për t'u patur parasysh që shprehitë e fituara në një biznes kriminal janë lehtësisht të transferueshme në një lloj tjetër biznesi kriminal, me tjetërsimin dhe zhvillimin e tregjeve kriminale. Për shembull, tani emigracioni ilegal shpesh përfiton nga rrugë e rrjete që kanë ekzistuar që më parë për trafikimin e narkotikëve e të armëve. Të dy 'mallrat' mund të lëvizin paralelisht e nganjëherë edhe sëbashku.

¹²⁹ Për të mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe pasjen e një perceptimi të përbashkët të këtij problemi social e kriminal për të gjithë Europën, vendet e projektit duhet të përdorin të njëjtin definicion me EUROPOL-in (shih Konventën e EUROPOL-it)

- Në nivel ndërkombëtar, shpesh është mohuar një lidhje e brendshme natyrale mes emigracionit dhe institucioneve të azilit në një anë, dhe terrorizmit ndërkombëtar në anën tjetër¹³⁰. Masat e marra në lidhje me kontrollin në hyrje, apo kontrollin kufitar, mund të kenë vetëm një ndikim të vogël në parandalimin e terrorizmit, pasi janë fusha të tjera ato që kanë shumë më tepër rëndësi (bashkëpunimi i shërbimeve sekrete, ngrirja e aseteve, etj.). Megjithatë, siç kanë provuar edhe shumë hetime e ngjarje terroriste, terroristët kanë përdorur majft herë kërkesat për azil si strehë për të përgatitur rrugën e tyre për realizimin e akteve terroriste ose, pas këtyre akteve për t'u fshehur në një ambient të sigurt (zona e pushimit).
- Nevoja për një bashkëpunim më të madh mes forcave komëtare të policisë, shërbimeve të doganës dhe sistemeve ligjore po rritet ndjeshëm. Në të njëjtën mënyrë edhe veprimtaritë e grupeve terroriste ndërkombëtare dhe të organizatave kriminale përfitojnë gjithmonë e më shumë nga liria e lëvizjes së njerëzve, parasë dhe mallrave dhe e përdorin këtë gjë për përfitimin e tyre. Për t'i luftuar ata me sukses, agjensitë e zbatimit të ligjit të vendeve të projektit duhet të bashkëpunojnë më tej me homologët e tyre në rajon dhe në Vendet e BE-s.
- Politikat kundër kontrabandimit të njerëzve nganjëherë bëjnë që të neglizhohen pasojat negative të krijuara në këndvështrimin e të drejtave të njeriut. Me bërjen gjithmonë e më të vështirë të hyrjes në vendet e BE-s dhe me forcimin e kontrollit kufitar, emigrantët gjithmonë e më shumë mbështeten në shërbimet e ofruara nga këto organizata kriminale, të cilat marrin përsipër transportimin e tyre. Fatkeqësisht kjo nuk ndodh vetëm në rastin e 'emigrantëve ekonomikë', por edhe me refugjatët. Në këtë kontekst Direktiva e Këshillit të BE-s për Procedurat e Azilit, 2005, që ka për qëllim krijimin e një sistemi të përbashkët azili duhet studiuar me kujdes dhe duhet adoptuar nga vendet e Europës Jug-lindore, për t'i hapur rrugën procesit të hyrjes në BE.¹³¹
- Në të njëjtën mënyrë, modulet e azilit, emigracionit dhe vizave të Programit CARDS të BE-s¹³² për "Vendosjen e kuadreve institucionale, rregullatore dhe ligjore kompatibël me vendet e BE-s në fushat e azilit, emigracionit dhe çështjet e vizave në Shtetet e Ballkanit Perëndimor ", që ka për qëllim të ndihmojë vendet e përfshira në projekt të përshtasin legjislacionin e brendshëm dhe praktikën administrative, si dhe të përmirësojnë strategjitë nacionale dhe plan-veprimet për përafërim me standartet e BE-s, do të jenë pika referimi shumë të rëndësishme për identifikimin dhe përpunimin e qasjeve të përbashkëta të menaxhimit të emigracionit në lidhje me hyrjen, qëndrimin, kthimin, ripranimin, emigracionin e parregullt dhe të dhënat statistikore.

3.4 KRIMI EKONOMIK

Përsheptimi i globalizmit ekonomik mbështetur në integrimin e tregjeve financiare globale dhe strategjitë e tregut të lirë e kanë pakësuar rëndësinë e kufijve, sikurse dhe kanë hapur dritare të reja për krimin ekonomik në Evropë.

Krimi ekonomik, ashtu siç përkufizohet në Rekomandimin e Këshillit të Evropës, R (81)12 të vitit 1985¹³³ ka qenë një nga shqetësimet madhore të shoqërive evropiane për dekada të tëra. Rekomandimi, mbështetet në supozimin se krimi ekonomik shkakton humbje të të ardhurave publike, ka një impakt negative mbi shoqërinë në përgjithësi dhe deformon ekonominë kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe cënon besimin tek sistemi ekonomik. Si

¹³⁰ Për shembull: ICMPD, Sekretariati për Sesionin Special të Procesit të Budapestit për rolin e emigracionit dhe kontrollit të kufirit në luftën kundër terrorizmit, 22 Shkurt 2002.

¹³¹ Direktiva e Këshillit për Procedurat e Azilit, adoptuar në 1 Dhjetor 2005, "Guri kilometrik " në sistemin e përbashkët të azilit në BE.

¹³² Përfshirë projektin 24-mujor "Mbështetje për, dhe Kordinimi i Strategjive të Integruara për Menaxhimin e Kufijve" që mbulon gjashtë vende të përfshira në projekt (Shqipëria, Bosnia dhe Herzegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia dhe "Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë").

¹³³ Rekomandimi I Këshillit të Evropës R (81) 12 I vitit 1981, mbi Krimin Ekonomik (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 qershor 1981) rendit 16 vepra penale specifike dhe jo-spezifike të cilat konsiderohen krime ekonomike.

përfundim, ai dëmton demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe progresin ekonomik dhe shoqëror.

Hartuesit e Rekomandimit të Këshillit të Evropës (2000)¹¹ lidhur me “Parimet udhërrëfyese në luftën kundër krimit të organizuar” kanë nxjerrë në pah “lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet krimit të organizuar dhe krimit ekonomik dhe sidomos me korrupsionin, pastrimin e parave dhe me mashtrimet”¹³⁴. Gjithsesi, një dallim i qartë ndërmjet krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimit ekonomik paraqet disa probleme, ashtu siç është vërtetuar edhe nga Konventat e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe për Financimin e Terrorizmit (CETS 198), Krimin Kibernetik (ETS 185), nga Protokollit i Dytë Shtesë i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Fushën Penale (ETS 182) si dhe nga Direktivat dhe Vendimet Kornizë me tematikë të ngjashme të BE-së.

Shkrirja e analizës së krimit ekonomik “të thjeshtë” dhe të padiferencuar, me krimin ekonomik “të organizuar” e bën analizën edhe më të vështirë, gati të pamundur. Akoma më tej, me krim ekonomik, kuptohet rëndom një tufë krimesh dhe pavarësisht rekomandimeve një përkufizim i qartë i tij ende paraqet vështirësi, që është e vërtetë sidomos në rastin e vendeve të Evropës Juglindore¹³⁵

Vendet e rajonit u përballën me forma të reja të krimit të organizuar që kishin lidhje me privatizimin dhe me sektorët bankarë dhe financiarë, të sapokrijuar, të ndjekura nga evazion fiskal, mashtrime në fushën e doganave, mashtrime në fushën e falimentit, mashtrime në fushën e kredive financiare, korrupsion dhe pastrim parash. Krimi ekonomik ka avancuar dhe përbën një shqetësim të veçantë për këto vende, për shkak të përmasave të tij të dukshme, humbjeve të jashtëzakonshme dhe impaktit në ekonomi, që ndjehet në masën më të madhe nga publiku i vetë këtyre vendeve.

Grupet e krimit të organizuar krijojnë ndërmarrje kriminale me qëllim kryerjen e krimeve, edhe kur ata investojnë në ekonominë e ligjshme. Krimi ekonomik, në anën tjetër e përdor ndërmarrjen e ligjshme për kryerjen e bizneseve të ligjshme, por duke u mbështetur tek mashtrimet, kartelet, monopolet dhe korrupsioni për të qenë i konkurrueshëm në një treg të ligjshëm. Të dyja këto forma të krimit përdorin aftësi dhe teknika të ngjashme, që realizohen nga struktura të organizuara dhe që lulëzojnë nëse gjejnë terren për bashkëpunim.

Integrimi i tregjeve financiare, shkrirja e kompanive shumëkombëshe dhe strategjitë neo-liberale të tregut (rreptësia fiskale, privatizimi, liberalizimi i tregut dhe reduktimi i barrierave tregtare) i shumëfishojnë mundësitë për kryerjen e krimeve ekonomike, në vendet e zhvilluara, siç është treguar edhe nga skandalet e Enronit, WorldComit, Tyco International, VW Flow-Tex, Elf Aquitaine dhe Parmalatit. Pavarësisht se hendeuku ndërmjet krimit ekonomik në Evropën Perëndimore dhe Evropën Juglindore, për nga fondet që ai implikon, është shumë i gjerë, faktori domethënës është impakti relativ, që ky lloj krimi ka mbi këto shoqëri, për shkak të natyrës dhe përmasave të ekonomive të tyre. Përveç kësaj mendohet se të ardhurat nga krimi ekonomik janë të tilla sa që i errësojnë të ardhurat dhe dëmet që shkaktojnë krimet e tjera.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Këshilli i Evropës¹³⁶, Komisioni Evropian dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë kanë dhënë një mbështetje të konsiderueshme për t’i ndihmuar zonat e projektit të kapërcejnë të metat në parandalimin dhe shtypjen e krimit të organizuar ekonomik dhe për t’i hapur rrugë demokratizimit dhe zhvillimit ekonomik, shtetit të fuqishëm të së drejtës dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në Deklaratën dhe Planin e Veprimit të miratuar në Samitin e 3-të të Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive të Këshillit të Evropës¹³⁷ u theksua dhe u përforcua më tej kjo përfshirje aktive.

¹³⁴ Shih par. 18 të Memorandimit Shpjegues të Rekomandimit të Këshillit të Evropës, (2001)11.

¹³⁵ Meqenëse të gjitha vendet evropiane numërojnë tipe të ngjashme, por edhe të ndryshme të krimeve, si krime ekonomike, krahasimet janë të vështira.

¹³⁶ Programet Octopus I dhe II, Programet e ndryshme PACO kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Këshillit të Evropës, GRECO, MONEYVAL, ose Projekti CARPO. Buxheti i të gjitha projekteve të Këshillit të Evropës kundër krimit ekonomik në vitin 2004 ishte 12 milionë Euro dhe në vitin 2005, rreth 15 milionë Euro. Një vështrim i përgjithshëm mbi nismat aktuale jepet në Raportin e Aktiviteteve të vitit 2005, mbi “Bashkëpunimin Teknik për krimin ekonomik”, Janar 2006.

¹³⁷ Deklarata e “Varshavës”, 16-17 maj 2005.

Për pasojë, vendet e Evropës Juglindore kanë nënshkruar, ratifikuar dhe miartuar pothuaj të gjitha konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë. Ato gjithashtu kanë përpunuar strategji, plane veprimi dhe programe të gjera, kanë bërë ndryshime në Kodet Penale dhe Kodet Procedurale Penale, me qëllim hetimin dhe dënimin e suksesshëm të krimeve ekonomike, në pajtim me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, kanë krijuar struktura organizative të ngjashme me ato që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të BE-së, kanë themeluar organizma të posaçme (të tilla si NJësitë e Inteligjencës Financiare), kanë shkëmbyer praktikat e mira/më të mira si dhe kanë bërë vëzhgime të njëri-tjetrit.

Një kapitull tematik i shkëlqyer, i hollësishëm dhe aktual është përgatitur në kuadër të raportit të përvitshëm mbi gjendjen e krimit të organizuar, të Këshillit të Evropës, të publikuar në dhjetor të vitit 2005¹³⁸. Kështu, analiza e krimit ekonomik dhe financiar, në kuadër të këtij raporti, do të kufizohet vetëm në zhvillimet e fundit, dhe shifrat që janë paraqitur nga zonat e këtij projekti, ashtu si më poshtë:

Mashtrimet në fushën e taskave dhe të doganave është raportuar nga të gjitha zonat e projektit si një prej fushave më të rëndësishme të këtij krimi. Ky lloj mashtrimi realizohet kryesisht me anë të kompanive fiktive të regjistruara, me dokumente identiteti të rreme (ID të vjedhura, ose të falsifikuara), të cilat hyjnë në tregti dhe “zhduken”, ose “falimentojnë” kur vjen koha e pagimit të taksave, me anë të mbajtjes së dy bilanceve dhe mjete të tjera të përbashkëta. Skema të tilla shpesh vihen në funksionim nga rrjete të organizuara të cilat marrin përsipër regjistrimin e kompanive, hapin llogari bankare, dhe organizojnë kontakte me pronarë të kompanive private, ose shtetërore për shit-blerjen e mallrave të tyre. Çelësi në këtë zinxhir aktivitetesh është fabrikimi i dokumenteve dhe faturave false, kostoja e prodhimit të të cilave, shkon nga 3 deri në 5% të fitimit, një kosto shumë here më e ulët se sa tatimi mbi shitjet (20%) që secila kompani e përfshirë në tregtinë me pakicë, do t’i paguante shtetit¹³⁹.

Detyrimet doganore shmangen nëpërmjet raportimit të një vlere më të ulët sesa vlera reale e mallrave të tilla si p.sh. nafta; nëpërmjet deklarimit si tranzit të mallrave, të cilat më vonë shiten në “tregun e zi” të brendshëm, si dhe kontrabanda e mallrave nëpërmjet kufijve. Kontrabanda e cigareve dhe e naftës në rajon e cila shkëlqeu në kohën e sanksioneve kundër Serbisë, ende vazhdon, megjithëse në shkallë më të ulët.

Suksesi në vënien nën kontroll të evazionit fiskal nëpërmjet futjes së sistemit të TVSH-së varion nga një shtet në tjetrin. Për ato shtete, që nuk kanë qenë shumë të suksesshme, mashtrimet me TVSH-në vazhdojnë dhe mbështeten përsëri në kompani fiktive, që shërbejnë si fasadë për eksport/importin e mallrave, por në fakt krijohen për mbledhjen e rimbursimeve të TVSHsë, ose karuseli i TVSHsë. Një kapërcim i tillë nga një sistem i mbledhjes së taksave (taksa/tatim mbi shitjet) në një tjetër sistem të mbledhjes së taksave (sistemi I TVSH-së) mund të shërbejë si paralajmërim i dobishëm për vendet, të cilat mendojnë ta fusin së shpejti sistemin e TVSHsë. Në përgjigjet e pyetësorit të vitit 2005, të gjitha zonat e projektit (me përjashtim të Shqipërisë me një rast të vetëm dhe Malit të Zi me një numër prej 15 rastesh të kontrabandës së organizuar) nuk kanë raportuar mbi përfshirjen e grupeve të krimit të organizuar në evazion fiskal, mashtrime në fushën e doganave, madje as në rastin e kontrabandës me mallrat e akcizës, e cila dominohet nga grupet e krimit të organizuar.

Shqipëria ka bërë pohime të përgjithshme lidhur me mashtrimet në fushën e doganave dhe evazionin fiskal (“mbështetet së tepëmi në dobësinë e institucioneve tatimore dhe doganore shqiptare”), dhe ka raportuar të dhëna statistikore, të cilat gjithsesi, nuk mund të shërbejnë për një analizë, meqenëse, shifrat ndryshojnë së tepërmi, në varësi të burimit të tyre, (nëse është Ministria e Brendshme, apo Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme) si dhe kanë përfshirë edhe një gamë të gjerë edhe të krimeve të tjera. Në fushën e doganave, Ministria e Brendshme ka raportuar shifrën e 120 veprave penale, nga të cilat 33 në lidhje me shkeljen e ligjeve tatimore, ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme, e cila zotëron statistika më të besueshme ka raportuar për 427 raste. Në vitin 2005, kapja e cigareve, e farërave të kafes, e telefonave celularë, dhe e mallrave të tjera ka arritur një vlerë të përgjithshme prej 4 milionë eurosh, si dhe është raportuar për një operacion policie të përfunduar me cmontimin e një grupi të krimit të organizuar, i cili dyshohej se kishte futur kontrabandë në vend, 11 kontejnerë me cigare dhe policia ishte e suksesshme në kapjen e dy trageteve, që përdorshin për kontrabandë, sikurse dhe të dy varkave me

¹³⁸ Këshilli i Evropës “Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar, viti 2005”, me theksin tek Kërcënimi i Krimit Ekonomik, dhjetor 2005.

¹³⁹ Të gjitha zonat e projektit, me përjashtim të Bosnjë Hercegovinës, aplikojnë sistemin e TVSH-së.

motorë, dy makinave luksoze, një magazine me 10 mijë metra katrorë sipërfaqe dhe një apartament me 250 metra katrorë sipërfaqe;

Bosnja dhe Hercegovina ka dhënë statistika të hollësishme lidhur me krimin ekonomik, që përfshijnë një game të gjerë të llojeve të ndryshme të krimeve si dhe shifra që u referohen katër juridiksioneve të saj përbërëse¹⁴⁰, e madje dhe më tej në nivel kantonal. Fatkeqësisht këto statistika nuk u përgjigjen pyetjeve të pyetësorit. Përsa u takon shifrave të paraqitura, nëse do t'i mblidhnim do të kishim për vitin 2005, 54 raste të evazionit fiskal, dhe në "fushën e doganave" të paktën 580 raste. Një përjasje e këtyre shifrave me vitin e shkuar nuk mund të bëhet, për shkak të këndvështrimeve të ndryshme dhe skemave të ndryshme të raportimit (2002-2004: 853 raste që kanë shkaktuar humbjen e të ardhurave publike me rreth 160 milionë euro), gjithësesi, duket se shifrat janë në rënie;

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka raportuar për 114 raste të evazionit fiskal, me 178 autorë, dhe përgjithësisht kuptohet se mashtrimet me TVSH-në dhe kontrabanda, vijojnë të mbeten një problem kyç, në veçanti kontrabanda e cigareve, alkoolit, tekstileve, kompjuterive, telefonave celularë dhe produkteve ushqimore, përmes territorit të vendit, që mendohet se është një e kontrabands për rajonin;

Kroacia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia nuk kanë dhënë asnjë informacion të detajuar.

Mashtrimet bankare – Reformat e institucioneve financiare që ende vazhdojnë, ofrojnë një game të gjerë mundësish për krimin e organizuar ekonomik. Për shembull, mënyrat e abuzimit me bankat apo me shoqëritë e kursimeve/të kredive janë të tilla: duke marrë kredi me një interes më të ulët, dhe dhënia e kësaj shume po prapë me kredi, por, me interes më të lartë; kreditë bankare merren duke përdorur dokumente të falsifikuara; kreditë përdoren jo për qëllimet, të shprehura në fillim; falsifikohen kartat e kreditit, etj. Reformat e papërfundara në fushën e bankave dhe mungesa e zbatimit të rregulloreve, kontribuojnë në dobësimin e mëtejshëm të sistemit bankar. Sidoqoftë, shumë pak informacion është paraqitur nga zonat e projektit me qëllim që të ndërmerrej një analizë, ose vështrim më nga afër të këtij fenomeni, duke krahasuar të dhënat e tyre në këtë fushë të krimit.

Privatizimi – Mashtrimet në fushën e privatizimit përbëjnë një shqetësim të madh për të gjitha vendet e rajonit. Zhveshja nga pasuritë të firmave që do të privatizoheshin dhe shkaktimi i falimentimit të tyre si dhe aktivitete të tjera janë të lidhura ngushtë me korrupsionin në sektorin publik. Efektet e këtyre mashtrimeve janë humbjet në kapacitetet produktive si dhe e vendeve të punës.¹⁴¹ Përveç kësaj subvencionet shtetërore (për shembull fondet që u akordohen bashkive, huatë qeveritare, për kompanitë që janë me humbje) po ashtu janë subjekt krimi, duke përfshirë në një shkallë të madhe, nëpunësit civilë, politikanët dhe menaxherët e kompanive. Megjithëse problemet e privatizimit lidhen ngushtësisht me tranzicionin e këtyre vendeve drejt një ekonomie tregu dhe nuk është se lidhen detyrimisht me krimin e organizuar, (krimin ekonomik), ka një konsensus të përgjithshëm ndërmjet vendeve, se krimet në fushën e privatizimeve, përbëjnë një sfidë unike për organet e zbatimit të ligjit dhe për gjyqësorin. Vendet kanë përshtypjen se besimi i publikut tek institucionet do të ndikohet së tepërmi nga rezultati i hetimeve komplekse të cilat do të godasin interesa të fuqishme politike dhe ekonomike që lidhen me fushën e privatizimeve. Sidoqoftë, shumë pak informacion është paraqitur nga zonat e projektit, për të lejuar ndërmarjen e një analize, ose vështrimin më nga afër të këtij fenomeni, duke krahasuar të dhënat e zonave të projektit në këtë fushë të krimeve.

Krimi ekonomik në përgjithësi – duke iu referuar të dhënave që lidhen me krimin ekonomik, vendet dallojnë në mënyrën se si i numërojnë rastet që ato i konsiderojnë krim ekonomik.

Për raportin e vitit 2005, zonat e projektit, me përjashtim të Malit të Zi, kanë ofruar të dhëna lidhur me krimin e organizuar dhe jo thjesht statistikat e përgjithshme të krimit, të vitit 2004. Për raportin e vitit 2006, disa zona të projektit kanë raportuar statistika të përgjithshme mbi krimin, disa prej tyre kanë dorëzuar informacione të hollësishme lidhur me lloje të caktuara krimesh, ndërsa disa kanë bërë pohime të përgjithshme. Si përfundim,

¹⁴⁰ Bosnia dhe Hercegovina ka katër juridiksione të sistemit të drejtësisë penale: nivelin shtetëror, dy nivele entitetesh (Republikën Srpska dhe Federatën e Bosnjë Hercegovinës) dhe Qarkun e Brckos.

¹⁴¹ Edhe pse privatizimi i një kompanie mund të përfshijë uljen në mënyrë të ligjshme të numrit të punonjësve për arsye të efektivitetit, ose ndryshimin e qëllimeve të kompanisë, vendet i kanë shprehur shqetësimet e tyre, mbështetur në rastet e hetuara

përgjigjet për pyetëtorët e vitit 2005 dhe 2006 janë fragmentare, të ndryshme, nuk lënë vend për krahasim dhe vështirë se mund të shfrytëzohen për analiza të mirëfillta, duke lejuar vetëm të nxirren disa modele të përgjithshme.

Zonat e projektit duhet të inkurajohen më shumë për të krijuar sisteme të sakta raportimi, mbështetur në perceptime të përbashkëta, përkufizime dhe rregulla (të ngjashme me sistemet e raportimit të zhvilluara nga institucionet e zbatimit të ligjit, në BE), për të mundësuar krahasimin e hollësishëm të zhvillimeve të krimit të organizuar në Evropë.

Gjithsesi, mbi bazën e përgjigjeve ndaj të dy pyetësorëve, mund të bëhen konstatimet e mëposhtëme:

- Mbetet e paqartë nëse krimi ekonomik është në rritje apo në rënie. Duke i përmbledhur përgjigjet e të dy pyetësorëve dhe duke i krahasuar ato me rezultatet e anketimeve të tjera ndërkombëtare, mendohet se krimi ekonomik është në rritje.
- Policia *shqiptare* ka raportuar më pak krime (22% më pak) dhe i ka përcjellë Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme (ZPP) vetëm 1024 raste¹⁴² të krimit ekonomik, të kryer nga 1227 autorë. Përqindja më e lartë e këtyre rasteve përbëhet nga falsifikimi i dokumenteve, me 718 raste¹⁴³, nga veprat penale në fushën e doganave, me 120 raste të regjistruara¹⁴⁴ dhe nga mashtrimet me 90 raste të regjistruara¹⁴⁵. Sidoqoftë, nëse i referohemi shifrave të Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme, krimi ekonomik është në rritje dhe shkon përafërsisht tek 10 000 raste. Policia në *Bosnjë Hercegovinë (BdH)* ka raportuar për 1,342 raste në nivel shtetëror që përbën një ulje prej 6%, që është shkaktuar nga një ulje drastike dhe habitëse e këtij krimi në Federatën e Bosnjë Hercegovinës (-62, 4 për qind), ndërkohë në Republikën Srpska (+16 per qind) dhe në Qarkun e Brckos (+28,9 per qind) janë raportuar shifra në rritje. Shumica e rasteve ka të bëjë me abuzime të postit dhe kompetencave, falsifikimin e parave, falsifikimin e dokumenteve, mosndërgjegjësimin në kryerjen e biznesit dhe mashtrimet për marrjen e kredive dhe privilegjeve të tjera. *Kroacia* ka raportuar për rreth 6 000 raste të krimit ekonomik (2,35 më pak se në vitin 2004), pjesa më e madhe e të cilave lidhet me keqpërdorimin e detyrës dhe të autoritetit zyrtar, përdorimin e paligjshëm të punës së një autori, shmangien nga kontrollet doganore, abuzimin me autoritetin në bizneset ekonomike dhe falsifikimin i dokumenteve zyrtare. "*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*" nuk ka raportuar asnjë të dhënë lidhur me zhvillimet e përgjithshme të këtij krimi, lidhur me prirjen e tij në rënie, ose në ngritje, por ka dhënë informacione lidhur me format më të shpeshta të krimit ekonomik, ku përsëri, dhunimi i pozicionit dhe autoritetit zyrtar udhëheq me 275 raste, ndjekur nga 140 raste të falsifikimit ose të shkatërrimit të regjistrave financiarë, 114 raste të shmangies nga taksat dhe 51 raste të falsifikimit të një Dokumenti Identifikimi (ID) zyrtar. Në vitin 2005, policia e *Malit të Zi* ka hapur dosje për 1,872 raste të krimit ekonomik (+ 10,4 për qind krahasur me vitin 2004) dhe ka raportuar gjithashtu për rritje të ndjeshme të humbjeve të të ardhurave publike me nga 17,2 milionë Euro (2004) në 30,5 milionë Euro. (+ 88, 6 për qind). *Kosova* dhe *Serbia* nuk kanë raportuar asnjë të dhënë lidhur me krimin ekonomik për vitin 2005.
- Një numër i konsiderueshëm i rasteve të krimit ekonomik është krim i organizuar ekonomik. Fatkeqësisht, përgjigjet e dhëna pyetësorëve kanë ofruar shumë pak informacion, që nuk lejon të bëjmë një analizë të gjerë, ose të krahasuar në nivel të zonave të projektit dhe për një periudhë afatmesme. *Shqipëria* (17) dhe *Kroacia* (14) kanë raportuar të dyja raste të krimit të organizuar ekonomik për vitin 2004, por që të dyja

¹⁴² Shifrat e paraqitura nga Prokuroria e Përgjithshme ndryshojnë ndjeshëm nga ato të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Në përgjithësi të dhënat e paraqitura nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme janë më të shtjelluara, meqenëse ky organ mbledh kallzime penale nga të gjitha palët e interesuar (institucione, apo individë), të cilat jo detyrimisht kalojnë nëpërmjet policisë.

¹⁴³ Duke iu referuar shifrave të paraqitura nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme numri i rasteve të regjistruara për falsifikim dokumentesh shkon në 1632 raste; të dhënat lidhur me veprat penale në fushën e doganave tregojnë për një numër të përgjithshëm prej 454 rastesh, me gjithsej 238 persona të përfshirë. Të dhënat e ZPP mbi veprat penale në fushën e taksave, tregojnë për vitin 2005, një numër prej 247 rastesh me gjithsej 163 persona të përfshirë.

¹⁴⁴ Të dhënat e Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme për veprat penale në fushën e taksave tregojnë për vitin 2005, një numër prej 247 rastesh me gjithsej 163 persona të përfshirë.

¹⁴⁵ Të dhënat e ZPP tregojnë për 218 raste në fushën e mashtrimeve.

vendet e projektit nuk kanë paraqitur asnjë informacion, ose të dhëna të krahasueshme për vitin 2005. *Bosnja dhe Hercegovina* nuk është shprehur për numrin përfundimtar të organizatave kriminale të përfshira në krimin ekonomik, por po t'ju referohemi disa prej krimeve që janë raportuar (falsifikimi i parave, falsifikimi i dokumenteve, falsifikimi i markave tregtare) të cilat kryesisht kryhen nga grupe të organizuara, mendohet se krimi i organizuar ekonomik është në rritje. *Mali i Zi* që ka raportuar për vitin 2005 një rritje të ndjeshme të krimit ekonomik në përgjithësi (+10,4 për qind) që me shumë gjasa përfshin krimin e organizuar¹⁴⁶, sidomos në fushën e falsifikimit të parave, ka dhënë informacion vetëm për 6 akuza të ngritura për 54 vepra penale, të ndërmarrja në formën e krimit të organizuar, kryesisht në fushën e kontrabandës (15), mashtrimeve (15), pastrimit të parave (7) dhe falsifikimit të parave (3), por edhe 10 raste të abuzimit me postin zyrtar, si formë e krimit të organizuar ekonomik. *Serbia*, e cila në përgjigjet e vitit të shkuar ka theksuar rolin dominues të grupeve të krimit të organizuar në fushën e krimit ekonomik (2003: 12 grupe të krimit të organizuar, 38 raste të krimit të organizuar ekonomik) dhe një humbje të përafërt vjetore të të ardhurave publike, prej 300-500 milionë Euro, për shkak të krimit ekonomik¹⁴⁷, nuk ka paraqitur të dhëna të tilla të ngjashme për vitin 2004 dhe 2005. Një konstatim i ngjashëm duhet bërë edhe për *Kosovën*. "*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*" ka raportuar për kontrabandë në shkallë të gjerë dhe për përhapje të falsifikimit të parave, dhe të dokumenteve të identifikimit zyrtar, që ndërmerren zakonisht nga grupe të krimit të organizuar ekonomik, por nuk ka paraqitur asnjë të dhënë apo shifër.

- Pavarësisht dallimeve sipas vendeve, krimi ekonomik në Ballkan ka natyrë në thelb *rajonale* dhe lulëzon vetëm nëse është ushqyer më pare nga lidhje të ngushta rajonale. Të gjitha vendet besojnë se krimi ekonomik përbën një kërcënim serioz për ekonominë dhe shoqëritë e tyre. Një prej arsyeve për këtë kërcënim është se impakti i krimit ekonomik ndjehet kryesisht nga vetë këto shtete, gjë që nuk vlen detyrimisht edhe për llojet e tjera të krimit të organizuar, të tilla si trafiku i drogave, kontrabanda e personave, etj, impakti i të cilave ndjehet në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera. Gjithashtu, krimi ekonomik shkatërron besimin tek sistemi ligjor dhe ekonomik. Në Kroaci, ashtu sikurse dhe në vendet e tjera të projektit, ka shumë presione nga ana e publikut që të ndërmerren veprime kundër mashtrimeve me privatizimet dhe mashtrimeve që lidhen me shpërndarjen e burimeve fitimprurëse bregdetare. Mosndërmarrja e veprimeve të tilla do të shkaktonte humbjen e besimit publik tek sistemi¹⁴⁸.
- Vetë krimi ekonomik shkakton humbje të mëdha të të ardhurave publike dhe e deformon tregun e ligjshëm. Vetëm disa zona të projektit (*Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi*) kanë raportuar për humbjet në miliona euro, kryesisht në fushën e shmangies nga taksat, kontrabandës dhe mashtrimeve.
- Falsifikimi i parave dhe ai i dokumenteve kanë qenë me rëndësi të veçantë për zonat e projektit, sidomos falsifikimi i parave duket se po rritet me shpejtësi në rajon, duke përfshirë edhe falsifikimin e monedhave. Numri i eurove të falsifikura rritet vit pas viti. Teknologjia e nevojshme për falsifikim gjehet më lehtë dhe më lire si dhe fuqia e euros dhe pranimi gjerësisht i saj si mjet pagese, sidomos në Evropën Juglindore, e bëjnë më tërheqëse për ta falsifikuar se sa dollarin amerikan. Analiza e Europolit dëshmon se kartmonedhat e falsifikuara me cilësinë më të mirë mendohet se prodhohen nga kriminelët e Evropës Juglindore (kryesisht Bullgaria) dhe nga rajonet balltike¹⁴⁹ dhe e vë falsifikimin e Euros nën kontrollin e këtyre tregjeve kriminale, që kërkon vëmendje më të madhe në të ardhmen¹⁵⁰. *Shqipëria* ka raportuar për më shumë se 1,600 raste të falsifikimit të dokumenteve. *Bosnja dhe Hercegovina (BdheH)* e ka përfshirë shpërndarjen e parave të falsifikuara dhe falsifikimin e dokumenteve në listen e veprave penale më të rëndësishme në fushën e krimit ekonomik (në federatën e Bosnjë Hercegovinës dhe në Republikën Srpska 242 raste). *Mali i Zi* ka raportuar vetëm 3 raste të falsifikimit të parave, *Kroacia, Kosova dhe Serbia* nuk kanë dhënë asnjë informacion lidhur me falsifikimin e parave. "*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*" ka raportuar për një numër të madh

¹⁴⁶ Termi "krim i organizuar", i cili u përdor për here të pare në prill 2004 nuk ka ekzistuar në legjislacionin penal të Malit të Zi, në kohën kur janë regjistruar rastet e përmendura penale. Fakti nëse një vepër e caktuar penale kishte ose jo shkallë organizimi, nuk përbënte subjekt të kualifikimit ligjor.

¹⁴⁷ Intervista me zyrtarë të zbatimit të ligjit, shtator 2004.

¹⁴⁸ Përgjigjet që Kroacia i ka dhënë pyetësorit dhe intervistat me zyrtarët kroatë të zbatimit të ligjit, shtator 2004.

¹⁴⁹ Raporti i BE-së për krimin e organizuar, 2005, Europol.

¹⁵⁰ Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar i BE-së, 2005.

rastesh të falsifikimit të kartmonedhave (195 raste) kryesisht në prerje të vogla të 100 Dinarëve Maqedonas, por edhe të 500, dhe 1000 Dinarëve Maqedonas si dhe kartmonedhave të Euros dhe Dollarit.

- Lidhjet ndërmjet krimit ekonomik dhe krimit të organizuar janë dukshëm të mbështetura tek korrupsioni, në të dyja nivelet, të lartë apo të ulët. Rryshfetet dhe praktika të tjera korruptive që përdoren për regjistrimin e kompanive si dhe të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, përcaktimin e procedurave për tenderat, transportimit të mallrave përtej kufijve, pagesa e gjyqtarëve dhe e prokurorëve për rikualifikim apo rrëzim të akuzave, trafiqet e influences në privatizime, dhe praktika të tjera të panumërta përdoren për të realizuar të dyja këto forma të krimit. Vendet shprehin një shqetësim të madh lidhur me rritjen e pushtetit dhe të ndikimit që krimi i organizuar ushtron mbi strukturat legjitime të qeverisjes dhe mbi shoqërinë, duke e përshkruar atë si kërcënimin më serioz që bashkon të gjitha aspektet e krimit të organizuar dhe të krimit ekonomik.
- Në shumicën e zonave të projektit kontrabanda mbetet një treg i rëndësishëm për krimin e organizuar. Luftërat në Evropën Juglindore gjatë viteve 90 në përgjithësi, dhe tregatia dhe embargoja e armëve kundër Serbisë në veçanti, ofruan mundësi të papersëritshme për kontrabanduesit, e shtuan kërkesën për mallra me tarifa të larta dhe krijuan një simbiozë ndërmjet zyrtarëve të sigurimit, politikanëve, zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe të doganave dhe krimin e organizuar. Sanksionet e nxitën zhvillimin e kanaleve rajonale të kontrabandës nëpërmjet Shqipërisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, që merreshin me naftë, cigare, armë, automjete dhe mallra të tjera. Kontrabanda u kthye në burim të rëndësishëm të ardhurash për grupe të ndryshme, që fillonin me elitat politike e përfundonin me komunitetet që jetonin në zonat kufitare. Megjithëse, shkalla e kontrabandës është ulur, si rrjedhojë e normalizimit gradual të rajonit¹⁵¹, kanalet e kontrabandës të krijuara në vitet 90, janë ende shumë aktive. Shërbimet kufitare dhe reformat në fushën e doganave, që po zbatohen aktualisht në rajon, nëpërmjet programeve të ndihmës të tilla si misioni CAFAO i Komisionit Evropian dhe programet e binjakëzimit, kanë çuar drejt një kontrollimi më të mire të kufijve dhe mbylljen e kalimeve të paligjshme të kufirit. Sidoqoftë, korrupsioni i doganierëve dhe zyrtarëve të kufirit përbën ende çelësin e aktiviteteve të kontrabandës, sikurse dhe përdorimi i kompanive paralele, të paqena ose fiktive¹⁵², përdorimi i dokumenteve të identitetit, ose i faturave të rreme për kalimin e ngarkesës përgjatë kufijve pa ndihmën e zyrtarëve “bashkëpunues”. Këto mënyra dëshmojnë për shkallën e sofistikimit, të një tregu që ngjan me një treg kriminal të zhvilluar dhe aktiv, që synon hapjen e rrugës drejt strukturave të ligjshme.
- Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, FMN-së, qeverive të BE-së dhe organizmave të tjerë, të tillë si Europoli, Frontex, dhe OLAF, impakti i kontrabandës së cigareve e drejtuar nga brenda-jashtë, ose nga jashtë-brenda, në Evropën Juglindore, vazhdon të ketë përpjestime shqetësuese, sidomos kur mësohet se së fundi, grupet turke të krimit të organizuar janë përfshirë në trafikimin e cigareve bashkë me heroinën¹⁵³. Kontrabanda e cigareve i privon Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet në rajon nga miliarda euro në vit¹⁵⁴. OLAF, ose Zyra Evropiane kundër Mashtrimeve, në raportin e vet të vitit 2004, e paralajmëronte Këshillin e Evropës dhe Parlamentin Evropian¹⁵⁵ lidhur me dëmet serioze që kontrabanda e cigareve shkakton për buxhetet e Shteteve Anëtare të BE-së dhe raportonte rezultatet e saj të mira në luftën kundër kontrabandës së duhanit, siç ishin ngritja e padive civile para gjykatave në New York, kundër kompanisë së cigareve RJ Reynolds dhe të tjerave, për përfshirje në kontrabandën e cigareve dhe pastrim parash, apo negociatat dhe

¹⁵¹ Sistemet e TVSH-së së krijuara aktualisht dhe liberalizimi i tregtisë ndërmjet vendeve do të ndihmojnë në reduktimin – por jo në ndërprerjen e plotë- të varësisë nga të ardhurat e doganore dhe të mallrave me akcizë.

¹⁵² Kompanitë “e paqena” janë ato që janë regjistruar në një adresë mos-ekzistuese, ose që përdorin dokumente të rreme identiteti; kompanitë “fiktive” janë ato që regjistrohen në dokumente të rreme identiteti; kompanitë “paralele” janë ato kompani që përdorin kopje të dokumenteve të regjistrimit me emrin e ndryshuar të pronarëve. Këto kopje përdoren më vonë për të hapur llogari bankare të reja dhe të pagjurmueshme. Në vitin 2004, Bosnja dhe Hercegovina ka qenë e detyruar të kualifikojë 1187 persona juridikë si të paqenë, fiktivë, ose paralelë.

¹⁵³ Raporti i BE-së mbi gjendjen e krimit të organizuar, i vitit 2005, Europoli.

¹⁵⁴ Sipas Ministrisë së Financave të Gjermanisë, në vitin 2005, vetëm në Gjermani humbet vlerësoheshin në 2,7 mijë milionë euro nga shmangiet për pagesat në lidhje me duhanin; raportuar në të përjavshmen germane News Magazine FOCUS, 20/2006; shih gjithashtu tabelën e impaktit me rastet e OFLAF.

¹⁵⁵ COM (2005) 323, publikuar më 19 korrik 2005.

marrëveshjen e lidhur me Phillip Morris International (PMI) më 9 korrik 2004, që menjëherë solli një bashkëpunim më të mirë ndërmjet kësaj kompanie dhe departamentet e Komisionit dhe në veçanti me OLAF. Sidoqoftë, në fund të vitit 2005, OLAF ende kishte 33 çështje të hapura në lidhje me kontrabandën e cigareve dhe në Raportin e vitit 2006¹⁵⁶ OLAF raportonte për operacionin e suksesshëm “Imitimi” në maj të 2005 (një operacion kontejner, në bashkëpunim me DG TAXUD, që vinte në shënjestër kontrabandën e mallrave të falsifikuara që vinin nga Azia) që çoi në sekuestrimin e 140 ngarkesave ajrore dhe të 60 kontejnerëve detarë. Masa e përgjithshme e mallrave të sekuestruara arrinte në 500 tonë. Më shumë se 1,2 milionë paketa me cigare pirate u sekuestruan së bashku me 0.8 milionë sende të tjera. Përveç cigareve materialet e tjera të falsifikuara ishin kryesisht, tekstile, malora elektronike dhe ilaçe. Sekuestrimet u shtrinë në të gjithë botën, dhe në njëfarë mase edhe në Evropën Juglindore. Është hera e parë që OLAF raporton për hapjen e çështjeve të kontrabandës së cigareve në vendeve kandidatë: Kroacia (2 raste) dhe “Ish Republika Jugoslave e Maqedonisë” (katër raste).

Table 4: Impakti financiar i Çështjeve të Hapura dhe të Mbyllura të OLAF (fondi i vitit 2005)

Sektori	Të hapura (€ milionë)	Të mbyllura (€ milionë)	Totali (€ milionë)
Bujqësia	112,1	222,2	334,3
Alkooli	0,0	179,8	179,8
Cigaret	344,6	972,3	1.316,9
Doganat	216,9	503,1	720,0
Shpenzimet direkte	175,2	86,9	262,1
ESTAT	102,9	3,1	106,0
Ndihma e jashtme	130,0	172,2	302,2
Hetimet e brendshme	18,2	230,2	248,4
Hetimet me shumë Agjenci	0,0	3,7	3,7
Prekursorët	0,0	0,0	0,0
Fondet Strukturore	390,2	1.144,9	1.535,1
Tregtia	0,0	934,7	934,7
VAT	435,1	242,9	678,0
Totali	1.925,2	4.696,0	6.621,2

Source: OLAF, Annual Report 2005

Në tetor të vitit 2005, një tjetër operacion i përbashkët ndërmjet policisë dhe doganës në Bullgari, çoi në kapjen e cigareve kontrabandë dhe parandaloi kontrabandimin e më shumë se 8,5 milionë cigareve të markës angleze Super Kings. Kontejnerët e ngarkuar me cigare (për të cilët ishte deklaruar se ishin mbushur me mallra kineze, të bëra prej qelqi) ishin nisur nga Kina, kishin kaluar nëpërmjet Turqisë dhe më pas ishin transportuar në portin grek të Selanikut. Prej andej, cigaret ishin ngarkuar në një tren që udhëtonte për në Bullgari për t'i shpërndarë më tej në vendet e Evropës Perëndimore, dhe buxheti i BE-së do të kishte pësuar një dëm prej përafërsisht 3,1 milionë Euro¹⁵⁷.

Në dritën e kësaj, ekonomia rajonale dhe thesari publik do të vazhdojnë të pësojnë humbje¹⁵⁸. Prandaj, krijimi sa më pare te jetë e mundur i Strukturave Koordinuese kundër Mashtrimit (AFCOS) është esencial. Pika të tilla qendrore referimi për koordinimin e të gjitha aspekteve ligjore, administrative dhe operationale të mbrojtjes së interesave financiare të BE-së janë krijuar tashmë në të gjitha vendet kandidatë për hyrje në BE: Rumani dhe Bullgari¹⁵⁹.

¹⁵⁶ OLAF, Raporti Vjetor 2005, 13.7.2006.

¹⁵⁷ http://ec.europa.eu/comm/anti_fraud/budget/2005/bg.pdf

¹⁵⁸ Shih raportin e Qendrës për Studime Demokratike *Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi I Organizuar në Evropë* (2003), pps.8.

¹⁵⁹ Mbledhja e AFKO në Bukuresht, më 1 qershor 2006, gjatë së cilës OLAF dhe ekspertë apo hetues kundër mashtrimeve nga dhjetë Vendet Anëtare të BE-së, që hynë në BE në vitin 2004 e ndanë përvojën e tyre operationale me kolegët nga vendet e asociuara, Rumania dhe Bullgaria dhe nga shtetet kandidatë, Kroacia dhe Turqia, të cilat gjithashtu do të kenë përfaqësim, pasi

Shqipëria e cila kishte raportuar për pothuaj një dyfishim të numrit të rasteve të kontrabandës me 164 raste, nga të cilat 14 raste lidheshin me 14 grupe të krimit të organizuar, të përbërë nga 62 autorë. Sidoqoftë, ajo nuk ka raportuar figura të krahasueshme për vitin 2005. *Bosnja dhe Hercegovina* ka raportuar për një shtim të kontrabandës dhe të prodhimit të mallrave pirate të të gjitha llojeve (alkoolit, duhanit, produkteve ushqimore, etj.) krahasuar me vitin 2003. Në vitin 2004 ka patur 22 raste të kontrabandës që kanë shkaktuar një humbje të përgjithshme prej 28,301,319 euro¹⁶⁰ dhe në vitin 2005 ka patur 30 raste të tjera të kontrabandës, që kanë përfshirë një marrëveshje të paligjshme me produktet e naftës në rajonin e Brckos, që ka shkaktuar një dëm prej 2 milionë BAM. Arsyeya kryesore për lulëzimin e tregut të kontrabandës qëndron në fragmentarizimin e zones së brendshme ekonomike të Bosnjë Hercegovinës, duke krijuar kushte të papersëritshme për evazionin tatimor dhe doganor në rajon dhe ekzistencën e tregjeve ku shiten mallrat e kontrabanduara, të tilla si tregu Arizona, në Qarkun e Brckos. Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (OHR) dhe qeveria e Bosnjë Hercegovinës i kanë bashkuar përpjekjet e tyre për të unifikuar sistemin e fragmentarizuar të mbledhjes së taksave dhe për të krijuar Agjencinë e Taksave të Tërthorta, e cila do të sjellë rezultate pozitive në të ardhmen¹⁶¹. *Kroacia* e cila në vitin 2003 vuante kryesisht nga kontrabanda e mallrave të akcizës, duke raportuar për 18 raste të krimit të organizuar, me përfshirjen e 17 grupeve dhe 127 autorëve, nuk ka raportuar asnjë rast të kontrabandës në pyetësin e vitit 2006. Kontrabanda e duhanit në *Mal të Zi* që lulëzonte në vitet 90, është ulur kohët e fundit, si rezultat i kombinimit të presionit ndërkombëtar dhe përpjekjeve të qeverisë vendase¹⁶². Në vitin 2003, kontrabanda me mallrat e akcizës, në mënyrë të veçantë, me naftën dhe benzinën ndërmjet Malit të Zi dhe Bosnjë Hercegovinës si dhe të gjësë së gjallë përmes kufirit shqiptar kanë shkaktuar humbje me rreth 9 milionë euro dhe sekuestrimet e kryesisht cigareve dhe alkoolit kapin vlerën e 1,7 milionë eurove. Megjithatë Mali i Zi nuk i ka specifikuar shifrat e tij për vitin 2005, rritja e humbjeve në të ardhurat publike (88,6 për qind, ose 30,5 milionë euro) shkaktuar krimi ekonomik në tërësi, ka qenë me siguri rezultat edhe i 15 rasteve të kontrabandës, të evidentuara nga 54 raste të krimit të organizuar ekonomik. *Kosova* ka qenë vendi i destinacionit për alkoolin dhe cigareet e kontrabanduara, me origjinë nga Sllovenia, Austria, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, ndërkohë që market pirate prodhohen kryesisht në Kosovë, por edhe në vendet fqinje, nga të cilat hyjnë më pas kontrabandë në Kosovë. Në vitin 2004 dhe në gjysmën e parë të vitit 2005, janë regjistruar 332 raste të kontrabandës së mallrave, por përveç kësaj, asnjë informacion shtesë nuk është paraqitur për pyetësin e vitit 2006. *Serbia* e ka ulur ndjeshëm kontrabandën me mallrat e akcizës. Itinerari dikur i famshëm i kontrabandimit të cigareve nëpërmjet Malit të Zi është mbyllur dhe tashmë rrugët e reja kalojnë nëpërmjet Kosovës, “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Kontrabanda e mallrave të cilat ri-pakëtohen dhe shiten në treg është në përgjithësi një tendencë e re në rajon dhe jo vetëm në Serbi. Në vitin 2003 janë regjistruar 17 raste të kontrabandës në formë të organizuar, që kanë përfshirë 9 grupe të krimit të organizuar, megjithatë, asnjë informacion tjetër nuk është dhënë për vitin 2004 dhe 2005. “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” vazhdon të jetë një vend tranziti për cigaret, alkoolin dhe pajisjet teknike, të tilla si telefonat celularë, kompjuterat dhe pjesët e tyre të këmbimit, që kontrabandohen në Greqi dhe në Kosovë si dhe për mallrat tekstile me origjinë nga Kina dhe të kaluara kontrabandë nëpërmjet Turqisë dhe Bullgarisë. Ri-paketimi, ri-etiketimi dhe shitja e produkteve të skaduara, sikurse dhe falsifikimi i produkteve ushqimore kërkon më tepër sofistikim. Në vitin 2003 ky vend ka regjistruar 174 raste me 8 grupe të krimit të organizuar. Në 9 muajt e parë të vitit 2004, autoritetet kombëtare sekuestruar një sasi mallrash akcize me vlerë të përgjithshme prej 1,72 milionë eurosh. Asnjë e dhënë nuk është paraqitur për vitin 2005.

Në një kontekst më të gjerë, Evropa vazhdon të mbetet një treg i rëndësishëm për duhanin. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zënë rreth 30% të prodhimit botëror të cigareve, 60% të eksportit global dhe më shumë se 50% të importeve globale. Duke pasur parasysh përmasat e tregut dhe mundësinë për të fituar të

mendohet që së shpejti të themelojnë strukturat e tyre AFCOS në kuadër të përgatitjeve për anëtarësimin e tyre të ardhshëm në BE.

¹⁶⁰ Të dhënat janë paraqitur nga Zyrat e Administratës së Taksave në Republikën Srpska, Federatën e Bosnjë Hercegovinës dhe në Qarkun Brcko.

¹⁶¹ Për vendimet e Përfaqësuesit të Lartë në këtë fushë, shih: www.ohr.int/decisions/econdec/archive.asp

¹⁶² Njoftimi për Shtyp i OLAF 12/2003, *OLAF jep dëshmi në gjyqin mbi “Lidhjet e Malit të Zi” dhe përfshirjen e tij në trafikun ndërkombëtar të cigareve.*, 30 prill 2003, europa.eu.int/olaf; Artikulli: *Prova e rolit të Malit të Zi në trafikun e paligjshëm të cigareve*, Financial Times, 9 gusht 2001.

ardhura shtesë, në rast se shmangen detyrimet doganore dhe taksat, rreth 25 % e cigareve që prodhohen në shkallë globale ose më tepër se 210 miliardë cigare (diferenca ndërmjet importit dhe eksportit të raportuar) shkon në tregun e zi. Prej kësaj shifre, një e treta, mendohet se hyn dhe kalon kontrabandë në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ligjet e kohëve të fundit që ndalojnë pirjen e duhanit në vendet publike, në gjithnjë e më shumë shtete të Bashkimit Evropian, siç janë Italia dhe Republika e Irlandës mund të ndikojnë në pakësimin e tregut në Evropën Perëndimore.

- Prodhimi pirat i produkteve dhe krimet kundër të drejtës së pronësisë intelektuale (IPR) kanë ndoshta impaktin më të madh tek Shtetet Anëtare të BE-së në drejtim të humbjes së taksave dhe punësimit¹⁶³ dhe është duke u zhvilluar si treg kriminal në Evropën Juglindore. *Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"* nuk kanë paraqitur asnjë të dhënë mbi këtë lloj krimi. Në *Bosnjë dhe Hercegovinë* zyra e Prokurorisë ka raportuar 20 raste veprash penale në lidhje me cënimin e të drejtave të autorit, ose përdorimit të paautorizuar të të drejtave të autorit. Këto aktivitete zhvillohen në Republikën Srpska. *Kroacia* ka raportuar 342 krime në fushën e pronësisë intelektuale dhe 7 raste të tjera lidhur me cënimin e të drejtave të patentës, të cilat japin shkas për të menduar për krijimin e një dege të prodhimit të mallrave pirate në Kroaci. Në *Serbi*, prodhimi i mallrave pirate lulëzoi në fund të viteve 90. Në përgjigjet e dhëna pyetësorit të parë, Serbia kishte raportuar për sekuestrimin e mbi 60 000 videokasetave dhe CD-ve si dhe të një sasive të madhe pajisjesh incizimi të zërit dhe të imazhit, si edhe programesh kompjuterike; por asnjë informacion nuk është dhënë për vitin 2004 dhe 2005.
- Krimi kibernetik dhe avantazhet që ofron Interneti në drejtim të informacionit dhe të teknologjisë së komunikimit janë tepër me vlerë për grupet e krimit të organizuar. Kulturat e nëndheshme të ndërtuara përreth disa prej fenomeneve të teknologjisë së lartë janë të përsosura për mbështetje, kontakte, komunikim kriptik, rekrutim dhe këshillim. *Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia* nuk kanë dhënë asnjë informacion ose statistikë lidhur me krimin kibernetik, në pyetësorin e vitit 2006. *Kroacia* ka raportuar për një shtim të numrit të veprave penale që lidhen me krimin kibernetik dhe krimet kundër pronësisë intelektuale (2004: 928 vepra penale, 2005: 1009 vepra penale¹⁶⁴) që duhet kuptuar si rrjedhojë e strukturave të zhvilluara ligjore dhe administrative dhe masave të kontrollit të vendosura kohët e fundit. Përgjithësisht konsiderohet se autorët e krimit kibernetik nuk veprojnë si anëtarë të grupeve të krimit të organizuar dhe shifrat e raportuara ende mbeten të vogla. Në vitin 2005, kishte vetëm dy vepra penale në fushën e pornografisë së fëmijëve në sistemin e kompjuterit, 11 vepra penale kundër integritetit të bazës së të dhënave të kompjuterit, programeve dhe sistemeve kompjuterike, 6 vepra penale të falsifikimit të kompjuterit dhe 15 vepra penale të mashtrimit me kompjutera. Por, duke qenë se një pjesë e madhe e krimit kibernetik është i ashtuquajtur "krim i kontrolluar" (nuk ka viktima që t'i raportojnë këtë lloj krimesh dhe organet e zbatimit të ligjit duhet t'i zbulojnë këto krime, duke monitoruar Internetin dhe duke ndërmarrë analiza operacionale), shifrat janë në rritje. *Mali i Zi* ka raportuar se krimi kibernetik nuk është i përhapur në vend. Në vitin 2005, vetëm 2 akuza kriminale ishin ngritur kundër 7 autorëve për kryerjen e 7 veprave penale me të ardhura të paligjshme të rreth 27 mijë eurove. "*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*" e ka ndryshuar Kodin Penal dhe ka shtuar krimin kibernetik. Por, nuk janë dhënë shifra, vetëm është bërë një përshkrim i hollësishëm i modeleve dhe prirjeve të vërejtura në këtë fushë. Vepra penale më e përhapur në këtë zonë të projektit është, para së gjithash blerja e mallrave nëpërmjet Internetit duke përdorur të dhënat e kartave të kreditit, të përfituara në mënyrë të paligjshme, nëpërmjet vjedhjes reale ose vjedhjes virtuale (hacking)¹⁶⁵, së dyti mbushja me reklama të panevojshme (spamming) e adresave elektronike të rivalëve¹⁶⁶

¹⁶³ Raporti për Krimin e Organizuar, i vitit 2005, Europoli.

¹⁶⁴ Siç raportohet nga Qendra e Kompetencës për Evropën Juglindore, në Universitetin e Gracit (Austri), prodhimi pirat i programeve kompjuterike në Kroaci është ende i lartë me 58 për qind. Dëmet e shkaktuara prodhuesve të programeve kompjuterike janë rritur me 5 milionë dollarë amerikanë dhe kanë arritur shifrën e 50 miliardë dollarëve, siç ka treguar një kërkim i kryer nga një analist i kompanisë IDC CEMA i cili u prezantua para Shoqatës për Aleancën e Biznesit (BSA), në Zagreb, dhjetor 2005.

¹⁶⁵ Hyrja në mënyrë të paligjshme në bazën e të dhënave, të kompjuterit të p.sh. një kompanie, procesorëve të palëve të treta, ose bankave dhe duke kopjuar të dhënat e ruajtura në këto baza të dhënash, përdorimi këtyre të dhënave për qëllime të ndryshme të paligjshme, për shembull, për prodhimin e kartave të kreditit të falsifikuara etj. Në vitin 2005, një aktivitet i përbashkët operacional i kryer me NTHCU nga Mbretëria e Bashkuar kundër një shtetasi maqedon që kishte marrë të dhënat personale të

dhe së treti prodhimi i produkteve pirate përmes kopjimit të paligjshëm të produkteve private ose të programeve kompjuterike, kryesisht të produkteve të Microsoftit (Windows XP dhe Windows Office). Vepra të tjera të rëndësishme janë rastet e “peshkimit”, një teknikë relativisht e re në Evropën Juglindore, që përdoret për të marrë të dhëna personale, ose financiare me qëllim vjedhjen e identitetit, ose “emaillet nigeriane” (emaile mashtruese lypëse), falsifikimi i kartave të kreditit dhe krime të tjera të ngjashme. Sipas informacionit të dhënë prapavija e autorëve të këtyre krimeve përfshin që nga të rinj maqedonas deri tek menaxherët dhe profesionistët e degëve të kompanive të teknologjisë kompjuterike. Deri më sot nuk ka prova për grupe të krimit të organizuar që veprojnë në këtë fushë. Hetimi i këtyre veprave penale është tepër kompleks dhe kërkon bashkëpunim të ngushtë, por meqenëse shkëmbimi i informacionit me Interpolin ishte shumë i ngadaltë, një projekt i ri ka nisur në bashkëpunim me Qendrën SECI, (SCIMER) për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe bankave.

kartave të kreditit nga një adresë e IP në Vietnam dhe ia kishte shitur ato një shtetasi britanik, që u kishte kushtuar bankave britanike një shumë prej 1.000.000 poundëve britanikë.

¹⁶⁶ Për shembull, autorët e veprave penale, shumë të zotë zhvillojnë programe të caktuara kompjuterike për të krijuar një trafik të madh Interneti, me qëllim që të mbingarkojë dhe bllokojë rrjetin e viktimës deri në “mohimin e shërbimeve” për të.

3.5 PASTRIMI I PARAVE

Lufta ndaj pastrimit të parave është një prej mënyrave më efektive për t'iu kundërvënë krimit të organizuar, meqenëse emëruesi i përbashkët i të gjitha krimeve të rënda dhe krimit të organizuar është nxjerrja e fitimit. Siguria, integriteti dhe stabiliteti i institucioneve financiare dhe kreditore si dhe besimi tek sistemi financiar në tërësi mund të vihet seriozisht në rrezik nga përpjekjet e kriminelëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre për ta tjetërsuar origjinën e të ardhurave të tyre, ose për të kanalizuar paratë e ligjshme për qëllime terroriste. Të ardhurat e përfituara në mënyra të paligjshme mund të ri-investohen në biznese kriminale apo biznese të ligjshme, mund të konsumohen apo mund të fshihen. Për të parandaluar kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit, ato pastrohen në mënyrë që të mos dallohen prej parave të fituara me mënyra të ligjshme. Paratë pastrohen në shumë mënyra, të cilat bëhen edhe më të lehta nga metodat elektronike të pagesës dhe të transaksioneve bankare.

Për të fshehur sa më mirë origjinën kriminale të fondeve, zakonisht pastrimi i parave kryhet në një kontekst ndërkombëtar. Masat e miratuara vetëm në nivel kombëtar, apo në nivelin e Komunitetit, pa marrë në konsideratë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, do të kenë efekte shumë të kufizuara. Me qëllim që të shmanget marrja e masave nga ana e Shteteve Evropiane që do të ishin të papajtueshme me funksionimin e tregjeve evropiane, është e domosdoshme të merren masa të përbashkëta në këtë fushë – në të gjitha kontekstet (BE, Këshilli i Evropës, Kombet e Bashkuara).

Pastrimi i parave është një vepër penale, që mendohet se kryhet nga grupe të krimit të organizuar për të ligjruar fondet e paligjshme dhe shtron një sfidë gjithnjë e më të madhe në planin global, sidomos në raport me financimin e terroristëve. Në vendet evropiane, shumica e hetimeve mbi krimin e organizuar lidhen me drogën, prandaj dikush mund të mendojë që pastrimi më i madh i parave, të ketë lidhje me drogën. Por, duke pasur parasysh informacionin e raportuar mbi pastrimin e parave që vijnë nga lloje të tjera krimesh, të tilla si trafikimi i qenieve njerëzore, ose kontrabanda e personave “krimi plotësues”¹⁶⁷ i pastrimit të parave po spikat gjithnjë e më shumë. Gjithshtu, duke patur parasysh rëndësinë e krimit ekonomik në Evropën Juglindore, pastrimi i parave në raport me fushat kryesore të krimit (të organizuar) ekonomik, mund të ketë të njëjtën përhapje. Për pasojë, “krime të tilla plotësuese” dhe krimi ekonomik që shkakton pastrim parash mendohet se do të zënë një pjesë të mirë të hetimeve financiare në të ardhmen.

Grupet e krimit të organizuar mbështeten gjithnjë e më shumë në strukturat e ligjshme dhe tregtare dhe në kushtet kur kufijtë ndërmjet strukturave të ligjshme dhe të paligjshme, sa vijjnë e zbehen, pastrimi i parave ngre vazhdimisht shqetësimin e depërtimit të të ardhurave të paligjshme në ekonominë e ligjshme, me anë të metodave të pagesës. Sikurse dihet, pastrimi i parave mbështetet zakonisht në tre faza:

- **Alokimi** – mënyrat në të cilat produktet direkte të krimit kanalizohen në sistemet financiare, kryesisht në formën e pagesave me para në dorë (cash).
- **Shtresëzimi** – qarkullimi i fondeve nëpërmjet një zinxhiri transaksionesh financiare, për të zhdukur çdo lloj lidhjeje ndërmjet kapitalit të alokuar dhe origjinës së tij kriminale, në mënyrë tipike kjo ndodh nëpërmjet transferimit të parave, apo çeqeve.
- **Integrimi** – investimi i të ardhurave, që kanë origjinë kriminale në transaksionet ligjore dhe ekonomike, në mënyrë tipike kjo ndodh në pasuri të paluajtshme, objekte me vlerë, kapitale biznesi, etj.

Teorikisht, një sistem rigoroz kundër pastrimit të parave për të vëzhguar dhe zbuluar këtë lloj krimi, është krijuar që në fillim të viteve 1990:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (1988)¹⁶⁸

¹⁶⁷ Raporti i BE-se mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar, Europol, 25 tetor 2005.

¹⁶⁸ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (1988) synonte fillimisht konfiskimin e të ardhurave që vinin nga krimet e drogës, ndërkohë që miratimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit e vitit 1990 (ETS 141) dhe rekomandimet e mëvonshme të Task-Forcës për Veprim Financiar (FATF) kishin për qëllim krijimin e sistemeve kundër pastrimit të parave që do të vinin në shënjestër të ardhurat nga të gjitha llojet e krimeve. Këto sisteme prekin kyesisht transaksionet e dyshimta, të cilat

- Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin, e vitit 1990 (ETS 141);
- 40 Rekomandimet e Task Forcës për Veprim Financiar (FATF)¹⁶⁹, të rishikuara në vitin 1996 dhe Shënimet e saj Interpretuese të cilat janë projektuar për të sqaruar zbatimin e rekomandimeve të veçanta dhe për të dhënë udhëzime të mëtejshme;
- Amendamentet e Task Forcës për Veprim Financiar (FATF) lidhur me financimin e terrorizmit, të tetorit 2004 (Rekomandimet 40+9);
- Rezoluta 1617 (2005) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila “u bën thirrje Shteteve Anëtare që të zbatojnë standardet e gjithanshme ndërkombëtare” të mishëruara në Dyzet Rekomandimet e FATF mbi pastrimin e parave dhe në Rekomandimin e Nëntë të Posaçëm lidhur me financimin e terrorizmit;
- Konventa e re e Këshillit të Evropës mbi Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit (2005)¹⁷⁰;
- Direktiva e Këshillit të BE-së, e vitit 2005 mbi pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit¹⁷¹ që sugjeron krijimin e njësisë të inteligjencës financiare në çdo vend të Bashkimit Evropian deri në fund të vitit 2007 që do të jenë përgjegjëse për marrjen dhe shqyrtimin e informacionit që ka lidhje me mundësinë e pastrimit të parave, ose të financimit të aktiviteteve terroriste me qëllim krijimin e një sistemi mbarë-botëror dhe gjithëpërfshirës kundër pastrimit të parave.
- Raportet e Tipologjive të FATF, që kanë shërbyer në të shkuarën si burim i përgjithshëm informacioni për sektorin për të kuptuar metodat bazë të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Këto raporte janë dokumentet më të kërkuarat në faqen e internetit të FATF;
- Krijimi i organizmave rajonale të stilit të FATF (ORSF), të cilat kanë fituar së fundi, statusin e “anëtarit të asociuar” (p.sh. Komitetit i Përzgjedhur i Ekspertëve të Vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave, i Këshillit të Evropës – MONEYVAL, i vlefshëm edhe për të gjitha zonat e projektit).

Në një kuadër të tillë të shkëlqyer raportimi për transaksione të dyshimta financiare nëpër Evropë është rritur vitet e shkuara¹⁷² që dëshmon jo vetëm për një rritje të mundshme të aktiviteteve të pastrimit të parave, por edhe për rigjallërimin e aktiviteteve për zbulimin e financimit të terrorizmit pas 11 shtatorit, shtimin e organizmave raportues dhe përmirësimin e sistemeve të luftës kundër pastrimit të parave në vendet evropiane si dhe për njësi më aktive të inteligjencës financiare.

Të influencuara nga ky moment, edhe vendet e Evropës Juglindore kanë marrë përsipër të formojnë kuadrin e përshtatshëm ligjor kundër pastrimit të parave si dhe të ngrënë njësitë e inteligjencës financiare, të cilat pjesërisht janë në fazat e hershme të punës së tyre. Në vijim të kësaj, hetimi financiar, si një mjet esencial në gjurmimin e produkteve të krimin, ende mbetet për t’u zbatuar në praktikë. Për pasojë, përveç të dhënave të rastësishme dhe vëzhgimeve që kryhen nga agjencitë rajonale të zbatimit të ligjit, të dhënat zyrtare që raportojnë nëse dhe si funksionojnë sistemet e pastrimit të parave në rajon, ose mungojnë fare, ose janë të pakta dhe të varfra.

mund të kenë lidhje me pastrimin e parave. Për më shumë hollësi, shih “Raportin mbi Krimin e Organizuar, të vitit 2005” të Këshillit të Evropës, me theksin tek krimi ekonomik, dhjetor 2005, fq.

¹⁶⁹ Mandati i FATF u zgjat së fundmi në maj të vitit 2004 në Mbledhjen e Ministrave të FATF për një periudhë 8 vjeçare (2004-2012). Në tetor të 2001, si kundërpërgjigje ndaj sulmeve të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara, FATF e zgjeroi mandatin e saj dhe miratoi Tetë Rekomandimet e Posaçme për të trajtuar çështjet e veçanta që lidhen me financimin e terrorizmit. Përmirësimi i vazhdueshëm i teknikave të pastrimit të parave e shtyu FATF-në t’i rishikonte Rekomandimet e saj dhe të miratone në qershor të 2006, Dyzet Rekomandime të plotësuara dhe të azhuruara. Më pas, në tetor 2004, FATF publikoi një Rekomandim të nëntë të Posaçëm, duke krijuar standardin e 40+9 Rekomandimeve – një kuadër i gjithanshëm për qeveritë në konsolidimin e përpjekjeve të tyre kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për më shumë hollësi shih: <http://www.fatf-gafi.org>

¹⁷⁰ Konventa e Këshillit të Evropës mbi Pastrimin, Depistimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe mbi Financimin e Terrorizmit (CETS 198), e hapur për nënshkrim në maj 2005.

¹⁷¹ Direktiva mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe për financimin e terrorizmit, 20 shtator 2005, 3631/05 + COR1, 11443/05 ADD.

¹⁷² “Raporti për Gjendjen e Krimin të Organizuar” i vitit 2005, i Këshillit të Evropës, me theksin tek krimi ekonomik, dhjetor 2005, fq. 47.

Metodat për pastrimin e parave në Evropën Juglindore mund të jenë më pak të sofistikuar se në vende të tjera evropiane, me tregje financiare më të zhvilluara¹⁷³. Megjithëse shumica e vendeve evropiane raportojnë se investimi i të ardhurave të paligjshme në bizneset e ligjshme është bërë një pjesë e rregullt e modus operandi të grupeve të krimit të organizuar (dhe ka një impakt domethënës në zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe demokratike të të gjitha shteteve), siç pasqyrohet ndër të tjera edhe në shtimin e numrit të hetimeve, akuzave dhe dënimeve për veprën penale të pastrimit të parave, një praktikë e tillë mbetet ende për t'u asimiluar nga vendet e Evropës Juglindore¹⁷⁴.

Zonat e projektit kanë raportuar se i kanë hasur të tre etapat e pastrimit të parave dhe kanë paraqitur shembuj të karakteristikave specifike të pastrimit të parave në rajon:

Në *Shqipëri*, një sasi e konsiderueshme e parave “të pista” e ka origjinën tek krimet e kryera nga grupet shqiptare të krimit të organizuar, jashtë kufijve shtetërorë. Sektori mbizotërues për pastrimin e parave, mendohet se është biznesi i ndërtimit, ndërkohë që zonat bregdetare dhe zonat urbane janë më tërheqëset, pasi ato ofrojnë potencial për kthimin shumëfish të investimit fillestar. Një prej pengesave kryesore për të bërë kërkime serioze në fushën e krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave është mungesa e të dhënave dhe karakteri i ndryshëm i tyre. Të dhënat statistikore e paraqitura janë të varfra dhe të fragmentarizuara: autoritetet shqiptare kanë raportuar vetëm për dy raste të pastrimit të parave në vitin 2003, gjashtë raste në vitin 2004 dhe asnjë të dhënë për vitin 2005.

Metodat e pastrimit të parave në *Bosnjë dhe Hercegovinë (BiH)* janë të ngjashme me ato që përdoren për evazionin fiskal. Mënyra mbizotëruese për pastrimin e parave nga evazoni fiskal dhe doganor është përdorimi i kompanive fiktive, të krijuara mbi bazën e ID-ve të rreme ose korrupsionit. Kjo metodë, presupozohet se përfshin në një shkallë të gjerë integrimin vertikal në strukturat ligjore, falë edhe bashkëpunimit ndërmjet elitave politike dhe ekonomike.¹⁷⁵ Një element kyç i kësaj skeme është ndarja e brendshme ndërmjet entiteteve të Republikës Srpska, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës me sisteme të ndryshme të zbatimit të ligjit, të bankave, të taksave dhe të regjistrimit. Shuma më të mëdha se 15000 euro ndahen në depozita më të vogla me qëllim që të shmanget zbulimi dhe shpërndahen nëpër llogari të ndryshme bankare, duke përdorur për këtë qëllim, korrierët me pagesë. Të ardhurat nga krimi integrohen nëpërmjet blerjes së pasurive të patundshme, sendeve luksoze dhe privatizimit. Në vitin 2005, BiH ka raportuar 16 raste (+ 100 për qind, krahasuar me vitin 2003). Vlera e parave të pastruara arrin përafërsisht shifrën e 26.5 milionë eurove, prej të cilave mendohet se 1 milionë Euro kanë ardhur nga evazoni fiskal. Duke iu referuar përgjigjeve të dhëna nga BiH, në vitin 2005 janë regjistruar vetëm 2 raste të pastrimit të parave në Federatën e BiH. Gjithsesi, numri i vërtetë mund të fshihet në lloje të tjera krimesh, të raportuara nga Republika Srpska dhe Qarku i Brckos. Deri në maj të vitit 2005, gjykatat e BiH kishin dhënë 8 dënime, dhe gjopa që arrinin vlerën e 690,000 Euro. Vlera e parave të pastruara ka qenë 554,100 Euro, kurse vlera e tatimeve të shmangura ka qenë 8,13 milionë Euro. Shmangia e detyrimeve tatimore ka qenë vepra penale pararendëse, për të tetë rastet e pastrimit të parave. Hetimet që çuan në tetë dënimet e para në fushën e pastrimit të parave kanë regjistruar, në degëzimet e tyre, 643 persona juridikë të dyshuar për pastrim parash.

¹⁷³ FATF ka treguar prirjet e mëposhtëme të pastrimit të parave dhe lidhjet e tij me financimin e terrorizmit: “transfertat në rrugë elektronike”, keqpërdorimi i organizatave jo-fitimprurëse (që mund të jenë një problem veçanërisht serioz për financimin e terrorizmit); “pikat e dobëta të sektorit të sigurimeve”; “mashtimet me karuzelin e TVSH-së”; “kazinotë dhe lojërat e fatit”; “kompanitë boshe dhe bankat e përtej-detit”; “Portierët”. Përveç këtyre, Europoli ka informuar mbi “sistemet alternative të të ardhurave” (ARS). Në janar 2006, FATF publikoi raportin mbi “pastrimin e parave me bazë tregtinë”, që përqendrohej në cënueshmërinë e operacioneve të eksport-importit si dhe një raport i ri “mbi pasuritë e paluajtshme” është duke u konceptuar.

¹⁷⁴ Një vlerësim periodik i efektivitetit të luftës kundër pastrimit të parave bëhet nga mekanizmi monitorues i Këshillit të Evropës, MONEYVAL (www.coe.int/moneyval).

¹⁷⁵ Hejja e Dragan Covic, anëtar i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës nga Përfaqësuesi i Lartë, Lord Ashdown në mars të vitit 2005, lidhej me një abuzim të mundshëm të postit. Ndaj Z. Covic është ngritur akuzë nga Zyra e Prokurorit të Bosnjë dhe Hercegovinës për përjashtime të padeklaruara nga taksat për ortakët e vet biznesmenë në kohën që ai ishte Ministër Financash në vitet 2000-2003. Faji ose pafajësia e Z. Covic mbetet ende për t'u provuar përpara gjykatës. Për detaje të tjera shih artikullin e BBC News: *Ashdown Sacks Top Bosnian Croat (Ashdown heq Një prej Krerëve të Boshnjakëve Kroatë)*, 29 mars 2005, newsbbc.co.uk/1/hi/world/Europe/4390635.stm, Vendimi i Përfaqësuesit të Lartë për të hequr Z. Covic nga detyra mund të gjendet tek faqja e internetit: www.ohr.int/decisions/removalssdec/archive.asp.

Në *Kroaci*, mundësia për pastrimin e parave u krijua nga privatizimi, meqenëse procesi i privatizimit në vetvete nuk kërkonte aspak kontrollin e origjinës së parave të investuara. Kështu që nuk dihet se sa para janë pastruar gjatë privatizimit kroat. Në drejtim të integritit të produkteve të paligjshme, bregdeti kroat mendohet se është më fitimprurësi, (kompani dhe prona të paluajtshme) dhe tërheqë investitorë të brendshëm si dhe investitorë rusë. Mesatarisht, 50 njoftime (sinjalizime) për transaksione të dyshimta (STRs) janë raportuar tek organet kompetente. Në periudhën e viteve 1999-2004, policia kroate ka hetuar 42 vepra penale të pastrimit të parave, të kryera kryesisht nga shtetas kroatë, me origjinë tek krime të tjera, që lidheshin kryesisht me drogën dhe me mashtrime në fushën e taksave. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë dy vendime nga gjykata lidhur me pastrimin e parave, që kanë çuar në konfiskimin e 2.5 milionë €, të fituara nga biznesi i drogës. Kroacia nuk ka paraqitur shifra dhe as informacione të hollësishme për pyetëtorin e vitit 2006.

Kosova miratoi Kodin Penale të Përkohshëm në prill të vitit 2004 dhe krijoi kuadrin organizativ për parandalimin dhe shtypjen e pastrimit të parave. UNMIK-u krijoi Departamentin për Krimin Ekonomik dhe Financiar dhe në shtator të vitit 2004 ngriti Qendrën për Informacion Financiar (QFI), e cila është ende në fazën e vënies në efikasitet. Megjithatë, mendohet se disa çështje janë duke u hetuar, asnjë shifër nuk është paraqitur dhe nuk është raportuar për asnjë dënim. Lidhur me pyetëtorin e vitit 2006 është dhënë vetëm një informacion i përgjithshëm mbi mënyrat se si përdoren kompanitë fiktive.

Në *Malin e Zi*, ashtu si edhe në Shqipëri dhe në Kroaci, sektori më i prekur nga pastrimi i parave mendohet se është bregdeti, i cili është tërheqës për biznesin e paligjshëm rus, ndërkohë që zonat bregdetare që kufizohen me Shqipërinë dhe që rrethojnë qytetin e Ulqinit mendohet se janë më tërheqëse për kapitalin e paligjshëm shqiptar. Janë vënë re gjithashtu disa transferata parash përmes kufijve¹⁷⁶. Për vitin 2005, Mali I Zi ka raportuar vetëm për 7 raste të pastrimit të parave, që lidhen me strukturat e krimit të organizuar, por nuk ka dhënë asnjë informacion shtesë për shumën e parave të pastruara, për dënimet, prirjet, etj.

Në *Serbi*, krimet që përfshijnë pastrimin e parave dhe korrupsionin konsiderohen si më të dëmshmet për shoqërinë. Sasi të mëdha të produkteve të paligjshme duket se vijnë nga shmangia e detyrimeve tatimore dhe doganore, por edhe nga trafiku i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe nga krimet e dhunshme. Produktet pastrohen nëpërmjet procesit të privatizimit si dhe nëpërmjet blerjes së pasurive të patundshme dhe sendeve të luajtshme, duke përdorur llogari bankare brenda dhe jashtë vendit (përtej detit). Një prej rasteve të pastrimit të parave i zbuluar gjatë hetimit të një rasti rrëmbimi, kishte përfshirë investimin e të ardhurave të përfituara në blerjen e apartamenteve dhe të makinave luksoze. Përveç kësaj, përgjigjet për të dy pyetëtorët nuk kanë dhënë asnjë shifër/statistikë për rastet e pastrimit të parave.

Në *"Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë"*, mundësia e parë për pastrimin e parave u krijua nga futja e Euros në vitin 2000. Që nga ajo kohë, shumica të konsiderueshme në cash (para në dorë) janë depozituar nga Kosova, me të cilën "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" nuk ka një qarkullim bankar elektronik. Ngjashëm me vendet e tjera në rajon, autoritetet vendase kanë kryer pak hetime, që nga viti 1997. Gjithsesi, këto hetime kanë dëshmuar për lidhje të fuqishme ndërkombëtare. Shumë prej alokimeve dhe shtresëzimeve të produkteve të krimit, bëhet duke abuzuar me llogaritë bankare të personave jo-rezidentë në këtë vend; nëpërmjet transfertave elektronike; nëpërmjet sistemeve të shpejta të transferimit të parave; nëpërmjet tregtisë me pasuritë e paluajtshme dhe me mallra të tjera; duke punuar në kompani të krijuara përtej detit; nga abuzimet e kompanive të import/eksportit dhe të kompanive me vetëm një punonjës, të krijuara me qëllim të fshehjes së produkteve të krimit; si dhe me anë të transferimit fizik të parave përgjatë kufijve¹⁷⁷. Kjo zone e projektit nuk ka paraqitur as informacion të hollësishëm dhe as shifra për pastrimin e parave, në përgjigjet që i ka dhënë të dy pyetëtorëve.

¹⁷⁶ Mbështetur në intervistat me zyrtarët malazezë të zbatimit të ligjit, gjatë seminareve dhe workshopeve të Projektit CARPO.

¹⁷⁷ Shih shembujt, për të cilët raportohet në Raportin për Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, të vitit 2005, të Këshillit të Evropës, gusht 2005.

3.6 KORRUPSIONI

Korrupsioni nuk përbën çështje specifike vetëm për Evropën Juglindore. Ai është i vjetër sa edhe raca njerëzore dhe ka përfshirë gjithë planetin. Gjithsesi, pabarazitë ekonomike ndërmjet shteteve të rajonit dhe Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera evropiane mund të shkaktojnë njëfarë presioni, që mund të shfrytëzohet lehtësisht nga grupet e krimit të organizuar, nëse mbetet pa përgjigje. Në vendet në tranzicion, ose në krizë¹⁷⁸, korrupsioni mendohet se ka përshtatur shumicën e strukturave të jetës publike, duke përfshirë organet e zbatimit të ligjit dhe sistemin e drejtësisë penale. Pagat e ulëta, papunësia, pasiguria dhe varfëria si dhe shpesh shembulli që ndiqet nga zyrtarët e lartë, i bën nëpunësit publikë, subjekte të pambrojtur dhe partnerë të besueshëm për grupet e krimit të organizuar. Sa më i madh të jetë depërtimi në sektorin e ligjit dhe atë qeveritar, aq më i madh është fleksibiliteti i grupeve të krimit të organizuar, për t'iu përshtatur situatave të reja dhe për të ndryshuar modus operandi të tyre.

Në Evropën Juglindore, korrupsioni është identifikuar vazhdimisht nga Këshilli i Evropës dhe nga Komisioni Evropian si një problem serioz¹⁷⁹. Ai ndikon administratën publike, politikanët, administratën e tatimeve dhe doganat, shërbimet kufitare, sistemin e drejtësisë penale, median dhe sektorin privat nëpërmjet përdorimit të rryshfeteve dhe mjeteve të tjera korruptuese siç janë mbështetja në marrëdhëniet pardon-klient, nepotizmin, favoritizmin, lidhjet familjare, marrëdhëniet etnike, raportet me personat që kanë poste të rëndësishme, ose "personat e ekspozuar politikisht" – kanë qenë metodat kryesore të grupeve të krimit të organizuar për të krijuar uar me sektorin e ligjshëm. Financimi i politikanëve të caktuar, i partive politike dhe fushatave zgjedore dhe në disa raste i kriminelëve të luftës, luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Korrupsioni ushqen marrëdhënie afat-gjata të cilat janë shumë më të qëndrueshme dhe të besueshme se ato të ndërtuara mbi bazën e dhunës dhe të frikësimit.

Korrupsioni dhe krimi i organizuar/ekonomik mendohet se janë dy anët e të njëjtës medalje. Ai përfshin rryshfetin dhe praktika të tjera korruptive të cilat drejtohen si kundër nëpunësve civilë të nivelit të ulët për përbushjen e nevojave operative (policët, zyrtarët e strukturave doganore dhe taksave, oficerët e sigurisë, nëpunësit e zyrave të regjistrimit, etj), ashtu dhe kundër atyre të nivelit të lartë për përbushjen e objektivave afat - gjata (prokurorët dhe gjykatësit, politikanët, anëtarët e parlamentit, shërbimi informativ, etj).

Korrupsioni është gjithashtu i rëndësishëm si praktikë maskuese për aktivitetet e krimit të organizuar. Grupet e krimit të organizuar e përdorin korrupsionin për të depërtuar në shtet, ekonominë e ligjshme, organet e zbatimit të ligjit dhe politikën dhe konsiderohet si një praktikë maskuese shumë më e fuqishme dhe me një nivel të caktuar garancie.

Vitet 90 duket se i janë kushtuar "ndërtimit" të bizneseve të ligjshme. Në vitet 2000, kriminelët e organizuar e kanë përqendruar vëmendjen në konsolidimin e bizneseve dhe në kryerjen e investimeve në ekonominë e ligjshme, dhe korrupsioni mendohet se është një prej metodave kryesore, të përdorura për këtë qëllim.

Zonat e projektit kanë ndërmarrë një shumëllojshmëri masash ligjore dhe të tjera, për të adresuar këtë fenomen kriminal:

Të gjitha zonat kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit¹⁸⁰, Konventën Penale kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (ETS 173) dhe Protokollin e saj Shtesë (ETS 191), sikurse dhe Konventën Civile kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (ETS 137). Pjesërisht, ato kanë marrë në

¹⁷⁸ Associated Press, e dates 29 tetor 2005, duke cituar Hetuesin Kryesor të Kombeve të Bashkuara, Paul Volckerm, i cili paraqiti raportin mbi Skandalin e Programit "Naftë në këmbim të Ushqimit" në Irak, që dukshëm ilustronte shtrirjen e korrupsionit në botë: Hetuesit zbuluan se kompani dhe individë nga 66 vende, kanë paguar një numër rryshfetesësh të paligjshme, duke përdorur metoda të shumëllojshme.

¹⁷⁹ Raporti i Gjashtë i Aktivitetit të Përgjithshëm të GRECOs i vitit 2005. Në këtë kontekst shih gjithashtu Këshilli i Evropës 2004: E ardhmja e Demokracisë, (Projekti i Integruar "Vënia në punë e Institucioneve Demokratike"), raportet e përvitshme të Strasburgut dhe të Komisionit të BE-së lidhur me progresin e Vendeve të Akcesuara.

¹⁸⁰ Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit të miratuar në vitin 2003, është nënshkruar nga 140 shtete dhe ratifikuar nga 38 prej tyre. Shtyllat kryesore të kësaj konvente kanë të bëjnë me : parandalimin, penalizimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kthimin mbarsht të të ardhurave.

konsideratë edhe Konventën e Bashkimit Evropian mbi Luftën kundër Korrupsionit të Zyrtarëve të Komuniteteve Evropiane ose të Zyrtarëve të Shteteve Anëtare, Konventën e OECD-së kundër Korrupsionit tek Zyrtarët e Huaj Publikë gjatë Transaksioneve Ndërkombëtare të Biznesit, Rekomandimin e Rishikuar të OECD-së mbi Luftën kundër Korrupsionit tek Zyrtarët e Huaj Publikë gjatë Transaksioneve Ndërkombëtare të Biznesit dhe Kodin e Sjelljes së Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) mbi Parimet e Biznesit të Luftës kundër Gjobëvënies dhe Rryshfetit, si masa kundër Rryshfetit.

Janë amenduar Kodet Penale Kombëtare, ose janë miratuar ligje të posaçme mbi parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit (shpesh të kombinuar me masat kundër krimit të organizuar). "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka hartuar një ligj të posaçëm që përmban përkufizimin ligjor të korrupsionit¹⁸¹, të gjitha zonat e projektit kanë raportuar se korrupsioni përbëhet nga disa vepra penale korruptive. Në disa prej tyre, korrupsioni në biznesin privat dhe në raport me personat e zgjedhur ka qenë temë e ndryshimit të ligjeve penale.

Të gjitha zonat e projektit kanë lançuar programme kombëtare, strategji dhe plane veprimi për shtypjen e korrupsionit dhe kanë krijuar organizma të centralizuar për të gjitha aktivitetet kundër korrupsionit – duke nisur nga Avokati i Popullit, (Ombudsmani), deri tek "Komisione Shtetërore" të pavarura dhe autonome, - si dhe departamente ose njësi të specializuara për hetimin e korrupsionit. Përparimi në çështjet kundër korrupsionit mbështetet dhe vëzhgohet në mënyrë të veçantë nga Këshilli i Evropës dhe nga OECD¹⁸²: Në vitet 2004 dhe 2005, ekipe vlerësimi të GRECO-s kanë kryer vizita në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe "Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë". Vlerësimi i përvitshëm i BE-së i shteteve të asociuara si dhe Komiteti Drejtues i Nismës Anti-Korrupsion të Paktit të Stabilitetit (SPAI) bëjnë vlerësimin e vazhdueshëm të zonave të projektit dhe përpilojnë raporte vlerësimi mbi baza periodike.

Ndonëse ka një perceptim të përgjithshëm – ashtu siç raportohet nga shumica e zonave të projektit – mbi lidhjet e ngushta ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar, të dhëna të besueshme, shifra të krahasueshme dhe analiza të mirëfillta për lidhjet e sakta që ekzistojnë ndërmjet rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, pothuaj nuk ekzistojnë. Shqipëria ka pohuar madje se grupet e krimit të organizuar nuk e përdorin zakonisht korrupsionin por angazhojnë ndërmjetës që veprojnë në emër të personave të tjerë.

Kroacia ka regjistruar 2 raste korrupsioni, me 2 grupe të krimit të organizuar dhe 6 persona të përfshirë. Edhe raste të tjera korrupsioni janë regjistruar, që kanë përfshirë gjyqtarë dhe zyrtarë të zyrave të regjistrimit, pranë gjykatave, që lëshojnë certifikata pronësie. Kosova ka raportuar për 20 raste të krimit ekonomik dhe korrupsionit. Mali i Zi ka regjistruar 221 raste të korrupsionit në vitin 2004, nga të cilat asnjë nuk kishte lidhje me krimin e organizuar. Serbia ka regjistruar 18 raste me 4 grupe të krimit të organizuar të përfshirë. "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" ka regjistruar 536 raste të korrupsionit. Asnjë lidhje me krimin e organizuar nuk është vërtetuar.

Në vitin 2005, duke iu referuar përgjigjeve të kapitullit 7 të pyetësorit të vitit 2006¹⁸³, me përjashtim të Shqipërisë, e cila nuk ka mundur t'i zbulojë lidhjet ndërmjet korrupsionit dhe krimit të organizuar, zonat e projektit kanë raportuar për zero raste të korrupsionit që ka lidhje me krimin e organizuar dhe dy zona të projektit nuk kanë paraqitur asnjë shifër ose informacion të hollësishëm mbi korrupsionin (Serbia dhe "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"). Të gjitha zonat e projektit kanë raportuar në terma të përgjithshme dhe kanë dhënë pak a shumë shifra të hollësishme.

Ministria e Brendshme e Shqipërisë ka përmendur 8 raste dhe nga Bosnja Hercegovina (BiH), vetëm Federata e BiH-së ka raportuar për raste të korrupsionit (167). Kroacia, e vetmja ndër zonat e projektit ka paraqitur të dhëna shumëvjeçare të hollësishme 2002-2005). Në vitin 2005 janë regjistruar 442 raste të korrupsionit (+ 66 për qind). Kosova ka informuar vetëm në mënyrë të përgjithshme për disa raste shumë pak të vlefshme (me rryshfete deri në 250 euro), ndërkohë që Prokurorët Ndërkombëtarë që punojnë në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut kanë

¹⁸¹ Korrupsioni konsiderohet se është shfrytëzimi i funksionit, autoritetit publik, i një detyre zyrtare, ose pozitës, për të nxjerrë përfitime për veten, ose për dikë tjetër.

¹⁸² Studimi I OECD-së mbi "Instrumentet kundër korrupsionit dhe Udhëzimet e OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe", shtator 2003; "Udhëzimet" është një prej nëntë instrumenteve të OECD-së për t'iu kundërvënë korrupsionit në planin global.

¹⁸³ Krahasuar me informacionin më të shtjelluar që është raportuar lidhur me Pyetësorin e vitit 2005 të Këshillit të Evropës.

raportuar për akuza të ngritura kundër 177 personave në 62 raste. Mali i Zi ka raportuar për gjithsej 207 raste dhe ka informuar me më shumë hollësi lidhur me llojet e ndryshme të krimeve korruptive.

Duke iu referuar dy zonave të projektit, të cilat kanë prezantuar informacione më të hollësishme, shumica prej veprave penale të korrupsionit kanë të bëjnë me abuzimin me postin, ose autoritetin public, abuzimin gjatë kryerjes së detyrave qeveritare dhe abuzimin e autoritetit në ekonomi (rreth 90 për qind). Gjithsesi, korrupsioni duket se përbën më shumë kërcënim gjatë procesit të privatizimit, planifikimit urban, inxhinierisë civile dhe tenderave publikë. Forma klasike e korrupsionit (marrja dhe dhënia e një rryshfeti) mendohet se është në përqindje një-shifrore.

Ekspertët vlerësojnë se në vendet e Evropës Juglindore, janë përdorur të gjitha llojet e rryshfeteve dhe të influencave korruptive: rryshfetet e nivelit bazë, rryshfetet sistemore dhe rryshfetet politike. Gjithsesi, mbështetur tek këto të dhëna të pakta nuk mund të bëhet një analizë e gjithanshme mbi karakteristikat, xhiron – sidomos lidhur me sektorët e prekur, impaktin mbi shoqërinë, shtetin e së drejtës, demokracinë, etj. Me qëllim që të përmirësohet situata, duhet të përdoret një metodologji e re, që kombinon parandalimin efektiv dhe shtypjen e korrupsionit, që e konsideron atë një simptomë të përbashkët për të gjitha aktivitetet e rënda kriminale, dhe jo shkakun e tyre, si dhe një sistem më i shëndoshë raportimi. Ende ka dyshime serioze lidhur me efektivitetin e politikave për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit si dhe për zbatimin e tyre në praktikë¹⁸⁴

Transparency International, organizatë me përvojë shumëvjeçare dhe e njohur ndërkombëtarisht për statistikat e saj të besueshme mund të cilësohet një nga mekanizmat monitorues më të fuqishëm dhe të besueshëm¹⁸⁵. Duke iu referuar Indeksit për Perceptimin e Korrupsionit të vitit 2005, zonat e projektit renditen poshtë në tabelë¹⁸⁶.


Konkluzionet e Barometrit Global të Korrupsionit, për vitin 2003, të Transparency International që përbën një radiografi të perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve në lidhje me korrupsionin në vendet e tyre, pasqyrojnë mosbesimin e publikut të gjerë tek sistemet e tyre kombëtare **politike** dhe të drejtësisë penale, tek partitë politike, parlamentet, policia dhe gjyqësori, që mendohet se janë sektorët më të prekur nga korrupsioni.

¹⁸⁴ Nisma e Këshillit të Evropës kundër korrupsionit “Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) dhe Raportet e tij Vlerësuese, p.sh. mbi Bosnjë Hercegovinën miratuar nga GRECO më 17-20 maj 2005, Malin e Zi, Serbinë, miratuar nga GRECO më 10-14 tetor 2005 dhe Kroacinë, miratuar më 5-9 dhjetor 2005.

¹⁸⁵ Për informacione të hollësishme mbi CPI dhe Indeksin e Pagimit të Rryshfeteve shih (www.transparency.org).

¹⁸⁶ Shih tabelën 1 të këtij raporti. Në periudhën ndërmjet viteve 2003 dhe 2005, Shqipëria ra nga pozicioni 92 në pozicionin e 108; Bosnia dhe Hercegovia nga pozicioni i 70, ra në pozicionin e 83 dhe më pas të 88; Kroacia ra nga vendi i 60, në vendin e 67, dhe më pas në vendin e 70; “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” u ngrit nga pozicioni i 108, në pozicionin e 99, dhe më pas ra përsëri në pozicionin e 103. Manli i Zi dhe Serbia, nga vendi i 109, në vendin e 100 dhe të 97.

Grafiku 7: Sektorët dhe Institucionet më të prekura nga korrupsioni



Burimi: Barometri Global i Korrupsionit i Transparency International për vitin 2005 (1 jo i korruptuar - 5 i korruptuar në ekstrem)

Rezultatet në nivel rajonal janë pak më të ndryshme, qytetarët e Evropës Juglindore i tregojnë sistemin e tyre partiak dhe policinë të korruptuar në të njëjtin nivel. Raporti jep informacione të vlefshme se si shpeshësia e dhënies së rryshfetit ndryshon nga njëri vend në tjetrin: Shtetasit e Serbisë (dhe Malit të Zi) kanë raportuar se ata kanë paguar rryshfet brenda një periudhe prej 12 muajsh më shpesh se sa shtetasit e Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”. Kjo përputhet me pritshmëritë e shtetasve: ata që jetojnë në Kosovë (njësoj si ata që jetojnë në Ukrainë, ose në Rumani) kanë qenë më pozitivët (një e treta shpresojnë se situata do të përmirësohet), përkundrazi, qytetarët e Bosnjë Hercegovinës, të cilët ishin krejt optimistë një vit më parë, me 40 për qind të tyre që besonin se korrupsioni do të ulej, tashmë ishin më pesimistët, me 40 për qind të tyre, që besonin se korrupsioni do të rritej gjatë tre viteve të ardhshëm.

4 Profilet e zonave të projektit¹⁸⁷

4.1 SHQIPERIA

Procesi i tranzicionit në Shqipëri, që prej vitit 1991 është ndikuar rëndë nga disa faktorë, të tillë si:

- Ndryshimet dramatike në sistemin politik, të shoqëruara me ndryshime në sistemin ekonomik dhe instalimin e pronës private, dhe ndikime nga preferencat partiake, presione politike dhe korrupsion;
- Kriza e skemave kriminale piramidale në vitin 1997, në të cilën burime financiare të konsiderueshme u përqendruan në duart e pak vetëve, duke shkaktuar revolta publike dhe ndryshimin e qeverisë;
- Fluksi i madh i refugjatëve kosovarë për në Shqipëri¹⁸⁸
- Migracioni në shkallë të gjerë i shqiptarëve, kryesisht në vendet fqinjë, Itali dhe Greqi.

Koha dhe shumëllojshmëria e këtyre sfidave e kanë vënë përballë presionit procesin e demokratizimit të institucioneve shqiptare. Krimi i organizuar në Shqipëri, sikurse dhe të gjitha faktet e tjera të vëzhguara pas vitit 1990, është tërësisht një fenomen i periudhës së tranzicionit. Ai mbetet ende një koncept i paqartë në shoqërinë shqiptare dhe ende konsiderohet homogjen nga pikëpamja etnike dhe i strukturuar formalisht dhe hierarkikisht.

Është e vërtetë, se që prej vitit 1998, viti që pasoi përmbysjen e skemave financiare piramidale, qeveritë kanë bërë përpjekje për të vënë në jetë reforma ligjore dhe institucionale. Për shembull, janë krijuar Drejtori të Posaçme kundër Krimit të Organizuar si në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu edhe në Ministrinë e Dikurshme të Rendit Publik (tani Ministria e Brendshme), si dhe Qendra Anti-Trafik. Pavarësisht këtyre përmirësimeve ligjore dhe ratifikimit të Konventës UNTOC, në korrik 2002, ligjet shpesh kanë kaluar me shpetjësi dhe pa ndërthurjen e duhur me ligjet ekzistuese. Ligjet janë zbatuar në mënyrë jokonsistente, dhe vetëm pjesërisht janë përshtatur dhe vënë në jetë nga autoritetet e zbatimit të ligjit, që ka rezultuar vetëm në disa aktivitete “modeste” të institucioneve të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.¹⁸⁹ Për ta përmbledhur performancën e sistemit të zbatimit të ligjit dhe sistemit gjyqësor mund të kishin qenë më të mira.

Shqipëria ka përmirësuar gjithashtu edhe shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit, jo vetëm duke përmirësuar kuadrin ligjor në këtë drejtim, por edhe në një nivel individual, me anë të trajnimeve intensive të cilat janë mbështetur nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Në vitin 2004, amendamente të ndryshme iu bënë Kodit Penal, me qëllim përshtatjen e tij me kriteret evropiane, si dhe u miratuan ligje të reja, si për shembull, Ligji nr 9248, “Mbi Prandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” si dhe Ligji nr 9084, që ndryshoi Ligjin nr. 8610 “Mbi Prandalimin e Pastrimit të Parave”, apo edhe Ligji nr. 9258, “Mbi Masat kundër Financimit të Terrorizmit”.

Në ditët e sotme, Shqipëria duket se është angazhuar më shumë në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik. Pas Zgjedhjeve të Përgjithshme të vitit 2005, Qeveria e re Shqiptare e ka konsideruar krimin e organizuar dhe krimin ekonomik, një prej problemeve më serioze me të cilat përballet vendi:

“Shqipëria dhe populli shqiptar po përballen sot me nivelin më të lartë të krimit të organizuar; një krim i organizuar tepër i fuqishëm që zotëron sasi të jashtëzakonshme parash nga trafiket kriminale. Ky krim kërcënon më tepër se çdo gjë tjetër, liritë dhe të drejtat e qytetarëve shqiptarë. Ky krim kërcënon jetën dhe pasuritë tona, si dhe dëmton shumë rëndë imazhin e vendit tone si dhe përpjekjet e tij për t’u ri-integruar në familjen euro-Atlantike. ... Unë dëshiroj t’ju siguroj juve se në programin e qeverisë, që unë drejtoj, lufta kundër krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, të bimëve narkotike dhe kundër trafikëve të tjera kriminale, pastrami i parave sikurse dhe financimi i organizatave terroriste, janë objektivat më madhorë që duhen përmbushur prej nesh. Ne i kemi deklaruar “tolerancë zero” krimit. Në këtë kontekst, unë e quaj vendimtare prerjen e marrëdhënieve të krimit me politikën. Ka qenë dhe mbetet besimi im i palëkundur se krimi i organizuar ka mbrojtje dhe frymëzim politik në Shqipëri, dhe jo vetëm në

¹⁸⁷ Me përjashtim të rasteve, kur ëshë përcaktuar shprehimisht e kundërta, i gjithë informacioni i paraqitur në “Profilet e vendeve” është mbështetur në përgjigjet e dhëna për pyetësorët nga vendet e këtij projekti.

¹⁸⁸ Siç është theksuar gjatë workshopeve dhe gjetjeve të ndryshme, gjatë përgatitjes së Raportit të vitit 2005.

¹⁸⁹ Shih Raportin e Vlerësimit nga Misioni i Asistencës Policore të Komisionit Evropian dhe Rekomandimet për misionin e ardhshëm ECPA; 22 korrik 2002

Shqipëri, por në të gjithë rajonin, sikurse kanë dëshmuar edhe disa prej veprave të krimit të organizuar, në epiqendrat e vendeve të rajonit...

Përvec kësaj, qeveria që unë drejtoj, e cila është përcaktuar qartë në këtë drejtim, ka vendosur të shpallë një Moratorium tre-vjecar mbi skafet, me qëllim që të ndalojë fluksin e trafiqeve ilegale drejt Perëndimit. Ne jemi të mendimit se përmirësimi i Kodit Penal, përshtatja e tij ndaj agresionit të krimit të organizuar, është I domosdoshëm, në mënyrë që krimi të marrë përgjigjen e merituar institucionale. Pra, në këtë kontekst, ne jemi të vendosur ta rishikojmë Kodin Penal, Procedural Penal, duke qenë të bindur se në këtë mënyrë, e bëjmë praktike thënien "zero tolerance" kundër krimit.¹⁹⁰

Në përkufizimin që Kodi Penal shqiptar i bën krimit të organizuar futen:

- "Organizatë kriminale", e cila është forma më komplekse dhe që ndëshkohet më rëndë nga Kodi Penal shqiptar;
- "Grupi i strukturuar kriminal", një formë më e lehtë e krimit të orgnaizuar, anëtarët e të cilit kanë kontakte më pak të ngushta, por që gjithsesi, nuk formohet rastësisht, por me qëllimin e kryerjes së një vepre të rëndë penale;
- "banda e armatosur".

KRIMI I ORGANIZUAR DHE TIPARET E TIJ TË SPIKATURA

Duke iu referuar përgjigjeve që autoritetet shqiptare i kanë dhënë pyetësorëve të Projektit CARPO, rezulton se krimi i organizuar është bërë më i fuqishëm nga ditët e tij të para,¹⁹¹ duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara si dhe duke i pasuruar aktivitetet e veta kriminale, me: trafikun e drogës, kontrabandën e personave, cigareve, armëve dhe mallrave të tjera, krimin ekonomik, korrupsionin si dhe duke fuqizuar lidhjet me jashtë. Këto zhvillime janë përsheptuar edhe më shumë, nga prania e koncepteve dhe mentaliteteve të vjetra sic janë burokracia, apatia, përzgjedhja dhe punësimi në pozicionet e administrates publike mbi bazën e kriterëve politike dhe korruptive, të cilat përbëjnë nxitje për krimin e organizuar dhe për korrupsionin.

Migracioni i cili ka nisur në fundin e vitit 1990, ka ushqyer gjithashtu lidhjet e ngushta ndërmjet diasporave të krijuara rishtazi, në gjirin e Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera, me vendin mëmë, të cilat shërbejnë si shtysa për transferimin e praktikave të reja të kundraligjshme. Si rrjedhojë e mentalitetit të përbashkët, (nderi, besnikëria), gjuhës, zakoneve, lidhjeve familjare dhe miqësore, janë krijuar grupe kriminale etnikisht shqiptare, (të tipit të klanit) të cilat janë të qëndrueshme dhe kryejnë aktivitete afatgjata, jo vetëm në Evropën Juglindore, por edhe në të gjithë Bashkimin Evropian¹⁹² dhe më tej. Këto grupe të krimit të organizuar janë relativisht "të modes së vjetër", të ngjashme me strukturën e Mafias italiane të dyzet vjetëve më pare.¹⁹³

Gjithsesi, disa grupe kanë anëtarë si me kombësi shqiptare, ashtu edhe me kombësi të huaj, ku të huaj janë përgjithësisht, italianë, por edhe belgë, gjermanë, grekë dhe qytetarë britanikë.¹⁹⁴ Zakonisht, këto grupe të krimit të organizuar, e shoqërojnë aktivitetin e tyre të paligjshëm me disa biznese të ligjshme, anëtarët e tyre kanë zakonisht arsim të lartë, janë madje anëtarë të administrates shtetërore, të gjyqësorit dhe të qeverisë, anëtarë të

¹⁹⁰ Kryeministri Berisha në Fjalën e tij Përsëhendetëse në Konferencën Ndërkombëtare mbi Sfidat Ndër-Kufitare për Evropën Juglindore, "Lufta kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit", Tiranë, 09-10 Nëntor 2005.

¹⁹¹ Ashtu sic është raportuar në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2005 mbi "Gjendjen e Krimit të Organizuar, me theksin tek Kërcënimi i Krimit Ekonomik. Dhjetor 2005" në Shqipëri janë regjistruar 1448 procedime penale, me 1353 të pandehur që kanë lidhje me krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandën, si dhe korrupsionin. Nga këto 16 procedime penale janë hapur kundër organizatave kriminale.

¹⁹² Për pasojë, Europol-i nxori që në vitin 2001, një vlerësim gjithpërfshirës të kërcënimit në fjalë, të titulluar: Grupet Kriminale Shqiptare", në vijim të një projekti të veçantë, me mbështetjen e të ashtuquajturës "Konferenca e Londrës" në nëntor 2002 dhe në vitin 2003 i dorëzoi një "vlerësim të rrezikut" Shefit Evropian të Task-Forcës Policore, që përmbante informacione të freskëta dhe alarmante. Deri më tani, "Grupet Kriminale Etnike Shqiptare" është një prej projekteve të Europol-it më operative dhe më të suksesshme. Shih gjithashtu, Raportin mbi Krimin e Organizuar të Bashkimit Evropian, të vitit 2005, tetor 2005, të përpunuar dhe të publikuar nga Europol-i.

¹⁹³ Gjendja e Krimit të Organizuar, në vendet e Evropës Juglindore, dhe Aktivitetet e Paligjshme të kryera nga Grupet Kriminale", një vlerësim i Paktit të Stabilitetit, i hartuar në kuadër të TRANSCRIME, Qendra Kërkimore për Krimin Ndërkufitar, në Universitetin e Trento-s, janar 2003.

¹⁹⁴ Ibid, profili i Shqipërisë, p. 29 - 36

administrates së taksave, ekonomistë, juristë, madje janë raportuar raste kur anëtarë kanë qenë edhe zyrtarë të policisë dhe të doganave. Në kryerje e aktiviteteve të tyre kriminale, grupe të tilla përdorin teknika tepër të sofistikura, sic janë përshembull: kundërsurvejimi, përdorimi i shpesh të mesazheve të koduara dhe shprehjeve të koduara gjatë bisedave telefonike, apo komunikimit me e-mail, ndryshimi i shpesh të kartave të parapaguara të telefonave, aktivitetet ndërkufitare, transfertat e paligjshme të parave të fituara në mënyrë të paligjshme, përtej kufijve shtetërorë dhe në bankat e huaja.

Është e drejtë të theksohet se çmontimi i disa organizatave kriminale kohët e fundit dhe arrestimi i disa personave me profil të lartë kriminal dhe anëtarë të grupeve të ndryshme të krimit të organizuar, i ka dhënë një goditje të fuqishme botës së krimit të organizuar në Shqipëri. Që prej nëntorit 2005, pothuaj çdo javë ka patur të reja lidhur me arrestimin e kriminelëve, trafikantëve, grupeve të organizuara dhe madje edhe zyrtarëve të korruptuar të policies së shtetit. Kjo tregon edhe një here vendosmërinë dhe gatishmërinë e qeverisë së re shqiptare për të goditur të gjitha llojet e krimit të organizuar, duke e rritur në mënyrë të ndjeshme reputacionin e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit shqiptar.

Shqipëria nuk ka paraqitur as të dhëna dhe as shifra të përgjithshme lidhur me krimin e organizuar për pyetësin e vitit 2006. Megjithatë, raporti zyrtar për gjendjen e krimit të organizuar në Shqipëri dokumentonte se 2,316 krime të organizuara janë kryer nga më shumë se 2600 kriminelë, nga të cilët 50 për qind janë arrestuar. Shumë prej krimeve të raportuara lidheshin me krimin ekonomik dhe me pastrimin e parave (49 për qind), me trafikun e drogës (28 për qind) dhe me trafikun e paligjshëm (20,5 për qind).

DROGAT E PALIGJSHME

Shqipëria, duket qenë një segment i degës së jugut, të së ashtuquajturës “Rrugë Ballkanike” konsiderohet më shumë një vend tranziti, se sa një vend konsumi i drogës. Sidoqoftë, biznesi i drogës, ka evoluar duke përfshirë si prodhimin ashtu edhe shpërndarjen në tregun vendas. Në përgjigje të këtij evolucioni, Shqipëria ka miratuar të gjitha Konventat e Kombeve të Bashkuara, ka ndryshuar legjislacionin vendas, ka miratuar në maj të vitit 2004, “Strategjinë Kombëtare kundër Drogës 2004-2010”. Në shtator të të njëjtit vit, ajo miratoi “Planin Kombëtar të Veprimit” që pasoi Strategjinë kundër Drogës. Përveç kësaj ndryshimet e fundit ligjore, që kanë përfshirë edhe zyrtarët e pushtetit vendor në luftën kundër kultivimit të kanabisit duke i bërë ata përgjegjës përpara ligjit, nëse nuk raportojnë, konsiderohet nga perspektiva e policisë një mundësi e mire, që mund të sjellë rezultatet e dëshiruara, nëse zbatohet me përpikmëri.

Shqipëria ka raportuar se drogat sintetike nuk përbëjnë ende një problem për Shqipërinë, pasi klientët nuk kanë shumë dijeni për to. Kjo është demonstruar në mënyrë të dukshme nga statistikat e paraqitura (2004: 1 rast, 1 autor, 10 pilula; ndërkohë që për vitin 2005, nuk është raportuar asnjë e dhënë). Sidoqoftë, prodhimi i drogave sintetike dhe i precursorëve duhet të përmendet. Ekspertët evropianë për drogat, e dine fare mire se kriminelët, nuk instalojnë laboratorë, nëse nuk gjendet ndonjë treg në afërsi, (me qëllim që të ketë disa faza më pak në zinxhirin e shpërndarjes së drogës, duke nxjerrë më shumë fitime për secilën fazë). Gjithsesi, prodhimi dhe trafikimi i drogave sintetike nuk është një çështje që u takon organizatave të mëdha kriminale që veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra. Përvojat e BE-së kanë treguar se ky treg priret të kontrollohet nga grupe të vogla, kriminelësh të mëdhenj (5-6 nivele), për shembull, financierë, ndihmës laborantë, furnizues të lëndës së parë, përzierës të pilulave, korrierë), duke nxjerrë fitime tepër të mëdha.

Meqenëse laboratorë të tillë të paligjshëm janë gjetur në pothuaj të gjitha vendet anëtare të BE-së, do të kishte qenë tepër e habitshme, nëqoftëse kriminelët shqiptarë nuk do të kishin përfituar nga rasti për të fituar para të paligjshme, nga një krim i tillë me rrezik të ulët, që gjeneron fitime kaq të mëdha. Prandaj, duhet të shtrohet pyetja, nëse sistemet e BE-së për monitorimin e precursorëve, përbërësve kimikë thelbësorë, (reagjentë dhe shkrirës) si dhe katalizatorëve, janë zbatuar në mënyrën e duhur në Shqipëri.

Për vitin 2005, janë raportuar vetëm dy hetime për kompani shqiptare, por këto kompani janë përpjekur të importojnë sasi të konsiderueshme efedrine nga Kina dhe nga Mbretëria e Bashkuar, duke përdorur licencë dhe autorizime false. Kjo e provon ekzistencën e tregut të drogave sintetike në Shqipëri, të paktën në sferën e prodhimit. Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, vendosja e sistemeve monitoruese të shëndosha dhe

gjithpërfshirëse, si dhe forcimi i sektorit të luftës kundër trafikut të drogës, janë instrumente të përkryera për të zbuluar më shumë laboratorë të tillë të paligjshëm.

Shqipëria vazhdon të jetë i vetmi vend në rajon që prodhon kanabis (hashash, marihuanë, dhe vaj hashashi) për eksport, sikundër dhe është raportuar, por me një tendencë në rënie: në vitin 2004 dhe 2005 janë arritur rezultate të konsiderueshme në shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, të cilat janë reflektuar edhe në rritjen drastike të çmimit të kanabisit në tregun shqiptar (nga 25-30 €/kg në 2003 në 100-130 €/kg në vitin 2005). Tashmë kanë mbetur të njohura vetëm pak zona të kultivimit të kanabisit, të tilla si Vlora, Shkodra, dhe Fieri, ndërkohë që në vitet e mëparshme, kultivimi i kanabisit ishte i përhapur në të gjithë Shqipërinë. Pavarësisht këtyre rezultateve të raportuara, të dhënat statistikore tregojnë për një numër në rritje të bimëve të kanabisit të sekuestruara, (në 2004: 155 raste me 74 000 rrënjë; në vitin 2005: 458 raste me 333 000 rrënjë të kapura; gjatë pesë muajve të parë të vitit 2006, 1915 bimë kanabisi të shkatërruara, ose 1,453.6 kg) të trafikimit të hashashit dhe të marihuanës (viti 2004: 93 raste, viti 2005: 228) dhe kapjet (janar-may 2006: 379.9 kg)

Vendet e destinacionit për hashashin dhe marihuanën janë kryesisht Greqia dhe Italia, por ka pasur edhe të dhëna për trafikimin e tyre në Maqedoni, Mal të Zi, Greqi dhe vende të tjera anëtare të BE-së. Në disa raste edhe në Turqi, në këmbim të heroinës. Hashashi dhe Marihuana transportohen zakonisht në Greqi, ose në vende të tjera të Evropës Juglindore, me anë të rrugës tokësore dhe të kamionëve. Përforcimi i masave të kontrollit kufitar, kanë rezultuar në çmontimin e rrugëve të trafiku të drogës në Itali, nëpërmjet përdorimit të skafeve, por, trafiku me anë të anijeve të ndryshme përdoret ende gjerësisht në rajon.

Shqipëria ende mbetet një prej vendeve tranzit për trafikimin e heroinës nga Afganistani nëpërmjet Turqisë dhe vendeve të tjera të Evropës Juglindore, pavarësisht shifrave në ulje, apo ngritje (për vitin 2004: 91 raste me 152 autorë; për vitin 2005: 67 raste me 116 autorë). Kriminelët shqiptarë e importojnë heroinën në bashkëpunim të ngushtë me trafikantët turq, maqedonas dhe kosovarë. Zakonisht, transportet organizohen me kamionë, autobuzë dhe makina nëpërmjet këtyre dy itinerarëve: ose *Turqi – Bullgari – “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” - Shqipëri*, ose *Turqi – Bullgari - “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” - Kosovë - Shqipëri*. Pjesa më e madhe e heroines vazhdon rrugën e vet drejt Greqisë, Italisë, apo vendeve veriore të Evropës Juglindore, deri tek tregjet e tjera të vendeve anëtare të BE-së. Vetëm një porcion i vogël i heroines, kryesisht e një cilësie të ulët, mbetet në Shqipëri për nevojat e një tregu vendas në rritje.

Duke iu referuar të dhënave për qendrat e trajtimit të varësisë nga droga, në vitin 2000, 968 persona kanë kërkuar trajtim, ndërkohë që në vitin 2003 numri ka qenë 1360 persona. Përgjigjet që i janë dhënë pyetësorit të vitit 2006, nuk përmbajnë të dhëna, por pohojnë se ka një rritje të qëndrueshme (konstante) në numrin e personave që kërkojnë trajtim¹⁹⁵. Deri më sot në Shqipëri çmimi i heroinës varion nga 11.000 euro për kilogram në 14,000 euro për kilogram. Konsumi i heroinës lidhet po ashtu ngushtësisht me incidente të HIV dhe AIDS, një aspekt i rëndësishëm, që duhet studiuar, vlerësuar dhe përfshirë në panoramën e përgjithshme të konsumit të drogave në tregun e brendshëm.

Kokaina mbërrin në Shqipëri, kryesisht nëpërmjet rrugëve ajrore ose nëpërmjet shërbimeve postale. Ajo e ka origjinën në SHBA, ose në vendet e Amerikës Jugore (Kolumbi, Peru, Panama, Meksikë, etj). Vetëm pak raste janë raportuar, në të cilat kokaina është trafikuar në Greqi, ose në Itali, por hetimet, të dhënat e shërbimeve inteligjente si dhe sekuestrimet, dëshmojnë për faktin se tregu i kokainës në Shqipëri nuk është shumë domethënës. Deri më tani, çmimi i një kilogrami kokainë në Shqipëri shkon deri në 35 000 Euro për kilogram.

Vite të tëra të një aktiviteti kriminal që lidhet me trafikun e drogës, i kanë bërë bandat shqiptare të krimit të organizuar tepër të njohura për agjencitë e zbatimit të ligjit të vendeve të BE-së dhe vendeve të tjera. Organizimi i tyre shumë i efektshëm mbështetet në ekskluzivitetin etnik si dhe në lidhjet e ngushta me Greqinë, Italinë dhe vende të tjera të BE-së, me komunitete shqiptare të konsiderueshme. Është vërejtur se bandat shqiptare mbajnë pozicione kyçe në trafikun e drogës në rajon, duke pushtuar hierarkitë më të larta si dhe duke arritur furnizime dhe shpërndarje të sasive të mëdha të drogës, ndërkohë që ua ngarkojnë kryerjen e detyrave bazë, kriminelëve të etnive të ndryshme në rajon.

¹⁹⁵ Të dhënat e grumbulluara nga agjenci të ndryshme qeveritare dhe nga OJQ tregojnë se në Shqipëri ka 30, 000 përdorues të drogës.

Një grupim kriminal, shpesh zotëron një strukturë hierarkike, në të cilën fitimet ndahen sipas pozicionit dhe rolit që secili ka në organizatë. Bashkëpunimi në kuadër të kësaj strukture kriminale, është relativisht i qëndrueshëm, pasi personat që arrestohen zëvendësohen lehtësisht me të tjerë. Kriminelët e përfshirë në trafikun e drogës kanë zakonisht një të shkuar kriminale, shpesh kanë qenë të përfshirë në akte të dhunshme (deri në vrasje) dhe mund të jenë marrë me trafikim grash, ose me kontrabandë të emigrantëve. Anëtarët e grupeve kriminale që merren me trafikun e drogës i bashkojnë lidhje shoqërore, rajonale apo familjare dhe shfaqin një sens të lartë discipline dhe vigjilence në ruajtjen e sekretit. Pavarësisht se grupe të tilla përbëhen kryesisht nga shqiptarë, ata mbajnë kontakte të rregullta edhe me kriminelë të huaj nga Turqia, Italia, “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, etj. Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit janë duke vëzhguar aktualisht deri në 20 grupe të krimit të organizuar, të përfshirë në trafikun e drogës, të përbërë nga 3-20 anëtarë, që kushtëzohet nga faza e krimit, në të cilin janë përfshirë. (mbjellja, blerja, përpunimi, transporti, shpërndarja, korrierët, etj).

Kapacitetet si financiare ashtu edhe teknike të grupeve të krimit të organizuar i tejkalojnë shpeshherë kapacitetet e agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit, të cilat përballen me vështirësi, sidomos kur u duhet të kryejnë hetime komplekse, afat-gjata dhe në shkallë të gjerë që diktojnë nevojën e përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve të përbashkëta (që kërkojnë njohjen e gjuhëve të huaja), sekuestrimin dhe menaxhimin e pasurive të sekuestruara, mbrojtjen e dëshmtiarit si dhe një proces gjyqësor më të efektshëm. Por aktualisht, duket se gjendja ka ndryshuar diametralisht, në raport me gatishmërinë dhe angazhimin e agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit për të luftuar aktivitetet kriminale, sidomos në lidhje me fenomenet që kanë lidhje me trafikun e drogës.

Në drejtim të modus operandi, korrupsioni i zyrtarëve të policies, doganave, apo të shërbimit informativ, ende përdoret për lehtësimin e trafikut të drogës. Disa nga grupet kriminale tentojnë drejt zgjerimit të aktivitetit dhe kontrollimit të ciklit të plotë të biznesit të drogës (financimin, prodhimin, shpërndarjen, transportimin dhe shpërndarjen/shitjen).

Vlera e drogës së prodhuar, ose të trafikuar nëpërmjet Shqipërisë, arrin, sipas autoriteteve shqiptare, vlerën e përafërsisht 50 milionë eurove në vit.¹⁹⁶

Tabela 5: Paraqitja në formë tabelle e sasisë së drogave narkotike të kapura (Shqipëria)

Drogat narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006 (Jan-May)
Heroina (kg)	4.5	71.7	114.5	156.0	40.9	77.6
Hashashi/ (kg)				4,544.2	6,332.0	379.9
Marihuana (kg) *						
Kokaina (kg)	0.27	0.006	1.3	2.4	2.8	1.0
Amfetamina (kg)						
Ekstazi (MDMA)				10		
Canabisi (bimë)	6,915	13,718	7,760	73,757	332,186	1,915
Poppy (bimë)				695		
LSD (doza)						

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë- qershor 2006 (* hashashi dhe marihuana vetëm me një shifër)


TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Shqipëria konsiderohet tashmë jo më një vend tranziti, por një vend origjine për trafikimin e qenieve njerëzore. Njerëzit trafikohen nëpërmjet pikave të kalimit të kufirit. Në vitin 2005, Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë iu bënë ndryshime thelbësore, dhe amendimet e tij të mëvonshme, të vitit 1996, 1997, 1998 dhe 2004 dhanë si rezultat ashpërsimin e dënimeve për trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim përqasjen e legjislacionit shqiptar me kërkesat ndërkombëtare dhe standardet evropiane. Këto amendime, përfshinin trafikimin e personave (neni 110/a), trafikimin e grave (neni 114/b) dhe trafikimin e të miturve (neni 128/b) dhe të gjitha nenet kishin të njëjtin

¹⁹⁶ Kjo vlerë përlllogaritet mbi bazën e drogës së sekuestruar në Shqipëri dhe jashtë (për drogat që janë trafikuar nëpërmjet Shqipërisë). Marzhi i fitimit është 20% e vlerës së një kile heroine, ndërkohë që në Turqi, çmimi varion ndërmjet 8 000 - 10 000 euro/kg, në Shqipëri, çmimi për një kilogram heroine shkon nga 11 000 deri në 14 000 euro.

formulim. Në rrethana rënduese dënimet dhe gjobot do të ishin edhe më të larta. Nëse vepra penale ka shkaktuar vdekjen e viktimës, dënimi nuk mund të jetë më i ulët se 20 vjet burgim.

Grafiku 8: Rastet e Raportuara të Trafikimit të Grave dhe të Fëmijëve



Pavarësisht kësaj prapavije ligjore, që lejon për një paraqitje të diferencuar të të dhënave, dhe pavarësisht raporteve të shërbimeve inteligjente të vendeve të tjera evropiane (Lindore-Jugore), që tregojnë për përfshirje të grupeve kriminale shqiptare në trafikimin e qenieve njerëzore, shifrat e paraqitura janë të ulëta dhe statistikatat e raportuara janë të ndryshme dhe të fragmentarizuara.

- 2003: 24 grupe të dënuara, akuzuar për trafikim të paligjshëm të qenieve njerëzore dhe kontrabandë personash;
- 2004: Gjatë nëntë muajve të parë të vitit janë regjistruar 74 raste të trafikimit të grave, me 115 autorë, si dhe 9 raste të trafikimit të fëmijëve me 11 autorë;
- 2005: Trafikimi i personave (Art. 110/a) – asnjë rast;
 Trafikimi i grave dhe fëmijëve (neni 114/b dhe 128/b i Kodit Penal) “Shifrat që ne kemi për vitin 2005 dhe 2006 nuk reflektojnë situatën reale dhe tendencat në ulje të këtij fenomeni. Shumica e rasteve të regjistruara në këto vite kanë ndodhur në të shkuarën, por nuk janë raportuar menjëherë prej viktimave, për shkak të ekzistencës së një stigmatizimi të theksuar shoqëror”.
 Gjatë vitit 2005, janë identifikuar dhe janë shkatërruar 3 organizata kriminale, që janë marrë me trafikimin e grave”.
 Në vitin 2005, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka përmendur shfirën e 408 rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, me 439 autorë, ndërkohë që autoritetet policore kanë raportuar për 30 raste të trafikimit të grave, me qëllim shfrytëzimin seksual, me 49 autorë, dhe 10 raste të trafikimit të fëmijëve, me 16 autorë.

Pavarësisht shifrave të ndryshme, të cilat nuk lejojnë të bëhet një pasqyrë e vërtetë e zhvillimeve në këtë zone të krimit, dhe të jepet një përshtypje e qartë për rezultat/arritjet e Shqipërisë¹⁹⁷, përgjithësisht mund të thuhet se trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen në ulje. Koordinimi më i mirë i aktiviteteve të organeve të zbatimit të ligjit, kryesisht në një kornizë rajonale¹⁹⁸, kontrolli më efektiv i kufirit si dhe zbulimi i disa grupeve të trafikut të qenieve njerëzore, janë edhe arsye bazë për tendencën e vërejtur. Tashmë, itinerari Durrës/Vlorë në drejtim të Italisë pothuaj është mbyllur. Sidoqoftë, ekziston një trafik i paligjshëm që kryhet në mënyrë më komode dhe më pak të rrezikshme nëpërmjet pikave të kalimit të kufirit, duke përdorur dokumente të falsifikuara. Përveç kësaj

¹⁹⁷ Në vitin 2001, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, e caktoi shifrën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, që do të thotë të grave shqiptare të detyruara të prostitutojnë jashtë shtetit, tek 8 000 veta. Në C. Fijnaut and L. Paoli, Krimi I Organizuar në Evropë, 2004, faq. 549.

¹⁹⁸ Të tilla si operacionet e përbashkëta “Harem” ndërmjet zyrës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe policies Italiane, operacionet e koordinuara për ruajtjen e kufirit, të ndërmarra në kufirin e përbashkët shqiptaro-grek, në bashkëpunim të ngushtë me oficerin e ndërlidhjes së policisë greke, ose aktivitetet e përbashkëta operacionale me policinë dhe gjyqësorin francez.

është vërejtur se trafikantët janë gjithnjë e më shumë duke u zhvendosur drejt zonave të tjera të kimit, sic është për shembull trafiku i drogës.

Në kontekstin e Programit CARDS dhe me ndihmën e Zyrës së IOM-it në Tiranë, është formuluar “Strategjia Kombëtare për Migracionin”, e cila është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 760, datuar, 19.11.2004. Kjo strategji u pasua nga një “Plan Veprimi për Migracionin” i përpunuar në mënyrë të hollësishme nga një grup pune, i përbërë nga disa institucione qeveritare dhe jo-qeveritare. Plani i veprimit është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, nr. 296, datuar 06.05.2005.

Gjithsesi, situata e trafikimit të fëmijëve duhet të merret në diskutim. Fëmijët trafikohen dhe shfrytëzohen jo vetëm për qëllime të shfrytëzimit seksual. Sikurse raporton rregullisht shtypi italian dhe ai grek, dhe shumë prej studimeve rajonale të ndërmarra nga OJQ-të e provojnë, shumë prej fëmijëve shqiptarë, detyrohen të lypin rrugëve, nga grupe Romësh dhe Jevgjiish, ndërkohë që fëmijë të tjerë shiten madje nga prindërit e tyre për t’u shfrytëzuar seksualisht, ose për adoptim të paligjshëm. Shifrat zyrtare prapë përfaqësojnë vetëm një porcion/pjesë minimale të realitetit dhe këtij problemi duhet t’i vihet theksi i duhur.¹⁹⁹ Fakti që ndërmjet viktimave, viktimat rome dhe egjiptiane kanë përqindje të lartë, dëshmon për prekshmërinë e pakicave etnike dhe dikton nevojën për përpjekje që do të marrin nën mbrojtje, këtë profil të veçantë të viktimave.

Disa organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, të tilla si UNODC, IOM Tirana, “Save dhe Children” dhe të tjera kanë analizuar situatën e viktimave të trafikimit dhe dhe të mbrojtjes dhe asistencës së këtyre viktimave në vend. Shumica e kërkimeve dhe studimeve të kryera arrijnë në përfundimin se shkak i vendimtar në trafikimin e viktimave në Shqipëri, ka të bëjë me marrëdhëniet e varfra brenda familjes, dhunën dhe abuzimin brenda mureve të shtëpisë, mungesa e mundësive ekonomike, fragmentarizimi shoqëror dhe varfëria. Studimet tregojnë se shumica e viktimave shqiptare është trafikuar nga një i njohur i tyre²⁰⁰. Në rastin e trafikimit të grave, viktimat janë rekrutuar kryesisht përmes premtimeve të rreme për martesë, por që në fakt, kanë patur synim shfrytëzimin seksual, nga reklamat për punë, ndërkohë që fëmijët trafikohen kryesisht për t’u angazhuar si lypës ose shitës ambulante, si dhe për kriminalitet. Ka patur raste kur trafikantët kanë paguar rryshfete me qëllim garantimin e transportimit të viktimave nëpërmjet pikave të kalimit të kufirit. Deri më tani, modus operandi në rekrutim, transportim, transferim dhe shfrytëzim nuk ndryshon shumë nga ai i zonave të tjera të projektit dhe janë të ngjashme me përvojat e fituara në vendet e BE-së.

Në Shqipëri, struktura e grupeve kriminale, që veprojnë në trafikimin e qenieve njerëzore është e rrafshët dhe e organizuar në celula të vogla të përbëra nga 3-5 vetë. Shpesh, ata janë të lidhur me grupe të tjera, që operojnë në fushën e kontrabandës së personave, trafikut të drogës, vjedhje dhe trafikim të makinave të vjedhura, etj. Grupet e trafikimit të qenieve njerëzore bashkëpunojnë edhe me trafikantë dhe falsifikues të dokumenteve nga vendet fqinje (Mali i Zi dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”. Përdorimi i dhunës është një prej karakteristikave të këtyre grupeve.

Organet e zbatimit të ligjit, kanë raportuar për vështirësi tepër të mëdha, gjatë hetimit të këtyre aktiviteteve, për shkak të përdorimit të telefonëve celularë të paregjistruar, të bisedave të koduara telefonike, të përdorimit të identiteteve të rremë si dhe makinave të shpejta, që është vështirë të mbikqyren.

Produktet e kimit janë investuar kryesisht në ndërtimin e vilave, hoteleve, dyqaneve dhe bizneseve të tjera. Fitimet që arrin të marrë një tutor shkon nga 800 në 1800 Euro në ditë.

KONTRABANDA E PERSONAVE

Një fluks i madh refugjatësh kosovarë në Shqipëri, filloi gjatë krizës së Kosovës, së vitit 1999, që u pasua nga një migracion në shkallë të gjerë i shqiptarëve²⁰¹. Duke qenë se kontrabanduesit kanë patur gjithnjë e më shumë

¹⁹⁹ Në bazë të raportit “Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri” në vitin 2001, të shkruar nga D. RENTON për OJQ-në “shpëtoni fëmijët” (Save the Children), rreth 1000 fëmijë romë nga Shqipëria shfrytëzohen vetëm në Selanik, qytetin e dytë në Greqi.

²⁰⁰ Raporti i Dytë Vjetor mbi Viktimat e Trafikimit në Evropën Juglindore, Evropë, IOM, 2005.

²⁰¹ Gjatë dhjetë vjetëve të parë të tranzicionit, rreth 25 për qind e popullsisë ka emigruar nga Shqipëria. Në C. Fijnaut dhe L. Paoli,

efikasitet në punën e vet, Komisioni Evropian i bënte thirrje qeverisë shqiptare në Raportin e vitit 2004 për Stabilizim Asociativ, që të merrte hapa më të vendosur, nëse donte ta zgjidhte çështjen e trafikimit dhe kontrabandës së qenieve njerëzore, në mënyrën e duhur.

Në Shqipëri, kontrabanda e personave parashikohet në nenin e ndryshuar 298 të Kodit Penal, i cili parashikon dënimin me gjobë ose me burg nga një deri në katër vjet dhe në rrethana rënduese nga tre deri në dhjetë vjet dhe në rast se vepra ka shkaktuar vdekjen e palës së dëmtuar, dënohet me jo më pak se 15 vjet.

Vendet e destinacionit ishin, në radhë të parë, Greqia dhe Italia fqinje, por shqiptarët kanë kërkuar një jetë më të mirë edhe në Belgjikë, Francë, Gjermani, Suedi dhe në vende të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, ku ata kanë krijuar diaspora të mëdha. Në këtë mënyrë ata kanë ndërtuar edhe bazën, për ngritjen e degëve të mirëorganizuar të akviteteteve kriminale në fushën e migracionit të paligjshëm. Për t'i organizuar më mirë aktivitetet e veta, kontrabanduesit shqiptarë nisën mjaft herët të bashkëpunojnë, fillimisht me kontrabanduesit puliezë (nga rajoni i Pulias) nga Sacra Corona Unita - dhe më pas me zyrtarë të policisë ose përfaqësues të tjerë shtetëorë të korruptuar.

Kontrollet më të shpeshta dhe më efektive të autoriteteve të zbatimit të ligjit, në vitet e fundit kanë krijuar pengesa për kontrabanduesit. Suksese domethënëse janë arritur në mënyrë të veçantë në mbylljen e rrugëve të kontrabandimit për në Itali, duke dënuar një numër të madh kriminelësh për këtë aktivitet.

Qindra gomone dhe skafe, që mbartnin dhjetëra mijëra migrantë janë ndaluar në Itali dhe janë kthyer mbrapsht në Shqipëri. Aktivitetet e suksesshme të autoriteteve të zbatimit të ligjit kryesisht në kuadër të kontrollit më efektiv të kufijve në rajon²⁰²; kontrollet më efektive të kufijve si dhe zbulimi i disa grupeve të falsifikatorëve, e kanë futur në një krizë të vërtetë aktivitetin e paligjshëm të kontrabanduesve.

Sipas autoriteteve shqiptare, numri i personave të kontrabanduar është zvogëluar ndjeshëm, megjithatë shifrat e raportuara janë të ndryshme dhe të fragmentarizuara (2003: 85 persona, Janar - shtator 2004: 516 persona dhe 280 raste, 2005: 259 persona dhe 123 raste, nga të cilat 13 raste përfshinin grupe të krimit të organizuar).

Duke iu referuar vetëm të dhënave të policies Italiane, në periudhën ndërmjet viteve 1998 - 2005, 95,822 persona kanë emigruar në mënyrë të paligjshme në Itali (shih tabelën e mëposhtme), dhe secili prej tyre ka paguar nga 500 deri në 1000 Euro, që i korrespondon një fitimi mesatar të paligjshëm (kriminal) prej afro 80 miliardë Eurosh. (per të gjithë periudhën). Shqipëria ka raportuar se pagesat që personat e kontrabanduar, u detyrohen kontrabandistëve shkojnë nga 300 deri në 3 000 Euro, në varësi të vendit të destinacionit. Sipas të dhënave të raportuara, produktet nga këto krime, janë investuar në ngritjen e agjencive të udhëtimit, kompani ndërtimi dhe lojëra fati, ose për blerjen e pronave të patundshme.

Autorët që merren me këtë lloj krimi janë kryesisht grupe të vogla të krimit të organizuar, që kanë përgjithësisht role dhe përgjegjësi të qarta në organizatë (falsifikatorët e dokumenteve personale, "shërbime sekserësh" duke rekrutuar emigrantët, udhërrëfyesit, ndihmës financiarë, etj). Dhuna dhe frikësimi nuk përdoren shpesh, por përdorimi i influences, me anë të korrupsionit dhe rryshfetit është kyç për këtë lloj biznesi kriminal. Shume prej grupeve kanë operuar si "agjenci turistike" apo organizatorë të "udhëtimeve turistike". Disa nga praktikatat e tjera maskuese, si p.sh. survejimi i meknizmave dhe i patrullimeve (turneve) të kontrollit të kufijve, ndryshimi i shpeshtë i celularëve, përdorimi i celularëve të paregjistruar, mjete të koduara të komunikimit, etj përdoren gjithashtu gjerësisht.

KRIMI EKONOMIK DHE KRIMI KIBERNETIK

Megjithëse Kodi Penal i Shqipërisë është në një linjë me Rekomandimin e Këshillit të Evropës No R (81) 12 mbi krimin ekonomik dhe i ka parashikuar shumë prej aktiviteteteve kriminale përsa i takon llojeve të ndryshme të mashtrimeve, (duke përfshirë patjetër një dispozitë të veçantë mbi skemat financiare piramidale), falsifikimit dhe kontrabandës, evazionit fiskal, rregulloret mbi valutat, falimentin, shpërdorimin e postit dhe të kompetencave

²⁰² Siç janë nismat e ndërmarra nga SECI "Mirage 1-3" dhe "Puna", të realizuara në bashkëpunim me Guardia di Finanza, si dhe policinë maqedone dhe greke.

zyrtare, dhe të tjera, ai përsëri nuk operon me një koncept të qartë për krimin ekonomik, që ka lidhje me krimin e organizuar. Përvec kësaj, janë përdorur përkufizime të ndryshme dhe lloje të ndryshme krimi janë numëruar si “krim ekonomik”.

Kapacitetet financiare dhe të tjera, që krimi i organizuar ka fituar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, aktualisht shërbejnë për të konsoliduar dhe zgjeruar operacionet në sektorin ligjor, qoftë nëpërmjet depërtimit të strukturave shtetërore qoftë me anë të diversifikimit të aktiviteteve në sektorin tregtar. Krimi ekonomik, si p.sh. mashtrimi me TVSH-në, forma të tjera të evazionit fiskal dhe të detyrimeve tatimore si dhe falsifikimi i produkteve të ligjshme (pirateria) stimulohen nga dobësia e institucioneve tatimore dhe doganore shqiptare që veprojnë në fushën e kontrollit dhe mbledhjes së të dhënave publike. Pavarësisht faktit se krimi ekonomik është perceptuar si një prej kërcënimeve më madhore për shoqërinë shqiptare, nuk ka asnjë përllogaritje (vlerësim) të demit të shkaktuar nga ky krim për buxhetin e shtetit. Përgjigja që i është dhënë pyetësorit të vitit 2006, është si më poshtë vijon:

“Krimi ekonomik, ashtu si dhe çdo lloj tjetër krimi lulëzon kur gjen një situatë të përshtatshme, që nënkupton kryesisht një kuadër ligjor të paplotë dhe jo të përshatshëm dhe mosfunksionimin e institucioneve shtetërore, dhe sidomos të atyre që kanë për detyrë të luftojnë korrupsionin dhe evazionin fiskal. Edhe pse krimi ekonomik paraqet një kërcënim serioz për shoqërinë demokratike në përgjithësi, deri më tani, nuk është bërë asnjë vlerësim i demit, që ky lloj krimi i shkaktonte buxhetit të shtetit shqiptar”.

Sikurse është theksuar edhe më parë, një prej pengesave kryesore për një kërkim të mirëfilltë mbi krimin ekonomik, është edhe mungesa e të dhënave, ose natyra e ndryshme e të dhënave. Të dhënat statistikore të paraqitura janë të varfra dhe të fragmentarizuara. Në vitin 2003, janë hetuar 91 raste të mashtrimeve në fushën e doganave dhe janë dënua 98 autorë, ndërkohë që në vitin 2004, këto shifra janë rritur në 163 raste me 224 kriminelë të përfshirë. Përvec kësaj, 66 vepra penale me 71 kriminelë janë regjistruar në fushën e taksave, dhe 852 vepra penale me 929 autorë në fushën e gjerë të falsifikimeve (duke përfshirë edhe mallrat pirate).

Për vitin 2005, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë raportuar 22 për qind më pak raste, se sa në vitin 2004. Në total, gjatë vitit 2005 janë hetuar dhe është përcjellë raporti tek Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme për 1,030 raste, me 1236 autorë. Tabela e mëposhtme paraqet në formë të përmbledhur disa prej veprave penale²⁰³ që janë paraqitur nga Ministria e Brendshme dhe nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme në fushën e krimit ekonomik. Të dhënat e paraqitura nga të dyja këto institucione, janë dukshëm të papërputhshme:

Table 6: Veprat penale të raportuara në fushën e krimit ekonomik

Veprat penale në fushën e	Falsifikimi I dokumenteve	Doganat	Mashtrimi	Ligjet tatimore	Totali
MoI	718	120	90	33	1 030
GPO	1 632	359	218	228	9 678

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme & Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

Megjithëse mund të merret e mirëqenë se shifrat e paraqitura nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme janë më të plota dhe më të besueshme, duhet marrë parasysh se statistikave të paraqitura për vitin 2005, përmbajnë informacione për personat kundër të cilëve procedimi penal ka nisur në vitin 2005 si dhe për ata, kundër të cilëve, procedimi ka filluar në vitin 2004. Është e vështirë të shpjegohen ose të interpretohen shifra kaq të ndryshme. Prandaj, Shqipëria duhet të kërkojë sa më shpejt që të jetë e mundur, të përmirësojë strukturat, metodat dhe mekanizmat për harmonizimin e statistikave kriminale kombëtare.

Sikundër është raportuar, autorët e krimit ekonomik të cilët janë kryesisht meshkujt shqiptare, janë të arsimuar, dhe kanë një të kaluar profesionale si menaxherë firmash. Ata ruajnë lidhje të ngushta me elementë të tjerë kriminalë, të shteteve dhe kombësive të ndryshme. Ata blejnë ose marrin me anë të mashtrimit aktivitete të ndryshme ligjore si dhe rekrutojnë dhe punësojnë persona me formim ekonomik ose juridik që shërbejnë për të

²⁰³ Vepra penale të tilla si (i) vënia në punë në mënyrë të paligjshme e lojërave të fatit, (ii) veprat penale kundër Shtetit dhe Gjyqësorit, (iii) falsifikimi I kartmonedhave dhe bonove të thesarit, (iv) korrupsioni dhe (v) vjedhja e pasurisë raportohen në këtë kategori, si nga Ministria e Brendshme ashtu edhe nga Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme.

ruajtur fasadën e biznesit. Për arritjen e qëllimeve të tyre, ata nuk hezitojnë të përdorin dhunën ose frikësimin e konkurrentëve, duke organizuar ndonjëherë edhe vrasjen e tyre. Në shumë raste, këto grupe sigurojnë dhe rekrutimin dhe bashkëpunimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, apo të administrates shtetërore.

Nuk është paraqitur asnjë informacion lidhur me produktet e këtyre veprave kriminale, por është theksuar se të ardhurat e përfituara në mënyrë të paligjshme janë investuar në biznese ndërtimi, në lojëra fati, etj.

Në dallim nga Pyetësori i vitit 2004/2005²⁰⁴, në pyetësorin e vitit 2006, nuk ishte raportuar se sa prej rasteve të raportuara në vitin 2005, si krim ekonomik, ka qenë me të vërtetë krim i organizuar i mirëfilltë. Parandalimi efektiv dhe hetimi i krimit ekonomik pengohet nga kuadri institucional i fragmentarizuar i administrates tatimore dhe i organeve të tjera të zbatimit të ligjit, me zyra të shpërndara në qytete dhe rajone të ndryshme që mbeten të shkëputura nga njëra-tjetra dhe pa mjetet e nevojshme. Kjo e cënon zhvillimin e politikave, përmirësimin e hetimeve, e ndërlikon shkëmbimin e informacionit, si dhe i bën rezultatet e analizave të diskutueshme. Së fundi, kjo nuk lejon që të kihet një pasqyrë e qartë e të gjithë krimit ekonomik si dhe vështirëson evidentimin e p.sh. boshllëqeve në legjislacion, nevojave për trajnim dhe sektorëve ku organet e zbatimit të ligjit, duhet të intensifikojnë aktivitetet e tyre.

Asnjë informacion nuk është paraqitur në lidhje me *krimin kibernetik*.

PASTRIMI I PARAVE

Përveç mashtrimit dhe operacioneve të falsifikimit, grupet kriminale shqiptare, në mënyrë rutinore i investojnë paratë që rezultojnë nga tregtitë dhe aktivitetet e paligjshme, jo vetëm në vendin e tyre, por edhe jashtë (përkatësisht nga diasporat e tyre). Në raport me xhiron e pastrimit të parave, janë përmendur disa studime të kryera nga organizata ndërkombëtare, të cilat tregojnë se rreth 50 për qind e GDP së vendeve të Evropës Juglindore, pastrohet. Si rrjedhojë, cënohet në mënyrë serioze integriteti dhe stabiliteti i institucioneve financiare dhe të kredive si dhe besimi tek sistemi financiar në tërësi, sikurse dhe themelet e shtetit të së drejtës. Ndër veprat penale që gjenerojnë më shumë të ardhura kriminale, renditen trafiku i drogës, trafiku i qenieve njerëzore, prostitucioni, kontrabanda, evazioni fiskal dhe aktivitetet korruptive.

Deri në fund të viteve 90, pastrimi i parave është dënuar vetëm në mënyrë sporadike nga prokurorët shqiptarë. Në vitin 2003, janë raportuar vetëm 2 vepra të tilla penale, ndërsa në vitin 2004, për shkak të një koordinimi më të mirë të Agjencisë së sapokrijuar për Bashkërendimin e Luftës kundër Pastrimit të Parave (që është edhe njësisia e inteligjencës financiare shqiptare – FIU shqiptar) janë raportuar 6 raste të pastrimit të parave, por është theksuar në të njëjtën kohë se vetëm 1 rast duket se ka lidhje me krimin e organizuar, që ka përfshirë 2 persona (që do të thotë se as në këtë rast nuk janë përmbushur kriteret e krimit të organizuar, që kërkon të paktën 3 veta), në vitin 2005, janë raportuar vetëm 4 raste të pastrimit të parave, nga të cilat tre raste kanë qenë “pastrim i parave vetjake” dhe vetëm 1 rast “pastrim në favor të palëve të treta”

Ndërmjet veprave penale që gjenerojnë më shumë produkte kriminale, Shqipëria përmend trafikun e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore, prostitucionin, kontrabandën, evazionin fiskal dhe aktivitetet korruptive.

Pavarësisht shfirave të pakta, është shpjeguar gjithashtu se në praktikë pastrimi i parave lidhet pazgjidhshmërisht me aktivitetet kriminale. Karakteristikat kryesore të pastrimit të parave përfshijnë, përdorimin e boshllëqeve ligjore, ende ekzistuese, shkallën e lartë të informalitetit të ekonomisë shqiptare, sofistifikimin e transaksioneve ²⁰⁵financiare, dhe maskimi i aktiviteteve të tilla nën emra kompanish, ose biznesesh fiktive. Pastrimi i parave përfshin investimet në prona të paluajtshme, në tokë, turizëm, etj. Shumë ndërtesa janë ndërtuar me para të

²⁰⁴ Tabela 2004: krimi Ekonomik: 17 raste të lidhura me krimin e organizuar dhe 17 grupe të krimit organizuar, me 52 autorë, të përfshirë: për Trafikun e Drogës, janë evidentuar 40 raste të krimit të organizuar 14 grupe kriminale me 142 kriminelë; për Trafikun e Qenieve Njerëzore janë raportuar 17 raste të krimit të organizuar, 17 grupe kriminale, me 61 kriminelë. Kontrabanda e personave: 16 raste të krimit të organizuar, 16 grupe kriminale dhe 58 autorë; Kontrabanda: 14 raste të krimit të organizuar, 14 grupe kriminale dhe 62 autorë; Korrupsioni: 1 rast i krimit të organizuar, 1 grup kriminal dhe 4 autorë.

²⁰⁵ Depozitimi i sasive të të hollave për periudha të shkurtra kohe pa e tejkalluar shumën që detyron zbulimin e burimit të të ardhurave.

paligjshme, disa prej tyre janë shkatërruar. Por, është gjithsesi e vështirë të bëhet një ndarje, se sa prej këtyre ndërtimeve të paligjshme i dedikohen pastrimit të parave (të drogës, evazionit fiskal, apo nga paratë e derdhura nga emigrantët shqiptarë që punojnë me sezone jashtë vendit), dhe sa prej tyre janë rrjedhojë e ligjeve të keq-formuluara të sektorit të ndërtimit.

KORRUPSIONI

Mendohet se korrupsioni nuk kryhet nga grupet e krimit të organizuar²⁰⁶, por ai mund të kryhet nëpërmjet ndërmjetësve, që zakonisht veprojnë në emër të personave, të veshur me pushtet. Pavarësisht disa përpjekjeve të bëra, korrupsioni duket se vazhdon të veprojë në administratën shtetërore, tek pushteti gjyqësor dhe në sektorin privat.²⁰⁷ Në vitin 2004, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka raportuar 443 të dyshuar dhe procedura për korrupsion. Në vitin 2005, janë regjistruar 442 raste, me 237 autorë të përfshirë. Deri më tani, shumica e këtyre procedimeve (377) kanë patur lidhje me abuzimin me postin dhe marrjen e vendimeve arbitrare. Vetëm 6 procedime janë ndërmarrë për veprën penale të korrupsionit aktiv, dhe 24 për korrupsion pasiv. 159 të pandehur kanë qenë nëpunës civilë të administratës publike qendrore dhe vendore. Në raportin e vet, paraqitur para Kuvendit të Shqipërisë, në prill të vitit 2006²⁰⁸ evidentonte një numër shqetësimesh:

- Niveli i lartë i perceptimit të korrupsionit lidhet kryesisht me vendim-marrjen politike në raport me menaxhimin e fondeve publike, në veçanti procedurat e prokurimit të drejtpërdrejtë, me argumentin e urgjencës së tij;
- Rregullat për menaxhimin dhe administrimin e kompanive tregtare me kapital shtetëror lënë shumë vend për interpretim, që do të thotë i lënë vendin korrupsionit;
- Në lidhje me tenderat publikë, megjithëse është ndërmarrë një proces për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, shumë vetë e gjykojnë si të pranueshëm faktin se marrëveshjet përfundohen, si rezultat i dhënies së rryshfeteve (tangenti) para se të kryhen procedurat e tenderit.

²⁰⁶ Në vitin 2005, autorët e hetuar për korrupsion nuk kanë qenë të organizuar në ndonjë grup, ose organizatë kriminale.

²⁰⁷ Qendra Shqiptare për Kërkim Ekonomik, ka theksuar në Raportin Empirik Shqiptar të vitit 2000, se korrupsioni perceptohet se është problemi kryesor në vend, së bashku me krimin, dhe që fillon me pagimin e rryshfeteve tek zyrtarët shtetërorë për të p.sh. shmangur pagimin e taksave, shitjen e gjyqtarëve dhe dhënien e vendimeve arbitrare, kontributet tek partitë politike, nisur nga interesa vetjakë, shitja e votave në parlament, sikurse dhe e dekreteve presidenciale, emërimi i miqve dhe të afërmeve për poste zyrtare. (<http://www1.oecd.org/daf/SPAIcom/pdf/AlbEmp.pdf>)

²⁰⁸ Burimi: Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm, paraqitur para Kuvendit të Shqipërisë (më 27 prill 2006) mbi Gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri, në vitin 2005.

4.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Situata e pas luftës në Bosnje dhe Hercegovinë u karakterizua nga një shpërngulje qytetarësh që kapi shifrën e një milion njerëzve, nga prona të shkatërruara, dhe nga një shtet i copëtuar me autoritete dhe pushtete të dobëta. Boshllëku politik dhe ligjor i shkaktuar nga lufta është mbushur në mënyrë të kujdesshme që nga viti 1996 nëpërmjet përpjekjeve të komunitetit vendas dhe ndërkombëtar. Në fund të viteve '90, mungesa e institucioneve, si ai i shërbimit kufitar, hapësira e copëzuar gjyqësore, ligjore dhe ekonomike, si dhe lidhjet rajonale të ndërtuara gjatë ekonomisë së luftës siguruan një kuadër të veçantë mundësish për krimin e organizuar. Situata e mbas luftës dhe faktorë të tjerë të shkaktuar nga tranzicioni, si për shembull ndryshimet mbi të drejtën e pronës, rënia ekonomike, dhe mbështetja në tregti ofruan një sërë mundësish të tjera. UNDP²⁰⁹ e ri-klasifikoi Bosnje Hercegovinën në vitin 2004 si një vend në tranzicion. Sidoqoftë, prapë ekziston një sektor i dobët privat dhe shpenzimet e qeverisë përbëjnë rreth 50 përqind të GDP. 20 përqind e popullsisë është e papunë dhe 30 përqind shumë e ndjeshme ndaj krizave financiare, gjë që mund të shtyjë drejt varfërisë. Në këto kushte, krimet e rënda arritën një avantazh, të cilin autoritetet e Bosnje Hercegovinës po mundohen ta arrijnë nëpërmjet reformave të shumta institucionale dhe ligjore, ku disa kanë përfunduar në vitet e fundit dhe shumë prej tyre ndodhen tashmë në proces, ashtu dhe siç vihet re në Raportin e Përputhshmërisë së GRECO-s²¹⁰, Situatën e Sigurisë 2005, kapitulli "Masat dhe Aktivitetet e Propozuara," dokumentet e MSA-së dhe raporte të tjera të fundit.

Një karakteristikë e Bosnje dhe Hercegovinës është lidhja midis krimit të organizuar dhe të akuzuarve për krime lufte, gjë që shkakton një shqetësim të madh për disa autoritete të Bosnje dhe Hercegovinës. Financimi i të akuzuarve për krime lufte në arrati, në veçanti i Ratko Mladic dhe Radovan Karadzic, duket të jetë i mirë organizuar dhe i lidhur me një numër institucioneve të tilla si banka, institucione publike dhe qeverisëse, si dhe parti politike në Republikën Srpska (RS). Në vitin 2004, llogaritë bankare të atyre që dyshoheshin për mbështetje të të akuzuarve për krime lufte, u bllokuan dhe shumë persona u shkarkuan nga postet publike nga Përfaqësuesi i Lartë në Bosnje dhe Hercegovinë, Lordi Ashdown²¹¹.

Janë bërë disa përpjekje për të konsoliduar dhe harmonizuar sistemin e pavoritshëm të të drejtës penale të Bosnje dhe Hercegovinës²¹² (përkatësisht shërbimet e prokurorisë dhe të gjyqësorit) të cilat tashmë mund të kenë prodhuar rezultate pozitive. Gjithsesi, agjencitë e zbatimit të ligjit janë akoma të copëzuara, të shkëputura dhe të tej shpërndara. Gjithashtu shkëmbimi i informacionit brenda vendit është jo efektiv.

Rrymat aktuale të krimit të organizuar, sidoqoftë, kërkojnë një shërbim informativ të mirë policor dhe një shkëmbim efektiv informacioni si brenda vendit ashtu dhe në planin ndërkombëtar²¹³. Në rastin e Bosnje dhe Hercegovinës reforma në sistemin e policisë- një strukturë e unifikuar policie e cila mund të ndihmojë në eliminimin e shumë problemeve të përmendura këtu - vazhdon të qëndrojë në krye të axhendës dhe është parashikuar të përfundojë në fund të vitit 2006, si afati më i largët. Sidoqoftë, siç është konfirmuar dhe në raundin

²⁰⁹ Raporti i UNDP, 10 Korrik 2005.

²¹⁰ Raporti i Përputhshmërisë së GRECO-s mbi Bosnje dhe Hercegovinën, GRECO RC-I (2005) 1E.

²¹¹ Në vitin 2004, Lordi Ashdown nxori 82 vendime që lidheshin me shkarkimin nga postet publike i atyre që dyshoheshin për mbështetje, financiare ose në rrugë të tjera, të të akuzuarve për krime lufte, si dhe për mbylljen e llogarive bankare që dyshoheshin të përdosheshin për të njëjtat arsye. Vendimet mund të gjenden në: <http://ëëë.ohr.int/decisions/ëar-crimes-decs/archive.asp?m=&yr=2004>. Rezultatet përfundimtare të këtyre hetimeve mbeten akoma për tu bërë të ditura.

²¹² Bosnja dhe Hercegovina (BH) ka katër juridiksione në sistemin e të drejtës penale: nivelin shtetëror, dy nivelet e kantoneve (Republika Srpska dhe Federata e BH) dhe Distrikti i Brcko-s.

²¹³ Kjo është gjithashtu e dukshme në kontributet e dhëna në pyetësorin e 2006- s, i cili së pari u dërgua disa javë mbas afatit përfundimtar (më konkretisht: disa ditë para datës së planifikuar për përfundimin e draft raportit) dhe së dyti Situata e Sigurisë të vitit 2005, e cila ishte pa dyshim e plotë dhe e detajuar, si për sa i përket përmbajtjes (çështjeve të migracionit, krimeve të të gjitha llojeve, trafikeve, bashkëpunimit me ICTY si dhe Zbatimit të Kthimit dhe Ri-zotërimit të Pronave), ashtu dhe administrimit geografik (të katërt juridiksionet dhe nivelet e kantoneve), por nga ana tjetër nuk përputhte të dhënat e ndryshme mbi nivelin shtetëror, nuk i përgjigjej pyetësorit dhe nuk fokusohet fare mbi krimin e organizuar.

e dytë zyrtar të negociatave për MSA-në, ka një progres të kufizuar në shumicën e zonave të Partneritetit Evropian, ku reforma në polici përben pengesën kryesore²¹⁴.

Kërcënimet kryesore të Bosnje dhe Hercegovinës janë droga, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi ekonomik.

TRAFIKIMI I DROGËS

Siç u raportua në raportin e situatës së vitit 2005, grupet e trafikimit të drogës nuk kanë ndonjë mbizotërim të veçantë etnike, por kanë lidhje të forta rajonale në vendet fqinje, në të cilat besnikëria bazohet në prejardhje dhe vendndodhje gjeografike të përbashkët. Faktorë të tillë si kufij relativisht të depërtueshëm, një kuadër ligjor dhe institucional në zhvillim, mungesa e pajisjeve teknike dhe copëzimi i brendshëm i sistemit të së drejtës penale, ndikojnë së bashku në favor të kriminelëve dhe e bëjnë Bosnje dhe Hercegovinën një vend transit tërheqës, të përshtatshëm për ripaketimin dhe rishpërndarjen e drogës.

Megjithëse të dhënat e siguruar ishin të copëzuara dhe jo të plota, BH mund të vihet re dukshëm si një 'qendër rishpërndarjeje', një vend transit për drogën. Përveç trafikimit të drogës, duket sikur kemi të bëjmë me një treg të brendshëm përdoruesish në rritje, i cili konsumon kryesisht droga sintetike të tilla si "ekstazi" dhe amfetaminë, si dhe kanabis, gjë që vërtetohet nga rritja e transportit të kanabisit nga Shqipëria nëpërmjet Mali të Zi për në BH.

Konfiskimi i 34 tonëve acetiku anhidrit (një lëndë e nevojshme për prodhimin e heroinës), i raportuar në vitin 2005 dhe në atë periudhë i kohëve të fundit, tregon për ekzistencën tregtisë së lëndëve të nevojshme për prodhimin e drogës. Kjo duhet parë në një linjë me zbulimet e fundit të raportuara në vitin 2006 nga Ministria e Brendshme e Republikës Srpska që tregojnë "se sasi të importuara për prodhim industrial i tejkalojnë nevojat industriale dhe në raste jo të rralla trafikimi i tyre është i jashtëligjshëm"²¹⁵. BH raportoi në vitin 2005 një total prej 1595 aktesh kriminale të lidhura me prodhimin e jashtëligjshëm, trafikimin dhe zotërimin e drogave narkotike, gjë që përbën një rritje prej më shumë se 13.5 përqind në krahasim me vitin 2004. Nuk u raportua se sa çështje ishin të lidhura me krimin e organizuar.

Megjithëse u raportuan shumë të dhëna statistikore, për shkak të mungesës së një analize të centralizuar dhe deklaratave e strukturave raportuese të ndryshme, ecuria e prodhimit të jashtëligjshëm dhe trafikimi mbeten të paqartë:

- Federata e BH: 363 çështje (+29.6 përqind), të kryera nga 377 autorë, me 12 raste vdekjeje të evidentuara;
- Republika Srpska: 199 çështje; një rritje (55 përqind) dhe numri i autorëve përfshin dhe zotërimin dhe përdorimin e drogave narkotike, kështu që nuk mund të bëhet një krahasim;
- Distrikti Brcko: 9 çështje; një rënie (44 përqind) dhe numri i autorëve përfshin gjithashtu zotërimin dhe përdorimin e drogave narkotike, si dhe një rast vdekjeje;
- Shërbimi Shtetëror i Kufijve: 38 çështje (-2.5 përqind), të kryera nga 49 autorë.

Përveç statistikave të siguruar, të cilat në secilin prej gjyqësorëve raportojnë në mënyrë të saktë por të ndryshme nga njëri tjetri numrin e çështjeve, autorëve, minoreneve dhe përsëritësve të veprave kriminale, nuk ka studime ose anketa për të gjithë vendin për sa i përket përmasave që mund të ketë ky treg, kush janë përdoruesit dhe trafikantët e drogës, sa grupe të krimit të organizuar janë zbuluar, nëse ka laboratorë të jashtëligjshëm dhe informacione të tjera të rëndësishme në fushën e krimit të organizuar. Për shqyrtimin e duhur të këtij problemi, Bosnje dhe Hercegovina duhet të ndërmarrë studime të tilla dhe të ndërtojë një sistem shërbimi informativ në mënyrë që të analizojë siç duhet format dhe strukturat e krimit të organizuar.

²¹⁴ Raport mbi mbledhjet e RPM dhe raundit të dytë zyrtar të negociatave për MSA-në, Sarajevë, 22 Qershor 2006, ku përmendet në veçanti refuzimi i projekt ligjit mbi luftën kundër krimit të organizuar, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurorisë, për shkak të shkeljeve të pretenduara në kërkesat për emërime të kryera nga një trup i pavarur, gjë që çoi në dorëheqjen e Kryeprokurorit të RS, Prokurorit të Posaçëm dhe prokurorëve të tjerë në Maj 2006.

²¹⁵ BH "Informacion mbi Situaten e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë në viti 2005."

Tabela 7: Përmbledhje tabelore e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (BH)*

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Heroin (kg)					68.53	
Hashash (kg)					11.86	
Marijuana (kg)					318.51	
Kokainë (kg)					30.86	
Amfetaminë (kg)					4.71	
Ekstazi (copë)					3,387	
LSD (doza)						
Kanabis (bimë)					1,956	
Popy (bimë)						

*Të dhënat, siç u siguruan nga Federata e BH, Republika Srpska, Distrikti i Brcko-s dhe Shërbimi Shtetëror i Kufijve, janë bashkuar, sidoqoftë, materiali i të dhënave ishte shumë i dobët/i ndryshëm për të bërë një krahasim me vitin 2004 apo dhe me të tërë periudhën kohore.

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Për sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore, situata ndryshoi si rrjedhojë e përpjekjeve nga ana e organeve të zbatimit të ligjit dhe e mbylljes në vend të shtëpive dhe klubeve të shumta publike. Si rrjedhojë shfrytëzimi seksual është bërë me klandestin dhe më i sofistikuar, duke u ushtruar më shumë në apartamente private, nëpërmjet shërbimeve eskorte dhe duke u zgjeruar në Internet. Gjithashtu, viktimat duket sikur trajtohen në mënyrë më pak të dhunshme dhe kane kushte jetese më të mira. Këto viktimat kryesisht janë në shërbim të tregut të brendshëm. Një zhvendosje e tillë e tregut tregon një përmirësim të menaxhimit nga ana e kriminelëve të përfshirë në biznesin e trafikimit të qenieve njerëzore. E gjithë kjo ngre një sfidë të re për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.

Personat e përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore janë kryesisht qytetarë të Bosnje Hercegovinës, zakonisht pronarë klubesh nate ose persona që kanë lidhje me pronarë baresh. Grupet e përfshira në këtë biznes kapërcejnë me lehtësi çdo kufi etnik, kombëtar, apo kantonesh dhe kryesisht bashkëpunojnë me trafikantë nga Serbia, vend që ndodhet në rrugën kryesore të trafikimit të qenieve njerëzore nga Romania, Moldova dhe Ukraina. Rastet e regjistruara tregojnë se kriminelë të Bosnje Hercegovinës kanë pasur bastionet e veta kriminale në Rumani dhe në Moldavi²¹⁶. Rekrutimi vendas, trafikimi i brendshëm dhe klientela që dominon në vend kërkon një politikë që ka nevojë jo vetëm për masa shtypëse por gjithashtu dhe për masa më të mira parandaluese. Gjithashtu është e nevojshme dhe një politikë më e mire për shëndetin publik në mënyrë që të përballen problemet shëndetësore që prodhon tregu i brendshëm i seksit.

Në vitin 2004, organizate e IOM-it në BH raportoi rryma disi në ndryshim të trafikimit, të tilla si zhvendosja nga klubet e natës në shtëpi dhe apartamente private, transportim me taksitë të klientët, martesat të detyruara dhe aplikime për azil për të garantuar qëndrim më të gjatë dhe status të ligjshëm në BH, si dhe presione psikologjike që zëvendësonin keqtrajtimet dhe dëmet fizike, në veçanti kërcënime për jetën e familjeve të viktimave në vendet e tyre të origjinës.

Megjithëse, një "Koordinator Shtetëror i BH për Anti-Trafikun dhe Imigracionin e Jashtëligjshëm" u krijua në vitin 2003, "Plani i dytë Kombëtar për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005 - 2007 (NAP)" u zhvillua së bashku me IOM dhe organizata të tjera ndërkombëtare në vitin 2004, "Protokolli mbi Menaxhimin e Qendrave pritëse për Viktimat e Huaja të Trafikimit në BH" u nënshkrua midis Ministrisë së Sigurisë dhe pesë OJQ-ve lokale në fillim të vitit 2005, u arrit firmosja e "Sistemit të Referimit (Procedurave) për Trajtimin e Viktimave të Trafikut Njerëzor" në Korrik të vitit 2005, si dhe u arrit progres i përgjithshëm drejt një kuadri të plotë legjislativ, Bosnje dhe Hercegovinës vazhdon ti mungojë një rrjet operativ i qëndrueshëm. Kjo gjë vihet re dhe në raportin "Informacion mbi Situatën e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2005", në të cilin trafikimi i qenieve njerëzore përmendet në një numër shumë të diskutueshëm çështjesh: në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës 2 çështje dhe 2 autorë, ndërsa në Republikën Srpska 12 çështje dhe 18 autorë. Në të nuk sigurohej asnjë informacion tjetër.

²¹⁶ Përgjigja e BH ndaj pyetësorit të vitit 2005.

TRANSPORTI KLANDESTIN I PERSONAVE

BH konsiderohet një vend transit nga ku qytetarët e Shqipërisë, Kinës, Turqisë, Indisë dhe Pakistanit transportohen në mënyrë të jashtëligjshme për në vendet e Evropës Perëndimore. Ata hyjnë në territorin e Bosnje Hercegovinës nëpërmjet Serbisë dhe Malit të Zi përmes kalimit të ligjshëm, ose jo, të kufirit në pjesën lindore të Bosnje Hercegovinës dhe pasi arrijnë në Sarajevë vazhdojnë për në pjesën perëndimore të vendit, zakonisht duke përdorur taksì. Që andej, grupe kriminale vendase i shoqërojnë përmes lumenjve apo kufijve të tjerë për në Kroaci. Në të shkuarën, ka pasur raste të futjes së grupeve të mëdha të emigrantëve të jashtëligjshëm në territorin e Bosnje Hercegovinës si turistë apo si anëtarë të shoqatave kulturore. Kohët e fundit, komuniteti i krijuar kinez duket të ketë krijuar lidhjet e veta që çojnë në lehtësimin e migrimit nga Kina për në Evropën Perëndimore. Tregu për transportimin klandestin të njerëzve është relativisht i fshehtë dhe duket të jetë i mbështetur në bashkëpunimin e ngushtë midis grupeve të krimit të organizuar të vendeve të ndryshme të rajonit²¹⁷.

“Informacioni mbi Situatën e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2005”, raporton gjerësisht mbi çështje të migracionit, të tilla si transportimi i personave, refuzimet e hyrjes (kryesisht për mungesë të dokumenteve të udhëtimit dhe vizave), hyrjet e personave me rrezik të lartë migrimi (kryesisht nga Turqia, Libani, Kina dhe në rritje nga Irani, India dhe Siria), pranimin e qytetarëve të vendeve të treta sipas marrëveshjes me Kroacinë, dëbimin e personave dhe përpjekjet për kalim të paligjshëm të kufirit (655 persona, kryesisht nga Shqipëria, BH, Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia). Sidoqoftë, raporti siguron vetëm një të dhënë të plotë për transportin klandestin të personave: dy çështje në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës. Nuk sigurohet ndonjë informacion tjetër i lidhur me këtë çështje ose mbi strukturat e organizuara.

KRIMI EKONOMIK

Krimi ekonomik po lulëzon për shkak të hapësirës së copëzuar ekonomike, ndarjes juridikionale midis organeve të zbatimit të ligjit në Bosnjë Hercegovinë, përhapjes së gjerë të falsifikimit të identitetit, gjë që mundësohet nga numri i madh i personave të shpërngulur dhe të vlarë gjatë luftës, si dhe ndarjes së brendshme të vendit. Mekanizmi kryesor për përhapjen e evazionit në të ardhurat publike ka qenë regjistrimi relativisht i lehtë i kompanive të rreme. Sipas autoriteteve tatimore të Federatës së Bosnje Hercegovinës, në vitin 2004 ka pasur rreth 1187 ente ligjore të regjistruara, por që kualifikoheshin si të padisponueshme, të rreme apo paralele. Gjithashtu që nga viti 2002 janë regjistruar 835 raste të evazionit fiskal të cilat kanë shkaktuar një humbje në të ardhura prej rreth 160 milion Euro. Autoritet tatimore të Republikës Srpska në të njëjtën kohë kanë regjistruar 464 kompani të padisponueshme, 73 kompani të rreme dhe 21 kompani “paralele”²¹⁸.

Duke ofruar mundësi të tilla të veçanta, Bosnje Hercegovina është kthyer në një zonë joshëse nëpërmjet së cilës kryhet tregtia e jashtëligjshme në rajon. Përpjekjet e fundit të autoriteteve të Bosnje Hercegovinës në fushën e tatimeve dhe regjistrimit të biznesit me qëllim forcimin e ndërlydhjeve të brendshme dhe unifikimin e sistemit të taksave dhe regjistrimit të biznesit, kanë filluar që të sjellin disa rezultate pozitive.

Raporti “Informacion mbi Situatën e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2005”, shërben pjesërisht me informacion më të detajuar. Në vitin 2005, u regjistrua një total prej 1324 çështjesh në nivel shtetëror, si dhe u shënua një rënie prej afro 6 përqind, e cila duket të jetë shkaktuar nga rënia e madhe dhe e diskutueshme në Federatën e BH (-62.4 përqind), ndërkohë që u shënuan rritje në Republikën Srpska (+16 përqind) dhe në Distriktin e Brcko-s (+28.9 përqind).

Shumica e çështjeve lidhen me abuzime në detyrë dhe në kompetenca, falsifikim parash, veprimtari të paqëndrueshme biznesi dhe mashtrime për marrje kredish dhe privilegjesh të tjera. Për aq sa u kërkuar, u siguruan të dhëna të cilat rezultonin se për vitin 2005 kishte 54 çështje evazionit fiskal, dhe “në fushën e doganave”, të paktën 580 çështje. Një krahasim i saktë me vitet e kaluara nuk është i mundur për shkak të këndvështrimeve dhe

²¹⁷ Ibid.

²¹⁸ Përgjigja e BH ndaj pyetësorit të vitit 2005. Kompani “te padisponueshme” janë ato të cilat regjistrohen në adresa që nuk ekzistojnë ose që kanë përdorur dokumente të falsifikuara regjistrimi; kompani “te rreme” janë ato të cilat përdorin dokumente të falsifikuara identifikimi; ndërkohë që kompani “paralele” janë ato që përdorin kopje të dokumenteve të regjistrimit me emra të ndryshuar pronarësh. Kopje të tilla me pas përdoren për të hapur llogari bankare të reja dhe të pagjurmueshme.

skemave raportuese të ndryshme (2002-2004: 835 çështje, duke shkaktuar një humbje në të ardhura prej rreth 160 milion Euro). Sidoqoftë, të dhënat duket se janë në ulje.

Raporti renditi si aktet më të rëndësishme kriminale të krimit ekonomik 256 çështje të falsifikimit të parave, të cilat u kryen në Federatën e BH (139 çështje të kryera nga 130 autorë, 37 prej të cilëve ishin 'autorë të dënuar dhe më parë ose minoren'; një rënie prej rreth 29 përqind krahasuar me vitin 2004), Republikën Srpska (103 çështje të kryera nga 99 persona; një rritje prej 26 përqind krahasuar me vitin 2004) dhe Distriktin e Brcko-s (14 çështje, nuk ka numër autorësh; një rritje prej rreth 29 përqind). Megjithatë raporti jep disa vrojtime të përgjithshme mbi rastet e falsifikimeve të hetuara ("shumë të edukuar", të familjarizuar me printimet dhe teknikat grafike) dhe shpërndarësit ("të aftë"), nuk sigurohet ndonjë e dhënë ose informacion shtesë mbi numrin e falsifikuesve, strukturat e krimit të organizuar, vendndodhjen e printimeve të jashtëligjshme, teknikat, kartëmonedhat e falsifikuara dhe prerjet e tyre, sekuestrimet, etj., si dhe analiza të tjera.

Nuk u sigurua ndonjë informacion mbi krimin elektronik (cybercrime).

PASTRIMI I PARAVE

Metodat e pastrimit të parave në Bosnje dhe Hercegovinë janë të ngjashme me ato që përdoren për evazionin fiskal. Në Republikën Srpska, numri i padive penale kundër personave të implikuar me evazion fiskal dhe pastrim parash u dyfishua nga viti 2002 deri në 2004 (nga 22 në 44 raste). Në vitin 2005, policisë së shtetit, zyrës së prokurorisë dhe gjykatave iu dha juridiksion mbi pastrimin e parave. Deri në Maj të vitit 2005, gjykata e Bosnje Hercegovinës lëshoi 8 dënime dhe gjoba që shkonin deri në 690,000 Euro. Sasia e parave të pastruara ishte 554,100 Euro, ndërkohë që vlera e evazionit në sistemin e taksave ishte përllëgaritur të kapte shifrën e 8.13 milion Euro. Evazoni fiskal ishte shkelja e paditur në të teta çështjet. Hetimet që filluan mbas tetë dënimeve të para hodhën dyshime mbi 643 ente ligjore që merreshin me pastrimin e parave²¹⁹.

Sipas një deklarate për shtyp²²⁰, Agjencia e Hetimeve dhe Mbrojtjes Shtetërore (SIPA) raportoi 27 transaksione të pastrimit të parave të regjistruara në vitin 2005 dhe të kryera nga 52 persona. Hetimet paraprake tregojnë se nga këto transaksione të jashtëligjshme ishin mbuluar rreth 58 milion Euro. Në deklaratën e saj, SIPA tha se pastrimi i parave nga kompani fantazmë më përpara ishte shumë i përhapur, por hodhi poshtë zërat se ka rreth 4,000 kompani fantazmë që pastrojnë para. Pavarësisht këtyre të dhënave të bëra publike, raporti "Informacion mbi Situataen e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2005", përmend vetëm dy çështje pastrimi parash në Federatën e Bosnje Hercegovinës dhe nuk siguron asnjë informacion tjetër shtesë.

Për sa i përket korrupsionit, informacioni i raportuar është gjithashtu i dobët, veçanërisht për sa i përket konkluzioneve të raundit të parë të vlerësimit të GRECO-s në Maj, 2005²²¹ dhe të masave të përmendura atje, të ndërmarra nga autoritetet e BH në përgjigje të 18 rekomandimeve.

Pavarësisht përmirësimeve të shumta, që nga Maji i vitit 2003, të tilla si ngritja e autoritetit qëndror për të gjitha aktivitetet anti-korrupsion (i cili zyrtarisht ekziston brenda Ministrisë së Sigurisë dhe njësisë së saj organizative SIPA), ngritja e një Departamenti të posaçëm për hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, përcjellja në Këshillin e Evropës e një projekt vendimi për ngritjen e një Zyre Anti-Korrupsion në të ardhmen, reforma në Kodin Penal (i cili gjithsesi nuk ka asnjë nen në lidhje me "korrupsionin" si një krim më vete, por mbulon të gjitha aktivitetet e korrupsionit me disa shkelje të veçanta, të ashtuquajtura "shkelje korrupsioni"), ngritja e një Rrjeti të Analizës Kriminale (CAN), informacioni i siguruar është jashtëzakonisht i dobët. Vetëm Federata e BH raportoi se ishin regjistruar dosje penale kundër 167 personave që lidheshin me ryshfetin, por nuk është siguruar asnjë informacion tjetër i mëtejshëm.

²¹⁹ Përgjigja e BH ndaj pyetësorit të vitit 2005.

²²⁰ Deklarata për shtyp e SIPA-s, 14 Shkurt 2006, e raportuar nga Qendra Kompetente e Evropës Jug-Lindore në Universitetin e Graz-it, 15 Shkurt 2006.

²²¹ Raporti i Përpunshëmrisë së GRECO-s mbi Bosnje dhe Hercegovinën, GRECO RC-I (2005) 1E.

4.3. KROACIA

Ashtu si të gjitha vendet e tjera të ish Jugosllavisë, Kroacia është prekur thellë nga lufta e cila shkaktoi ndryshime në rrethanat politike, sociale dhe ekonomike të cilave iu bashkëngjiten edhe sfidat që solli tranzicioni në periudhën e pas luftës. Organizatat kriminale në Kroaci nuk i ndalën asnjëherë aktivitetet e tyre që tashmë ishin krijuar në shtetin ish-Jugosllav dhe mbajtën lidhje shumë të ngushta me analogët e tyre në shtetet e tjera të ish Jugosllavisë, ndërkohë që bashkëpunimi midis organeve të zbatimit të ligjit në shtetet e sapo formuara u ndërpre gjatë konfliktit dhe në periudhën e menjëhershme të mbas luftës. Krijimi i një avantazhi të tillë lejoi grupet e krimit të organizuar që të identifikonin tregjet e krimit ku mund të siguronin përfitime dhe pushtet, por dhe që të arrinin një përshtatje shumë të mirë me ndryshimet e mbas luftës.

Sidoqoftë, vendi fitoi pavarësinë e tij më 25 Qershor 1991 dhe pati rreth një dekadë e gjysmë në dispozicion, si dhe një mbështetje të fortë nga komuniteti ndërkombëtar për të ngritur struktura të qëndrueshme. Në këtë mënyrë, u siguruan struktura të përmirësuara ligjore, arritje organizative, oficerë të kualifikuar të zbatimit të ligjit, dhe një bashkëpunim më i mirë me vendet e Evropës Jug-Lindore, por dhe me vendet e tjera Evropiane, gjë që mundësoi hartimin e një imazhi më të qartë për krimin e organizuar në Kroaci. Në përgjithësi dhe në ngjashmëri me vendet e tjera të rajonit, krimi i organizuar dhe ekonomik është një pasqyrim specifik i zhvillimit ekonomik, social dhe politik të vendit. Kriminelët e organizuar kanë aftësi që të përshtaten shpejt në situatën e ndryshuar sociale, ekonomike dhe politike dhe të përshtaten në reagimet e tyre ndaj sfidave të tregjeve kriminale duke fituar në këtë mënyrë një mbizotërim shkatërrues kundër autoriteteve të zbatimit të ligjit. Këtu mund të përmenden veçanërisht kriminelët që i përkasin një hierarkie të lartë, të cilët më shume i lehtësojnë dhe drejtojnë aktivitetet kriminale, sesa i kryejnë vetë këto krime. Duke u bazuar në përgjigjen e dhënë, krimi i organizuar në Kroaci dobëson strukturat shtetërore dhe vlerat morale dhe pritet që në të ardhmen, kërcënimet nga krimi i organizuar do të rriten dhe do të influencojnë (p.sh. nëpërmjet korrupsionit) të gjithë rrjedhën e proceseve politike, sociale dhe ekonomike.

Sidoqoftë, Kroacia lëvizi dhe vazhdon të lëvizë me hapa më të shpejtë se vendet e tjera të rajonit për sa i përket krijimit të politikave dhe strategjive kundër krimit të organizuar dhe atij ekonomik²²², adoptimit të të gjitha rregulloreve ligjore të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksionim të një sistemi të zbatimit të ligjit me një bazë të centralizuar të dhënash për krimin dhe një sistem funksional raportimi.

Si rrjedhojë e “Programit të masave të posaçme për shtypjen e krimit të organizuar” të Kroacisë në vitin 2003, si dhe të “Planit Kombëtar për Luftën kundër Krimit të Organizuar” në vazhdim, u arritën rezultate të dukshme jo vetëm për sa i përket reformave organizative dhe aktiviteteve specifike, si krijimi i programeve kundër pastrimit të parave dhe mbrojtjes së dëshmitarëve, zbatimi i rregulloreve të ndryshme mbi mbrojtjen e të dhënave, forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar (p.sh. “Marrëveshja Operacionale e Bashkëpunimit” mjaft e rëndësishme me Europol-in, e nënshkruar më 13 Janar 2006), por edhe për sa i përket vetë hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në çështjet e krimit të organizuar.

Në vitin 2004, Kroacia raportoi 1,098 vepra penale të krimit të organizuar, të kryera nga 540 individë (1.32 përqind e të gjithë krimeve të raportuara). Në vitin 2005 Kroacia shënoi një numër në rritje (+22.4 përqind) për çështjet e regjistruara të krimit të organizuar (1,340) dhe për individët (771) e veprave të zbuluara dhe raportuara penale të që bien nën kompetencën e Departamentit të Krimit të Organizuar (1.73 përqind e të gjithë krimeve të raportuara). Megjithëse ka një rritje të dukshme këto të dhëna janë të vogla në numër.

Si shumë vende të tjera, Kroacia nuk ka një dallim të prerë midis krimit ekonomik (si krimi i kravatave të bardha nga individë të biznesit të ligjshëm) dhe krimit të organizuar (si kriminelët të kravatave të zeza që veprojnë në tregjet e jashtëligjshme), dallim i cili sipas këndvështrimit të Kroacisë do të ishte shumë artificial. Për sa i përket krimit ekonomik, problemet kryesore duket se rrjedhin jo nga humbja e drejtpërdrejtë e të ardhurave publike, por

²²² Më 12 Qershor 2006, Kroacia dhe Komisioni Evropian filluan negociatat e anëtarësimit. Sipas Komisionerit të BE-së për Zgjerimin Ollie Rehn, Kroacia do të jetë ndoshta “e para që do të përmbushë të gjitha kushtet e nevojshme” dhe në këtë mënyrë do të jetë “vendi tjetër në listë”, tha Rehn. Viti i parashikuar i anëtarësimit, 2010, është i lidhur ngushtë me debatin e BE-së në vazhdim rreth Traktatit Kushtetues.

nga forma të tjera të krimit ekonomik si mashtrimet në prokurime publike, mashtrimet bankare dhe fajdetë si dhe mashtrimet në lidhje me falimentimet dhe privatizimet²²³. Ky i fundit është në veçanti mjaft i ndjeshëm duke marrë parasysh statutin e kufizuar të hetimeve dhe ndjekjes penale të këtyre çështjeve. Pasojat e krimeve të tilla janë shumë të dukshme për publikun. Publiku zakonisht e shikon këtë gjë si padrejtësi sociale dhe pasurim të paligjshëm dhe zakonisht ka pritshmëri të lartë për dënimin me sukses të këtyre krimeve nga organet e zbatimit të ligjit dhe ato të gjyqësorit. Mendohet se besimi publik në këto institucione varet nga zgjidhja e çështjeve të tilla të cilat njihen për vështirësinë e tyre për tu hetuar e për tu ndjekur penalisht për shkak të ndërlikimit dhe lidhjeve politike që mund të jenë në mes.

Mendohet se besimi publik në këto institucione varet nga rezultati përfundimtar i çështjeve të tilla të cilat njihen si të vështira për t'u hetuar dhe ndjekur për shkak të kompleksitetit dhe lidhjeve politike që mund të jenë përzier.²²⁴ Për më tepër, dëmi që i shkaktohet shoqërisë nga ky lloj krimi ekonomik është i vështirë të matet dhe të peshohet. Grupet kriminale që përfshihen në krimin ekonomik përdorin metoda të sofistikuara që lejojnë zhvillimin profesional dhe rekrutimin e ekspertëve (financiare, ligjore, etj.) dhe rrisin lidhjet me strukturat publike nëpërmjet financimit të, për shembull, aktiviteteve sportive, artikujve mediatike, ndihmave financiare, shkëmbimit të informacionit policor, sipërmarrjeve të përbashkëta me organizata nga Italia dhe Rusia në zonat bregdetare.

Anëtarët e këtyre grupeve kriminale janë kryesisht qytetarë kroatë me një nivel shkollimi të mesëm dhe me një status mesatar ekonomik. Rolet e tyre zakonisht ndahen në organizatorë, financierë, falsifikues (p.sh. të dokumenteve të nevojshme për të përmbushur kërkesat për kredi) si dhe ndërmjetës (punonjës firmash apo bankash që u interesojnë grupeve kriminale).

Grupet vetë, duket se nuk kanë ndonjë strukturë hierarkike. Por, anëtarë nga grupe të ndryshme fillojnë një biznes së bashku duke u bazuar në interesat e tyre personale. Në shumicën e rasteve, grupe specifike kriminale krijohen për kryerjen e krimeve specifike. Këto grupe kanë kryesisht një karakter lokal, dhe vetëm me raste mbulojnë të gjithë territorin e Kroacisë ose operojnë në vendet fqinje si Serbia, Mali i zi, Bosnje Hercegovina, Austria, Italia, Sllovenia dhe Hungaria.

TRAFIKIMI I DROGËS

Për sa i përket trafikimit të drogës, Kroacia ka lëvizur deri në një farë mase nga një prej vendeve transit në "Rrugët Ballkanike", në një vend destinacion. Sidoqoftë, prodhimi i drogës në Kroaci nuk lidhet me krimin e organizuar. Me saktë, prodhimi i drogës lidhet me prodhues të vegjël e individuale për konsum të brendshëm.

Njësoj si për hashashin dhe kokainën, është vënë re një tendencë në rritje në tregun e brendshëm për drogat sintetike, si rrjedhojë e rritjes së kërkesës për këto lloj drogash, por edhe duke u bazuar në furnizimin më agresiv që është mundur të zbulohet. Në shumicën e rasteve, droga sintetike është kontrabanduar nga vendet e BE-së, por ka ardhur në rritje dhe nga disa vende të Evropës Jug-Lindore dhe Lindore, në të cilat kanë lulëzuar laboratorë të jashtëligjshëm. Droga sintetike shërbehet në tregun e brendshëm nëpër zonat urbane apo në qytetet bregdetare, veçanërisht gjatë muajve të verës.

Sasi të mëdha hashashi dhe marijuane, të cilat janë mjaft të pranishme në tregun e jashtëligjshëm të drogës në Kroaci, arrijnë kryesisht nga deti nëpërmjet kanaleve ndërkombëtare të kontrabandës (kontenier) nga vende të Afrikës Veriore dhe Perëndimore në portet Italiane dhe Sllovene, e më pas nëpërmjet rrugëve tokësore në Kroaci. Por, hashashi dhe marijuana, ashtu dhe si kokaina, vijnë drejtpërdrejt nga Shqipëria ose nga vende të Amerikës së Jugut në portet detare të Kroacisë, nga ku më pas shkojnë në vende të tjera të Evropës ("kanalet detare të Rrugëve Ballkanike"). Nëpërmjet transportit rrugor, hashashi dhe marijuana vijnë kryesisht nga territoret e Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë.

Për sa i përket heroinës, është e qartë se të ashtuquajturat "Rrugë Ballkanike", nyja qendrore e së cilave kalon nëpërmjet territorit të Republikës së Kroacisë, përdoren ende shpesh për kontrabandimin tokësor (rrugor ose hekurudhor), sepse ato paraqesin lidhjet më të shkurtra midis vendeve prodhuese dhe vendeve destinacion. Për

²²³ Fatkeqësisht, Kroacia, ashtu dhe si vende të tjera të projektit, nuk raportoi mbi kontrabandën e duhanit.

²²⁴ Shiko Kroacia: Një punë në zhvillim nga Anna McTaggart dhe Drago Hedl, IWPR Nr. 562, 27 Qershor 2005

më tepër, rritja e shpejtë e trafikut të mallrave dhe pasagjerëve në “Evropën e re”, redukton rreziqet dhe investimet e mëdha për trafikantët e drogës, të cilët veçanërisht në trafikun e drogës ndjekin parimin sipërmarrës: “Rrezik i ulët – Përfitim i lartë”.

Trafikimi i drogës nëpërmjet ajrit, duket të jetë akoma një problem më i vogël. Ky trafik ekziston kryesisht në tregun e kokainës nga vendet e Amerikës Jugore dhe bëhet në sasi të vogla nga transportues dhe pako postare, bagazhe, etj.

Kroacia ka kohë që është vendi i vetëm në rajon i cili ka ndërmarrë disa masa për kuptimin dhe përlllogaritjen e tregut të brendshëm të drogës dhe për ndalimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit me drogën. Ekzistojnë të dhëna statistikore me modele të zakonshme (moshë, gjini, kombësi, etj.) individësh të akuzuar për abuzim (2005: 5,700), mbajtje (2005: 5,124) dhe shpërndarje të drogave narkotike (393). Pavarësisht regjistrimit të 94 çështjeve të krimit të organizuar të lidhura me drogat narkotike, në vitin 2005 nuk u shpërbënë grupe të tjera të mëdha të krimit të organizuar me struktura hierarkike. Prandaj, u parashikua se grupe të huaja të krimit të organizuar të mirë konsoliduara kanë zhvilluar rrjetet Kroate të ri-shitjes të cilat kanë një strukturë më piramidale, të dukshme vetëm në bazë, në të ashtuquajturën “treg milingonash”.

Sidoqoftë, ekspertët u shprehën që në anketimin e vitit 2004 se ka disa lloj organizatash kriminale të trafikimit të drogës të bazuara kryesisht në kombësi, përkatësi territoriale dhe lidhje klanore/familjare. Grupet shqiptare të krimit të organizuar i përkasin llojit të parë dhe në to përfshihen shqiptarë nga Kosova dhe “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, të cilët janë kryesisht në bashkëpunim të ngushtë me grupe Turke të krimit të organizuar për organizimin e trafikimit të heroinës. Struktura e tyre është mjaft hierarkike dhe bazohet në lidhje të ngushta familjare apo prejardhje të ngjashme, dhe me lidhje të ngushta në vende të tjera. Ndryshe nga Shqiptarët, njerëz që i përkasin etnive të tjera nuk kanë pozicione kyçe, por shërbejnë si kontrabandistë. Organizatorët kryesorë kanë arritur nivele më të larta edukimi, gëzojnë një standard të mirë jetese dhe shpesh zotërojnë kompani apo prona në të cilat investojnë të ardhurat e tyre të krimit.

Lloji i dytë i organizatave kriminale lidhet me grupet e krimit që merren me kanabis. Ky grup përbëhet kryesisht nga persona që mbajnë shtetësi të dyfishtë të Bosnje Hercegovinës dhe Kroacisë. Këto grupe kanë një strukturë më pak të përcaktuar dhe në to organizatori kryesor njihet nga anëtarët e tjerë të grupit. Në përbërje të këtyre grupeve ka ekzekutorë që refuzojnë të përdorin shërbimet e personave të tretë, përveç oficerëve doganore të vendosur në pikat e kalimit të kufirit. Grupe të tilla kanë lidhje të mira me grupe të tjera të vendosura në pikat ku kryhet transporti klandestin. Mund të vihet re gjithashtu se anëtarët e këtyre grupeve kanë prirje për të kryer dhe krime të tjera.

Lloji i fundit është ai i organizatave kriminale të vendosura në vende të tjera dhe të drejtuara nga individë me eksperiencë në vende tradicionale të prodhimit të drogës si Holanda dhe vendet e Amerikës Latine, ku organizohet trafikimi i drogave sintetike dhe kokainës nëpërmjet rrugëve ajrore dhe detare. Ata mbështeten në persona transportues të cilët mund të jenë trafikantë profesionistë droge ose persona të rastësishëm që punësohen vetëm për një rrugë. Trafikantët përdorin shërbimin postar të shpejtë ose agjencitë turistike të udhëtimit dhe fshehin destinacionin përfundimtar duke zgjedhur fluturime me disa ndërprerje.

Grupet kriminale të zhvilluara në vend kanë struktura të përziera dhe shpesh drejtohen nga një person me precedentë penale. Disiplina imponohet duke përdorur kërcënimet dhe dhunën, kryesisht për të detyruar klientët për të paguar borxhet e tyre, ose duke mbajtur një pjesë të të ardhurave kriminale. Anëtarët e këtyre grupeve kanë prirje për të kryer krime të tjera si trafik armësh, cigaresh apo dhe grabitje. Të ardhurat e krimit kryesisht shpenzohen për të blerë prona të luajtshme dhe të paluajtshme në vende turistike, si dhe për të bërë një stil të spikatur jetese. Autoritetet Kroate të zbatimit të ligjit raportuan se kriminelët e organizuar përdorin rrugë të ndryshme për të siguruar aktivitetet e tyre, si metoda kundër - zbulimi, përdorim të shpeshtë të mesazheve dhe shprehjeve të koduara gjatë bisedave telefonike dhe komunikimeve nëpërmjet postës elektronike, ndërrim të shpeshtë të kartave telefonike me parapagesë, aktivitete ndër-kombëtare, transferim të paligjshëm të parave të pista nëpërmjet kalimit të kufirit dhe në banka të huaja.

Tabela 8: Përmbledhje ne forme table e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (Kroacia)

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Heroin (kg)	19.6	36.9	85.7	114.4	27.1	
Hashash (kg)	4,6	2,1	2.3	5.9	53.4	
Marijuana (kg)	737,9	595.2	435.0	428.2	983.2	
Kokainë (kg)	1,5	3.3	350.8	17.6	9.0	
Amfetaminë (kg)	0,9	28.0	3.8	7.2	14.3	
Ekstazi (copë)	12.905	11.0632	29.840	27.048	33.601	
LSD (doza)	154	192	14	60	21	
Kanabis (bimë)	-	-	-	-	-	
Popy (bimë)						

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Në tetor të vitit 2004, hyri në fuqi ligji i përmirësuar mbi "Trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë" (Neni. 175 ff. i Kodit Penal të Kroacisë) dhe tani është rreptësisht në linjë me standardet ekzistuese dhe përkufizimet ligjore ndërkombëtare, siç paraqiten në acqui-në e BE-së, Rekomandimin R (2000) 11 të Këshillit të Evropës²²⁵, dhe të ashtuquajturin "Protokolli i Palermos" të OKB-së²²⁶. Deri tani, u arrit qëllimi i një "përqasjeje të orientuar drejt viktimës"²²⁷, e nevojshme në këtë fushë specifike të krimit. Në këtë drejtim janë arritur rezultate pozitive që nga Korriku i vitit 2002²²⁸, kur filloi zbatimin projekti LARA i Këshillit të Evropës. Për shembull, trafikimi i qenieve njerëzore tani mund të dënohet si një vepër e rëndë penale, me një dënim maksimal prej 10 vjet heqje lirie, ndërsa për çështje të tjera të rënda (p.sh. trafikimi fëmijësh, me një numër të madh viktimash, brenda përkufizimit të një organizate kriminale, ose që shkaktojnë vdekjen e personit të trafikuar) me 5 deri në 15 vjet. Gjithashtu u ngrit një kuadër legjislativ për sigurimin e ndihmës së duhur dhe mbrojtjes për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe për sigurimin e ndihmës ligjore, mjekësore, dhe psikologjike që nga momenti i identifikimit të tij/saj, deri në sigurimin e një sistemimi përfundimtar²²⁹.

Për më tepër, Kroacia i kushtoi rëndësi përputhshmërisë së Planit të saj të Veprimtari mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore, me parimet dhe standardet Evropiane dhe ngriti një Komitet Ndërkombëtar për koordinimin e aktiviteteve kombëtare dhe rajonale në fushën e ndalimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Ky komitet përbëhet nga përfaqësues të të gjitha ministrive përkatëse, Parlamentit Kroat, Zyrës së Avokatit të Shtetit, OJQ-ve dhe medieve.

Megjithëse rastet e konfirmuara të trafikimit të qenieve njerëzore janë të rralla (2005: 6 raste të trafikimit të qenieve njerëzore, 2 prej të cilave ishin të lidhura me krimin e organizuar), mund të nxirret ky përfundim:

Rekrutimi fillon në vendet e origjinës së viktimave kryesisht nga Moldova, Bullgaria, Rumania, Shqipëria, por dhe nga Federata Ruse, Ukraina, Mali i Zi, Serbia, Bosnje dhe Hercegovina dhe Kroacia. Vendet destinacion janë kryesisht Austria, Belgjika, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar²³⁰. Si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik, Kroacia shfaqet si një vend transit klasik për trafikimin e qenieve njerëzore nga Evropa Qendrore, Jug-Lindore dhe Lindore drejt vendeve të Evropës Perëndimore. Me një liri lëvizjeje më të madhe brenda Evropës, është i pashmangshëm fakti se rrjetet e trafikimit do të fillojnë të vënë gjithashtu në shënjestër zonat e projektit. Kroacia raportoi të dhëna statistikore që dëshmojnë qartë se vendi po bëhet gjithashtu një vend destinacion.

²²⁵ Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Rekomandim mbi Veprimtari kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për qëllime shfrytëzimi seksual, Nr. R (2000) 11.

²²⁶ Protokolli për të Parandaluar, Shtypur dhe Dënuar Trafikimin e Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndër-Kombëtar (UNTOC), të ratifikuar nga Republika e Kroacisë si një nga zonat e para të projektit në fillim të vitit 2003.

²²⁷ Siç është kërkuar prej vitesh nga VOICE, një grup pune ad hoc i 40+ OJQ-ve aktive në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.

²²⁸ Trafikimi i qenieve njerëzore, LARA, Reforma e ligjit Penal në Evropën Jug-Lindore, për më shumë detaje shiko Raportin mbi "Seminari Rajonal i LARA-s", Ecuria, Zagreb 1 - 4 Prill, 2003.

²²⁹ Kroacia raportoi, që nga viti 2003, identifikimin e gjithsej 45 viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, të cilat përfituan një program të plotë ndihme dhe mbrojtjeje.

²³⁰ "Trafikimi i Qenieve Njerëzore për Shfrytëzim Seksual në BE: Një Këndvështrim i Europol-it", Janar 2006.

Trafikantët në Kroaci janë kryesisht shtetas të Kroacisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë dhe Italisë, por gjithashtu raportohet dhe një përfshirje kriminale e shtetasve nga vendet e origjinës, si Moldavia, Ukraina, Rumania dhe Bullgaria. Trafikantët janë gjithashtu shumë të përfshirë dhe në forma të tjera krimi, veçanërisht me krime që kanë të bëjnë me imigracion të paligjshëm, falsifikim dokumentesh, krime seksuale dhe organizim prostitucioni.

Struktura organizative e grupeve të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore ka një ndarje hierarkike, si në nivel ndërkombëtar ashtu dhe në atë vendas. Të gjithë personat e përfshirë në zinxhirin e trafikimit të qenieve njerëzore fitojnë në mënyra të ndryshme, në varësi të vendit të origjinës së viktimës, transportit, llojit të rekrutimit, etj. Sasia e përgjithshme dhe e saktë e të ardhurave që burojnë nga ky krim nuk është e njohur. Të ardhurat e këtij krimi zakonisht investohen në prona të luajtshme dhe të paluajtshme, për korrupsion dhe për financimin e aktiviteteve të tjera të jashtëligjshme. Rrugët për trafikim dhe transportim klandestin janë të ngjashme me ato të vendeve të tjera të rajonit. Në të gjitha rastet e hetuara, kufijtë ose ishin kaluar në mënyrë të jashtëligjshme ose duke përdorur dokumente pjesërisht ose plotësisht të falsifikuara.

Rekrutimi, transporti, transferimi dhe shfrytëzimi nuk ndryshojnë nga zonat e tjera të projektit dhe janë të ngjashme me eksperiencat në BE.

TRANSPORTI KLANDESTIN I PERSONAVE

Ndryshe nga trafikimi i qenieve njerëzore, Kodi Penal Kroat e përshkruan në Nenin 177 “transferimin e jashtëligjshëm të personave përmes kufirit shtetëror” si një shkelje të lehtë, për të cilën aplikohet një gjobë ose një dënim deri në 3 vjet heqje lirie. Në qoftë se krimi kryhet nga grupe të krimit të organizuar dënimi duhet të jetë nga 1 deri në 10 vjet heqje lirie. Kroacia është një vend klasik transit drejt BE-së.

Në vitin 2005, u zbuluan dhe u raportuan 260 vepra penale (me 270 migrantë të jashtëligjshëm) në bazë të Nenit 177 të Kodit Penal Kroat. Krahasuar me vitin 2004, me 194 vepra penale (me 223 migrantë të jashtëligjshëm), vihet re një rritje prej 34,02 përqind.

Imigracioni i jashtëligjshëm dhe transferimi i tyre përmes Kroacisë kryhet kryesisht nëpërmjet “kufijve jeshil” (nëpërmjet mjeteve të mallrave të rënda, makinave apo mjeteve që përdoren për rrugë të pa asfaltuara, shpesh duke përdorur ndarje të modifikuara për transport, ose thjesht në këmbë) drejt Sllovenisë dhe “kufijve blu” (nëpërmjet varkave, skafeve, anijeve) kryesisht drejt Italisë. Transporti përmes Kroacisë kryhet nëpërmjet makinave të marra me qera, taksive, furgonave dhe kamionëve të vegjël.

Për sa i përket karakteristikave etnike të migrantëve të jashtëligjshëm, kryesisht u raportuan shtetas të Shqipërisë, Turqisë dhe Kinës, por dhe migrantë nga VENDET E Evropës Jug-Lindore dhe Lindore, Azia, Afrika dhe vende të tjera të botës.

Grupet e krimit të organizuar që janë të përfshirë në këtë fushë ndërtohen në një mënyrë vertikale, me detyra të përcaktuara qartë dhe me lidhje me grupe ndërkombëtare kriminale që nga fillimi deri në fund të zinxhirit të trafikimit. Analizat e bëra sollën në dritë një bashkëpunim të ngushtë midis trafikantëve nga Kroacia dhe atyre nga Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, vende në të cilat grumbullohen dhe përgatiten migrantët për fazën tjetër të udhëtimit të tyre të jashtëligjshëm përmes Kroacisë.

KRIMI EKONOMIK DHE ELEKTRONIK (CYBERCRIME)

Kroacia ka ngritur një departament të posaçëm për krimin ekonomik dhe korrupsionin, i cili merret me të gjitha format e veprave penale që kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës, si publike ashtu dhe private, pastrimin e parave, zotërimin e pronësisë intelektuale dhe korrupsionin. Në total, në vitin 2005 u raportuan rreth 6.600 vepra penale, 2,35 përqind më pak se në vitin 2004 (rreth 6.750). Veprat penale më të shpeshta në vitin 2005 ishin: abuzim me postin dhe autoritetin zyrtar, mashtrim, përdorim i jashtëligjshëm i punës së një autori, evazion ndaj kontrollit doganor, abuzim me autoritetin në biznesin ekonomik dhe falsifikim i një dokumenti zyrtar.

Rritja e veprave të lidhura me krimin elektronik dhe e atyre kundër të drejtave të pronësisë intelektuale (2004: 928 vepra, 2005: 1009 vepra ²³¹) duhet parë si një rrjedhojë e strukturave administrative të përmirësuara ligjore dhe masave kontrolluese të filluara së fundmi. Kroacia ka nënshkruar tashmë “Konventën e Krimin Elektronik” në Nëntor 2001, e cila ka hyrë në fuqi në Korrik 2004. Gjithashtu ka nënshkruar në Janar të vitit 2003 Protokollin e Konventës që lidhet me penalizimin e veprave të një natyre racist dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik. Për më tepër, në Departamentin e Krimin Ekonomik u ngrit një njësi e veçantë, e cila merret me krimin elektronik dhe mbrojtjen e të drejtës mbi pronësinë intelektuale. Gjithashtu, përkrahja e veprave penale në Kodin Penal të Kroacisë u përmirësua dhe u shtuan nene të tjerë, të cilat kanë hyrë vetëm së fundmi në fuqi (Tetor 2004), për të adresuar fenomene të reja, si pornografinë e fëmijëve në një sistem kompjuterik, dëmtimin e të dhënave kompjuterike, programeve dhe sistemeve dhe falsifikimet e mashtrimet kompjuterike.

Mendohet, se autorët e krimin elektronik nuk punojnë si anëtarë të grupeve të organizuara kriminale. Kroacia ka filluar që të fitojë eksperiencë, të përmirësojë aftësitë e saj dhe të ngrijë mekanizma të qëndrueshëm për të analizuar të tilla fusha krimi. Për arsye se pjesa më e madhe e krimin elektronik është i ashtuquajtur “krim në kontroll” (viktimit nuk raportojnë në polici, autoritetet e zbatimit të ligjit duhet ti zbulojnë këto krime nëpërmjet monitorimit të internet-it dhe analizave operacionale), të dhënat janë të vogla (në vitin 2005: 2 vepra pornografie fëmijësh në një sistem kompjuterik, 11 vepra kundër integritetit të të dhënave kompjuterike, programeve dhe sistemeve, 6 vepra mbi falsifikimin kompjuterik dhe 15 vepra mbi mashtrimin kompjuterik).

Krimet si keqpërdorimi i çeqeve/kartave të kreditit (299), ose kundër të drejtave të pronësisë intelektuale (342), ose i dhunimit të së drejtës së patentës (7) po mbizotërojnë dhe po motivojnë zhvillimin e një dege të piraterisë së produkteve në Kroaci.

KORRUPSIONI

Zhvillimi i dukshëm i numrit të veprave penale të lidhura me korrupsionin (2002: 430 vepra; 2003: 329 vepra; 2004: 266 vepra; 2005: 442 vepra) duhet të interpretohet. Së pari, mund të jetë një rrjedhojë e regjistrimit të vonuar të statistikave, duke u balancuar kështu në një vlerë mesatare (rreth 370 vepra në vit) dhe duke e barazuar me uljen e dukshme të pashpjegueshme për vitin 2004. Së dyti, mund të shikohet si një rrjedhojë e strukturave administrative dhe ligjore të përmirësuara, të zbatuara dhe të adoptuara në lidhje me Programin Kombëtar të vitit 2001 për Luftën kundër Korrupsionit dhe atë të vitit 2006, që u miratua në mars të vitit 2006, që mund të shihet si përmirësim i aktiviteteve të autoriteteve të zbatimit të ligjit. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë ndryshuar gjithashtu duke parashikuar dhe dënuar në dispozita të veçanta për korrupsionin, duke pasuar miratimin e Konventës së UNTOC, Konventat e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik si dhe Konventën Penale kundër Korrupsionit.

Programi Kombëtar për Shtypjen e Korrupsionit parashikon ngritjen brenda vitit të Autoritetit kundër Korrupsionit – ose “Këshillit Kombëtar” që ka për qëllim monitorimin dhe zbatimin e Programit Antikorrupsion si dhe që është i ngarkuar me detyrën e edukimit publik dhe të parandalimit të korrupsionit.

Neni 21 i Ligjit për Zyrën e Luftës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përkrahja gjashtë vepra të ndryshme korruptive të cilat konsiderohen si korrupsion, të tilla si abuzimi me postin dhe autoritetet zyrtare, ofrimi dhe marrja e një ryshfeti, abuzimi në kryerjen e detyrave qeveritare, mashtrimet në çështjet e shpalljes së falimentimit e të tjera. Për më tepër, në vitin 2004, Kodi Penal u ndryshua për të ndëshkuar ryshfetin në veprimtaritë e biznesit. Kroacia ka theksuar rëndësinë e zbatimit të rregulloreve ligjore të hartuara, si ligji mbi “Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Zbatimin e Funksioneve Publike”, “Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale”, “Mbrojtjen e Dëshmitarëve”, “Ndalimin e Pastrimit të Parave”, “Ndihmën Ligjore Ndërkombëtare në Çështje Penale” dhe “Të Drejtën për Informim”. Ndihet keqardhje për mos ekzistencën e një ligji mbi financimin e partive politike. Gjithsesi, të dhënat mbeten të pakta dhe të ndryshme edhe në përgjigjes së Kroacisë ndaj pyetësorit. Shumica e veprave të korrupsionit kanë të bëjnë me abuzim të postit dhe të autoritetit

²³¹ Siç raportohet nga Qendra për Kompetencën e Evropës Jug-Lindore në Universitetin e Graz-it (Austri), pirateria e software-it në Kroaci mbetet akoma e lartë, deri në 58 përqind. Dëmi i shkaktuar prodhuesve të software-ve u rrit nga 5 miliardë dollarë Amerikanë, në 50 miliardë, siç tregon një studim i kompanisë analiste IDC CEMA, i cili iu prezantua Shoqatës së Lidhjes së Biznesit (BSA) në Zagreb, Dhjetor 2005.

zyrtar (259), abuzim në kryerjen e detyrave qeveritare (10) dhe të dyja format e ryshfetit (139), të cilat të marra së bashku përbëjnë më shumë se 90 përqind të të gjitha veprave penale për korrupsion.

PASTRIMI I PARAVE

Kroacia ka një përkufizim ligjor për pastrimin e parave në Nenin 279 të Kodit të saj Penal që lejon burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet; nga 1 vit deri në 10 vjet kur kjo vepër penale kryhet nga një anëtar i një grupi apo organizate kriminale. Financimi i terrorizmit përbën një vepër penale të veçantë të përcaktuar nga Neni 187 a ff. i Kodit Penal.

Bazuar në analizat e krimit të ndërmarra nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Kroacisë, totali i të ardhurave kriminale arrin një vlerë prej rreth 1.5 miliardë Euro në vit (të përfituara p.sh. nga krimi ekonomik dhe trafikimi i drogës). Kjo shumë duhet parë si një minimum (për shembull nuk ka të dhëna për imigracionin e jashtëligjshëm dhe trafikimin e qenieve njerëzore) dhe si niveli më i ulët i parave të pista që duhet të “zbardhohen”, siç presupozohet zakonisht nëpërmjet investimit në prona të paluajtshme. Pa dyshim, Kroacia ka një vijë bregdetare mjaft joshëse për investitorë fondesh të ligjshme ose jo, qofshin këta vendas apo te huaj. Pasuri të tilla natyrore shpesh mund të shfrytëzohen për pastrimin e të ardhurave të krimit, përmes të cilave blihen ose bëhen ndërtime. Për këtë arsye kërkohet një monitorim i kujdesshëm dhe një kombinim i mekanizmave shtypës dhe parandalues për ruajtjen e integritetit dhe kapacitetit të këtyre pasurive dhe zhvillimit ekonomik. Një nevojë e tillë vihet re dhe në çështjet e korrupsionit të kohëve të fundit në zyrat e regjistrimit të pasurive dhe të gjyqësorit²³².

Pavarësisht këtyre përlogaritjeve, janë raportuar vetëm pak raste (8) të pastrimit të parave siç përshkruhen në Nenin 279 të Kodit Penal, por parashikohet që kërcënimi nga krimi i organizuar të rritet në të ardhmen, sidomos për shkak të tendencës së kriminelëve për të depërtuar në elitat politike dhe ekonomike. Kjo shfrytëzohet si një mënyrë për të përmirësuar imazhin e tyre publik dhe për të influencuar vendimet politike, ekonomike dhe administrative duke përdorur të ardhurat kriminale. Korrupsioni i cili lidh krimin e organizuar dhe ekonomik është mjeti kryesor për depërtimin në strukturat qeverisëse.

²³² Shiko artikullin *Punonjësit e Administratës Shtetërore në Makarska nën hetim*, HINA, Lista Jutarnji, 12 Maj 2005; dhe *Kroacia: Një punë në zhvillim* nga Anna McTaggart dhe Drago Hedl, IWPR Nr. 562, 27 Qershor 2005.

4.4. MALI I ZI

Lufta dhe sanksionet e viteve 1990, shteti i bashkuar i Serbisë dhe Malit të Zi nga viti 2003 deri në qershor të vitit 2006 dhe procesi drejt pavarësisë u shoqërua me sfida të veçanta për këtë vend. Këtu përfshihen mundësitë për aktivitete kriminale, ku bëjnë pjesë dhe kontrabanda dhe pastrimi i parave.

Për sa i përket kërcënimit të krimit të organizuar mbi shoqërinë dhe shtetin e Malit të Zi ka shumë pak informacion të disponueshëm. Si rrjedhojë, organet e zbatimit të ligjit nuk kishin grumbulluar asnjë të dhënë mbi krimin e organizuar deri në momentin që ky krim u fut si koncept në legjislacionin penal të vitit 2004. Gjithsesi, në një anketë mbi krimin ekonomik të ndërmarrë nga Këshilli i Evropës²³³, Mali i Zi raportoi për vitin 2003 një total prej 81 çështjesh të krimit të organizuar; kryesisht trafikim droge (32 çështje), trafikim i qenieve njerëzore (28 çështje), krim ekonomik (28 çështje) dhe vjedhje/grabitje (16 çështje).

Ministria e Brendshme dhe e Administratës Policore ka ndërmarrë masa të ndryshme për të përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar dhe ekonomik, - veçanërisht në fushën e kontrabandës, - dhe ka vendosur në kapitullin 30 të Ligjit të Procedurës Penale të Malit të Zi një përkufizim ligjor "të krimit të organizuar", në përputhje me konventën e UNTOC dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Krimi i organizuar mund të përfshijë çdo lloj krimi për aq kohë sa përmbushen kriteret e organizimit.

Mali i Zi gjithashtu përmirësoi të dhënat statistikore dhe analizën e krimit, gjithsesi nuk siguroi ndonjë të dhënë për vitin 2004. Për vitin 2005, Prokurori i Posaçëm i Malit të Zi për Krimin e Organizuar regjistroi 14 padi kundër 58 kriminelëve që merrnin pjesë në grupe të krimit të organizuar. Janë cituar 85 krime të ndryshme, kryesisht mashtrime dhe mashtrime kompjuterike (2 raste), kontrabandë (rreth 10 raste), trafikim droge dhe krime të lidhura me të (10 raste), abuzim i posteve zyrtare (10 raste), pastrim parash dhe armëmbajtje pa leje (secila nga 7 raste). Gjykatat kompetente mbaruan njëkohësisht hetimet kundër 35 kriminelëve të organizuar dhe proceset gjyqësore kundër 13 të tjerëve janë akoma në proces. Zonës së projektit i është dashur të raportojë për disa lloje të ndryshme krimi se ka një vështirësi në adresimin e pyetjeve që lidhen me to, për shkak të mungesës së përlllogaritjeve, të dhënave dhe analizave të mjaftueshme e të plota. Në këtë mënyrë, Malit të Zi i duhet akoma që të ndërtojë një sistem cilësor për mbledhjen e të dhënave dhe analizën e krimit të organizuar.

Si rrjedhojë, është e vështirë që të ndërmerret një vlerësim kërcënimi kuptimplotë. Por duke u bazuar në informacionin e disponueshëm, trafikimi i personave, drogës armëve/eksplzivëve, krimi ekonomik dhe korrupsioni duket të jenë problemet kryesore të zonës. Si pasojë, siç u tha dhe më sipër është e vështirë që të ndërmerret një vlerësim kuptimplotë apo një analize për situatën e krimit të organizuar dhe ekonomik në Mal të Zi.

DROGAT E PALIGJSHME

Trafikimi i drogës është i dukshëm, sidomos trafikimi i kanabisit nga Shqipëria dhe i heroinës nga Turqia. Aktivitetet kriminale të lidhura me narkotikën ndikojnë dukshëm në rritjen e numrit të përdoruesve të drogës që kanë krijuar një varësi ndaj saj, si dhe në strukturën e kriminalitetit, p.sh. në rritjen e llojeve të veprave penale dhe në kryerjen e disa veprave të reja penale. Në vitin 2005, u depozituan tre padi penale kundër 10 personave që kishin kryer 10 vepra të krimit të organizuar. Mali i Zi është kryesisht një vend transit, por disa droga, sidomos kokaina dhe kanabis të cilat trafikohen kryesisht në rrugë tokësore, konsumohen në tregun e brendshëm.

Drogat sintetike, si ekstazia, janë lëndë narkotike relativisht të reja në Mal të Zi, prania e të cilave është regjistruar në këto vitet e fundit. Në operacionet e sekuestrimit, është arritur në përfundimin se kjo lëndë narkotike vjen nga Serbia. Llojet e logove në kokrrat e ekstazisë ndryshojnë, ashtu si dhe cilësia, gjë e cila dëshmon se burimet furnizuese dhe kanalet e trafikimit të kësaj lëndë narkotike nuk kanë një karakter të qëndrueshëm. Prania e "shpejtësisë" është regjistruar në disa raste sekuestrimi të shtetas të huaj. Disa droga të tjera, si opiumi, vaji i hashashit, llojet e drogave të amfetaminës dhe LSD, kanë shfaqje sporadike në tregun e narkotikëve.

²³³ Këshilli i Evropës, "Raporti i vitit 2005 i Situatës së Krimit të Organizuar me përqendrim të veçantë në krimin ekonomik", Dhjetor 2005.

Produktet e kanabisit, kryesisht marijuana, e cila transportohet në Malin e Zi nga Republika e Shqipërisë, konsiderohet të jetë e një cilësie të lartë (me gradë të lartë THC-je). Në tregun e jashtëligjshëm të Malit të Zi, marijuana është lëndë narkotike më e përhapur, e cila konsumohet nga minorenët dhe njerëzit që i përkasin moshave të mesme. Nga çështjet e gjykuara, mund të vihet re se territori i Malit të Zi shërben gjithashtu dhe si një zonë transit, nëpërmjet së cilës sasi më të mëdha të kësaj droge trafikohen kryesisht me destinacion tregjet e Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kroacisë. Aktivitetet kriminale të transitit që lidhen me këtë lëndë narkotike kryhen nga grupe të organizuar trafikantësh, shpesh herë me origjinë të përzier etnike dhe me role e hierarki të përcaktuar

Heroina ka ardhur duke u zbuluar në rritje në Mal të Zi. Në tregun e brendshëm heroina përhapet dhe trafikohet kryesisht nga Shqipëria, megjithëse disa sasi vijnë nga Turqia nëpërmjet detit. Në shitjen në rrugë, heroina ka zakonisht një ngjyrë në kafe dhe përzihet me substanca të ndryshme si paracetamoli, mielli e të tjera.

Kokaina arrin në territorin e Malit të Zi nëpërmjet portit të Barit, por gjithashtu dhe nëpërmjet kanaleve të trafikimit nga Shqipëria. Ka raste të transportimit të kokainës nga vende të Amerikës së Jugut duke përdorur rrugët detare. Në këto raste zakonisht janë përfshirë sasi të mëdha të kësaj lëndë narkotike dhe me një cilësi të lartë. Transportet më të mëdha të kokainës kanë zakonisht një karakter transit, duke u drejtuar drejt tregjeve të Evropës Perëndimore.

Kriminelët e trafikimit dhe shpërndarjes së drogës kanë shkallë të ndryshme organizimi, në varësi të fokusit hapësinor të aktiviteteve të tyre (lokal, rajonal, ndërkombëtar). Janë vënë re disa lloje strukturash hierarkike, në disa raste me orientim familjar, veçanërisht në grupet me aktivitet ndërkombëtar. Gjithashtu, është raportuar përfshirje në fusha të tjera të krimeve të rënda (vrasje, rrëmbime, vjedhje, etj.). Nuk disponohet informacion më i detajuar mbi strukturat, përbërjen, modus operandi të krimit të organizuar të lidhur me trafikimin e drogës. Gjithashtu, nuk ekzistojnë përlllogaritje për sasinë e përfitimeve nga trafikimi i drogës në Mal të Zi²³⁴.

Tabela 9: Përmbledhje tabelore e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (Mali i Zi)

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Heroinë (kg)					17.6	
Hashash (kg)					10.5	
Marijuana (kg)					367.5	
Kokainë (kg)					0.03	
Amfetaminë (kg)*						
Ekstazi						
LSD (doza)						
Kanabis (bimë)						
Popi (bimë)						

* Në total, 0,00079 kg drogë sintetike u sekuestrua në vitin 2005

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Kodi Penal i Malit të Zi përcakton në Nenin 444 trafikimin e qenieve njerëzore në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare, me dënime për çështje bazë nga 1 deri në 10 vjet, në çështje të rënduara burgim minimal nga 3 deri në 10 vjet (vdekje personash). Për më tepër, neni 446 i Kodit Penal parashikon dënime për ndërtimin e marrëdhënieve skllavërore dhe për transportimin e personave të skllavëruar.

Trafikimi i qenieve njerëzore i shfaqur si një problem i dukshëm në rastin e trafikimit të një gruaje Moldave në vitin 2002, nxiti qeverinë të ndërmerre masa progresive.²³⁵ Për vitin 2003, u raportuan gjithsej 28 raste të trafikimit të qenieve njerëzore të kryera nga grupe të krimit të organizuar, por nuk u përmend ndonjë e dhënë mbi këto grupe të përfshira. Siç duket, trafikimi i organizuar i qenieve njerëzore është në rënie, pasi në vitin 2005 u kryen

²³⁴ Sipas të dhënave që mbulojnë periudhën 2001-2004, autoritetet e zbatimit të ligjit sekuestrojnë çdo vit rreth 10-15 kg heroinë dhe 1,000 kg kanabis, duke përfshirë 250-300 autorë.

²³⁵ Këshilli i Evropës, "Raporti i vitit 2005 i Situats së Krimit të Organizuar me përqendrim të veçantë në krimin ekonomik", Dhjetor 2005.

padi vetëm kundër 3 autorëve që kishin kryer 3 vepra krimi të organizuar për trafikim të qenieve njerëzore, ku ishin trafikuar 23 viktima.

Trafikanti tipik i qenieve njerëzore përshkruhet si “një qytetar i papunësuar, mashkull i Malit të Zi dhe Serbisë, në kushte të varfra ekonomike, me edukim të mesëm dhe me moshë të ndryshme”. Në të gjitha rastet është vënë re përdorim dhune dhe kërcënimi dhe në disa raste një strukturë hierarkike.

Informacion dhe të dhëna më të detajuara mbi trafikimin e qenieve njerëzore nuk disponohen për shkak të mungesës së analizave.

TRANSPORTI KLANDESTIN I PERSONAVE

Kalimi i jashtëligjshëm i kufirit shtetëror parashikohet në Nenin 405 të Kodit Penal. Transporti klandestin i personave duket të jetë zvogëluar si rrjedhojë e liberalizimit të ndryshimeve në regjimin e vizave për rajonin, sidomos kur bëhet fjalë për kalimin klandestin nga Shqipëria. Në anën tjetër, një regjim më i rreptë vizash për qytetarët Shqiptarë dhe Kosovarë që kërkojnë të futen në Bosnje Hercegovinë dhe Kroaci, ka krijuar si rrjedhojë një treg për transport klandestin përgjatë këtyre kufijve. Në periudhën midis Janarit dhe Shtatorit të vitit 2004²³⁶, u regjistruan 372 kalime të jashtëligjshme të kufirit: Nuk u raportua se sa nga këto çështje kualifikoheshin si të kryera nga grupet e krimit të organizuar. Në vitin 2005, nuk pati padi në lidhje me transportin e organizuar klandestin të personave.

Kalimet e paligjshme të kufirit shtetëror në rajon ndodhin në këto drejtime:

- Nga territori i vendeve të Evropës Jug-Lindore (Rumania, Bullgaria dhe “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”) nëpërmjet Malit të Zi drejt Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së;
- Nga territori i Kosovës, nëpërmjet Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë ose Malit të Zi drejt Sllovenisë dhe më pas drejt shteteve të tjera anëtare të BE-së;
- Nga territori i Shqipërisë, nëpërmjet Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë ose Malit të Zi drejt Sllovenisë dhe më pas drejt shteteve të tjera anëtare të BE-së;
- Nga Republika e Shqipërisë, nëpërmjet portit të Barit ose detit Adriatik, drejt Italisë dhe më pas drejt shteteve të tjera anëtare të BE-së.

Meqenëse Mali i zi shërben si një zonë transit për migrantët e jashtëligjshëm, kjo dukuri nuk sjell ndonjë impakti të dukshëm në shoqërinë dhe ekonominë e vendit. Sidoqoftë, Ministria e Brendshme dhe e Administratës Policore duhet të ketë parasysh faktin se ajo nuk zotëron të dhëna ose përlllogaritje mbi përfitimet e mundshme që burojnë nga grupet kriminale të përfshira në transportin klandestin të personave, ose për përdorimin/keqpërdorimin e më vonshëm të këtyre të ardhurave.

KRIMI EKONOMIK DHE ELEKTRONIK (CYBERCRIME)

Në ngjashmëri me vendet e tjera të rajonit, Mali i Zi e shikon krimin ekonomik si një nga kërcënimet kryesore që shkakton humbje të konsiderueshme në të ardhurat publike, nëpërmjet evazionit në sistemin doganor dhe të taksave. Ky evazion kryhet nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, kompanive të rreme të regjistruara jashtë vendit dhe nëpërmjet skemave të tërthorta tregtare me vendet fqinjë. Mungesa e disa mallrave strategjikë, në fillim të viteve '90 (energji, ushqimi, etj) shërbeu si një terren i frytshëm për përhapjen e një “ekonomie gri” dhe krimit ekonomik. Për më tepër, Mali i Zi rrethohet nga vende me stabilitet të dallueshëm ekonomik, si dhe ka një sistem të ndryshëm taksash, regjim të ndryshëm të detyrimeve doganore dhe një regjim më të lehtësuar me Serbinë.

Në kapitullin 23 të Kodit Penal të Malit të Zi, renditen të gjitha veprat penale në lidhje me “veprimet e pagesave dhe aktivitetet tregtare”. Për më tepër, kapitulli 34 “veprat penale kundër mbarëvajtjes në detyrë”, kapitulli 33 “veprat penale kundër transaksioneve të ligjshme”, kapitulli 22 “veprat penale kundër pronës”, mbulojnë një

²³⁶ Nuk ka të dhëna të raportuara për gjithë vitin 2004.

fushë të gjerë veprash penale që bien brenda krimit ekonomik²³⁷. Megjithëse, autoriteteve Malazeze iu desh që të raportonin për një pamundësi për të pasur të dhëna të plota, më qëllim ndërmarrjen e analizave të mjaftueshme dhe të detajuara mbi krimin e organizuar ekonomik, ato mundën të jepnin disa të dhëna bazë:

Në vitin 2004, policia depozitoi 1320 padi penale (1358 në vitin 2003) kundër 1572 personave (1811 në vitin 2003) për 1707 (1877 në vitin 2003) krime të regjistruara ekonomike (të organizuara ose jo). Humbja e përgjithshme në të ardhura e shkaktuar nga ky krim arrin deri në 17.2 milion Euro (16.5 milion Euro në vitin 2003). Falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe tregtia e jashtëligjshme, vijuar nga abuzimi me postet publike, mashtrimi, dhe shpyllëzimi i paligjshëm, dominuan fushën e krimit ekonomik në këto vitet e fundit. Asnjë nga këto raste nuk është cilësuar si e kryer nga ndonjë grup i krimit të organizuar.

Në vitin 2005, u depozituan gjithsej 1,872 vepra penale të krimit ekonomik (+10,37 përqind në krahasim me vitin 2004), u kryen 1,437 padi (+9,44 përqind në krahasim me vitin 2004) kundër 1,723 personave (+10,16 përqind në krahasim me vitin 2004). Humbja e përgjithshme në të ardhura e shkaktuar nga ky krim arrin deri në 30,5 milion Euro (+88,6 përqind në krahasim me vitin 2004). Sidoqoftë, për sa i përket krimit të organizuar, u kryen vetëm 6 padi penale kundër 36 personave për kryerjen e 54 veprave penale, kryesisht kontrabandë (15), mashtrim (15), abuzim në poste publike (10), pastrim parash (7) dhe falsifikim parash (3).

Kompanitë dhe personat e përfshirë në biznese dhe funksione shtetërore të mëdha, kryesisht kanë kryer krime ekonomike. Nuk mund të vendoset një ndarje e qartë kur konsiderohet përbërja etnike, shtresa shoqërore apo edukimi i anëtarëve të grupeve të krimit të organizuar ekonomik, gjithsesi mund të pohohet se krimet e sofistikuara kërkojnë një edukim të mirë, madje dhe të një niveli universitar. Në vend të përdorimit të dhunës apo shantazheve, përdoret korrupsioni dhe metoda të tjera më të lehta.

Kontrabanda e mallrave të akcizës përmes kufijve vazhdon të mbetet problem, megjithëse kontrabanda e cigareve që dikur ndodhte rëndomtë tani është reduktuar. Në anën tjetër, kontrabanda e naftës dhe produkteve të saj shkaktoi një humbje në të ardhura prej 9 milion Euro në vitin 2003. Gjithashtu po vihet re dhe një transportim i jashtëligjshëm i shumave të mëdha të hollash. Përveç një porti detar, disa zonave kufitare dhe bregdetit, shumica e aktivitetit ekonomik ndodh ose kalon nëpërmjet kryeqytetit ku jeton më shumë se një e treta e popullsisë së Malit të Zi, gjë që mundëson përqëndrimin e hetimeve financiare në një zonë. Përlllogaritjet e vlerës së kësaj ekonomie të zezë nuk janë kryer, sidoqoftë, është i dukshëm efekti negativ i saj, duke marrë parasysh përmasat relativisht të vogla të tregut të brendshëm Malazez. Kjo gjë vihet re dhe në faktin që tregtarët e mallrave kontrabandë mbajnë çmime konkurruese duke shmangur rreth 200% të vlerës së mallit nga taksat dhe kontributet. Kontrabandistët e mallrave të ligjshëm nuk veprojnë sipas ndonjë strukture hierarkike, por duke formuar aleanca sipas rasteve të veçanta, si brenda Malit të Zi ashtu dhe jashtë kufijve të tij me grupe nga vendet fqinjë. Kontrabanda e mallrave të ligjshëm (cigareve, naftës dhe produkteve të saj) ka rënë dukshëm që nga heqja e sanksioneve rritja e përpjekjeve të autoriteteve të zbatimit të ligjit që nga viti 2000. Praktikrat e kontrabandës kanë ndryshuar për t'ju përshtatur kushteve të reja dhe akoma vazhdojnë ti rezistojnë përpjekjeve të autoriteteve të zbatimit të ligjit, ndërkohë që integrohen në rrymat Evropiane dhe globale të kontrabandës dhe shpërndarjes së cigareve të prodhuara në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme²³⁸. Kanalet e kontrabandës nëpërmjet Malit të Zi, kryesisht janë zbuluar, por janë formuar rrugë të reja që kalojnë përmes Bullgarisë, Kroacisë, Kosovës, Rumanisë dhe "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë".

Për sa i përket *krimit elektronik*, u krijua një kuadër ligjor i cili mund të ndihmojë në luftimin e këtij lloji krimi (kapitulli 28 i Kodit Penal). Në këtë kuadër përfshihet një gamë e gjerë veprash penale kundër sigurisë së të dhënave kompjuterike. Megjithatë, Mali i Zi raportoi se ky lloj krimi i organizuar nuk është shumë i pranishëm në vend. Në vitin 2005, u kryen vetëm 2 padi penale, kundër 7 personave që kishin kryer 7 vepra penale, ku të ardhurat kriminale kapnin shifrën e rreth 27,000 Euro. Për këtë arsye, Mali i Zi raportoi se nuk kishte informacion të mjaftueshëm për të siguruar një analizë të saktë mbi karakteristikat, qarkullimin, ndikimin e këtij lloji krimi në ekonomi, shoqëri, shtetin ligjor, etj.

²³⁷ Siç sugjerohet nga Rekomandimi i Këshillit të Evropës R (81)12.

²³⁸ Shiko gjithashtu profilin e zonës së projektit të Serbisë.

KORRUPSIONI

Nene të ndryshme të Kodit Penal të Malit të Zi trajtojnë fenomenin shqetësues të korrupsionit, i cili duket sikur sjell një sfidë të veçantë përpara veprimeve të suksesshme, - duke përfshirë proceset hetuese dhe gjyqësore, - kundër krimit të organizuar.

Në vitin 2005, forma klasike e korrupsionit (dhënia dhe marrja e një ryshfeti) u regjistrua vetëm në 6 raste. Gjithsesi, asnjë nga këto vepra penale nuk ishte kryer dhe lidhur me krimin e organizuar apo me në ndonjë rrugë të organizuar. Kjo është gjithashtu e vërtetë për krimet e regjistruara që lidhen me korrupsionin, si abuzimi me postin publik (167 raste), abuzim i autoritetit në ekonomi (25 raste), ose punë e pandershme në detyrë (9 raste).

Korrupsioni përshkruhet si një lloj “krimi plotësues”, për të cilin nuk ekzistojnë grupe të veçanta të krimit të organizuar dhe i cili është pak a shumë shërben si një mjet për kryerjen e krimeve të tjera.

Duke u bazuar në këto të dhëna të vogla dhe të thjeshta, nuk mund të sigurohet një analizë e plotë mbi karakteristikat, rezultatet, sektorët e prekur në veçanti, ndikimin në shoqëri, ekonomi, shtetin e së drejtës, demokraci, etj. Në çdo rast, korrupsioni konsiderohet si më i rrezikshëm në proceset e privatizimit, planifikimit urban, inxhinierisë civile dhe prokurimit publik.

PASTRIMI I PARAVE

Megjithëse koncepti i pastrimit të parasë është futur në kuadrin ligjor dhe institucional të Malit të Zi (Neni 268 i Kodit Penal) vetëm në këto vitet e fundit, është deklaruar se ky lloj krimi është plotësues ndaj krimeve të tjera, kryesisht atyre të kryera kuadër të krimit të organizuar (trafikimit të drogës), ose në rastet e abuzimit me postet publike. Për më tepër Mali i Zi raportoi se financim i terrorizmit përben një vepër të veçantë penale të parashikuar në Kodin Penal.

Në vitin 2005, ka vetëm 2 padi penale kundër 7 personave që kanë kryer 7 vepra penale të lidhura me krimin e organizuar. Një çështje tjetër e vetme, në të cilën paratë e pastruara arrinin shifrën e 287,000 Euro, nuk ishte kryer në një mënyrë të organizuar.

Mali i Zi, në këto kushte, nuk paraqet tregues të qartë, të cilët do të mund të lejonin analizimin e nivelit të ndikimit të pastrimit të parave në shoqëri, ekonomi, etj., megjithëse është e qartë se një ndikim i tillë i dëmshëm ekziston dhe mund të supozohet se ushtrimi i korrupsionit mund të shërbejë si një instrument për aktivitetet e pastrimit të parave.

4.5. SERBIA

Lufta dhe sanksionet gjatë viteve 1990, ndikuan thellësisht karakterin politik, ekonomik dhe social të Serbisë dhe ofruan mundësi të posaçme përfitimi për krimin e organizuar, jo vetëm në Serbi por në të gjithë rajonin. Rënia e regjimit të Milosheviçit në vitin 2000, solli në jetën politike një qeveri të re, të gatshme për te përballuar disa prej sfidave të tranzicionit dhe të periudhës së pas luftës, duke përfshirë dhe goditjen e krimit të organizuar. Mbas vrasjes së Kryeministrit, Zoran Djindjic, në vitin 2003, dhe operacioneve të zbatimit e ligjit “*Sabre*” në vijim, të cilat i dhanë fund Klanit të Zemunit, Serbia u fut në rrugën e përpjekjeve serioze kundër krimit të organizuar.

Megjithëse e suksesshme, shpërbërja e Klanit të Zemunit është konsideruar si të ketë qenë “një vrimë në ujë”.²³⁹ Gjithsesi, e kundërta tregohet nga rezultatet e hetimeve të fundit²⁴⁰ dhe informacioni nga bisedimet e përgjuara telefonike gjatë përgatitjes së një tentative për atentat, nga një bandë e përbërë nga 5 ekzekutorë me pagesë/vrasës profesionistë me kombësi Serbe dhe Kroate, kundër Kryeministrit Dodik²⁴¹, për shkak të përfshirjes së tij në fillimin e politikave kundër krimit të organizuar, lajmërimin e hapjes së një Departamenti të veçantë për përmirësimin e luftës kundër krimit të organizuar, si dhe qëllimet e tij të shprehura shpesh në publik për ndalimin e “njëmbëdhjetë kontraktorëve në procesin e privatizimit”.

Lidhja midis shërbimeve të sigurimit, krimit të organizuar, politikanëve, ekonomisë dhe ish grupeve (para -) ushtarake, e krijuar nga regjimi i Milosheviçit dhe e zhvilluar gjatë luftës në vitet 1990, është adresuar deri në një farë shkalle. Kanë filluar reforma për ndarjen e agjencive informative të policisë dhe të sigurimit dhe për prezantimin e mbikëqyrjes civile dhe transparencës mbi sektorin e sigurimit. Përfundimi i tyre me sukses dhe qëndrueshmëria e tyre, së bashku me zgjidhjen e problemeve të ndryshme që lidhen me arrestimin dhe ekstradimin në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Luftë në Ish- Jugosllavi (ICTY), në Hagë²⁴², të ish Gjeneralit të Serbëve të Bosnjës Ratko Mladic dhe të akuzuarve të tjerë për krime luftë, do të jenë pika kyçe për zhdukjen e kërcënimit nga krimi i organizuar dhe për rifillimin e bisedimeve paraprake me BE-në për një Marrëveshje Stabilizim Asociimi²⁴³. Këto bisedime u ndërpre në Maj të vitit 2006, pasi Serbia dështoi të dorëzonte të arratisurin për krime luftë, Ratko Mladic, brenda afatit të vënë në datë 30 Prill 2006.

Përveç kësaj, Beogradi dhe Podgorica, duhet të përfshihen në bisedime konstruktive dhe të përshpejtuara për sa i përket “divorcit të tyre të lehtë”, pas referendumit historik për pavarësi të Mali të Zi në Maj 2006.

Tani, të dyja anët duhet të respektojnë rregullat mbi të cilat kanë rënë dakord palë të ndryshme me mbështetje të BE-së, si dhe duhet të standardet e rëna dakord me BE-në mbi shpërbërjen e federatës së tyre të dobët. BE-ja së shpejti do të prezantojë një mandat të modifikuar negocimi për Serbinë, si shtetin pas ardhës të Serbisë dhe Malit të Zi.

Serbia adoptoi një Kod të ri Penal që hyri në fuqi në 1 Janar 2006, i cili përmban përkufizime ligjore të “krimit të organizuar”, “grupeve të krimit të organizuar” dhe “grupeve të tjera të krimit të organizuar”²⁴⁴ me dënim me burg nga katër e më shumë vjet. Për këtë arsye, nuk u siguruan të dhëna të qarta mbi krimin e organizuar dhe të dhënat ekzistuese janë të shpërndara në lloje të ndryshme krimi, ose ndryshojnë gjatë viteve të mëparshme²⁴⁵.

²³⁹ Intervistë e vitit 2005 me një oficer Serb të zbatimit të ligjit.

²⁴⁰ Të tilla si arrestimet e grupit të fuqishëm të krimit të organizuar Magdina në fillim të vitit 2006, pjesërisht të dënuar më parë burgim afatgjatë.

²⁴¹ Oslobodjenje, Dnevnis avaz dhe Slobodna Bosna, 15-19 Maj 2006, kontribuar nga një publikim i Qendrës Kompetente për Evropën Jug-Lindore në Universitetin e Graz-it (Austri).

²⁴² Mladic akuzohet për masakrën e 8,000 Boshnjakëve në Srebrenicë në 1995 si dhe për rrethimin e Sarajevës, e cila zgjati 43 muaj dhe gjatë së cilës u vranë 10,000 civilë.

²⁴³ “BE-ja është gati të rifillojë bisedimet në ditën kur do ndërtohet bashkëpunim i plotë”, Komisioneri i BE-së për Zgjerimin Ollie Rehn, në fjalën e tij të hapjes në takimin e Paktit të Stabilitetit në Evropën Jug-Lindore, Beograd, 23 Maj 2006.

²⁴⁴ Kodi mbi Ndryshimet dhe Shtesat e Kodit të Organizimit dhe Kompetencave të Organeve Shtetërore në Luftën kundër Krimit të Organizuar, 11 Prill 2003

²⁴⁵ Në 2004/2005 ka një llogaritje për 62 grupe me 420 anëtarë. Në: Raportin e Këshillit të Evropës 2005 për Situatën e Krimit të Organizuar, me fokus në kërcënimin nga krimi ekonomik, Përmbledhjet e Vendeve, Dhjetor 2005.

Duke pasur parasysh fuqinë e krimit të organizuar, - financiar apo të ndonjë lloji tjetër, - krimi i lidhur me trafikun e drogës, trafikimi i personave dhe krimi i organizuar ekonomik duket të jenë kërcënimet kryesore për Serbinë. Korrupsioni, mashtrimet në privatizime dhe pastrimi i parave po shkaktojnë një shqetësim të ngjashëm me atë të zonave të tjera të projektit. Pas vitit 2000, kontrabanda e mallrave të ligjshme (naftës dhe cigareve) u zvogëlua dhe mbledhja e të ardhurave publike u përmirësua. Sidoqoftë, pasojat sociale, ekonomike dhe politike të pasurimit të jashtëligjshëm dëmtojnë besimin publik ndaj strukturave qeverisëse, të zbatimit të ligjit dhe gjyqësore. Një numër rastesh të krimit të organizuar u dënuan, ndërkohë që numri i vrasjeve u zvogëlua dukshëm që nga ndryshimi i regjimit në vitin 2000.²⁴⁶ Megjithëse janë arritur rezultate pozitive, gjyqet në vazhdim ndaj të dyshuarve për vrasjen e Djindjic përbëjnë një test për besimin publik²⁴⁷.

DROGAT E PALIGJSHME

Në vijën e parë, Serbia është një "vend transit" klasik, - disa herë dhe një "vend i përkohshëm destinacion", - por po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një vend destinacion, veçanërisht për tregjet e marijuanës dhe drogave sintetike që kanë ardhur në rritje. Duke pasur parasysh pozicionin gjeografik, krimi i organizuar për trafikun e drogës është momentalisht një nga format më të rrezikshme të krimit të organizuar në Serbi dhe është i përqendruar në qytetet më të mëdha të vendit, si Beogradi, Novi Sadi, Nishi, Kragujevac, në të cilat autoritetet e zbatimit të ligjit mund të bënin dhe sekuestrimet më të mëdha.

Autoritetet e zbatimit të ligjit në Serbi kanë marrë pjesë me sukses në një sërë operacionesh policore ndërkombëtare, veçanërisht në shpërndarje të kontrolluar dhe në aktivitete të përbashkëta, - për sa i përket lëndëve psikotrope dhe prekursorëve. Serbia po bashkëpunon ngushtë me Qendrën SECI dhe ka miratuar një Strategji Kombëtare për Luftën kundër Varësisë nga Droga dhe ka ngritur një Komision Kombëtar për Drogën me qëllim koordinimin e të gjithë aktiviteteve kombëtare, kontrollimin e zbatimit të duhur të të gjithë Konventave që ka nënshkruar Serbia dhe të sigurojë bashkëpunim ndërkombëtar. U bënë ndryshime në "Kodin e drogës" dhe miratua një "Kod për Prekursorët" i ri.

Nuk ka dyshim se territori i Serbisë është pjesë e "Rrugëve Ballkanike", tashmë mjaft të dëgjura. Heroina vjen nga Afganistani nëpërmjet Shqipërisë/Malit të Zi, Bullgarisë (Pika e kalimit të kufirit të *Gradinës*), Kosova dhe Metohija, ose nga Kosova dhe Mali i Zi në Serbi dhe që atje më pas në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe BE (pika e kalimit të kufirit *Gjeneral Jankovic*). Drogat sintetike (ekstazia) më shpesh vijnë nga vende të BE-së dhe hyjnë në Serbi përmes Hungarisë dhe Kroacisë. Kanabisi vjen nga Mali i Zi dhe Shqipëria, ndërkohë që rrugë trafikimi të zbuluara së fundmi tregojnë kalimin e kësaj droge nga Serbia për në Hungari. Nuk ka të dhëna të raportuara për vitin 2004 dhe 2005.

Drogat sintetike (ekstazia dhe amfetaminat), të cilat janë mjaft të njohura te rinia janë të shpërndara gjerësisht në tregun kombëtar, - gjithashtu me çmime të përshtatshme për të gjitha kategoritë sociale, - vijnë kryesisht nga Holanda. Gjithsesi, janë zbuluar disa laboratorë të prodhimit të ekstazisë në vend, të cilat rezultuan në arrestimin e organizatorëve kryesorë dhe të pronarëve të kompanive që shërbenin si mbulojë. U konfiskuan afërsisht 2 milion pilula ekstazie si dhe 20 ton kimikate të nevojshme për prodhimin e drogës, me një vlerë disa milion euro. Ashtu si dhe në Bosnje Hercegovinë policia Serbe zbuloi një tregti në prekursorë kimike të nevojshëm për prodhimin e drogës, të futur kontrabandë nga Franca, Republika Ceke dhe Rumania, të cilët më pas transportoheshin kontrabandë për në Bullgari dhe Turqi.

²⁴⁶ Sipas një oficeri të lartë të zbatimit të ligjit, numri i vrasjeve ra nga 200 në 60 në vit që nga rënia e regjimit të Milosheviçit. Intervistë, Qershor 2005.

²⁴⁷ CNN 22.12.2003: Gjithsej 36 gangsterë dhe anëtarë të një njësie elitare policie u përballën me akuza për krijimin e një "sipërmarrjeje kriminale" që tentoi të rrezonte qeverinë e Djindjic, bazuar në padi. Njëzet e një persona u arrestuan dhe do të paraqiteshin në gjykatë. Djindjic, udhëheqësi i parë demokrat i Serbisë në 50 vjet, u qëllua për vdekje jashtë Kryeministrisë më 12 Mars 2003. Të pandehurit që u paraqitën në gjyq përfshijnë dhe Zv. Komandantin Zvezdan Jovanovic, 38 vjeç, i njësisë parashtarake të Beretave të Kuqe, i cili akuzohet të ketë gjuajtur plumbin që vrau kryeministrin. I akuzuari si ideator i vrasjes, ish komandanti i Beretave të Kuqe Milorad "Legija" Lukovic dhe 14 të tjerë të dyshuar si konspirues apo si pjesëmarrës në vrasje do të gjykojnë në mungesë.

Produktet e *kanabisit* (hashashi dhe marijuana) janë drogat më të përhapura në Serbi dhe më problematike. Ndërkohë, që për vitin 2003 u zbulua dhe u asgjësua një sasi e vogël prodhimi prej 2000 rrënjëve marijuane në një minierë të braktisur, për vitin 2004 dhe 2005 nuk u raportua ndonjë prodhim kanabisi. Kanabisi në të shumtën e rasteve importohet dhe shitja me një çmim relativisht të ulët e bën atë mjaft të disponueshëm.

Heroina është droga e dytë më e përhapur në tregjet Serbe, duke pasur parasysh se kontrabanda dhe shitja e heroinës përbën biznesin më fitimprurës kriminal. Deri tani, nuk është zbuluar ndonjë prodhim heroine në Serbi. Shumica e heroinës vjen nga Kosova dhe policia Serbe bashkëpunon rregullisht me UNMIK-un dhe policinë e Kosovës për çështjet që lidhen me trafikimin e heroinës. Megjithatë, sipas autoriteteve Serbe shkëmbimi i informacionit lë vend për përmirësime.

Kokaina e trafikuar kryesisht shkon për tregun e brendshëm të konsumatorëve, por mund të thuhet se sasi më të mëdha kalojnë transit nga Serbia. Rrugët e trafikimit të kokainës duket të kenë ndryshuar kohët e fundit. Nëpërmjet anijeve nga Amerika Latine, kokaina, zakonisht e paketuar në shishe, arrin në portet e Greqisë, Malit të Zi, Kroacisë, Shqipërisë dhe Italisë dhe më pas transportohet për në Serbi e më tej për në BE nëpërmjet kamionëve. Policia Serbe në një operacion të përbashkët bashkëpunim me forca të tjera policore, kryesisht me autoritetet Italiane të zbatimit të ligjit, ndihmoi në kapjen e 200 kg kokaine (190 kg u kapën në Itali, ndërkohë që 10 kg u kapën në Serbi). Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e kokainës janë të mirë organizuara dhe kanë strategji të efektshme transporti.

Mbi gjashtëdhjetë përqind e grupeve të krimit të organizuar në Serbi shfaqet të jetë e përzier në trafikimin e drogës. Rreth 50% e këtyre grupeve, përveç trafikut të drogës, është e përzier dhe me krime të tjera të dhunshme si vrasje, shantazhe, rrëmbime dhe grabitje. Megjithatë numri i krimeve të tilla ka pësuar një rënie të dukshme që nga viti 2003. Në mënyrë të ngjashme me vrojtimet e UNMIK-ut, grupet më të organizuara dhe më të fuqishme të përfshira në trafikun e drogës në Serbi janë grupet Shqiptare, me anëtarë me origjinë nga Kosova ose Serbia jugore.

Vihet re gjithashtu, se organizatat kriminale Bullgare dhe Shqiptare janë në konkurrencë me njëra tjetrën për kryesim të tregut të drogës në Serbi. Në ngjashmëri me Shqipërinë, grupet e krimit të organizuar po punojnë që të konsolidojnë influencën e tyre, ndërkohë që shpërndajnë aktivitetet e tyre në tregje të tjera të jashtëligjshme apo dhe në sektorë të ligjshëm. Për sa i përket trafikantëve vendas, operacioni "Saber" shkatërroi disa grupe të krimit të organizuar dhe neutralizoi një prej rrjeteve më të mëdha të trafikimit dhe shitjes së heroinës në Serbi dhe në vendet e tjera të Evropës.

Grupi më i madh, Klani i Zemunit²⁴⁸, kishte gjashtë nën-grupe që mbulonin shitjet me rrjetet e tyre të shpërndarjes. Klani kishte një famë të keqe për përdorimin e dhunës në disiplinimin e anëtareve dhe të personave që i pengonin në punën e tyre. Menjëherë mbas shkatërrimit të këtij klani²⁴⁹ u zbardhën një numër i madh vrasjesh dhe tentativash për vrasje. Kryetarët e klanit i kishin investuar të ardhurat e tyre të krimit në prona të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe në mallra luksoze. Për të siguruar biznesin e tyre, duke përdorur fuqinë e tyre të jashtëzakonshme financiare të përllogaritur në qindra milionë Euro, klani korruptonte zyrtarë nga radhët e policisë dhe të gjyqësorit, dhe kishte krijuar një organ të medias për të influencuar opinionin publik. Te ardhurat e jashtëligjshme duken të jenë investuar në privatizime, pasuri të paluajtshme, biznese tregtare, etj.

Tabela 10: Përmbledhje tabelore e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (Serbia)

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Heroinë (kg)			262 995.0	469 604.0	342 010.0	
Hashash (kg)			648.1	3 350.1	8 020.0	
Marijuana (kg)			774 284.1	3 901,870.1	1 142,005.0	
Kokainë (kg)			5 336.1	15 468.0	5 321.0	
Amfetaminë (kg)*			113.1	6.1	1.1	

²⁴⁸ Zemuni është një lagje e Beogradit.

²⁴⁹ Menjëherë mbas vrasjes së Kryeministrit të fundit Djindjic (Mars 2003), u identifikuan 123 grupe me 844 anëtarë. Operacioni i policisë "Sabre" që vijoi ndihmoi që të ndërpriteshin lidhjet e rrjeteve kriminale në Serbi me ato në Kosovë dhe Metohi, duke ndryshuar kështu strukturën e krimit të organizuar në Serbi.

Ekstazi		76 194	9 260	7 539	
LSD (doza)		167	102	1 013	
Kanabis (bimë)		2,000			
Popi (bimë)					
Neni. 245 KP (çështje)		2 276	3 879	4 968	

TARFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Për sa i përket trafikimi të qenieve njerëzore, Serbia ka bërë progres të dukshëm në përafrimin e legjislacionit të saj kombëtar me standardet ndërkombëtare. Duke filluar nga 1 Janari 2006, Kodi i ri Penal ka përkufizime ligjore për trafikimin e qenieve njerëzore (Neni 388 KP), në përputhje me Konventat ndërkombëtare dhe me dënime me burgim nga 2 deri në 12 vjet; në raste të rënda (të tilla si trafikimi i minoreneve, trafikim që rezulton në dëmtime të rënda fizike, trafikime nga një grup i organizuar) dënimi minimal i burgimit shkon në 3 ose 5 vjet; në qoftë se shkaktohet vdekja e ndonjë personi dënimi fillon që nga 10 vjet. Një dispozitë e veçantë u krijua për "Trafikimin e fëmijëve për birësim" (Neni 389 i KP) dhe për "Mbajtjen në skllavëri dhe transportimin e personave të skllavëruar" (Neni 390 i KP)²⁵⁰.

Për shkak të pozicionit gjeografik të Serbisë, faktorëve të saj ekonomik, sidomos varfërisë dhe papunësisë, grupeve sociale të veçuar (Roma), etj., Serbia duket të shërbejë kryesisht si një vend transit dhe me destinacion të përkohshëm për qytetarët e Rumanisë, Bullgarisë, Ukrainës dhe Moldovës. Për sa i përket trafikimit të fëmijëve, kryesisht romëve, Serbia është një vend origjine. Për sa i përket trafikimit të meshkujve për shfrytëzim krahu pune, Serbia është kryesisht një vend transit, por po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një vend origjine.

Trafikimi njerëzor, kryesisht për shfrytëzim seksual, lypje në rrugë dhe krahu pune, në shumicën e rasteve është një krim i organizuar. Kriminelët kanë ndërtuar rrjete ndërkombëtare, por ka gjithashtu grupe më të vogla të cilat nuk futen brenda përkufizimit ligjor të "krimit të organizuar" të përcaktuar në Kodin Penal Serb. Sipas autoriteteve Serbe, në vitin 2004, rreth 10 grupe kriminale me rreth 100 anëtarë ishin të përfshira në trafikun e qenieve njerëzore. Fatkeqësisht, të dhëna të ngjashme apo të krahasueshme me këto nuk u raportuan për vitin 2005. Grupet janë kryesisht aktive në zonat kufitare, janë të mirë organizuara dhe të lidhura ngushtë me grupe kriminale në vende të tjera fqinje si për shembull Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Hungari, Itali, "ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Rumani, Slloveni, Turqi dhe Ukrainë.

Grupet janë mjaft përshtatshme sipas kushteve dhe formojnë lehtësisht aleanca bazuar në interesa të përbashkëta. Ata përdorin kode komunikimi dhe takohen nëpër vende ku sistemohen viktimat e trafikimit. Si një praktikë mbrojtëse ata përdorin të ashtuquajturat "pastruese" - makina që udhëtojnë përpara "mjetit transportues" me qëllim paralajmërimin për rreziqe të mundshme që mund të hasen në rrugë e sipër. Kryetarët e këtyre grupeve nuk përfshihen asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto operacione, por janë të përgjegjshëm për kryerjen e pagesës mbas përfundimit të transportit. Të hollat zakonisht transferohen nëpërmjet një banke të "Western Union". Të ardhurat investohen në biznese tregtare si dhe në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Numri i viktimave të trafikimit që kanë Serbinë si destinacion duket se ka pasur rënie këto vitet e fundit²⁵¹, kryesisht për shkak të regjimeve të reja të vizave për qytetarët e Rumanisë dhe Moldovës. Për 6 vitet e fundit Ministria e Brendshme e Serbisë raportoi 314 çështje të kryera nga 286 persona. Tendanca e re duket të jetë rekrutimi vendas (nëpërmjet Internetit) dhe trafikimi i brendshëm, ku qytetarë Serbë fillimisht shfrytëzohen brenda vendit dhe më pas trafikohen në vende të tjera.

Që nga koha e ndërtimit të qendrave pritëse për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Janar 2002 deri tani, rreth 190 viktima (151 prej të cilëve ishin qytetarë të huaj) u përkujdesën nga anëtarë të "Shërbimit për Koordinimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore". Në vitin 2005, të dhënat treguan gjithsej për 44 viktima, duke përfshirë 21 qytetarë të huaj nga Moldova (8), Ukraina (6), Rumania (3) Kroacia, Rusia dhe Kongo (secila 1).

²⁵⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 85/2005, 88/2005 dhe 107/2005

²⁵¹ Sipas autoriteteve Serbe, 2.000 qytetarë të huaja femra u gjetën duke 'punuar' në restorante dhe hotele në vitin 2000. Në vitin 2003, ky numër u zvogëluar në 203.

Përpjekjet e kohëve të fundit nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, vunë në shënjestër trafikimin e fëmijëve duke ndërmarrë masa kundër prindërve që shisin fëmijët e tyre dhe kundër personave që i blinin këta fëmijë. Në dy raste u kryen padi penale për trafikim qeniesh njerëzore duke përdorur martesë të detyruara, - në të dyja rastet viktimat ishin vajzat, të shitura nga prindërit e tyre për 300 Euro në një rast dhe për një pronë në rastin tjetër. Në vitin 2005, u shënuan 9 viktima të këtij trafiku, 4 prej të cilave ishin minorene (7 nga Mali i Zi, 1 nga Bullgaria dhe 1 nga Rumania).

Një çështje e vetme me 20 padi, përfundoi pa një gjykim përfundimtar për 4 autorë dhe zgjati nga 3 deri në 8 vjet, duke lënë shumë pak për të thënë rreth skemave të krimit të organizuar. Megjithatë, në këtë rast u zbulua se grupi, që përbëhej nga 3 Serbë, një Ukrainas dhe një Boshnjak, i cili ishte organizatori i grupit, kishte rekrutuar dy viktima femra Ukrainase për ti transportuar për në Itali dhe për ti shfrytëzuar si prostituta.

TRAFIKU KLANDESTIN I PERSONAVE

Serbia e ka përshtatur Kodin e saj Penal me standardet Evropiane²⁵². “Kalimi i jashtëligjshëm i kufirit shtetëror dhe trafiku i qenieve njerëzore” parashikohet në Nenin 350 të KP më dënime që ndryshojnë në varësi të llojit të transportit klandestin të personave.

Transporti klandestin i personave është një aktivitet kriminal në zgjerim, kryesisht sepse shërben si një zëvendësues për trafikimin e drogës, duke ofruar të ardhura të kënaqshme me rreziqe më të ulëta. Në vitin 2005, 1,076 qytetarë të huaj hynë në mënyrë të jashtëligjshme në territorin e Serbisë, kjo krahasuar me vitin 2004 (1,053 qytetarë të huaj) përbën një rritje prej 2 përqind. Gjithsesi, duke parë gjininë e personave të trafikuar, duhet të theksohet se të dhënat për gratë e trafikuar u rritën në mënyrë më të ndjeshme, (në vitin 2004: 58 gra, në vitin 2005: 115 gra) gjë që përbën një rritje prej pothuajse 100 përqind. U interpretua se një përqindje e madhe e këtyre viktimave mund të ishin viktima të trafikimit të qenieve njerëzore për qëllim shfrytëzimin seksual. Vihet re gjithashtu një rritje në trafikimin e minoreneve (2004: 85 qytetarë të huaj, 2005: 135 qytetare të huaj), gjë e cila përbën një rritje alarmante prej rreth 60 përqind.

Transporti klandestin i migrantëve zakonisht organizohet nga persona nga vendi i origjinës, së bashku me kontrabandistë nga rajoni dhe pagesa që kërkohet është nga 2.500 deri në 8.000 euro. Tendencat e fundit të trafikimit tregojnë për transportime grupesh të vogla prej 4 - 8 persona, madje dhe 1 - 2 persona në një rrugë, duke përdorur makina pasagjerësh, furgona dhe kamionë me strehëza të posaçme për fshehjen e klandestineve. Emigrantët klandestinë transportohen me makinë deri në kufi dhe më pas merren në dorëzim nga një gaitë që i shoqëron përtej kufirit në këmbë. Mbas kalimit të kufirit, përdoret një makinë tjetër për transportimin e emigrantëve deri në kufijtë e tjerë me Hungarinë ose Kroacinë, dhe prej andej më pas për në vendet e destinacionit në BE.

Sipas të dhënave nga viti 2003, u ndërpreu 22 kanale nëpërmjet të cilave ishin transportuar në mënyrë klandestine 247 persona.

Në vitin 2004, u raportua se qytetarët Rumunë, kryesisht ata ekonomik, janë emigrantët më të zakonshëm në Serbi, duke u vijuar nga migrantë nga Afganistani, Iraku dhe Turqia (kryesisht Kurdë). Zbulimet e fundit të rrjeteve të kontrabandës përmes aeroporteve të Sarajevës dhe Prishtinës, i zhvendosën rrugët e trafikimit në Bullgari dhe Rumani, përmes të cilave qytetarë Turq transportohen për në Serbi e më pas drejt Perëndimit.

Megjithatë, në vitin 2005 u kryen 37 padi penale kundër 87 personave (73 Serbë, 5 Kinezë, 4 Boshnjakë, 3 Maqedonas, 1 Holandez, dhe 1 Indian) për kryerjen e 37 veprave penale të transportimit klandestin të 219 migrantëve, kryesisht nga Shqipëria (92), Kina (56), Turqia (29), Mali i Zi, Serbia me Kosovën/Metohinë (21), India (8), Bangladeshi (4), Sri Lanka (4), Ukraina (2) dhe Rumania (1).

Përpjekjet për të luftuar transportin klandestin të personave, përfshijnë një menaxhim më të mirë të kufirit, rregullime në regjimin e vizave dhe masa të përmirësuara dhe koordinuara shtypëse kundër grupeve kriminale të

²⁵² Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, Nr. 85/2005, 88/2005 dhe 107/2005.

përfshira në transportin klandestin, kontroll të ambienteve që dyshohen si strehëza emigrantësh dhe një sistem raportimi të qëndrueshëm me një analize krimi të plotë dhe cilësore.

KRIMI EKONOMIK DHE ELEKTRONIK (CYBERCRIME)

Një anketë e kohëve të fundit mbi *krimin e organizuar ekonomik* në Evropë²⁵³ tregoi se në Serbi krimi i organizuar ekonomik përbën tregun kryesor të aktiviteteve të krimit të organizuar (38 çështje të krimit të organizuar ekonomik nga 92 të hetuara në vitin 2003), duke u ndjekur më pas nga kontrabanda, trafikimi i qenieve njerëzore (27 çështje) dhe trafikimi i drogës (15 çështje). Krimet financiare që përfshijnë pastrimin e parasë dhe korrupsionin konsiderohen veçanërisht të dëmshme. Si në vende të tjera të Evropës Jug- Lindore, mashtrimet tatimore dhe doganore, krijimi i kompanive të rreme dhe shpallja e falimentimeve të rreme përbëjnë format më të përhapura të krimit ekonomik. Megjithatë nuk u raportua ndonjë e dhënë mbi krimin ekonomik për vitin 2004 dhe 2005, përveç disa informacioneve mbi krimin elektronik, kontrabandën dhe piraterinë e produkteve.

Kontrabanda e mallrave të ligjshëm (cigareve, naftës dhe produkteve të saj) ka rënë dukshëm që mbas heqjes së sanksioneve dhe si rrjedhojë e përpjekjeve midis të tjerash nga ana e organeve të zbatimit të ligjit që nga viti 2000. Praktikant e kontrabandës kanë ndryshuar duke ju përshtatur kushteve të reja. Sidoqoftë ato akoma vazhdojnë që ti rezistojnë përpjekjeve të zbatimit të ligjit duke u integruar në rrjedhat e kontrabandës Evropiane dhe globale të shpërndarjes së cigareve të prodhuara në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme. Cigaret e kontrabanduar fshihen në mjetet e transportit të mallrave dhe pasagjerëve, ose paketohen si produkte të tjera (fruta të ngrira ose miell për ndihma humanitare)

Si në vendet e tjera të rajonit, tregtia e cigareve dhe e mallrave të tjera të akcizës bëhet nëpërmjet kompanive të rreme dhe dokumenteve të falsifikuar. Për sa i përket prodhimit kontrabandë, është vënë re një tregti në pije alkoolike të prodhuar me lëndë bazë të importuar nga kompani të rreme dhe së fundmi një tregti produktesh të cilave u kishte kaluar afati i skadencës.

Pirateria lulëzoi në vitet 1990. Në fillim të vitit 2003, u ndërmorën një numër masash²⁵⁴ për shtypjen e piraterisë të cilat rezultuan në konfiskimin e mbi 60.000 video kasetash dhe CD-ve, sasive të mëdha të pajisjeve audio vizuale të përdorura për regjistrimin e zërit dhe imazheve, si dhe software kompjuterësh.

PASTRIMI I PARAVE

Për sa i përket *pastrimit të parave*, shumica e të ardhurave që pastrohen buron nga evazioni fiskal, më pas nga trafiku i drogës dhe qenieve njerëzore dhe së fundi nga krime të dhunshme si grabitje dhe rrëmbime. Gjithsesi, pavarësisht veprave penale të presupozuara, mendohet se personat që merren me pastrim parash janë zakonisht anëtarë të grupeve të krimit të organizuar me eksperiencë në biznes dhe ekonomi. Të ardhurat kryesisht investohen në nivel ndërkombëtar në privatizime, në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ose transferohen në llogari bankare si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Transferta të mëdha parash kryhen nëpërmjet Hungarisë, Qipros dhe Austrisë si dhe nëpërmjet llogarive të hapura. Autorët e këtij lloji krimi janë zakonisht persona me eksperiencë në biznes dhe ekonomi.

Kodi i ri Penal i Serbisë parashikon në Nenin 231 KP një përkufizim ligjor për pastrimin e parave dhe i dënon shkelësit me një burgim maksimal deri në 10 vjet, si dhe me sekuestrim të të ardhurave të krimit. Gjithashtu, në të parashikohet dhe "financimi i terrorizmit" (neni 393 KP), lidhjet me terrorizmin (Neni 312), terrorizmi ndërkombëtar (Neni 391 KP) dhe marrja e pengjeve (Neni 392 KP). Për më tepër, një "Sektor për Pastrimin e Parave" u formua brenda Shërbimit për Luftimin e Krimit të Organizuar. Gjithashtu, një ligj i veçantë për Parandalimin e Terrorizmit është pothuajse gati për tu miratuar.

²⁵³ Këshilli i Evropës, "Raporti i vitit 2005 i Situatës së Krimit të Organizuar me përqendrim të veçantë në krimin ekonomik", Dhjetor 2005.

²⁵⁴ Ngritja e një Komiteti për Shtypjen e Piraterisë, i cili miratoi rregullore të ndryshme dhe filloi zbatimin e masave kundër keqpërdorimit të së drejtës së pronësisë intelektuale.

Serbia raportoi vetëm një padi kundër tre arkivistëve që kishin asistuar një grup të krimit të organizuar. Gjithsej ky seksion u përfshi në pesë hetime, duke përfshirë dhe një rast ku vepra penale e presupozuar ishte rrëmbimi.

KORRUPSIONI

Kodi i ri Penal që hyri në fuqi më 1 Janar 2006, është në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare në lidhje me aktivitetet korruptive. Në tre vitet e fundit dhe pavarësisht rregulloreve të reja mbi “Ndërmjetësimin e Jashtëligjshëm” (Neni 366 KP), “Kërkimin dhe Marrjen e Ryshfeteve” (Neni 367 KP) dhe ‘Ryshfetin’ (Neni 368 KP), lufta kundër korrupsionit nuk ka arritur rezultatet e dëshiruara. Korrupsioni vazhdon të ketë akoma rrënjë të thella, të jetë gjerësisht i përhapur dhe me një manifestim të dëmshëm, një fenomen i cili pak a shumë mbetet vetëm pjesë e ligjëratave dhe aktiviteteve ligjore. Për vitin 2003, Serbia raportoi vetëm 18 raste korrupsioni të lidhura me krimin e organizuar, të kryera nga 4 grupe të krimit të organizuar të përbërë nga 81 persona. Megjithëse Serbia nuk mund të siguronte apo të raportonte numrin e rasteve të korrupsionit për vitin 2005, mendohet që ky numër të jetë mjaft i madh.

4.6. KOSOVA

Provinca e Kosovës, e fundit që u prek nga luftërat në ish Jugosllavi në vitet 1990, ashtu si dhe Bosnje Hercegovina, përballet me sfidat e rindërtimit të mbas luftës dhe tranzicionit nën administrimin e UNMIK-ut. Në prag të fazës më kritike të bisedimeve, të ndërmjetësuar nga OKB-ja, mbi statusin e ardhshëm të provincës, janë të pashmangshme çështjet në lidhje me situatën aktuale rreth ngritjes së institucioneve në fushën e sigurisë dhe lirisë, adoptimin e kërkesave ligjore dhe konvencionale, të cilat përputhen me standardet Evropiane dhe/ose ndërkombëtare, si dhe zbatimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme duke përfshirë trajnimin e stafit të autoriteteve të zbatimit të ligjit. Një interes të veçantë duhet të ketë mbi situatën rreth luftës kundër krimit të organizuar, sidomos rreth luftës kundër kriminelëve të organizuar me etni Shqiptare.

Nga njëra anë, Kosova ka qenë dhe po përballet me shpërngulje, shkatërrim të pronës, teknologji të prapambetur, vonesa në procesin e privatizimit i cili është përfshirë nga ndikimi politik dhe kriminal, një nivel të përgjithshëm destabiliteti, kapitullim të sektorit të prodhimit industrial, papunësi të madhe²⁵⁵ dhe mundësi të zvogëluara për pjesën më të madhe të popullsisë së re.²⁵⁶ Që nga përfundimi i konfliktit të Kosovës në vitin 1999, rreth 200,000 Serb u larguan që andej. Aktualisht, rreth 100,000 Serbë vazhdojnë të jetojnë në provincë. Që prej shumë pak kohe²⁵⁷, Serbët në pjesën veriore të Kosovës kanë deklaruar gjendjen e jashtëzakonshme dhe kanë kërcënuar për braktisjen e marrëdhënieve me UNMIK-un për shkak të mbrojtjes së pamjaftueshme ndaj sulmeve të dhunshme.

Në anën tjetër, Kosova ka një shërbim policor, i cili, krahasuar me policitë e tjera të rajonit, është i pajisur siç duhet dhe i trajnuar mirë, veçanërisht kur bëhet fjalë për njësitë që luftojnë krimin e organizuar. Gjithsesi, ky shërbim mbetet me mungesa në staf dhe në eksperiencë kur bëhet fjalë për përdorimin e politikave dhe procedurave të reja (është akoma një shërbim policor mjaft i ri). Në të kaluarën, ka patur një 'bashkëpunim' pjesërisht konkurrues dhe të pabesueshëm me Njësinë e Policisë Civile të UNMIK-ut (CIVPOL), të përbërë nga oficerë policie që vinin nga rreth 50 vende të ndryshme, pa një Ministri të Brendshme dhe strategji të plota me standarde Evropiane dhe ndërkombëtare²⁵⁸, me mungesë të sistemeve të qëndrueshme të raportimit, me baza të dhënash të paplota dhe të papërshtatshme, me struktura organizative të paqarta dhe të panjohura më parë, me mungesë të vazhdueshme të ligjeve për mbrojtjen e dëshmitarëve (të cilat janë të rëndësishme sidomos për hetimin e krimeve të luftës) dhe me shumë ankesa të tjera. Ndërkohë, Departamenti i Krimit të Organizuar ka kaluar pothuajse plotësisht në zotërim të vendasve dhe Shërbimi Policor i Kosovës, vazhdimisht, po merr gjithnjë e më shumë përgjegjësi, ndërsa ndërkombëtarët po tërhiqen drejt një pozicioni monitorues dhe këshillues.

Në përgjithësi ka një nivel të pakënaqshëm progresi në ndërtimin e asaj që quhet "nëna e të gjitha standardeve" dhe shtet kushtetues, - dhe akoma nuk ka një status përfundimtar për provincën²⁵⁹. Në një gradë më të lartë se sa në vendet e tjera fqinje të projektit, boshllëku politik dhe ekonomik ofroi mundësi për krimin e organizuar.

Në dispozitat e Kodit Penal të Kosovës (KPP), i cili hyri në fuqi nga fundi i Prillit 2004, ka një përkufizim ligjor për "grupet e krimit të organizuar". Gjithsesi, në Nenin 274 të KPP, disa klauzola ligjore pasqyrojnë nocionin e "krimit të organizuar", dënim me burgim minimal nga 5 vjet e sipër (krijuesit ose "menaxherët" e grupeve të krimit të organizuar rrezikojnë madje një burgim minimal nga 7 deri në 20 vjet) dhe ofrimin e përfitimeve për informatorët.

²⁵⁵ AGEF Prishtinë "Përmbledhje e Papunësisë", marrë nga www.agef-saar.de, 22 Mars 2005, e cila përlllogarit papunësinë në më shumë se 60 përqind.

²⁵⁶ Për situatën ekonomike në Kosovë, shiko *Ç'industrializimi dhe pasojat e tij: Një histori Kosovare*, Nisma Evropiane e Stabilitetit, Mars 2002, www.esiweb.org.

²⁵⁷ Reuter, 13 Qershor 2006 (<http://de.today.reuters.com/nees/nees>).

²⁵⁸ Në 9 Qershor 2006, Grupi Ndërkombëtar i Kontaktit (Franca, Gjermania, Italia, Federata Ruse, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja) i dorëzuan autoriteteve Kosovare një listë me 13 standarde minimale kushtetuese që akoma mungonin dhe të cilat shpesh zbatoheshin deri në fund të këtij viti. Mbrojtja e minoriteteve është një nga çështjet kyçe që duhet zhvilluar në të ardhmen.

²⁵⁹ Erhard Busek, Koordinator i BE-së për Ballkanin, në një intervistë me "Berliner Zeitung", 13. 06. 2006; Busek tha: "Unë po punoj mbi supozimin se Serbia do të, në një periudhë afat-mesme, humbë gjithashtu Kosovën".

UNMIKU-u gjithashtu adoptoi përkufizimin e OKB-së për krimin e organizuar²⁶⁰, nëpërmjet përkufizimeve të praktikës.

Gjithsesi, pavarësisht mjeteve të tilla ndihmëse, analiza dhe krahasimi ndërkombëtar është i vështirësuar. Nga viti 2003 deri në vitin 2004, 27 grupe të krimit të organizuar kryen 27 çështje të krimit të organizuar, të cilat lidheshin me trafikimin e drogës (15 raste dhe grupe me 150 persona), trafikimin e qenieve njerëzore (82 raste, asnjë grup, me 83 persona të arrestuar), krimin ekonomik (3 raste të diskutueshme dhe grupe me rreth 600 autorë) dhe dhëna të tjera të të gjitha llojeve të krimit. një përmbledhje të plotë të ngjashme nuk u siguroa për të dhënat e vitit 2005.

U shpreh se nuk ka akoma ndonjë institucion në Kosovë, i cili mund të sigurojë të dhëna siç kërkohen dhe në përgjithësi u tha se kërcënimi kryesor për Kosovën duket të jetë krimi i organizuar ndër-kombëtar i përfshirë në trafikun e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore, transportin klandestin të migrantëve, evazionin fiskal dhe korrupsion. Grupet e krimit të organizuar që ndodhen në Kosovë janë kryesisht të organizuara rreth lidhjeve familjare, klaneve apo lidhjeve me organizatat e mëparshme, të tilla si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Këto grupe janë mjaft të mbrojtura, siç edhe vihet re në analizat dokumenteve sekrete zyrtare²⁶¹.

TRAFIKIMI I DROGËS

Kosova ka një vendndodhje kyçe në rajon për shumë kriminelë në Evropën Jug - Lindore. Lidhjet e ngushta me popullsinë etnike Shqiptare në "ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë", në Shqipëri si dhe me diasporën Shqiptare jashtë vendit i bëjnë grupet e krimit të organizuar Kosovare mjaft efektive veçanërisht në trafikimin e drogës në tregjet Perëndimore.

Në Kosovë, lufta kundër trafikut të drogës është e organizuar në dy nivele të ndryshme:

- Drejtoria e Krimit të Organizuar, *Hetimi i Krimit të Organizuar Ndër - Kufitar*, e cila merret me hetimin afatgjatë në bashkëpunim me Zvicrën, Francën, Austrinë, Gjermaninë, Bullgarinë dhe Turqinë. Kjo strukturë është krijuar kryesisht për hetimin e çdo lloj krimi të organizuar
- Drejtoria e Krimit të Organizuar, Sektori i Hetimit të lëndëve Narkotike, i cili merret me çështjet e drogës brenda territorit të Kosovës.

Në vitin 2004 dhe 2005, u regjistruan gjithsej 265 çështje të lidhura me drogën, të kryera nga 458 persona, por që nuk i përkisnin krimit të organizuar. Nga viti 2003 deri në vitin 2005 u hetuan katër çështje ndërkombëtare afatgjata në lidhje me trafikimin e drogës. Midis Qershorit dhe Dhjetorit 2003 u sekuestruan gjithsej 90 kg heroinë, nga të cilat 38 kg u kapën në Kosovë, 24 kg në Itali dhe 28 kg në Bullgari (sasi të cilat besoheshin të kishin ardhur nga Kosova).

Ne vitin 2004 dhe 2005 u hetuan 20 çështje afat - gjata, ndërkohë që gjashtë prej tyre kërkonin një bashkëpunim ndërkombëtar. Bazuar në këto hetime, nga Janari deri në Dhjetor të vitit 2004, në Kosovë u konfiskuan 45.5 kg heroinë, ndërkohë që 504.5 kg u konfiskuan në Austri, Gjermani, Itali, Zvicër, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri (sasi e cila besohet të kishin ardhur nga Kosova), duke arritur një total heroine prej 550 kg të konfiskuar në këtë periudhë. Aktualisht, janë në vazhdim pesë hetime afat - gjata.

²⁶⁰ Konventa UNTOC, e cila mund të konsiderohet përpjekja më e rëndësishme deri tani që ka arritur në një konsensus global mbi konceptin e krimit të organizuar. Hyri në fuqi në Shtator 2003. Deri në vitin 2006 u nënshkrua dhe ratifikua gjithashtu nga të gjitha vendet e rajonit.

²⁶¹ Shërbimi Gjerman Federal i Inteligjencës, Analize mbi Krimitin e Organizuar në Kosovë, 22 Shkurt 2005; Raport i Njësisë Qendrore të Inteligjencës së OKB-së i datës 29.12.2003; Raport i KFOR-it mbi krimin e organizuar. Të gjitha të cituara në një raport në media nga J. Roth, në "Die Weltwoche", 43/2005.

Në vitin 2005, janë hetuar gjithsej 15 çështje të trafikut të drogës të lidhura me grupet e krimit të organizuar, duke përfshirë më shumë se 55 persona²⁶². Në sasi mesatare, trafikantët përdornin makina me targa Austriake, Gjermane, Serbe dhe Zvicëranë për të transportuar nga 7 deri në 32 kile heroinë të paketuara në çdo makinë, kryesisht nga Shqipëria drejt Kosovës, ose nga Kosova drejt Italisë dhe Austrisë.

Drogat Sintetike (kryesisht amfetaminat) janë të disponueshme dhe shpërndahen nga grupe të organizuara. Nuk ka informacion që të dëshmojë që kjo lloj droge paraqet problem të madh për Kosovën.

Produktet e Kanabisit (hashashi, marijuana) po bëhen gjithnjë e më shumë pjesë e tregut të drogës në Kosovë. Policia e Kosovës dhe UNMIK-u zbuluan dhe asgjësuan 12 fusha me kanabis në vitin 2004.

Heroina, siç raportohet dhe nga studimet e vrojtura dhe sipas informacionit të pakët të dhënë për sekuestrimet e drogës në Kosovë, është droga më e pranishme në tregjet e Kosovës. Sekuestrime të sasive të mëdha mund të kryhen brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet aksioneve ndërkombëtare të përbashkëta dhe të koordinuar²⁶³. Gjithsesi, duke u nisur nga përlllogaritjet e sasisë së madhe të heroinës që trafikohet përmes Shqipërisë dhe Kosovës, sekuestrimet mbeten akoma në një nivel të mesëm.

Kokaina është e disponueshme në tregun kombëtar dhe për të nuk ka informacion të mëtejshëm.

Mbi grupet dhe rrjetet kriminale që veprojnë në vend, ekziston vetëm informacion i turbullt. Raportohet se grupet kriminale Kosovare janë të dhunshme, përdorin metoda mbrojtëse, si kundër – zbulime, metoda të koduara, mjete të sofistikuara komunikimi, duke i vështirësuar në këtë mënyrë operacionet e Policisë. Për më tepër, çështjet e pastrimit të parave, zakonisht lidhen me ato të trafikut të drogës.

Tabela 11: Përmbledhje tabelore e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (Kosova)

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006*
Heroinë (kg)	0.82	6.11	46.78	23.28	36.48	5.81
Hashash (kg)				0.95	0.21	0.26
Marijuana (kg)	30.72	48,05	30.82	23.29	55.30	16.16
Kokainë (kg)	0.04	1.41	8.48	0.01	3.79	
Amfetaminë (kg)*	0.03	0.02		12.00	13.12	
Ekstazi	4	50	40	56	39.5	
LSD (doza)	1					
Kanabis (bimë)				7 983	31 158	
Popi (bimë)						

* Janar - Maj 2006

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Legislacioni i Kosovës në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare. Neni 139 i KPPK parashikon një dënim bazë burgimi nga 2 deri në 12 vjet. Në raste të rënda, janë parashikuar dënime më të ashpra, si në rastet e trafikimit të minoreneve (3 deri në 15 vjet), kur trafikantët kanë vepruar si pjesë e një grupi kriminal (7 deri në 20 vjet) dhe/ose kur përgatitja është kryer nga persona zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës (5 deri në 15 vjet).

²⁶² Të dhëna të siguruar nga Prokurorët ndërkombëtare që punojnë në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut. Nuk ka të dhëna të disponueshme nga Shërbimi Policor i Kosovës apo gjyqësori.

²⁶³ Në vitin 2003, rreth 52,0 kg heroinë u sekuestruan jashtë vendit, në bashkëpunim me hetimet në Kosovë, kryesisht në Itali dhe Bullgari. Në vitin 2004, rreth 504,5 kg heroinë u sekuestruan jashtë vendit, në bashkëpunim me hetimet në Kosovë, kryesisht në Austri, Gjermani, Itali, Zvicër, Serbi, Bullgari dhe Shqipëri.

Sektori i Trafikimit të Qenieve Njerëzore (STQNj)²⁶⁴ në Policinë e UNMIK-ut siguroi raporte të mira ndaj pyetësorit të vitit 2005, duke mundësuar kështu një analizë më të detajuar. Në 1 Nëntor 2005, përfunduan ndryshimet e fundit në strukturat dhe emërtimet e policisë dhe sektorët rajonal të STQNj iu nënshtruan, duke shpresuar për herë të fundit, kalimit të plotë nën komandën e Shërbimit Policor të Kosovës, brenda Departamentit të Krimin të Krimin të Organizuar (DKK) si dhe një rajonalizimi të plotë. Oficerët Ndërkombëtare të Policisë (ONP) e humbën rolin e mbikëqyrësve dhe që atëherë kanë marrë atë të monitoruesve dhe oficerëve ndërlidhës.

Gjithashtu në Maj të vitit 2005, u miratua Plani i Veprimit të Kosovës për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, një kuadër i konsoliduar i të gjitha veprimtarive dhe aktorëve që merrnin pjesë në aktivitetet e anti-trafikimit.

Kosova vendosi një Koordinator Inteligjence për Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe në vitin 2006 paraqiti një analizë të përmirësuar. Në vitin 2005, oficerët e STQNj-së dhanë një seri sesionesh trajnimi. STQNj në DKK, së bashku me Policinë e Zonës Kufitare të UNMIK-ut, merr pjesë në një takim dy mujor me homologët në Ministrinë e Brendshme Serbe në Nën Komitetin e Grupit të Punës për Luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe transportit klandestin të migrantëve. Gjithashtu është vendosur dhe po funksionon mirë një bashkëpunim i ngushtë me agjencitë e zbatimit të ligjit në vendet fqinje.

Në vitin 2003, IOM-i raportoi një numër të konsiderueshëm Kosovarësh të trafikuar brenda vendit (83), veçanërisht minorenë të moshës rreth 15 vjeç²⁶⁵. Në vitin 2004, u identifikuan 48 viktima, 11 prej të cilëve ishin fëmijë (nën moshën 18 vjeç). Shumica e viktimave vinin nga Moldavia (17), Shqipëria (13) dhe vetëm 11 ishin nga Kosova.

Sipas analizës së besueshme zyrtare të Sektorit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore të UNMIK-ut²⁶⁶, për vitin 2005, u regjistruan gjithsej 95 vepra penale, u paditën rreth 90 persona dhe u arrestuan 34. Shumica e autorëve të këtyre veprave ishin me etni Shqiptare (45). U trafikuan 49 viktima, 14 prej të cilëve ishin fëmijë. 38 viktima (11 fëmijë) pranuan asistencën e qendrave pritëse dhe një pjesë riadhesimin (14).


Në vitin 2005 u kryen disa operacione të hapura dhe sekrete të përmasave të mëdha. Deri tani (I/2006), STQNj kontrolloi 603 ambiente, mbylli 15, kreu 20 arrestime për trafikim të qenieve njerëzore dhe prostitucion dhe identifikoi 20 viktima, 13 prej të cilëve ju dha ndihmë nga "DAS" (Asistencë e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit, një partneritet midis shumë agjencive, duke përfshirë STQNj, Drejtorinë e Krimin të Organizuar, CSË, IOM, dhe OJQ). Analiza e çështjeve të vitit 2005, akoma tregon se fenomeni i trafikimit në Kosovë ndodh kryesisht për qëllime shfrytëzimi seksual. Kosova vazhdon të jetë një zonë destinacion dhe transit për viktima të huaja të trafikimit, me një rritje të dukshme të trafikimit të brendshëm të qenieve njerëzore. Në një shkallë më të ulët, Kosova është dhe një zonë origjine për trafikimin.

²⁶⁴ Ky emër i ri ju dha në Janar 2005 ish Policisë së UNMIK-ut, Njësisë së Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit

²⁶⁵ Shiko Amnesty International (2004) dhe IOM (Korrik 2004) f. 63 - 64.

²⁶⁶ STQNj – Raporti i fundit të vitit 2005; Prokurorët Ndërkombëtare që punojnë së bashku me UNMIK-un, Departamentin e Drejtësisë, raportuan për të njëjtën periudhë vetëm 17 raste të kryera nga 37 persona nga të cilët vetëm 17 ishin dënuar.

Grafiku 9: Vendi i Origjinës i Personave të trafikuar në Kosovë 2004




Burimi: Policia e UNMIK-ut, Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (NJHTP)

Grafiku i vitit 2004 dëshmon qartë se shumica e femrave të trafikuar vinte nga vende të varfra (Moldavia, Rumania, Ukraina). Shumica e viktimave ishte midis moshës 18 dhe 30 vjec, por rreth një e treta ishin minorenë të moshës 12 deri në 18 vjec. Linjat e trafikimit përputhen me zbulimet e vendeve të origjinës: Viktimat arrijnë kryesisht në rrugë tokësore nga vendet e tyre të origjinës përmes Malit të zi, Serbisë (56,2 përqind), “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” (23,7 përqind) dhe Shqipëria (4,6 përqind). Vetëm pak viktima vijnë më linjë ajrore nga Turqia (3,2 përqind). Trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore është në rritje dhe përfshin “djem dashnorë” dhe viktima më të reja (mosha mesatare e personave të trafikuar brenda vendit është më e re se 20 vjec).

Siç tregon dhe grafiku i mëposhtëm për vitin 2005, vendet e origjinës duket se po bëhen më të “balancuara”:

Grafiku 10: Vendi i Origjinës i Personave të trafikuar në Kosovë 2005



Burimi: Policia e UNMIK-ut, Shërbimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore (STQNj)

Kosova është si vend transit, ashtu dhe destinacion, fillimisht për shkak të prezencës së forcave ushtarake ndërkombëtare dhe aktualisht për shkak klientelës së brendshme. Në ngjashmëri me Bosnje dhe Hercegovinën, klientela e brendshme e shërbimeve seksuale është e konsiderueshme, duke arritur në 90 përqind të numrit të klientëve²⁶⁷. Strukturat e grupeve kriminale të përfshira në trafikim janë të lidhura drejtpërdrejt me vendet furnizuese. Grupet që merren me shfrytëzimin seksual në Kosovë, i mbledhin viktimat e tyre pas mbërritjes në Kosovë, gjë që sugjeron lidhje të drejtpërdrejta midis grupeve që veprojnë në vendet e origjinës dhe grupeve që veprojnë në Kosovë.

²⁶⁷ IOM (Korrik 2004), f. 67.

Duket sikur ekzistojnë tre nivele grupesh kriminale që veprojnë në Kosovë që shpesh ndërliken me njëra tjetrën. Grupet e nivelit të ulët kujdesen për transportin e viktimave me makinë ose furgona, ose thjesht sigurojnë të hollat e nevojshme që viktimat të kalojnë kufirin me autobus. Më pas këto viktima strehohen në të njëjtat ambiente ku dhe do të shfrytëzohen. Grupet e niveleve më të larta organizojnë udhëtimet, përfshirë këtu dhe sigurimin e dokumenteve dhe vizave të falsifikuara, por nuk përfshihen vetë në shfrytëzimin e viktimave, megjithëse ato organizojnë dhe ri - trafikimin. Grupe të tilla veprojnë sipas në një mënyrë më të strukturuar dhe shfaqin një hierarki, duke filluar që nga përdorimi i "personave manekinë", te cilët sigurojnë mbulesën ndaj kryetarit të rrethit kriminal, duke vazhduar me personelin e sigurisë dhe kundër-zbulimit i ngarkuar me detyrën e përçarjes së aktiviteteve të policisë, e më pas me zyrtarë të korrumpuar që informojnë grupet kriminale për aksionet e policisë.

Në këtë mënyrë, grupet kriminale të përfshira në këtë krim janë kryesisht ndëretnike, megjithëse, disa kombësi mund të jenë dominante në një grup. Këto grupe janë të ngjashme me ato të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore. Ato bashkëpunojnë ngushtë me grupe nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia.

Mënyrat e veprimit të krimit të organizuar në këtë treg po bëhen më të sofistikuara dhe po ingranohen për të shërbyer si tregut të brendshëm ashtu dhe atij rajonal. Gjithashtu vihet re të jetë prezent dhe trafikimi e rekrutimi i brendshëm. Kriminelët që merren me trafikim të qenieve njerëzore janë të lidhur dhe me grupe të tjera kriminale dhe lloje krimi, si trafik droge, armësh, etj. Në disa raste ata kanë influencë në autoritetet lokale të zbatimit të ligjit. Nuk u siguroa informacion i mëtejshëm mbi të ardhurat e krimit, asetet, etj.

Duhet nënvizuar një ndryshim interesant: trafikantët e qenieve njerëzore në Kosovë që kanë rolin e rekrutuesve, në 50 përqind të rasteve janë femra dhe zakonisht ish viktima të shfrytëzuara në industrinë e seksit. Trafikantët meshkuj renditen nga rekrutues "djemsh dashnorë", në banakierë, biznesmenë mesatarisht të respektuar (pronarë klubesh nate, baresh, restorantesh, etj.) që u ofrojnë punë të rreme viktimave të mundshme.

MIGRACIONI I PALIGJSHËM

Transporti klandestin i personave mbulohet nga Dispozitat e fundit të Kodit Penal të Kosovës. Tregu i transportimit klandestin të personave shfaqet si shumë fitimprurës në Kosovë, ashtu si dhe në vende të tjera, ose nëpërmjet organizimit të transportimit klandestin, ose nëpërmjet rregullimit të udhëtimeve (agjencitë e udhëtimit), duke i pritur përkohësisht migrantët e jashtëligjshëm ose duke siguruar dokumente të rreme identiteti.

Numri i migrantëve që kalojnë klandestin përmes territorit të Kosovës përlogaritet të shkojë në disa mijëra në vit (përgjigje ndaj pyetësorit të vitit 2005). Gjithsesi, në përgjigje të pyetësorit të vitit 2006, Njësia e Hetimit të Policisë Kufitare të Shërbimit Policor të Kosovës raportoi për vitin 2005 vetëm 105 çështje të migracionit të jashtëligjshëm. Ndërsa Prokurorët Ndërkombëtarë, të cilët punojnë me Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, raportuan vetëm 7 çështje, të kryera nga 27 persona, ku përfshiheshin një numër i panjohur migrantësh nga Pakistani, Bangladeshi dhe India (Asnjë nga autorët e këtyre veprave penale nuk është dënua akoma).

Në shumicën e këtyre rasteve, ishin lëshuar viza ftesa të rreme, duke mundësuar kështu hyrjen në Evropë nga aeroporti i Prishtinës ose, së fundmi për shkak të mekanizmave të përmirësuar të kontrollit të rregullit në aeroport, nga rrugë tokësore duke përdorur autobusë të linjave ndërkombëtare apo furgona lokalë. Përdoren disa rrugë për të transportuar në mënyrë klandestine migrantët nga Kosova drejt Shteteve Anëtare të BE-së, kryesisht dhe fillimisht drejt Gjermanisë, Italisë, ose Zvicrës.

Për sa i përket strukturës këto grupe, janë të ngjashme me ato të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore. Ato bashkëpunojnë ngushtë me grupe nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia. U vu re se grupe të krimit të organizuar të përfshirë në transportin klandestin të personave, mund të ishin gjithashtu të përfshirë në kontrabandën e armëve dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme.

KRIMI EKONOMIK DHE ELEKTRONIK (CYBERCRIME)

Ekonomia e Kosovës është pothuajse e bazuar tërësisht në tregti, duke i bërë të ardhurat publike të varen nga vetëm një burim, i cili është gjithashtu shumë tërheqës për krimin ekonomik. Kontrabanda, evazoni në sistemin doganor dhe të taksave dhe krime të tjera të lidhura me korrupsionin në sektorin publik përbëjnë gjithashtu një kërcënim për shoqërinë Kosovare. Disa reforma, si për shembull, licensimi i importeve të karburantit dhe cigareve, si dhe futja e sistemit kompjuterik në dogana kanë sjellë një ndryshim të dukshëm në mbledhjen e të ardhurave. Në mënyrë të ngjashme me Malin e Zi, shumica e aktiviteteve ekonomik dhe e kompanive veprojnë në Prishtinë, duke mundësuar hetimin më me lehtësi të krimit ekonomik.

Ekziston një informacion shumë i pakët në lidhje me krimin ekonomik, si në shifra ashtu dhe në analiza të detajuara, përveç faktit se rreth 5,000 çështje të krimit ekonomik u regjistruan në vitin 2004, me vetëm tre prej tyre të lidhura qartë me krimin e organizuar në kuptimin tradicional²⁶⁸. Gjithsesi, në përgjigjen ndaj pyetësorit të vitit 2005, u dhanë disa përshkrime informuese të njohura mbi ambientin e krimit ekonomik, që kishin të bënin me problemet e tranzicionit, shfrytëzimin e procesit të privatizimit, mungesën e njohurisë në prokurimet publike dhe biznesin privat, delikatesën e sektorit privat, evazionin fiskal, kontrabandën, zbatimin e dobët të ligjit, korrupsionin, legjislacionin e gjymtuar, e të tjera.

Policia e UNMIK-ut ngriti një Departament për Krimin Ekonomik dhe Financiar, por në përgjigje të pyetësorit të vitit 2006, u raportuan mungesa të dukshme si më poshtë:

- Qendra e Informacionit Financiar (“Njësia e Inteligjencës Financiare – FIU”), e ngritur në Shtator 2004, akoma nuk funksionon siç duhet;
- Baza e të dhënave akoma nuk është vënë në zbatim siç duhet;
- Ngritje e pamjaftueshme e administratës së shërbimit tatimor dhe doganor;
- Faturat dhe dokumentet e tjera të biznesit privat dhe publik nuk janë ruajtur siç duhet;
- Ligji mbi evazionin fiskal ka shumë boshllëqe dhe duhet rishikuar;
- Një nivel i ulët bashkëpunimi me organet kombëtare dhe ndërkombëtare të përfshira.

Kontrabanda e të gjitha llojeve të mallrave dhe produkteve të falsifikuara, të ndjekura ngushtë nga forma të tjera të krimit ekonomik, (duke përfshirë prokurimet publike, mashtrimet në akcizë, sistemin e taksave dhe atë doganor) është përmendur në një tjetër anketë të Këshillit të Evropës.²⁶⁹ Një “problem i madh për Kosovën, ashtu si dhe për Evropën në përgjithësi, veçanërisht nëpërmjet rolit të saj në kontrabandën e produkteve të falsifikuara”, u raportua dhe më tej:

“Ekonomia e Kosovës ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga evazoni në detyrime për shkak të mallrave kontrabandë. E gjithë shoqëria është e dëmtuar [me] një influencë shumë negative në besimin e qytetarëve ndaj zyrtarëve (agjencive të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit, politikanëve...). Më shumë sesa ndjenja e një pasigurie publike, problemi më i madh qëndron në kërcënimin që mund të lindë nga një krizë e re civile në fushën e lidhur me çështjet ekonomike.”

Në fund të fundit, mbetet i rëndësishëm fakti se që nga viti 2003/2004 nuk mund të arrihej asnjë progres i rëndësishëm. Kjo është gjithashtu e vërtetë për *krimin elektronik*, për të cilin nuk u sigurua absolutisht asnjë informacion.

KORRUPSIONI

Korrupsioni shikohet si një veprë penale që dhunon funksionimin e duhur të sistemit ekonomik të Kosovës. Nene të veçanta të Dispozitave të Kodit Penal mbulojnë kryesisht këtë lloj krimi (Pranimi i ryshfeteve – Neni 343, dhe Dhënia e ryshfeteve – Neni 344), por Kosova raportoi vetëm për raste të vogla (ryshfete që kapnin shifrën 250 Euro) dhe nuk siguroi shifra të tjera. Sipas Prokurorëve Ndërkombëtarë, të cilët punojnë me Departamentin e

²⁶⁸ Këshilli i Evropës, “Raporti i vitit 2005 i Situatës së Krimit të Organizuar me përqendrim të veçantë në krimin ekonomik”, Dhjetor 2005. (“Krimi Ekonomik dhe Krimi i Organizuar”, f. 88 ff.).

²⁶⁹ Këshilli i Evropës, “Raporti i vitit 2005 i Situatës së Krimit të Organizuar me përqendrim të veçantë në krimin ekonomik”, Dhjetor 2005. (“Përmbledhja e vendeve”, f. 64).

Drejtësisë së UNMIK-ut, ka patur 62 raste të kryera nga 177 persona, prej të cilëve deri tani janë dënuar 6 vetë (nuk ka informacion mbi përqindjen e rasteve të lidhura me krimin e organizuar apo me dënimet).

PASTRIMI I PARAVE

Në përgjigje të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, seksioni 10.2, që mbulon pastrimin e parave, e cila kërkoi ngritjen e një "Zyre kundër Pastrimi të Parave", u krijua Qendra e Informacionit Financiar. Në përgjigjet ndaj pyetësorit të vitit 2005, u përmend ngritja e kësaj Zyre, por nuk u raportua rreth ndonjë çështje apo shifre. Në përgjigjet ndaj pyetësorit të vitit 2006, nuk u shtua asnjë informacion tjetër ndaj shënimit: *"hetimet/ndjekjet e pastrimit të parave janë në fazën e sapo lindjes në Kosovë"*.

4.7. "ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISE"

Me përjashtim të një konflikti të shkurtër në vitin 2001, "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" i shpëtoi shkatërrimit në masë nga lufta dhe shpërnguljes së popullsisë së saj.

Si rrjedhojë, situata politike është e stabilizuar, në vend është krijuar një gjendje sigurie dhe institucionet janë në funksionim. Ligjeve ekzistuese u janë bërë ndryshimet e nevojshme, ligjet e reja të miratuara janë në përputhje me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. Procesi i zbatimit është në rrugë e sipër, gjë e cila sjell një reflektim pozitiv mbi marrëdhëniet ndër-etnike dhe tolerancën midis komuniteteve të ndryshme që jetojnë në vend. Ka filluar reforma gjyqësore dhe është ndërmarrë me sukses zbatimi i reformës policore të vitit 2005, në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit. Gjithsesi, vendi është ndikuar nga rënia ekonomike, taksat e larta, papunësia (në nivel rreth 35 përqind të popullsisë të aftë për punë) dhe një ekonomi e errët në përmasa të mëdha. Buxheti i shtetit dominon ekonominë e vendit, duke e kthyer shpesh prokurimin publik si të vetmin burim për mbijetesë ekonomike, gjë që shkakton korrupsion. Ashtu dhe si në vende të tjera të rajonit, këta faktorë i siguruan kriminelëve të organizuar mundësi të mëdha dhe avantazhe të pamerituara.

Neni 29 i ligjit për Prokurorinë Publike parashikon një përkufizim ligjor për "krimin e organizuar", i cili është plotësisht i përputhshëm me përkufizimet ndërkombëtare²⁷⁰. Gjithashtu në të parashikohen dhe detyrat kryesore të "Njësisë së Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit" brenda Zyrës së Prokurorisë Publike të vendit në njërën anë, dhe detyrat e sektorit të sapoformuar për Luftën kundër Krimit të Organizuar me 280 punonjës, brenda Ministrisë së Brendshme, në anën tjetër. Për më tepër, Neni 122, seksioni 20, i Kodit Penal jep përkufizimin e termit "grup i organizuar kriminal", ndërsa në Kodin e Procedurës Penale, në vitin 2004, u bënë disa ndryshime rreth disa mjeteve të posaçme të hetimit fatkeqësisht, disa rregullore të rëndësishme ligjore, p.sh. për përgjimin e bisedave dhe për konfiskimin e të ardhurave të krimit, nuk janë adoptuar ende).

"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" mendohet të jetë e kërcënuar nga krimi i organizuar, kryesisht trafiku i drogës, transporti klandestin i personave, kontrabanda e armëve dhe e një sërë mallrave (cigareve, alkoolit, karburantit, etj) dhe aktiviteteve të krimit ekonomik, si mashtrimet në prokurimet publike, falimentimet, mashtrimet në privatizime, dhe ato në lidhje me TVSH-në. Momentalisht, nuk ka llogaritje të sakta në lidhje me dëmin që këto krime i bëjnë portofolit publik, dëme të cilat arrijnë në qindra milionë Euro. Mbi këto lloj krimesh kanë filluar hetime, rezultatet e të cilave do të duken në të ardhmen. Gjithsesi, sipas përgjigjeve të dhëna ndaj pyetësorit të vitit 2005 dhe 2006, dhe në kontrast me kërcënimin e përshkruar më sipër, shifrat e dhëna janë të vogla: Në vitin 2003 janë paditur tetë grupe të krimit të organizuar ekonomik. Këto grupe, me strukturë të përzier organizative, ushtruan aktivitetin e tyre brenda dhe jashtë vendit dhe investuan të ardhurat në konsume të bollshme, në zgjerimin e aktiviteteve të biznesit dhe në prona të paluajtshme. Për vitin 2004 nuk u raportua ndonjë shifër. Në vitin 2005, Ministria e Brendshme raportoi 20 grupe krimi të organizuar, kryesisht të përfshira në krime droge, transport klandestin të migrantëve, cigareve, armëve, dhe makinave luksoze. Zakonisht këto grupe përbëhen nga 5 deri në 30 kriminelë (në varësi të llojit të krimit) dhe kanë një strukturë hierarkike me role dhe detyra të ndara (financierë, organizatorë, transportues, ndërlidhës, etj.)²⁷¹.

Anëtarët e grupeve të krimit të organizuar të dënuar në vitet e mëparshme, i kanë investuar intensivisht të ardhurat e krimit në biznese të ligjshme. Ashtu dhe si në çdo procedurë penale në Evropë, problemi më i madh është barra e provës në lidhje me konfiskimin, e cila i takon prokurorit dhe nuk mund të kthehet asnjëherë.

²⁷⁰ Veprimi i Përbashkët 98/733/JHA i 21 Dhjetorit 1998 adoptuar nga Këshilli në bazë të Nenit K.3 të Traktatit mbi BE-në dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës (2001)11i Komitetit të Ministrave, Shtator 2001; "Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Ndër-Kombëtar (UNTOC)", 2003.

²⁷¹ Bazuar në Raportin e vitit 2005 të Këshillit të Evropës mbi Krimin e Organizuar, me një përqendrim të veçantë në krimin ekonomik, Dhjetor 2005, të dhënat variojnë në vlerë dhe sasi.

2003: Gjithsej 59 çështje të kryera nga 47 grupe të krimit të organizuar të përbërë nga 158 persona;

2004: Gjithsej 217 çështje të raportuara, kryesisht të lidhura me falsifikimin e parave (122 raste), trafikim droge (19 raste), trafikim të qenieve njerëzore (19 raste), kontrabandë mallrash (14 raste) dhe korrupsion (31 raste).

DROGAT E PALIGJSHME

Numri në rritje i personave të përfshirë në trafikun e drogës sjell një ndikim të madh mbi shume fusha te shoqërisë Maqedonase. Trafikimi i drogës ndodh kundrejt një sfondi të një situatë të vështirë socio-ekonomike në vend (papunësi, varfëri, etj.) pasi sjell të ardhura të shpejta dhe të lehta, si dhe ofron me pak mund të gjitha anët e pëlqyeshme të një jete moderne me plot pasuri.

Që prej disa vitesh, vendi ka humbur statusin e tij si vetëm një vend tranziti për trafikantët e drogës, - duke ardhur e duke u rritur u shndërrua në një vend destinacion. Kërkesa për drogë, kryesisht heroinë dhe kanabis, po rritet megjithëse përmasat e vendit dhe situata e tij ekonomike nuk janë shumë tërheqëse për një treg konsumatorësh në zgjerim. Gjithsesi, sipas autoriteteve të shëndetit, çdo vit nga 600 deri në 700 individë kërkojnë ndihmë mjekësore si rrjedhojë e abuzimit me drogën.

Mosha e abuzuesve me drogën është në ulje dhe në disa raste janë regjistruar si përdorues droge fëmijë të moshës 12 vjec. Çdo vit, nga 15 deri në 20 veta, vdesin nga overdoza. Persona të rinj në moshë, jo vetëm që vendosin jetën, shëndetin, edukimin dhe zhvillimin social të tyre në rrezik, por gjithashtu u duhet që të fillojnë një karrierë kriminale (p.sh. si hajdutë, grabitës, ose prostituta) në mënyrë që të grumbullojnë paratë e nevojshme për të blerë dozën e përditshme të drogës. Ata gjithashtu rrezikojnë zhvillimin socio-ekonomik të vendit duke zvogëluar përfshirjen në GDP-në kombëtare dhe duke rritur kërkesën e nevojshme për sistemin shëndetësor dhe social shtetëror.

Gjithsej janë zbuluar dhe hetuar 292 vepra penale të “prodhimit dhe shpërndarjes së jashtëligjshme të drogave narkotike dhe prekursorëve”, me 355 autorë të tyre.

Trafikantët e drogës janë kryesisht meshkuj, me moshë brenda një grupi kriminal që varion nga 22 deri në 55 vjec, shumica e të cilëve janë Maqedonas. Në përgjithësi, si struktura ashtu dhe përbërja e grupeve kriminale që merren me drogë është e përzier. Lidhjet krijohen dhe mbahen nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta familjare, por qëndrueshmëria e tyre mund të mos jetë shumë afatgjatë. Vetëm një numër i vogël kriminelësh ka shtetësi të huaj nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Greqia dhe Bullgaria. Grupet kriminale që bëjnë trafikimin e drogës dhe i shërbejnë tregut të brendshëm kombëtar, janë thuajse të përçara. Është theksuar se do të ishte “jo reale të thuhej se brenda vendit ekziston një organizatë e madhe, e ndërlidhur dhe e koordinuar, e cila do të kryente të gjitha aktivitetet kriminale në këtë zonë”.

Pavarësisht këtyre fakteve, janë zbuluar gjithashtu dhe grupe të vogla, me struktura hierarkike, me role dhe detyra të ndara (financierë, furnizues, shitës, shpërndarës dhe persona që merren me aktivitete që lehtësojnë transportin, p.sh. duke ndërtuar vende të fshehta në kabinat e makinave, rimorkiove, etj.)

Nga pesë rastet më tipike të vitit 2005, është vënë re qartë heterogjeniteti etnik: Steriotipi “mono-etnik dhe me përqendrim familjar” i grupeve të krimit të organizuar që trafikojnë drogë është kaluar. Shërbimet informative të policisë tregojnë se kriminelët nga “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” mbajnë kontakte me grupe kriminale nga Zvicra, Gjermania, dhe vendet Skandinave. Gjithashtu, është vënë re se grupet kriminale të trafikut të drogës shpesh bashkëpunojnë në lidhje me kalimet e jashtëligjshme të kufirit, transfertat e jashtëligjshme të parave, shkëmbimin e avokatëve mbrojtës kur anëtarët e tyre arrestohen, pagesat për lirimet me kusht, etj.

Përveç disa të dhënave mbi konfiskimin e ekstazisë, pilulave të diazepamit, përzierjeve të kafeinës dhe paracetamolit, metadonit dhe heptanonit, nuk është regjistruar ndonjë treg apo prodhim i madh për droga të tilla. Gjithashtu, nuk është dhënë informacion i mëtejshëm në lidhje me prodhimin dhe trafikimin e drogave sintetike, prekursorëve, kimikateve të nevojshme, katalistëve, apo pajisjeve laboratorike për laboratorët e jashtëligjshëm.

Për sa i përket kultivimit të kanabisit, është raportuar vetëm për sasi të pakta dhe sporadike. Produktet e kanabisit, si hashashi ashtu dhe marijuana, të cilat mbizotërojnë tregun e brendshëm (sipas analizave strikte raportohen rreth 800 kg produkteve kanabisi), në nivel rruge dhe pak më sipër, kontrollohen nga Maqedonasit. Ndërkohë, hashashi i kultivuar në Shqipëri dhe i transportuar brenda tregut të drogës vendas, si dhe ngarkesat e mëdha me destinacion tregjet e Evropës Perëndimore, kontrollohen nga grupe kriminale që dominohen nga

Shqiptarët, por që gjithnjë e më shumë po përbëhen nga përzierje etnike të Maqedonasve dhe Shqiptarëve bashkë. Deri tani, peizazhi i vitit 2004 i dominuar nga grupet e krimit të organizuar Shqiptare me lidhje të ngushta në Kosovë dhe Shqipëri, ku deri në një farë masë detyrat e rëndomta u lihen kriminelëve të etnive të tjera, vazhdon të mbetet akoma i saktë. Papërshkueshmëria e grupeve të krimit të organizuar Shqiptare dhe ndjeshmëria politike që mund të sjellë hetimi dhe ndjekja penale e çështjeve të tilla, i pengojnë përpjekjet e autoriteteve të zbatimit të ligjit në këtë fushë.

Një analizë konservative e raportuar për konsumin e drogës në tregun e brendshëm, bazuar në numrin e personave që kërkonin ndihme mjekësore, tregon për një konsum vjetor heroine prej 300kg në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Gjithashtu vihet re një rënie çmimi për opiumin, gjë që lidhet me tendencat e furnizimit nga Afganistani, ku prodhimi i opiumit është rritur.

Fitimet nga ky treg Maqedonas arrijnë nga 10 deri në 12 milion euro. Përfitimi i përgjithshëm nga krimet që lidhen me trafikun e drogës nuk mund të përcaktohet në mënyrë më specifike për shkak të mungesës së hetimeve në fushën e pastrimit të parave.

Sidoqoftë, nga të dhëna të tjera policore rezulton se të ardhurat investohen në pasuri të paluajtshme, në industrinë e turizmit si dhe në aktivitete të tjera private si klube nate dhe bare, të cilat shpesh përdoren për shfrytëzim seksual të grave.

Përveç heroinës së trafikuar nga Turqia, nëpërmjet “Rrugëve Ballkanike” të njohura, sasi të vogla kokaine që vijnë nga portet fqinjë gjithashtu kanë mundur të depërtojnë në vend. Për shkak të llojeve të tilla të krimeve me përfitim të madh dhe me një sfond të rrezikshëm, përdoret zakonisht dhunë dhe kërcënime, kryesisht kundër grupeve konkurrencte të krimit të organizuar dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Përmasat e vogla të vendit, ku shumë njerëz e njohin njëri-tjetrin dhe ku është e lehtë që të gjeshe këdo, si dhe fakti që nëpunësit publikë marrin rroga mjaft të ulëta, krijojnë një atmosferë të përshtatshme për korrupsion të një shkalle të lartë.

Tabela 12: Përmbledhje tabelore e sasive të sekuestruara të drogave narkotike (“ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”)

Drogat Narkotike	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Heroinë (kg)					69.3	
Hashash (kg)					3.2	
Marijuana (kg)					203.2	
Kokainë (kg)					11.0	
Amfetaminë (kg)					1.8	
Ekstazi					2 857	
LSD (doza)					-	
Kanabis (bimë)					3 077	
Popi (bimë)						

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Bazuar në Nenin 418-1 të Kodit Penal (“trafikimi njerëzor), trafikimi i qenieve njerëzore sanksionohet siç vijon: Transportim, blerje, shitje, fshehje dhe pritje e personave për shfrytëzim nëpërmjet prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, pornografi, punësim i detyruar, ose shërbim, skllavëri, martesë të detyruara, fertilizim i detyruar, birësim i jashtëligjshëm, ose ndonjë formë e ngjashme sjelljeje apo marrëdhënieje, ose një transplant i jashtëligjshëm, i palejueshëm i organeve dhe pjesëve trupore të njeriut. Gjithashtu, sipas Nenit 418-v të Kodit Penal Maqedonas, sanksionohet organizimi i akteve të tilla kriminale. Në këtë mënyrë, sfondi ligjor i përmbush kërkesat e Konventave dhe standardeve ndërkombëtare.

Në vitet e mëparshme, vendi ka qenë kryesisht vetëm një vend transit për trafikimin e qenieve njerëzore. Të dhëna të fundit nga IOM dhe UNICEF tregojnë për një rekrutim vendas, për trafikim të brendshëm dhe për një treg vendas, por këto nuk janë konfirmuar plotësisht nga të dhënat e autoriteteve vendase. Gjithashtu është dhe një vend origjine për një numër viktimash (vetëm tre çështje të regjistruara të trafikimit të qenieve njerëzore ishin me qytetarë të huaj?). Në një kohë kur vendi po përjeton një rritje në tregun e brendshëm për shërbimet seksuale, kërkohet që të ndërmerren politika të gjithanshme parandaluese dhe shtypëse.

Sipas autoriteteve kombëtare, rreth 2000 deri në 4000 gra trafikohen përmes vendit. Shpesh viktimat e trafikut qëndrojnë përkohësisht brenda vendit e më pas ri-trafikohen për në vende të tjera. Shfrytëzimi seksual shpesh ndodh nëpër klube nate dhe bare, në të cilat gratë i shërbejnë 2 - 3 klientëve në ditë duke fituar një minimum prej 50 Euro. Kjo shumë arrin në 15,000 Euro në vit, ose në një total prej rreth 30 milion Euro për të gjithë tregun e brendshëm. Në kontrast me këto përlllogaritje, numri i rasteve të raportuara mbetet i vogël (në vitin 2003 dhe 2004: nuk ka të dhëna statistikore, në vitin 2005: janë raportuar 12 vepra penale me 40 autorë meshkuj Maqedonas të moshës 20 deri në 50 vjec).

MIGRACIONI I JASHTËLIGJSHËM

Kalimi i jashtëligjshëm i kufirit sanksionohet në bazë të Kodit Penal Maqedonas, Neni 402 ("Kalimi i jashtëligjshëm i Kufirit Shtetëror") dhe forma e organizuar e kësaj shkeljeje parashikohet në paragrafin e tretë të Nenit 402. Gjithsesi, për shkak të pranisë në rritje, karakterit të organizuar të këtij krimi dhe lidhjeve ndërkombëtare të kontrabandistëve, si dhe për shkak të nevojës për tu përafuar me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së, në Mars të vitit 2004 u bënë ndryshime në Kodin Penal, ku u shtuan dy nene të reja që sanksionin në mënyrë të drejtpërdrejtë transportin klandestin të migrantëve: Neni 418-b ("Transporti klandestin i migrantëve") dhe Neni 418-v (shiko Trafikimin e qenieve njerëzore).

Në vitin 2005, janë raportuar 35 çështje të regjistruara me 61 autorë, dy prej të cilave klasifikoheshin si krime të organizuara me 23 autorë. Në njërin rast një grup i organizuar me 31 anëtarë (nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, dhe "ish Republika Jugosllave e Maqedonisë") i përfshirë në falsifikim pasaportash, transport klandestin migrantësh dhe që kishte vjedhur 11 makina luksoze, u zbulua në një hetim të një shkalle të gjerë që zgjati 6 muaj. Në nëntë aktivitete të ndryshme ky grup kishte trafikuar rreth 100 persona përmes kufijve Greko - Maqedonas, duke u ndihmuar pjesërisht nga tre punonjës të Policisë Kufitare Maqedonase, të cilët gjithashtu u arrestuan.

Kryesisht, migrantët e sjellë në rrugë klandestine nga Lindja kalojnë përmes "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" drejt Greqisë, portës së BE-se, dhe që andej më pas në vende të tjera destinacioni në BE ku ka një deficit në krahun e lirë të punës (kryesisht në fushën e bujqësisë, turizmit, ndërtimit), një diasporë etnike të konsoliduar, një sistem të mirë shëndetësor dhe social, të cilat të gjitha së bashku premtojnë për një jetë më të mirë.

Më shpesh transportohen në rrugë klandestin qytetarët Kosovarë dhe Shqiptarë, të cilët paguajnë nga 50 deri në 100 Euro për transportin me makinë (në shumicën e rasteve shoferët janë nga Maqedonia, dhe makinat që përdoren janë taksi) dhe 600 deri në 800 Euro për organizatorët e transportit klandestin. Grupet e kontrabandistëve kanë një organizim hierarkik, me role dhe detyra të ndara (organizatorë, furnizues të dokumenteve të rreme, shoferë, bashkëpunëtorë për strehim të përkohshëm të migrantëve, mbështetës në agjencitë e kontrollit të kufirit). Kryesisht janë hetuar shtetas të Shqipërisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Rumanisë, Serbisë dhe Sllovenisë. Transporti klandestin i migrantëve nga Lindja e Mesme dhe Amerika Latine nëpërmjet "ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë" për shembull, organizohet nga grupe kriminale nga Bullgaria dhe Kosova.

ARMËT E VOGLA DHE TË LEHTA DHE EKSPLOZIVËT

Lufta kundër tregtisë së jashtëligjshme apo mbajtjes së armëve të vogla dhe të lehta dhe eksplozivëve përbën një problem të madh për vendin, veçanërisht në lidhje me konfliktin e vitit 2001, kur armë të jashtëligjshme u përdorën për të kryer një numër të madh krimesh të dhunshme. Si rezultat i masave intensive të organeve të zbatimit të ligjit u hetuan 335 çështje të "prodhimit, mbajtjes dhe tregtisë së jashtëligjshme të armëve dhe mjeteve të tjera të përdorura për kryerjen e veprave penale", me 7 autorë. Policia sekuestroi 464 copë armë, kryesisht armë/revolverë (165), pushkë (rreth 110), por dhe granata/granata dore (110) pushkë të rënda gjysmë automatike dhe kundërajrore (12), automatike të rëndë (3), hedhëse predhash (2), një minë anti tank, 10,351 kg eksploziv industrial dhe 1,0 kg TNT. Krahasuar me vitin 2004, sekuestrimet e armëve të vogla dhe të lehta dhe eksplozivëve u rritën me 100 përqind. Fatkeqësisht, nuk u dha ndonjë informacion rreth grupeve të kriminit të organizuar të përfshira në trafikun e armëve të tilla.

KRIMI EKONOMIK DHE ELEKTRONIK (CYBERCRIME)

Një gamë e gjerë veprash penale, në përgjigjen e Maqedonisë, dhe të konsideruara si “krim ekonomik” mbulohen nga disa seksione të Kodit të ndryshuar Penal (të tilla si të gjitha krimet kundër financave publike, pronave dhe detyrimeve zyrtare), Ligjit të Prokurimit Publik dhe Ligjit të Doganave. Ndryshimet e fundit të bëra në Shtator 2004 përfshijnë gjithashtu mundësinë për të sanksionuar entet ligjore

Krimi Ekonomik si deklarimi i falimentimit, mashtrimet në privatizime dhe përvetësimi i fondeve publike në sektorin e shërbimeve për publikun përfshinin klasën menaxhuese, lidhjet politike dhe korrupsionin. Natyra e ndërlikuar dhe e ndjeshme e çështjeve të tilla i bën ato të vështira për tu hetuar dhe për tu ndjekur penalisht, ndërkohë që pasojat e tyre sociale dhe ekonomike në shoqëri e bëjnë publikun mjaft të ndjeshëm ndaj zgjidhjes së tyre.

Në vitin 2005, krimet më të shpeshta të raportuara si “krime ekonomike” ishin:

- 275 vepra penale mbi “dhunimin e postit dhe autorizimeve publike” me 344 autorë,
- 140 vepra penale mbi “falsifikimin ose shkatërrimin e dosjeve financiare” me 170 autorë,
- 114 vepra penale mbi “evazionin fiskal” me 178 autorë dhe
- 51 vepra penale mbi “falsifikimin e një Karte Identiteti zyrtare” me 57 autorë.

Mashtrimi në prokurime zakonisht kryhet mbas përzgjedhjes së kompanisë më të kualifikuar duke shtuar nene në kontratë në mënyrë që të rritet çmimi i fillimit të tenderit. Gjithashtu janë regjistruar dhe mashtrime bankare ku është arritur të merren kredi nëpërmjet përdorimit të dokumenteve të falsifikuar. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe administrative përdoret gjerësisht për përfitime të paligjshme pronash, për marrjen e licensave për import mallrash me kushte të favorshme, etj.

Mashtrimet në lidhje me TVSH-ne si dhe kontrabanda dhe falsifikimi i mallrave të ligjshëm gjithashtu është identifikuar si një problem. Ky i fundit duket të ketë një tendencë në ulje ndërsa i pari në rritje. Korrupsioni përdoret gjerësisht për të lehtësuar aktivitetet e jashtëligjshme, për të marrë licenca për eksportin e mallrave; disa kompani madje i fillojnë aktivitetet e tyre korruptuese dhe ato të lobing-ut, kur zyrtarët shtetërorë zgjidhen për emërim.

Për sa i përket *piraterisë* dhe falsifikimit të mallrave të ligjshme, nuk u raportuan të dhëna të reja. Në vitin 2004, autoritetet Maqedonase vunë re një prodhim, shpërndarje, shitje dhe dhënie me qera në mënyrë të paligjshme të filmave pornografikë dhe produkteve kompjuterikë. Veprimet e fundit kundër këtij lloji krimi rezultuan në shkatërrimin e një grupi kriminal që prodhonte produkte të tilla dhe në konfiskimin e pajisjeve dhe të materialeve të regjistruara. Ka patur gjithashtu raste të falsifikimit të produkteve ushqimore, pijeve freskuese dhe alkoolike dhe produkteve të tjera konsumatore të destinuara për konsum të brendshëm.

Kontrabanda e mallrave të akcizës, në veçanti e cigareve, kanalizohet nga Kosova për në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” e më pas për të vazhduar në Greqi. Kontrabanda e pijeve alkoolike kalon nga Greqia, Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi për në “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Gjithashtu në vend futen kontrabandë dhe tekstile me origjinë turke, kineze dhe bullgare, ndërkohë që telefonat celularë, kompjuterët dhe pjesët e tyre futen nga Greqia. Produktet ushqimore kalojnë kontrabandë nga Bullgaria si dhe nga Mali i Zi dhe Serbia.

Kontrabanda e mallrave të ligjshëm bëhet nëpërmjet kalimit të ligjshëm ose jo të kufirit. Për sa i përket mënyrës së veprimit, në grupet kriminale që merren me kontrabandë përfshihet të paktën një oficer doganor që ndihmon në kalimin e kufirit. Ata zakonisht korruptojnë oficerët doganorë dhe mashtrojnë për importimin e mallrave nëpërmjet kompanive të rreme. Struktura e këtyre grupeve është relativisht horizontale, në të cilën persona të veçantë mbulojnë furnizimin me mallra kontrabandë, kalimin e kufirit dhe shitjen e mallrave në treg. Anëtarët e këtyre grupeve kanë nivel edukimi dhe prejardhje etnike e sociale të përzier. Aktivitetet e tyre janë ndërkombëtare dhe ata mbështeten në përdorimin e telefonave celularë të parapaguar, gjë që e bën mjaft të vështirë identifikimin e përdoruesit. Të ardhurat kryesisht ri-investohen në këtë biznes, por edhe në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gjatë vitit 2003, u zbuluan 8 grupe të tilla të cilat kishin kryer 174 vepra kriminale. Në vitin 2003, u konfiskuan rreth 20,000 kuti cigaresh dhe 21 ton pije alkoolike. Në 9 muajt e parë të vitit 2004 u konfiskuan 32.700 kuti cigaresh, 13.034 litra pije alkoolike, si dhe pajisje teknike, produkte ushqimore dhe tekstile, etj. Vlera e mallrave të konfiskuar gjatë vitit 2003 dhe 2004 arrin afërsisht në 17 milion Euro.

Për sa i përket *falsifikimit të parave*, si të brendshme ashtu dhe ndërkombëtare, janë parashikuar dispozita të përshtatshme ligjore (Neni 268 dhe 271 i KP). Falsifikimi i parave trajtohet si një prej fushave me serioze të krimit meqenëse mund të rrezikojë gjithë sistemin financiar të vendit. "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", në vitin 2005 raportoi sasi jo të mëdha parash të huaja të falsifikuara, por për sa i përket atyre vendase u raportua një shumë e madhe kryesisht në kartëmonedha me prerje të vogël, shumica 100 Dinarë Maqedonas dhe në disa raste 200 dhe 1,000 Dinarë. Shpërndarësit e parave të huaja të falsifikuara zakonisht i kanë marrë kartëmonedhat false në një cilësi mjaft të mirë (Euro dhe Dollarë Amerikanë) nga grupet e krimit të organizuar në vendet fqinje (Bullgari dhe Shqipëri) të cilët siç duket përdorin teknika mjaft të avancuara. Mendohet se autorët e këtyre veprave zakonisht janë të përfshirë dhe në fusha të tjera krimi. Autoritetet e zbatimit të ligjit Maqedonas në vitin 2005 hetuan gjithsej 195 çështje të kryera nga 127 autorë (48 raste u hetuan kundrejt autorëve të panjohur) dhe sekuestruan 6 kartëmonedha me prerje 500 Euro, 59 kartëmonedha me prerje 200 Euro, 19 kartëmonedha me prerje 100 Euro dhe 68 kartëmonedha me prerje 50 Euro (nuk u siguruan të dhëna mbi Dinarët Maqedonas dhe Dollarët Amerikan, nuk mbërriti ndonjë informacion mbi vendet e brendshme të prodhimit).

Për sa i përket *krimit elektronik*, vendi adoptoi ligje të reja mbi teknologjitë e informacionit dhe ndryshoi disa nene të Kodit Penal, si Neni 251 ("Dëmtimi dhe Hyrja e Jashtëligjshme në një Sistem Kompjuteri"), Neni 251-a (Prodhimi dhe Futja e Viruseve Kompjuterike), Neni 251-b (Mashtrimi Kompjuterik), Neni 286 (Përdorimi i Jashtëligjshëm i një Shpikjeje ose një Software-i). Gjithsesi nuk është raportuar ndonjë e dhënë.

Shkeljet më të shpeshta janë së pari blerja e produkteve në internet, nëpërmjet përdorimit të të dhënave të kartave të kreditit të siguruara në mënyrë të jashtëligjshme, nga vjedhje të mëparshme, nga dekodimi elektronik (hyrja në një bazë të dhënash p.sh. të një kompanie, qendre tregtare, bankave apo institucioneve të palëve të treta dhe kopjimi i të dhënave të ruajtura në këto baza të dhënash për ti përdorur më pas për qëllime të ndryshme si p.sh. prodhimi i kredit kartave të rreme²⁷²). Së dyti, përdorimi i asaj që quhet "spam" midis furnizuesve konkurrentë të internetit, me qëllim prurjen e një trafiku të madh të dhënash në internet, gjë që bllokoi rrjetin dhe sjell një bllokim të shërbimit (DOS). Së treti, kemi të bëjmë më shkelje që lidhen me piraterinë e produkteve duke kopjuar në mënyrë të jashtëligjshme, si privatisht ashtu dhe për biznes, produktet e software-ve, kryesisht prodhimet e Microsoft (Windows XP dhe Windows Office). Shkelje të tjera të rëndësishme janë rastet e "peshkimit" (teknika relativisht të reja që përdoren për të përfitur të dhëna personale dhe financiare me qëllim vjedhjen e identitetit dhe mashtrimin: faqe interneti të rreme të cilat vjedhin identitetin e bankave të mëdha dhe krijohen në mënyrë të atillë që të duken si faqet e internetit origjinale të bankave të vërteta; Viktimat mashtrohet për të siguruar të dhënat e llogarisë së tyre, të cilat më pas përdoren për të transferuar paratë për në llogari të tjera), "Email-at Nigerianë" (letrat lutëse), falsifikim i kartave të kreditit dhe krime të tjera të ngjashme.

Vazhdimisht, përshkrimi i autorëve të këtyre krimeve ndryshon nga Maqedonas të rinj të pa martuar, në menaxherë dhe profesionistë të degëve të teknologjisë së informacionit në kompani të ndryshme. Akoma nuk ka prova për grupe të krimit të organizuar – përveç rrjeteve të tilla ndërkombëtare si "Email-at Nigerianë" dhe faktit se disa autorë të kategorisë së parë të krimeve më të shpeshta janë anëtarë të "FROUDE forumi i kredit kartave" të krijuar nga faqe interneti të huaja ndërkombëtare që ofrojnë të dhëna të ndryshme (numrin e kredit kartave të vlefshme, datën e vlefshmërisë, kodet PIN, CVV2, të dhëna personale të pronarit të ligjshëm të kredit kartës, etj.). Në këtë mënyrë, hetimet janë mjaft të ndërlikuara dhe kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar. Meqenëse shkëmbimi i informacionit përmes Interpol-it ishte shumë i ngadaltë, atëherë filloi zbatimin një projekt i posaçëm (SCIMER), brenda kuadrit të Qendrës SECI, për të përmirësuar bashkëpunimin midis autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe autoriteteve bankare.

²⁷² Në 2005, u ndërmorën aktivitete operative të përbashkëta me NTHCU nga Mbretëria e Bashkuar. Në këtë rast një qytetar i Malit të Zi, Serbisë, siguroi të dhënat personale rreth kredit kartës dhe një adrese IP në Vietnam dhe ia shiti një qytetari Britanik, i cili i solli bankave Britanike një dëm në vlerën 1.000.000 Pound Britanikë.

KORRUPSIONI

Vendi i ka nënshkruar të gjitha Konventat ndërkombëtare mbi masat kundër korrupsionit. Kodi Penal Maqedonas, nuk ka një përkufizim ligjor për “korrupsionin”. Pak a shume, mendohet se korrupsioni përshkruhet mjaftueshëm në disa nene, të tilla si dhunimi i postit publik (Neni 353 KP), marrja apo dhënia e një ryshfeti (Neni 358 KP), ndërmjetësimi i jashtëligjshëm (Neni 359), shpalosja dhe marrja në rrugë të jashtëligjshme e një sekreti zyrtar (Neni 360, 360-a, 281 KP), ryshfeti gjatë zgjedhjeve dhe votimit (Neni 162 KP) dhe disa vepra të tjera penale që i referohen krimit ekonomik

Gjithsesi, politika anti korrupsion është trajtuar mirë nga ligji i posaçëm mbi “Parandalimin e Korrupsionit” i vitit 2002²⁷³, i cili në Nenin 3 përshkruan me një përkufizim ligjor termin kriminologjik të korrupsionit, i cili mund të përdoret për një renditje më të saktë të krimeve të korrupsionit:

“Dhunimi i postit publik, postit të personit publik që ushtron detyra të interesit publik, për arritjen e çdo përfitim për atë apo dikë tjetër, konsiderohet të jetë korrupsion dhe sjell një sanksion, civil apo të ndonjë përgjegjësie tjetër”. Në ndryshimin e këtij ligji, Neni 3 parashikon një përkufizim më të gjerë²⁷⁴: “Korrupsion konsiderohet të jetë shfrytëzimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare, apo pozicionit për të arritur çdo përfitim për veten apo për dikë tjetër”.

Ngritja “Komisionit Shtetëror” autonom dhe të pavarur për të parandaluar korrupsionin (2002), adoptimi i Programit Kombëtar kundër korrupsionit dhe Programi Shtetëror për Parandalimin dhe Shtypjen e Korrupsionit me Matricën e Planit të tij Për Veprim (2003), përbënin pika kyçe në luftën kundër korrupsionit.²⁷⁵

Zyrtarët që merren me zbatimin e procedurave të falimentimit të ish ndërmarrjeve shtetërore duket të jenë më të ekspozuar ndaj korrupsionit. Gjithashtu janë vënë re dhe forma të tjera të korrupsionit në nivele të ulëta dhe të larta. Në vitin 2004, policia regjistroi 536 krime të lidhura me korrupsionin të kryera nga 664 persona. Rastet që lidhen me abuzimin e posteve publike arrijnë deri në 504 dhe janë kryer nga 631 persona. Më pas vijojnë rastet e tjera të korrupsionit pasiv ose aktiv. Fatkeqësisht, për vitin 2005 nuk u siguruan të dhëna statistikore.

PASTRIMI I PARAVE

Kodi Penal i “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” ka në Nenin 273, një përkufizim ligjor për pastrimin e parave dhe të ardhurave të krimit, si dhe një dispozitë të plotë për aktivitete të tilla penale. Për më tepër, Kodi Penal u ndryshua nga Neni 394-a në mënyrë që të mbulonte financimin e terrorizmit.

Bazuar në eksperiencat e nxjerra nga viti 1999 deri në vitin 2000 (5 çështje të kryera nga 9 persona me një shumë që arrinte në rreth 45 milion Dinarë Maqedonas), nga viti 2003 (1 çështje e kryer nga 1 person me një shumë që arrinte në 600 milion Dinarë Maqedonas) dhe nga viti 2005 (1 çështje e kryer nga 2 persona me një dëm që arrinte shumën 148 milion Dinarë Maqedonas) raportohet se në shumicën e rasteve që kemi të bëjmë me pastrim parash, shkelja e parashikuar duket të jetë në evazion fiskal, aktivitete të rreme dhe, në vitin 2005, “privilegjim i kontraktorëve”, “mashttrim i siguracioneve”, ose “evazion fiskal”. Pavarësisht përlllogaritjeve të mëdha të të ardhurave të krimeve të tjera, si trafikimi i drogës, imigracioni i jashtëligjshëm, ose trafikimi i qenieve njerëzore, nuk u dha ndonjë informacion rreth këtyre fushave të krimit.

²⁷³ Fletorja Zyrtare e “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” Nr 28/2002.

²⁷⁴ Fletorja Zyrtare e “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” Nr 83/2004.

²⁷⁵ Më në detaje në Këshillin e Evropës, GRECO, Raport mbi Vlerësimin e Dytë mbi “Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, Strasburg, 10-14 Tetor 2005 (www.greco.coe.int).

5 KONKLUZIONE

Krimi i organizuar është një koncept dinamik i cili është në përshtatje të vazhdueshme ndaj një ambientit që ndryshon dita ditës dhe ndaj mundësive të reja që ofrohen për krimin. Kjo është gjithashtu e vërtetë për krimin e organizuar në Evropën Jug – Lindore:

Rrugët tradicionale Ballkanike të trafikimit të drogës janë shndërruar në rrugë me dy kalime, në të cilat heroina dhe kanabisi lëvizin drejt BE-së, ndërkohë që perkursorët, kokaina dhe drogat sintetike po lëvizin në drejtim të lindjes. Në disa vende po vihet re një rritje e tregut të brendshëm së bashku me një rritje të numrit të përdoruesve. Është e nevojshme që të shtohen jo vetëm masat shtypëse të këtij fenomeni, por edhe masat parandaluese.

Bashkërendimi i përpjekjeve nga ana e organeve të zbatimit të ligjit dhe i masave rregulluese kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe transportimit klandestin të personave duket të ketë sjellë një ndryshim pozitiv për sa i përket zvogëlimit të numrit të personave të trafikuar përmes kufijve. Në të njëjtën kohë, trafikimi i qenieve njerëzore tani ka sjellë një sfidë të re për sa i përket trafikimit dhe rekrutimit të brendshëm, si dhe rritjes së klientelës vendase.

Gjithashtu po zhvillohet dhe krimi ekonomik, i cili ndikon seriozisht të gjitha vendet e rajonit. Heqja e sanksioneve ndaj Serbisë dhe shkatërrimi në vijim i kanaleve të kontrabandës së cigareve dhe karburantit, si dhe përpjekjet e tjera rregulluese nga ana e organeve të zbatimit të ligjit, ndikuan në mënyrë të dukshme në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave. Kështu, janë hequr disa mundësi për tregtinë e paligjshme në rajon. Por gjithsesi, mjaft mundësi të tjera vazhdojnë të mbeten. Falsifikimi i dokumenteve dhe kompanitë e rreme, – mjete kyçe që përdoren për evazion fiskal dhe pastrim parash, – duket të jenë të pranishme në të gjitha vendet e rajonit. Forma të tjera të krimit ekonomik, - të tilla si mashtrimet në prokurimet publike, privatizime dhe në sektorët financiarë, - mendohet të jenë në rritje dhe të vazhdojnë të ndikojnë në besimin publik në ekonominë e tregut dhe në sistemin e së drejtës penale.

Me maturimin e tregjeve të krimit, grupet kriminale përpiqen të konsolidojnë aktivitetet e tyre ekzistuese, të shpërndahen në aktivitete të tjera dhe të legalizojnë fitimet dhe pozicionet e tyre në shoqëri. Korrupsioni, si në nivel të ulët ashtu dhe në nivel të lartë, duket të jetë mjeti kryesor i përdorur për të depërtuar strukturat politike dhe ekonomike. Përpjekjet e fundit kundër korrupsionit në këto vende kanë shtuar numrin e hetimeve dhe proceseve penale por deri tani ka patur pak dënime. Fakti se shumica e vendeve kanë adoptuar tashmë strategji të hollësishme dhe shërbime anti - korrupsioni është mjaft premtues. Përpjekje të tilla mund të ndihmojnë në dëmtimin e lidhjeve midis krimit të organizuar dhe atij ekonomik me strukturat ligjore dhe publike.

Përveç disa karakteristikave të veçanta për çdo vend, problemet e lidhura me krimin e organizuar dhe atë ekonomik kanë një dimension rajonal. Si të tilla ato kanë nevojë për zgjidhje rajonale, të cilat gjithsesi duhet që të përfshijë dhe këndvështrimin e BE-së. Përafrimi ligjor, dhe nëse mundet dhe harmonizimi i tij, strategjitë, përpjekjet dhe aktivitetet e përbashkëta dhe të hartuara mirë të organeve të zbatimit të ligjit, si dhe shkëmbimi i informacionit policor në një nivel rajonal, duke përfshirë dhe Europol-in atje ku është e mundur dhe e përshtatshme, do të jenë kyç për luftimin e suksesshëm të krimeve të rënda në Evropën Jug – Lindore. Për këtë arsye, policimi në rajon i mbështetur në informacion duhet të ndërtohet mbi baza të forta duke krijuar sisteme të qëndrueshme të mbledhjes së informacionit dhe raportimit.

Megjithëse vendet e rajonit i kanë njohur efektet negative të krimeve të rënda mbi shoqëritë e tyre, akoma nuk është bërë i disponueshëm një vlerësim i humbjes së të ardhurave publike ndaj krimit ekonomik, ose përmasës së tregut vendas të drogës. Me disa përjashtime, sistemet e zbatimit të ligjit në rajon akoma nuk kanë kapacitet e nevojshme për mbledhjen e informacionit, analizimin dhe hetimin.

Duke patur parasysh se të ardhurat janë emëruesi i përbashkët i formave të ndryshme të krimit të organizuar dhe ekonomik, hetimet dhe informacionet financiare janë të domosdoshme për analizimin e këtyre krimeve. Vendet e rajonit kanë ngritur tashmë njësi të hetimit financiar dhe deri në një farë mase kanë filluar hetime financiare në lidhje me hetimet kriminale. Gjithsesi duhet që këto mjete të përdoren në mënyrë më sistematike.

Masat e zhvilluara nga vendet dhe zonat e rajonit brenda kuadrit të projektit rajonal të policisë CARPO do të ndihmojnë në kalimin e këtyre mangësive. Ato mund të përfshijnë:

- Forcimin e mbledhjes dhe analizimit të informacionit në mënyrë që të përmirësohet njohuria dhe kuptimi i fenomenit të krimit të organizuar dhe ekonomik në rajon. Në të ardhmen, kjo duhet të bëhet gjithashtu në fushat e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit.
- Ngritjen e statistikave kombëtare të krimit në nivelet e BE-së, përdorimin e termave dhe përkufizimeve të përbashkëta, ngritjen e një sistemi të përbashkët raportimi në përputhje me sistemin e përdorur nga Europol-i dhe në 25 Shtetet Anëtare të BE-së (ENFOPOL 35), duke i kushtuar vëmendjen e duhur sigurimit të niveleve të konfidencialitetit (përfshi zbatimin e instrumenteve ligjore Evropiane të lidhur me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave), përgatitjes së rregullt të Raporteve vjetore ose Vlerësimeve të Kërcënimit mbi Situatën e Krimit të Organizuar dhe Ekonomik, mjeteve të përbashkëta për matjen e krimit mbi nivelet ndër institucionale dhe midis juridiksioneve të ndryshme, studimeve mbi rrezikshmërinë e sektorit ekonomik dhe impaktit financiar të krimit të organizuar dhe ekonomik, bashkëpunimit të organeve të zbatimit të ligjit me studiuesit e pavarur dhe akademikët;
- Mekanizma të mbështetur në informacion me një përqsaje aktive për përcaktimin e politikave bazuar në vlerësime tërësore, strategji ose plane të hartuara veprimi, të shoqëruara me një bashkëpunim hetimor dhe bashkëndim real, të orientuar drejt objektivit dhe të prioritetizuar midis të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit të vendeve të rajonit. Kjo mund të ndjekë formulën: “Inteligjenca është informacion i përpunuar për veprimet që lidhen me zbatimin e ligjit” dhe mund të vihet në zbatim në mënyrë të ngjashme me instrumentin e BE-së “Ekip i Hetimit të Përbashkët”, por duhet të jepet një formë e orientuar më shumë drejt praktikës dhe të evitohet pengesat legjislative dhe burokratike, duke ndjekur “modelin e grupit në objektiv” të zhvilluar nga Europol-i, si dhe duhet të përfshijë policinë, policinë kufitare, doganat dhe shërbime të tjera të specializuara të zbatimit të ligjit. Gjithashtu duhet të ndërtohet një bashkëpunim më i ngushtë me Shtetet Anëtare të BE-së dhe me vendet e tjera, veçanërisht duke shfrytëzuar Ambasadat (Atashetë e Policisë dhe Ekspertët), Europol-in (rrjetin e Oficerëve Ndërlidhës të BE-së), Frontex-in (akoma në zhvillim), Interpol-in (NCB), Qendrën SECI (pikat kombëtare), Grupet e Punës për këto Çështje dhe, sa herë që të jetë e mundur ligjërisht dhe e përshtatshme, Eurojust-in dhe/ose OLAF-in (si vëzhgues, pjesëmarrës, mbështetës);
- Përforcimin e aftësive hetuese në fushat e krimit të organizuar dhe ekonomik. Kjo mund të përfshijë përpjekje të mëdha për të mposhtur pengesat gjuhësore, nëpërmjet një trajnimi të përshtatshëm gjuhësor të oficerëve të zbatimit të ligjit. Përdorimin e teknikave speciale të hetimit, aksioneve të fshehta, inteligjencës njerëzore, sistemeve të monitorimit për kimikatet e nevojshme si lëndë e parë për prodhimin e drogës, makinave tableto, mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, inteligjencës financiare, sekuestrimin e të ardhurave të jashtëligjshme të krimit, ose metoda të tjera specifike pune, p.sh. Operacioneve me Ndikim të Lartë (HIO), përqsaje mbarë-sektoriale duke u përqendruar në fusha parësore (SWAP), procedura standarde funksionimi (SOP);
- Monitorimi në mënyrë sistematike i efektshmërisë së masave për parandalimin dhe kontrollin e krimit të organizuar dhe ekonomik. Kjo mund të mos përfshijë vetëm vlerësimin përfundimtar të projekteve CARDS, duke përfshirë projektin CARPO dhe projekte të tjera që janë në zbatim²⁷⁶. Mund të jetë e vlefshme qenë të ardhmen, sa herë që të jetë e nevojshme, të kryhet një analizë kostoje/përfitimimi dhe një studim për të analizuar se cila hapësirë rajonale dhe projekt po funksionon mirë, me ritmet e homologëve nga rajoni. Janë krijuar mundësi, por ato duhet që të shfrytëzohen më shume në mënyrë që të kthehen në realitet. Krijimi i komiteteve rajonale dhe kombëtare, të përbëra nga përfaqësues të organeve kryesore mbështetëse ndërkombëtare dhe të homologëve lokalë, mund të ri-forcojë më tej kërkesën për sinergji dhe reduktim kostoje;
- Ratifikimi dhe zbatimi i plotë i instrumenteve Evropiane do të ndihmonte vendet e projektit që të avancojnë në këtë drejtim dhe të lehtësonin bashkëpunimin ndërkombëtar. Këto përfshijnë në veçanti Protokollin e

²⁷⁶ P.Sh. MOLI-MK, PACO-Serbia ose PACO-Impact.

dyte Shtesë mbi Asistencën Reciproke në Çështje Penale (CETS 182), Konventën mbi Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave të Krimit dhe mbi Financimin e Terrorizmit (CETS 198) dhe Konventën e re mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS 197). Gjithsesi, për vendet e projektit do të jetë gjithashtu me një rëndësi të madhe dhe adoptimi dhe zbatimi i standardeve dhe rregulloreve të Këshillit të Evropës dhe BE-së, veçanërisht instrumenteve ligjore mbi privatësinë, legjislacionin e përshtatshëm për mbrojtjen e të dhënave, si dhe direktivat e tjera të BE-së për të forcuar pronësinë e tyre mbi gjithë procesin, për të rritur besueshmërinë dhe interesin dhe për të arritur një marrëveshje operationale me Europol-in. Kjo do të shtronte më tej rrugën për një anëtarësim të ardhshëm në BE dhe do të ndihmonte në mbylljen e boshllëqeve në arkitekturën e sigurisë Evropiane.

6 BIBLIOGRAFIA

Amnesty International:

Kosova (Serbia & Mali i Zi) – “A do të thotë kjo që unë kam të drejta?” – Mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave të trafikuar për prostitucion në Kosovë, Londër, 2004

Gratë dhe vajzat e trafikuar në Kosovë kanë të drejta njerëzore, Botim shtypi, 5 Qershor 2004 (<http://news.amnesty.org/mavp/news.nsf/print/ENGEUR700122004>)

Kosovë: Paqeruajtësit ndërkombëtare mbajnë ndezur shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe mizorinë njerëzore, 6 Maj 2004.

Begovic Boris, Mijatovic, Bosko, dhe Hiber Dragor: *Korrupsioni ne Gjyqësor, Qendra e Studimeve Liberale – Demokratike*, Beograd 2004, <http://www.clds.org.yu>

Bosnja dhe Hercegovina, Ministria e Sigurimit: *Raport mbi Sigurinë: Tre – mujori i parë*, 2004

Korporata e Transmetimit Britanik (BBC, <http://news.bbc.co.uk>):

Trupat e OKB-se në Kosovë ‘mbajnë ndezur tregtinë e seksit’, 5 Qershor 2004, news.bbc.co.uk/go/pr/fr/-/2/hi/europe/3686173.stm

Krimi ekonomik ‘kushton 40 miliard paund britanik’, 17 Tetor 2004

Ashdown shkarkon liderin e Boshnjakëve Kroatë, 29 Mars 2005,

www.newsbbc.co.uk/1/hi/world/Europe/4390635.stm.

Black, C./Van der Beken, T./Frans, B./Paternotte, M. (2001): *Raportim mbi krimin e organizuar. Një zhvendosje nga përshkrimi në shpjegim në Raportin Vjetor Belg mbi Krimin e Organizuar*, Antwerp, Maklu.

Projekti Blue Bird (Axehtë për Shoqërinë Civile në Evropën Jug - Lindore: *Në kërkim të një Qeverie Reaguese: Ndërtimi i Shtetit dhe Rritja Ekonomike në Ballkan*, Qendra për Studimin e Politikave, Central European University, 2003 (www.cls-sofia.org))

Capps, Robert: *Jashtë ligjit dhe ‘Fryrësit e bilibilit’ skllavë - seksi të mbrojtur*, nga Korriku dhe Gushti 2002, www.salon.com.

Castells, M. (2003²): *Ngritja e Shoqërisë në Rrjet*. Malden/Oxford/Victoria.

Qendra për studimin e Demokracisë (www.csd.bg/publications.php)

Korrupsioni, Kontrabanda dhe Krimi i organizuar ne Evropën Jug - Lindore, Sofje, 2003

Tregu i drogës në Bullgari, Sofje, 2003

Bashkëpunëtorë në krim: Rreziku i simbiozës midis sektorit të sigurimit dhe krimin të organizuar në Evropën Jug - Lindore, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofje, 2004

Transporti, Kontrabanda dhe Krimi i Organizuar, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofje, 2004

Tendencat e krimin në Bullgari: Statistikat e policisë dhe anketat viktimizuese, Qendra për studimin e Demokracisë, Sofje, 2005

Chossudovsky, Michel: *Shefi i OKB-se fajëson pjesërisht shtetet e BE-së për dështimin në pengimin e rritjes së trafikimit në Evropën Jug - Lindore*, 26 Korrik 2002, Qendra për Kërkime mbi Globalizimin, www.globalresearch.ca

Këshilli i Evropës:

Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Korrupsioni (Programi PACO, TP 28 rev), Strasburg, 2002

Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Reforma e Legjislacionit Penal në Evropën Jug-Lindore, Projekti “LARA”, Zagreb, Prill 2003.

Raporti i situatës mbi Krimin e Organizuar, 2004 - Fokusi: Kërcënimi i krimin elektronik, Strasburg, 2005

Raporti i situatës mbi Krimin e Organizuar, 2004 - Fokusi: Kërcënimi i krimin ekonomik, Strasburg, Dhjetor 2005

Këshilli i Bashkimit Evropian / Grupi Ndër – Disiplinor mbi Krimin e Organizuar (2003): *Kontrabanda e produkteve të duhanit në Bashkimin Evropian dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar*. Bruksel (CRIMORG 90).

Komisioni Evropian:

Opinion mbi Aplikimin e Kroacisë për Anëtarësim në Bashkimin Evropian: Komunikatë nga Komisioni, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 20 Prill 2004

Raporti mbi Situatën CARPO

Procesi i Stabilizimit Asociimit për Evropën Jug – Lindore: *Raporti i Tretë Vjetor*, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 2004

Delegacioni i KE-se ne Bosnje Hercegovinë: *Mashtrim i mundshëm i sheqerit*, Botim shtypi, Sarajevë, 2 Gusht 2004, <http://www.delbih.cec.eu.int/en/worddocuments/word271.htm>

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga (EMCDDA):

Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës në Bashkimin Evropian dhe Norvegji, Lisbonë, 2003

Raporti Vjetor 2003: Situata e problemit të drogës ne vendet hyrëse dhe kandidatë të Bashkimit Evropian. Lisbonë, Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga.

Iniciativa Evropiane e Stabilitetit (www.esiweb.org):

Momenti i Helsinkit: Ndërtimi i Shteteve Anëtare Evropiane në Ballkan, 1 Shkurt 2005

Ç'industrializimi dhe pasojat e tij: Një histori Kosovare, Mars 2002

EUROPOL:

(www.europol.eu.int)

Raporti i Bashkimit Evropian mbi Krimin e Organizuar, Dhjetor 2004,

Raporti i Bashkimit Evropian mbi Krimin e Organizuar, Tetor 2005,

Trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual në BE: Një këndvështrim i Europol-it, Janar 2006, (www.europol.eu.int)

Vlerësimi i Kërcënimit të Bashkimit Evropian për Krimin e Organizuar, (OCTA) 2006

Krimet e lidhura me kompjuterin brenda BE-së: Krime të vjetra, mjete të reja; krime të reja, mjete të reja, (2002), Hagë.

Niveli i Bashkimit, Sirakuzë/Itali, Maj 2005.

Financial Times: *Sondazh mbi rolin e Malit të Zi në tregtinë e jashtëligjshme të cigareve*, 9 Gusht 2001;

FOCUS:

"Fauler Geschmack", raport mbi kontrabandën e duhanit dhe prodhimit të jashtëligjshëm të cigareve në Gjermani, Nr. 20, Maj 2006

"Weiße Lawine", raport mbi sekuestrimet e kokainës në **Bashkimin Evropian**, Nr. 27, Korrik 2006

FIJNAUT, Cyrille dhe Letezia Paoli, *Krimi i Organizuar në Evropë, Konceptet, Modelet dhe Politikat e Kontrollit në Bashkimin Evropian e më tej*, Studime të Kriminologjisë të Organizuar, edituar nga Springer, Doordrecht/ Holandë, Shtator 2004

HINA (Agjencia Kroate e Lajmeve): *Punonjësi i administratës shtetërore në Makarska nën hetim*, Lista Jutarnji, 12 Maj 2005.

Human Rights Watch: *Shpresat e tradhtuara: Trafikimi i grave dhe vajzave ne Bosnje Hercegovinën e mbas luftës për prostitucion të detyruar*, Vol 14, Nr. 9, Nëntor 2002.

Huremagic, Ramiz: *Trajtimi i "Fantazma": Krimi i Organizuar dhe Kontrolli i tij*, Tema e Studimeve pas universitare për M.Sc në Kriminologji dhe Sistemin e Drejtësisë Penale, Universiteti i Wellsit, Cardiff, Shtator 2001 (i pa publikuar)

Komisioni Ndërkombëtar mbi Ballkanin: *Ballkani në të ardhmen e Evropës*, Prill 2005, www.balkan-commission.org

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM):

Modelet dhe Tendencat në ndryshim të trafikimit të personave në rajonin e Ballkanit: Vlerësim i bërë në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Provincën e Kosovës (Serbia, Mali i Zi), "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" dhe Republika e Moldovës, Korrik 2004, www.iom.int

Grupi Ndërkombëtar i Krizave:

Serbia: Rrotullimi i rrotave të saj, Njoftim i përditësuar, Njoftim i Evropës Nr. 39, 23 Maj 2005, Beograd/Bruksel, www.crisisgroup.org

Kthesa në vend e Serbisë, Raporti Evropës N°154, 26 Mars 2004, www.crisisgroup.org

Raporti Ndërkombëtar i Luftës dhe Paqes (IWPR, www.iwpr.net)

Jovanovska, Svetlana: *BE mendon për një marrëveshje të re ndihme për Ballkanin*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005

Barnett, Neil: *Raketat e sekuestruara në Shqipëri*, IWPR, Nr. 533, 16 Dhjetor 2004

Raporti mbi Situatën CARPO

- Musta, Suela: *Nano pyetet në lidhje me paditë mbi kontrabandën e armëve*, IWPR, Nr. 528, 19 Nëntor 2004
- Ahmetasevic, Nidzara: *Opozita Boshnjake kërkon ligje anti - korrupsion*, IWPR, Nr 552, 15 Prill 2005
- Jelacic, Nerma: *Hetuesit e mafias nën sulm*, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Lasica, Natalija: *Bosnja lufton me valën e varësisë nga droga*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: *Hetuesit e mafias nën sulm*, IWPR, Nr. 542, 18 Shkurt 2005
- Jelacic, Nerma dhe Griffiths, Hugh: *A do të përballohet Evropa me Mafien e Bosnjës?*, (IWPR), Nr. 531, 2 Dhjetor 2004
- Jelacic, Nerma: *Përhapjet e Eksplozivëve*, IWPR, Nr. 458, 05 Shtator 2003
- Papic, Srdjan: *Kontrabandistët e Bosnje Hercegovinës gjejnë rrugë për të anashkuar shtrëngimet e kufirit*, IWPR, Nr 425, 25 Prill 2003
- Radic, Renata: *Shpenzimet e larta të liderëve Boshnjakë përçajnë buxhetin*, IWPR, Nr. 511, 12 Gusht 2004
- Anna McTaggart dhe Drago Hedl: *Kroacia: Një punë në vazhdim*, IWPR Nr. 562, 27 Qershor 2005
- Dimovski, Sase: *Gjykatat Malazeze, Serbe në krizë*, IWPR, Nr. 437, 13 Qershor 2003
- Hajrullahu, M., Salihu, A., Xharra, J.: *Perëndimi i egër i Kosovës*, IWPR, Nr 542, 18 Shkurt 2005
- Xharra, Arbana: *Gangsterët dhe burokracitë pengojnë Investitorët e Kosovës*, IWPR, Nr. 550, 6 Prill 2005
- Sullivan, Stacy: *Raport Special: A i ka mbushur standardet Kosova?*, IWPR, Nr. 549, 1 Prill 2005
- Sunter, Daniel: *Policia merr në kontroll kufijtë e Serbisë*, IWPR, Nr 543, 25 Shkurt 2005
- Sunter, Daniel: *Shkarkimi i shefit të policisë shikohet si "pastrim"*, IWPR, Nr. 512, 20 Gusht 2004
- Cvijanovic, Zeljko: *Drita jeshile e BE-se do të siguronte një qeveri reaguese*, IWPR, Nr. 548, 23 Mars 2005
- Simpson, John dhe Bojovic, Zelimir: *Serbia humb luftën me korrupsionin doganor*, IWPR, Nr. 541, 11 Shkurt 2005
- Serbia: *BE-ja mund të zgjasë ndalimin e sheqerit*, IWPR Nr. 445, 18 Korrik 2003
- Joosens, Luk/Raw, Martin (1998): *'Kontrabanda e cigareve në Evropë: Kush përfiton në të vërtetë?'* Në: *Kontrolli i duhanit 1998* (7) 66-71.
- Kleinfeld Belton, Rachel: *Përkufizime konkurruese të shtetit të së drejtës: Implikime për Praktikuesit, Esetë e Carnegie-t, Seritë e Shtetit të së Drejtës, Ndihma e Carnegie-t për Paqen Ndërkombëtare*, Nr. 55, Janar 2005 (www.ceip.org/files/projects/dlr/dlr_home_121002.ASP)
- Krastev Ivan: *Retorika anti - korrupsion dhe reformat e politikave*, Qendra për Strategjitë Liberale, 1997 (www.cls-sofia.org)
- Morrison, J. (1992): *'Skanimi mjedisor'*, në M. Whitely et al (eds.): *Një guitë për Studiuesit e rinj institucionalë*, Tallahassee, Shoqata për Kërkime Institucionale.
- Shërbimi Kombëtar Informativ për Krimin (NCIS): *Vlerësimi i Kërcënimit i Mbretërisë së Bashkuar: Kërcënimi nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar*, 2003, www.ncis.gov.uk
- Nelken, D. (2002): *Krimi i kravatave të bardha*. Në: Maguire et al., 844-876.
- Nolic-Ristanovic, V. et al (2004): *Trafikimi i personave në Serbi. Beograd* (Shoqëria e Viktimologjisë në Serbi dhe OSBE).
- Obradovic, Vladimir: *Trafikimi i grave në Bosnje Hercegovinë*, Fakulteti i Qendrës për Kërkime në Kriminologji, Universiteti i Sarajevës, Sarajevë, Janar 2004
- OLAF (Zyra Anti - Mashtrim e Bashkimit Evropian, europa.eu.int/olaf):
Olaf jep fakte në gjyqin e "Lidhjes Malazeze" për përfshirjen në trafikimin ndërkombëtar të cigareve, Botim për shtyp OLAF/12/2003, 30 Prill 2003,
Hetimi i Olaf-it në importin e sheqerit nga rajoni i Ballkanit, OLAF/15/2003, 29 Maj 2003,
- Instituti i Shoqërisë së Hapur (www.eumap.org):
Monitorimi i procesit të anëtarësimit në BE: Politika e korrupsionit dhe anti - korrupsionit, OSI, 2002
Monitorimi i procesit të futjes në BE: Kapaciteti gjyqësor, OSI, 2002
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (www.osce.org):

Raporti mbi Situatën CARPO

Raporti i Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në vizitën e tyre në Podgoricë (Mali i Zi, Serbi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, raporti i përbashkët i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Këshillit të Evropës, 3 Shtator 2003

Qëndrimi dhe Konkluzioni i qeverisë së Malit të Zi në lidhje me Raportin e Ekspertëve të pavarur për Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës në vizitën e tyre në Podgoricë (Mali i Zi, Serbi) nga 22 deri më 24 Korrik 2003, Qeveria e Malit të Zi, 16 Tetor 2003.

Komisioni për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, Raporti përfundimtar mbi punën e Komisionit për ristrukturimin e policisë së Bosnje Hercegovinës, , Dhjetor 2004 (www.ohr.int/ohr-dept/rule-of-law-pillar/prc/)

Radio Evropa e Lirë: Mali i Zi: Kryeministri mohon akuzat për kontrabandë cigaresh, 7 Nëntor 2003

Zyra Ndërlidhëse Informativë Rajonale për Evropën Perëndimore - RILO (2001): LASSO 2000 – Përmbledhje mbi Kontrabandën e cigareve në Evropë, Cologne/Rotterdam.

Save the Children, Mbretëria e Bashkuar (Programi i Serbisë) 2004: Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore. Beograd.

Savona, Ernesto U. dhe Curtol, Federica: Kontributi i Sistemit të shkëmbimit të të dhënave në Luftën kundër krimit të organizuar në vendet e Evropës Jug – Lindore: Raporti Përfundimtar, Krimi ndërkombëtar (Qendra e Studimeve të Përbashkëta mbi Krimin Ndërkombëtar e Universitë Degli Studi di Trento dhe Universitë Cattolica Del Sacro Cuore), Nëntor 2004, www.transcrime.unitt.it

Skrozza, Tamara: Intervju - Verica Barać: Vlada je centar korupcije, Vreme Nr. 748, 5 Maj 2005, www.vreme.com

Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug – Lindore: Raporti i Parë Vjetor mbi Viktimat e Trafikimit në Evropën Jug Lindore, Task Forca e Paktit të Stabilitetit mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Shtator 2003

TRANSCRIME, Qendra e Kërkimit mbi Krimin Ndërkombëtar në Universitetin e Trentos, Janar 2003 “Situata e Krimit të organizuar në vendet e Evropës Jug-Lindore dhe Aktivitetet e Jashtëligjshme të kryera nga grupet e kriminelëve të organizuar”, një vlerësim i Paktit të Stabilitetit, të kryer nga

Transparenca Ndërkombëtare:

Raporti Global mbi Korrupsionin, 2005: Korrupsioni në ndërtimin dhe rindërtimin e mbas luftës, Transparenca Ndërkombëtare, (www.globalcorruptionreport.org)

Tisné, Martin, dhe Smilov, Daniel: Nga toka sipër: Vlerësimi i Rekordit të Ndihmës Anti – Korrupsion ne Evropën Jug - Lindore, Qendra për Studimin e Politikave, Central European University, Rrjeti i Fondacionit Sorros, 2004

Anti - Korrupsioni në Evropën Jug – Lindore: Hapat e para dhe politikat, Qendra për Studimin e Demokracisë, Iniciativa Evropës Jug – Lindore për Zhvillimin Ligjor (SELDI), 2002,

Kombet e Bashkuara (UN):

UNMIK Trafikimi dhe Njësitë e Prokurorisë (TPIU): Raporti i fundit të vitit 2003

Trafikimi i qenieve njerëzore në Evropën Jug – Lindore, Raporti i përbashkët me UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Nëntor 2003

Trafikimi i qenieve njerëzore në Evropën Jug – Lindore: 2004 – Përqendrimi në parandalim, raport i përbashkët i UNICEF, UNOHCHR, dhe OSBE/ODIHR, Mars 2005

UNODC (www.unodc.org)

Raporti Botëror i Drogës, 2004, Vjenë

Drogat dhe tendencat e krimit në Evropë e më tej, 2004 (a), Vjenë.

Sondazhi i shtatë i Kombeve të Bashkuara për tendencat e krimit dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, duke mbuluar periudhën 1998 – 2000, Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin / Qendra për Parandalimin e Krimit Ndërkombëtar, 2002, Vjenë.

Raporti mbi Situatën CARPO

Departamenti i Shtetit Amerikan: *Raporti i Trafikimit të Personave, Zyra për Monitorimin dhe Luftimin e Trafikimit të Personave*, 14 Qershor 2004, (www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2004)

Vander Beken, Tom: *Matja e Krimit të Organizuar në Evropë: Një studim i realizueshmërisë së një metodologjie të bazuar në rrezikun nga krimi i organizuar në Bashkimin Evropian*, Instituti për Studime Ndërkombëtare dhe Politika Kriminale, Universiteti Ghent, Publikuesit Maklu, 2004

Von Lampe, Klaus (2001) *Tregu i jashtëligjshëm i cigareve në Gjermani: Një studim i një çështjeje të krimit të organizuar* (Ese e prezantuar në takim të parë vjetor të Shoqërisë së Kriminologjisë Evropiane, Lausanne, Zvicër, 6 Shtator 2001).

Xenakis, Sappho: *Sfida e krimit të organizuar ndaj sovranitetit shtetëror në Ballkan, Një përfaqje historike*, 7 Janar 2001, www.ksg.harvard.edu/kokkalis/GSW3/Sappho_Xenakis.pdf

7 SHKURTIMET DHE AKRONIMET

ABA CEELI	Shoqata Amerikane e Avokatisë dhe Nisma Ligjore e Evropës Qendrore dhe Lindore
AFCOS	Strukturat Koordinuese Kundër Mashtrimit
AHTU	Njësia kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore e UNODC
AI	Amnistia Ndërkombëtare
AIDS	Sindroma e Përfiturar Imuno-Deficite
AISI	Nisma Detare e Adriatikut dhe Jonit
ARQ	Pyetësorët e Raporteve Vjetore
ATS	Simulantët e Llojit të amfetaminave
BiH (BIH)	Bosnje dhe Hercegovina
BUMAD	Programi i Asistencës së BE-së për Parandalimin e abuzimit me drogën dhe trafikimit të saj në Belarus, Ukrainë dhe Moldavi.
BSCE	Nisma Bashkëpunimit të Detit të Zi
CADAP	Programi Aksionit të Drogës së Azisë Qendrore të Bashkimit Evropian
CAN	Rrjeti i Analizës Kriminale
CARDS	Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet (KE)
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave
CEE	Evropa Qendrore dhe Lindore
CEI	Nisma e Evropës Qendrore
CEPOL	Kolegji i Policisë Evropiane
CIA	Agjencia Qendrore e Informacionit
CIDA	Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit Kanadeze
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura
CIVPOL	Njësia e Policisë Civile të UNMIK-ut
CNPA	Policia Anti Narkotike e Afganistanit
COE	Këshilli i Evropës
CRC	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
CPI	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
DAS	Asistencë e drejtpërdrejtë e viktimave të trafikimit
DFID	Departamenti Britanik Për Zhvillimin Ndërkombëtar
DG	Drejtoria e Përgjithshme (KE)
DOC	Departamenti i Krimit të Organizuar
DOS	Mohim i Shërbimit
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
EUFOR	Forca e Bashkimit Evropian në Bosnje dhe Hercegovinë
EURODAC	Baza e të dhënave të BE-së për azil kërkuesit
EUROPOL	Zyra e Policisë Evropiane
EUROJUST	Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin Gjyqësor
ELCS	Sistemi i Europol-it për etiketimin e kokainës
EPLN	Rrjeti Evropian i Mësimit Policor
EMDCCA	Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogës
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FIU	Njësia e Inteligjencës Financiare
FIC	Qendra e Informacionit Financiar
FRONTEX	Kufijtë e Jashtëm, (ligjërisht: Agjencia e Bashkimit Evropian për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian)
FSRB	Organ rajonal i ngjashëm me FATF
GAP	Programi i Vlerësimit Global
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GPAT	Programi Global kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
GPO	Zyra e Prokurorisë së Përgjithshme

GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
HAART	Terapia Shumë Aktive Antiretrovirale
HDI	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
HIO	Operacionet me Ndikim të Lartë
HINA	Agjencia Kroate e Lajmeve
HOPS	Projekti i Opsionit të Shëndetshëm, Shkup
HIV	Virusi Imuno - Deficit Njerëzor
IDI	Indeksi i Drogave të Jashtëligjshme
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës Trajnuese për Hetimet Penale
ICMC	Komisioni Ndërkombëtar Katolik për Migrimin
ICMPD	Politika e Zhvillimit e Qendrës Ndërkombëtare për Migrimin
ICS	Sindikata Italiane e Solidaritetit
ICTY	Gjykata Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish - Jugosllavi
IIPM	Misioni Policor Italian - Interforze
IHRLG	Grupi Ligjor i të Drejtave Ndërkombëtare të Njeriut
ILO	Oficer Ndërlidhës Emigracioni (Rrjeti i BE-së)
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ILO-IPEC	Programi Ndërkombëtar i ILO-s për Eliminimin e Punësimit të Fëmijëve
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
IPO	Oficer Ndërkombëtar Policie
IREX	Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime
ISS	Shërbimet Sociale Ndërkombëtare
KFOR	Forca e Kosovës (Forcë e udhëhequr nga NATO)
KLA	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPS	Shërbimi i Policisë së Kosovës
LPO	Oficerët Lokalë të Projektit të Këshillit të Evropës CARPO
MAPE	Element Shumë Kombësh Këshillues i Policisë
MARRI	Nisma e Paktit të Stabilitetit për Migracionin, Azilin, Refugjatët dhe Ri-atdhesimin
MoI (MOI)	Ministria e Brendshme
MOJ	Ministria e Drejtësisë
ML/TF	Pastrim i Parave/Financim i Terrorizmit
MONEYVAL	Komiteti i Zgjedhur i Ekspertëve të Këshillit të Evropës mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave
MOU	Memorandum Mirëkuptimi
NCB	Byroja Qendrore Kombëtare (Interpol)
NGO	Organizatë jo-Qeveritare
NHDR	Raport i Zhvillimit Kombëtar Njerëzor (UNDP)
NPA	Plani Kombëtar i Veprimit
NPO	Organizatë jo Fitimprurëse
NRM	Raportuesi Kombëtar Holandez kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
OCTA	Vlerësim i Kërcënimit nga Krimi i Organizuar
OHR	Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnje dhe Hercegovinë
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OLAF	Zyra e Bashkimit Evropian kundër Mashtrimit
OPDAT	Zyra e Jashtme e Asistencës dhe Trajnimit për Zhvillimin e Prokurorisë
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSCE/CPE	Qendra e OSBE-së për parandalimin e krimit
OSCE/ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
PAMECA	Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Evropian në Shqipëri
PCU	Njësia e Kontrollit të Perkursorëve
PMI	Philip Morris Ndërkombëtar
PRSP	Dokumentet Strategjike për Zvogëlimin e Varfërisë

PNI	Rrjeti i Kombeve të Bashkuara të Parandalimit të Krimit dhe Programit të së Drejtës Penale
SALW	Armë të vogla dhe të lehta
SAA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SAP	Procesi i Stabilizim Asociimit BE - Ballkani Perëndimor
SCF	Fondi Shpëto Fëmijët
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECI	Nisma Jug Lindore e Bashkëpunimit
SEE	Evropa Jug - Lindore
SEEPAG	Grupi Këshillimit të Prokurorëve të Evropës Jug - Lindore
SEESAC	Shtëpia e pastrimit të Evropës Jug - Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta
SELDI	Nisma e Zhvillimit Ligjor të Evropës Jug - Lindore
SIPA	Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (Bosnje dhe Hercegovinë)
SIDA	Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SOP	Procedurat Standarde të Veprimit
SP	Pakti i Stabilitetit
SPMU	Njësia e Çështjeve Policore Strategjike OSBE
SPOC	Nisma e Paktit të Stabilitetit për Krimin e Organizuar
SPTF	Task Forca e Paktit të Stabilitetit për Trafikimin
STI	Infeksion Seksualisht i Transmetueshëm
STR	Transaksion i Dyshimtë
SWAP	Përqasje Mbarë-Sektoriale
TAXUD	Unioni i Taksave dhe Doganave (Komisioni Evropian)
TI	Transparenca Ndërkombëtare
TIP	Njësia e Trafikimit të Personave e Departamentit të Shtetit Amerikan
THB	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
THC	Tetrahidrokanabinol
THBS	Shërbimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Kosova)
TPIU	Njësia e Hetimit të Trafikimit dhe Prostitucionit (Kosova)
TRANSCRIME	Qendra Kërkimore mbi Krimin Ndërkombëtar në Universitetin e Trentos
UN	Kombet e Bashkuara
UNAIDS	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara mbi HIV/AIDS
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
UNICEF	Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara
UNICRI	Instituti Ndër-Rajonal i Kombeve të Bashkuara për Kërkime Mbi Krimin dhe Drejtësinë
UNIFEM	Fondi i Zhvillimit për Gratë i Kombeve të Bashkuara
UNINCB	Bordi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Narkotikëve
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara për Administrim të Ndërmjetëm në Kosovë
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNOHCHR	Zyra e Kombeve të Bashkuara e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndër-kombëtar
VAT	Tatim mbi Vlerën e Shtuar
VOICE	Grupi i Punës ad-hoc i 40+ OJQ-ve aktive në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore
WODC	Qendra e Kërkimeve dhe Dokumentacionit (Qendra Holandeze e njohurive në fushat e drejtësisë)